

NIJAZI RAMADANI

**SHTEGTIM NË HISTORI
(RRËFIMI PËR KOKAJT 1842- 2012)
(MONOGRAFIA)**



RRJEDHA

KOKAJ¹ - NJË VENDBANIM NË MALËSINË E KARADAKUT TË SHKUPIT - MALET E KARADAKU (MALËT E ZEZA) - KOKAJT ME RRETHINË²

Malet e Karadaku, (Malet e Zeza) , e që në shumicën e rasteve njihet si Karadaku i Shkupit, shtrihet nga Gryka e Karadakut, gjegjësisht nga Lumi Llapushnicë në lindje Letnicë në perëndim e deri te Gryka e Konçulit te lumi Morava e Binçës në juglindje, me një gjatësi rreth 50 km dhe ndërmjet Anës Moravës në veri, Lugina e Preshevës në juglindje dhe fushës së Shkupit në jug. Struktura e relievit është mjaft e copëtuar. Këtë e bëjnë luginat e lumenjve si pjesë më të ulëta dhe majet e maleve si pjesë më të larta të relievit. Sendimentet reja në pjesën perëndimore, mesozoike, në pjesën e mesme dhe ato të vjetra të paleozoikut në lindje

¹ Kokaj është katund i komunës së Gjilanit, 18 km. larg tij, i shtrirë në Karadak. Ky vendbanim ka emërtime të ndryshme nga pushteti administrativ serb. Është një emër i ri i quajtur Inatoc për shqiptarët dhe emër tjetër Renatoc për muhaxhirët e Kokajve. Deri më 1999 ka pasur 15 shtëpi, kurse tani janë 4-5 sosh. Janë dy lagje: e Epërmja e dhe e Poshtmja. Është një shkollë katërklasëshe e quajtur “Liria”, një paralele e ndarë e Pogragjës.* (<http://www.klaiqi.com/libri>, shtegtime rrugëve të ngrira, R.Klaiqi).

¹ Kokaj është katund i komunës së Gjilanit, 18 km. larg tij, i shtrirë në Karadak. Ky vendbanim ka emërtime të ndryshme nga pushteti administrativ serb. Është një emër i ri i quajtur Inatoc për shqiptarët dhe emër tjetër Renatoc për muhaxhirët e Kokajve. Deri më 1999 ka pasur 15 shtëpi, kurse tani janë 4-5 sosh. Janë dy lagje: e Epërmja e dhe e Poshtmja. Është një shkollë katërklasëshe e quajtur “Liria”, një paralele e ndarë e Pogragjës.*Ismail Idriz Koka.

² Kokajt gravitojnë kah qyteti i Gjilani, qendër kazaje në sanxhakun e Prishtinës të vilajetit të Kosovës pranë një lumit që derdhet në Moravë. Sipas Sami Frashërit, ky qytet ndodhet 35 km në juglindje të Prishtinës, e cila ka 4500 banor. Gjilani ka 2 xhami, 1 kishë, 2 shkolla fillore. Kazaja e Gjilanit kufizohet nga juglindja me kazanë e Prishtinës, në veriperëndim me sanxhakun e Shkupit dhe në verilindje me Serbinë. Së bashku kazaja ka rreth 190 fshatra me 30000 banor. Në territorin e saj shtrihen fushat pjellore dhe e rrethuara me vargmale të Malit të Zi (Karadakut) që përbën kufirin juglindor, në kufirin me Serbinë gjendet mali Goljak (Gollaku), kurse në anën perëndimore shtrihen malet e Zagovcit (Zhegocit) dhe Koniça. Nga këto male zbresin lumenjtë që formojnë Moravën dhe nëpër kazanë e Gjilanit zbret në Serbi ku derdhet në Detin e Zi. Kjo kaza është e njohur për ujëra minerale dhe për disa kisha e kala e sidomos për kalanë e Novobërdës e cila gjendet në pjesën veriore të kazasë. Pra, Gjilani zuri një vend të rëndësishëm më enciklopedinë e njohur dhe të parën nga një autor shqiptar siç ishte Sami Frashëri.? *Përshkrimi i Gjilanit sipas enciklopedisë Kâmûs Al – a’Lâm /2online/*


tregojnë një lloj-llojshmëri në ndërtimin gjeologjik. Në formimin e relievit kanë ndikuar rrjedhat e lumenjve që kësaj pjese i kanë dhënë një pamje të copëtuar. Ato, duke zbritur prej viseve të larta, kanë thelluar shtratin e tyre, me vete kanë bartur material të eroduar. Lumenjtë më të rëndësishëm të kësaj krahine janë: Golemareka, Letnica, Karadaku, Llashtica, Pasjani, Llapushnica etj. Të gjithë këta derdhen në Moravën e Binçës. Relievi i lartë i kësaj zone pengon depërtimin e masave të nxehta të jugut, ndërsa ndaj veriut është e hapët. Zonën e Karadaket të Shku-pit e përshkon izoterma e vjetore 9°C e 10°C, kurse reshjet mesatare vjetore janë midis 700 e 800 mm. Kushtet e tilla natyrore janë shprehur në fizionominë e peizazhit. Sipërfaqet më të mëdha janë pyje, duke përfshirë më se gjysmën e territorit të trevës. Sipërfaqet me ara përfshijnë 31% të territorit dhe janë për gjysmë më të vogla se në Drenicë. Kullotat dhe livadhet përfshijnë rreth 11 % të sipërfaqeve të tokave. Një strukturë e tillë e tokave ka kushtëzuar që popullsia të merret me shfrytëzimin e tokave punuese dhe sipërfaqeve me pyje. Blegtoaria, për shkak të bazës ushqyese të vogël, është më e kufizuar. Janë male të larta prej 700 - 1.500 m. Pikat më të larta të këtyre maleve janë: Maja e Kopilaqës me 1.490 metra lartësi, Maja e Zeza me 1.219 metra lartësi dhe Maja Topan me 1.178 metra lartësi. Malet e Karadaket përfshijnë një sipërfaqe prej 389 km² dhe është e banuar me afro 50 000 banorë, përkatësisht 120 banorë në një km².³

Qendrat e vendbanimeve të Karadaket Shkupi, Hani Elezit, Kaçaniku, Vitia, Gjilani, Bujanoc Presheva, Kumanova Vija qarkore e njëres prej trevave më të pasura të Kosovës juglindore gjatë gjithë asaj të kaluar historike me vlera tradicionale dhe të përpunuara të etnosit kombëtar, deri më tashti është treguar të jetë edhe territori më kompakt i varg-

³ Wikipedia shqip - Karadaku

maleve të alpeve dardano-ilire dhe shqiptare, Malësia e Karadakut që e pasur me histori dhe reliev të bukur duhej patjetër të kishte një busull për çdo udhëtar nga gjithandej etnisë ose nga vende të tjera të botës. Zona malore e Karadakut paraqet pjesën më të lartë të rajonit të komunave të Karadakut (Shkupi-Hani i Elezit-Kaçaniku-Vitia-Gjilani-Presheva-Kumanova), në të cilën veçanërisht spikatet pjesa e saj jugore, në të cilën disa male kalojnë lartësinë mbidetare mbi 1000m, ku edhe gjendet maja më e lartë në gjithë komunën, Ostrovica (1168 m). Tipar kryesor i morfologjisë së kësaj treve është copëtmi i madh horizontal dhe energjia e relievit. Në këtë pjesë të Karadakut është shteruar lumi i Stanecit me sistemin e tij dhe lumi i Kurbalisë. Të dy këto lugina në pjesën e poshtme të tyre kanë karakter kanonik dhe shquhen për bukuritë të rrallë. Përpos maleve, kodrave, luginave dhe formave të tjera të relievit normal, të cilat japin një natyrë shumë piktoreskë, në malësinë e Karadakut është zhvilluar edhe relievi karstik me forma të ndryshme sipërfaqësore dhe nëntokësore. Format e relievit karakteristik sipërfaqësorë përfaqësohen nga disa sipërfaqe shkrepure dhe me disa vorbëtina karstike. Vorbëtinat më të rëndësishme janë në karstin e Kodrës së Ilincës (3 sosh) në katundin Sefer vorbëtina e quajtur Hardhuç, dhe në kurrizin e malit Ostrovicë, ku gjenden disa vorbëtina, ndër to, më e madhja shtrihet ndërmjet Ostrovicës së Madhe dhe Ostrovicës së Vogël. Ajo nga populli vendas quhet Pusi i kaut. Edhe format e relievit karstik nëntokësor janë mjaftë të zhvilluara. Ato përfaqësohen me një humnerë në malin e Ostrovicë e Vogël, dhe dy shpella (guva), Shpella e Ilincës dhe Shpella e Arushës (Tërnavë). Shpella më e madhe në territorin e komunës së Preshevës është Shpella e Ilincës me gjatësi të përgjithshme të kanaleve prej 687m. Pozita e kësaj shpelle është shumë e përshtatshme, pasi ajo shtrihet vetëm 2 km larg udhës së asfaltuar Preshevë-Gjilan. Kjo udhë është mjaftë e rrahur. Shpella e Arushës (Tërnavë) shtrihet në bregun e djathtë në

Rekë të Zezë (Lumi i Tërnavës), përballë rrëzës juglindore të Ostrovicës⁴. Shpella e Arushës ka një gjatësi të përgjithshme të kanaleve të hulumtuar prej 145 m (gjatësia e kësaj shpelle është më e madhe, por nevojiten hulumtime të mëtejshme). Kjo shpellë është më e bukur, jo vetëm në territorin e komunës së Preshevës, por edhe më gjerë. Ajo është e pasur me "stoli shpelleje" (stalaktite, stalagmite, shtylla, klita (perde) shpelloje etj). Udhëtarit për të shkuar atje i duhet të dijë, nëse është turist, se cilën duhet të shijojë më parë klimën e mrekullueshme, gurrat me ujë të kulluar, lumenjtë e Llapushes dhe ai i Karadaku apo bjeshkët e larta të Kodra e Tupanit, Maja e Zezë, Maja e Godenit, etj. Një busull "drite" ka hedhur edhe studimi i Dr.Jahi Stanecit, gjeograf i parë i doktoruar në këto hapësira ballkanike...



Pamje nga Malësia e Karadaku

Pyjet e Komunës së Preshevës nuk janë njësoj të përhapura. Ato, thuajse, krejtësisht shtrihen në trevën e Karadaku. Dikur Karadaku ka qenë i njohur për pyje të larta dhe të dendura. Ato kanë pësuar ndryshime të mëdha nga se dora e njeriut i ka shkatërruar dhe sot paraqesin, kryesisht, pyje të reja. Këto janë pyje gjetherënëse (ahu, bungu, qarri, shkoza, krekëza, etj.). Kohëve të fundit, aty-këtu, janë ngritur sipërfaqe të kufizuara të pishave. Shpërngulja e popullsisë, nga vitet e gjashtëdhjeta, nga Karadaku ka ndikuar në rritjen

⁴ Legjendat në Malësinë e Kardaku, Dr. Jahi J.Staneci, gjemorfolog

e sipërfaqeve të kullosave si rrjedhim i kthimit të arave në kulloso. Kulloso ka edhe në trevën e Malit Rujn. Komuna e Preshevës është e pasur me shtazë dhe shpend të egër. Në Karadak jeton kaprolli, lepuri, ujku, dhelpra dhe derri i egër, kurse prej shpendëve: thëllëza e gurit, ndërsa pula e egër është zhdukur. Në fushën e Preshevës dhe në Kodrën e Rujnit ka mjaft lepuj dhe thëllëza të fushës. Në Llopushnicë ka peshq, ndërsa në Lumin e Kurbalisë, veçanërisht në pjesën e poshtme, nuk ka fare gjallesa. Peshq ka edhe liqeni artificial i Rahovicës. Afër Preshevës shtrihet në kulmin (Kërrusen e Preshevës) e Lugnajës së Moravë-Vardarit, ku lidhen këto dy lugina të mëdha, të cilat për së gjati, në drejtim veri-jug, përshkojnë siujdhesën ballkanike. Udhë e vjetër, në drejtim lindje-perëndim, kryqëzohet në Luginën e Preshevës. Pozita Karadaku si qendër në siujdhesës ballkanike dhe në Lugnajën e Moravës-Vardarit, Llapushë përpos rëndësisë strategjike ka pasur edhe rëndësi të madhe ekonomike dhe kulturo-re. Kështu, qysh nga kohërat më të vjetra-antika dhe mesjetë, territori i kësaj komune ishte i banuar dhe jeta në të kurrë nuk është ndërprerë. Këtë më së miri e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike dhe numri i madh i rrënojave të kështjellave iliro-shqiptare, më vonë të rindërtuara nga romakët. Nëpër luginën e Moravë-Vardarit qysh nga periudha parahistorike pandërprerë kanë lëvizur kultura të ndryshme në drejtim jug-veri dhe anasjelltas. Pozitën gjeografike të komunës së Preshevës e bën të rëndësishme edhe shtrirja e saj në udhëkryqin ku magjistrallja e luginores së Moravë-Vardarit⁵ prehet nga një udhë e tërthortë ballkanike me rëndësi të veçantë, e cila shtrihet në drejtim lindje-perëndim dhe lidh Ballkanin lindor me atë perëndimor. Edhe në këtë drejtim qysh nga parahistoria e këndeje kanë rrymuar kultura të ndryshme. Kështu, pozita e

⁵ [Anamorava](#) është rajon i cili gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Anamorava përbëhet prej pjesës së luginës dhe skajeve malore të maleve të [Karadaku](#) në të djathtë dhe maleve të Zhegotit e Koznikut në të majtë

jashtë rëndomtë gjeografike si dhe kushtet e përshtatshme natyrore që ka komuna e Presh-evës, kanë bërë që territori i saj të banohet qysh nga periudha e neolitit, e që vazhdon të banohet edhe gjatë periudhëve të mëvonshme, të bronzit, të hekurit e deri në ditët tona. Është e ditur se tërë Ballkani perëndimorë dhe pjesa më e madhe qendrore e tij në të kaluarën banohej nga fisi ilir daradan, nga rrënja e pavenitur e të cilëve padyshim janë shqiptarët e sotëm. Këtë e dëshmojnë të dhënat arkeologjike, antropologjike, kulturore-historike, gjuhësore, etnologjike. Karadaku lindore lidhet nëpërmes të një magjistraleje në vitin më 1979 Preshevë - Gjilan, me rrugë të asfaltuar, e cila shfrytëzon Qafën e Livadhit të Shehut dhe Muçibabën. Në këte trevë, ishin të parët tanë ilirët, përkatësisht fisi Peont, ilir-dardanët. Më vonë, për shkak të pushtimeve të njëpasnjëshme të popujve të ndryshëm, ndryshohet struktura etnike, por kurrë nuk zhduket rrënja iliro-shqiptare. Ajo në antikën e vonshme dhe në mesjetën e hershme, me siguri, ka ekzistuar, përkundër romanizimit të popullsisë iliro-shqiptare. Edhe gjatë periudhës bizantine dhe mesjetës serbe në territorin e komunës së Preshevës, përkundër sllavizmit intensiv, etnikumi iliro-shqiptar vazhdon të ekzistojë deri në ditët tona. Pas ardhjes së turqve në trojet shqiptare është ndaluar procesi i sllavizmit të shqiptarëve, por ka filluar myslimanizimi i vrullshëm i tyre. Megjithatë në disa fshatra të Karadakut deri vonë është ruajtur feja katolike⁶.

⁶ http://sq.wikipedia.org/wiki/Sanxhaku_i_Nishit



Ish Sahat Kulla , Gjiilan

Pas luftës serbo-turke (1876-1878) në territorin e Komunës së Preshevës vendoset një numër i shqiptarëve (muhaxhirëve) të ikur nga trevat e Vrajës dhe të Toplicës. Pas luftërave ballkanike, Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore një pjesë e shqiptarëve të këtushëm, për shkak të trysnive politike, fetare dhe ekonomike, shpërngulet për në Turqi. Karadaku (nëntë fshatra të tij) i takonin Kosovës



Para Luftës së Dytë Botërore u aneksuan në territorin e komunës se Preshevës ishte qendër e rrethit e në këtë kohë është qendër komunale. Duhet se për të shkuar në këto vende, sepse një tjetër udhëtar nëse është studiues ose shkencëtar i duhet për të parë shenja të virgjëra të etnosit të endur në veshjet dhe kostumet popullore të gdhendura në punimet me dru dhe kështu; gjurmë pas gjurme në trevën që mban emrin

Karadak do të ndjehet origjinaliteti i një populli të lashtë dhe shenjat e forta e të sigurta të principatës së dikurshme të Arbrit. Ka të tjera vlera, ka të tjera bukuri natyrore, por edhe kaq do të mjaftonin që ta bënin të domosdoshëm një atlas emërtimelesh gjemorfologjike, që janë shkruar edhe legjendat e Kardakut me harta dhe fotot përkatëse, madje të mëvetëshëm për këtë trevë të famshme shqiptare. E njohur në histori për etjen e banorëve të saj për dituri, për famën e burrave që kanë mbetur ikona të kulturës dhe historisë kombëtare, aty mbetet një reminishencë e fortë e vlerave më të mira kombëtare. Kujtojmë këtu që në vitin 1905 në Stubëll është hapur shkolla e parë shqipe në Kosovë dhe Maqedoninë perëndimore. Të ardhur nga fisi Peon dhe Dardan i Ilirëve, banorët e sotëm të Malësisë kanë ruajtur shumë tradita të çmuara për kulturën e jetesës që shtrihet në fushën e zejtarisë, bujqësisë dhe organizimit të familjes. Më pas këto treva ilire ngelën në zotërimin e Dardanëve të cilët iu bashkuan ushtrisë së Skënderbeut, pas kthimit nga rrethina e Nissusit (Nishit) për të ruajtur krishterimin dhe lirinë e Arbrit. Pjesëmarrja e tyre ka qenë evidente dhe la pas traditën e kuvendeve të burrave për të zgjidhur çështje të rëndësishme kombëtare prej kohës së shtetit të Arbrit. Justinionit që ishte nga këto anë të trekëndëshit Dardan (Nisuss/ Skopia / Ulpiniana. Kodet e diktuar në këto treva luajtën një rol thelbësor në ruajtjen e shtetit, familjes, gjuhës shqipe dhe kulturës arbërore, si shkolla e parë shqipe në Kosovë(1905) në Stubëll të Karadakut. Treva e Karadakut e ka ruajtur trashëgiminë historike kulturore e shpirtrore të saj me mjaft përkushtesë. Vetëm duke parë këtë atlasin i Jahi Stanecit dhe monografia e kardinalit dr. kur sheh të lulëzuar gjurmët e kishës së Dunavit, Stublllovaqa një nga kishat katolike Binçë-Letnicë dhe vija Prizren-Ferizaj-Shkup më të vjetra nëpërmes Karadakut mbush sadopak fletët "e djegura" të historisë kombëtare prej pushtuesve tanë. Kjo kishë përmendet si udhëzues që në pjesën e tretë të shekullit XX, shënon autori.

Nuk mungon në këtë atlas as çiftelia tradicionale, as porta dhe dyert e bukura të kullave. Një pjesë e mirë e shenjave dalluese të kësaj treve do të gjenden në arkivat e Konstantinopojës. Pastaj mësimet e Don Mikel Tarabolluzit, Mark Gashit (babit të boemit Mirko Gashit të autorit të shumë veprave poetike, si dhe të Ndue Gashit, mësuesit të përndjekur hap pas hapi vazhdon me hartën fizike të Karadakut edhe gjeomorfologu i parë që hartoi fjalorin e parë terminalogjik mbi malësinë e Karadakut, prof. dr. Jahi Stanecit që shoqërohet me të dhëna për popullsinë nga gojëdhënat për "Mitet e Karadakut", nëse kam të drejtë ta quaj; busulla horizonti dhe leximi i hartës janë aty.

Kosova Lindore⁷.- Regjion në lindje të Kosovës, përkatsisht Shqipëria Verilindore. Lugina e Preshevës përfshinë teritorin e komunave të Preshevës në jug, Bujanocit në mes dhe Medvegjës në veri.

Lugina e Preshevës administrativisht ishte ndarë nga Kosova në vitin 1945 prej komunistëve jugosllav në shkëmbim të dy komunave në veri të Kosovës, me Leposaviqin dhe Zubinpotokun, të cilat në atë kohë kishin popullsi shumicë sllave. Qëllimi i kësaj ndarje ishte copëzimi i trungut shqiptar dhe defaktorizimi i tyre, si në aspektin politik, por edhe nacional. Presheva, Bujanoci dhe Medvegja gjendet dhe njihet si Lugina e Preshevës. Kjo Luginë në perendim është sikur të jetë e mbrojtur me vargmalin e Karadakut të Shkupit, e njohur si karadak i Preshevës, nga lindja me Malet e Rujenit. Lugina shtrihet në drejtimin verijug në formë të pandërprerë nga Ristovci në veri, e në jug në drejtim të Preshevës dhe të Kumanovës. Ristovci deri në vitin 1912 ka qenë pikë kufitare, kur Presheva e Bujanoci, pra edhe Maqedonia dhe Kosova "shlirohen" nga ushtria serbe, fqinje kjo e pa ngopur për

⁷ N.Ramadani:wikipedia shqip|Koka11.

[http://sq.wikipedia.org/wiki/Karadaku_n%C3%AB_rezistenc%C3%ABn_e_armatosur_\(1941-1951\)](http://sq.wikipedia.org/wiki/Karadaku_n%C3%AB_rezistenc%C3%ABn_e_armatosur_(1941-1951))

toka të reja dhe zgjerime teritoriale. Për së gjati kësaj Lugine kalojnë rrugët – magjistralja dhe hekurudha, të cilat e lidhin Europën me Azinë përmes Greqisë. Kjo lidhje natyrore tranzite e bënë që Lugina e Preshevës të jetë me rëndësi të madhe strategjike dhe të ketë një peshë specifike politike për kohën kur ajo pa dëshirën e popullatës mbetet me Serbinë, sepse në atë kohë kishte rezistuar edhe me armë. Mirëpo në fillimin e shekullit XXI, kur tanimë jemi dëshmitar të proceseve përfundimtare të formimit të plotë të Bashkësisë Evropiane në të cilën janë duke u përfshirë edhe shtetet e Evropës Juglindore, kjo rëndësi strategjike – politike nuk do ta ketë më atë vlerë dhe rëndësi, sepse edhe ajo do të jetë pjesë e Evropës së bashkuar. Lugina e Preshevës në veri kufizohet me Serbinë jugore, në jug me Maqedonin perendimore, nga lindja e ka Bullgarinë, e në perëndim me Kosovën. Pra, nga jugu dhe perëndimi jemi të mbështetur fuqishëm në trungun e ndarë shqiptar, që pas mbarimit të luftës së dytë botërore Lugina e Preshevës.

PRESHEVA⁸ është një qytet i vogël, qendër kazaje në sanxhakun e Prishtinës, të Vilajetit të Kosovës, i cili gjendet 50 kilometra në juglindje të saj dhe të Shkupit, pothuajse aq në verilindje të tij afër kufirit të Serbisë dhe mbi vijën hekurudhore. Popullsia e kësaj kazaje ishte rreth 3000 banor. Kazaja e Preshevës gjendej në skajin juglindor të sanxhakut të Prishtinës. Kufizohet dhe është e rrethuar nga ana verilindore me kufirin e Serbisë, nga ana veri-perëndimore me kazanë e Gjilanit dhe në jug me sanxhakun e Shkupit, respektivisht me kazanë e Kumanovës. Në këtë kaza toka është pjellore dhe shumë prodhuese. Rrushi që rritet në këtë kaza është shumë i mirë. Kazaja e Preshevës përbëhej prej 134 fshatrave, me 39545 banor, shumica e të cilëve janë mysliman (shqiptarë) dhe të tjerët sllavë. Në këtë

⁸ Për enciklopedinë *Kâmûs Al – a’Lâm* i kam paraqitur në punimin e mëhershëm me titullin “Gjilani në enciklopedinë *Kâmûs Al – a’Lâm* të Sami Frashërit” .

kaza gjendën rreth 13 xhami, 2 të tjera më të vogla që quhen mesxhide, 500 dyqane, 33 hane, 13 posta xhandarmërie dhe një spital ushtarak.



Rezistenca e armatosur e Karadakut në juglindje të Kosovës 1941-1951-(*Reflektimi i tyre në opinionin publik 28 shtatorit 1942 dhe 30-të nëntor- 1944*) - Formimi i grupeve të para ilegale të rezistencës së armatosur në radhët e shqiptarëve në zonën e pushtuar nga bullgaret ushtrohej dhunë e represion gjithmonë e më i madh, prandaj edhe LNC-ja, po zhvillohej në ato zona në përmasa më gjithëpërfshirëse. Rradhët e fshatarëve dhe minororëve po shtoheshin përkrah LNC-së, ku pas daljes nga burgu i Xhel-edin Kurbaliut, formohet grupi i parë ilegal nga Babush e Kadri Halimi, Kurtesh Agushi, Selami dhe Shemsi Hallaçi, mësuesit nga pjesa tjetër shqiptare: Hasan Dyngjeri, Sadri Mehmeti, Muharrem Çollaku, Malë Beci, Vesel dhe Vehbi Rexhepi. Në muajt e korrikut po zgjeroheshin radhët edhe në mes të Gjilanit dhe Dardanës (ish-Kamenica) si në Petroc nga Xheledin Kurbaliu formohet një grup, prej andej përmes Sinan Hasanit një tjetër në Pozhoran dhe nga ana e Ramadan Agushit në Tërpezë të Vitia. Edhe në Preshevë përmes Abd-

ullah Krashnicës formohet një grup nga vëllazërit Selami e Shenasi Hallaçi, Riza Selimi, Selim Selimi, Xhemush Bina përmes një lidhje nëpër Karadakun e Shkupit dhe të Kum-anovës nga ana e Hazir Hazirit^[19] në Karadakun e Gjilanit.

ARADHA E PARË SHQIPTARE E KOSOVËS - Aradha e parë shqiptare partizane e Kosovës u formua më 28 shtator 1942 në Ramjan te Vitia. Përballja po zinte fill si rezistencë e mosdurimit, mbylljes brenda vetvetes dhe shiki-mi i horizontit për të qarë këtë rrethimë të hekurt që po ngushtohet ditë e për ditë shtohet edhe më tepër. Kjo po bëhej në mes brigjeve të lumit Morava dhe Bjeshkës së Madhe, Karadakut përmes mësueseve, nxënësve e studentëve nëpër manastire e mejtepe që për herë po shtohet me mësimin amtarë ndër oda e konakë të kthyer në mësojtore të para si ato fetare edhe laike. Më 28 shtator 1942, pas një konsultimi nga grupet e armatosura antifashiste në një fshat të Ferizajt erdhën deri te marrëveshja që në misërishten e Ramjanit të mblidhen si një tog ndër ata që bënin bërthamat e para të atyre motmoteve në frymën e luftës çlirimtare, po prini Babushi e Kadri Halimi, Kurti, Selami, Meta, Çollaku dhe Beci.² . Xheladin Kurbalia sapo ishte kthyer nga burgu me një përvojë të madhe po i mbledh rreth vetes në shtëpinë e tij të marrë për banim prej se ishte ik si muhaxhir nga anën tjetër që shtypej më fortë nga dajaku e plumbi i Bugarit dytë. Mëhallë më mëha-llë po endeshin njerëzit e tyre për t'i bërë mendjet në forci-min e krahëve të tyre, jo vetëm për në punët e mundimshme që bënin nëpër minierat që po grabisnin të huajt pasurinë e tyre, por edhe nga një krah pushke për të forcuar përballjen përmes një rezistence të pamposhtur, duke u ndërlidhur përmes korrierëve nëpër të gjitha shtigjet që çonin drejt një udhe që e shihnin dritën dhe të nesërmen e tyre të lirë. Ata besoni në bindjet e tyre që do ta arrinin me formimin dhe rreshtimin e tyre në aradhën e

⁹ Wikipedia shqip:Kategoria Kokaj

parë që kishte bërë skeletin e një hierarkie ushtarake komanduese e të ndërlidhur me një front të përbashkët që lidhja mbahej përmes Kokës. Komitetin e Gjilanit e përfaqësonte Xheledin Kurbaliu, sepse një lidhje e tillë serioze ishte mjaftë bindëse e shpresëdhënëse nisi në një cep të Ramajve në drithënajat që po vihej në një bazë të fortë përmes një të dërguari Fadil Hoxha^[1] nga ana tjetër e tokës së Kosovës juglindore së bashku me Spahiun, Kërpuskën, Gulin, Kaspin, Dejдини dhe Sojevën .

Sulimi i parë i armatosur - Sulimi i parë i armatosur për marrjen e Minierës së Llojanit në mes të Preshevës dhe Kumanovës. Natën e 28 shtatorit të asaj vjeshtës së hershme kishin arritur edhe luftëtarë të tjerë që zgjodhën Xheledin Kurbalën për t'i prirë në aksionin e parë për të liruar nga pushtuesit digat e pasura të minierës, në të cilin aksion prijnë Xheladin Kurbaliu, komandant, Fadil Hoxha, Komisar Kurtesh Agushi, Sinan Hasani, Riza Selimi, Reshat Xhaferi dhe Hazir Kokës² dhe pas vrasjes së tij, caktohet Ramiz Černica dhe Kurtesh Agushi*³. Ata po i mbështeste fuqishëm edhe iu bashkuar edhe nënpr-efekti i kazasë Rifat Berisha dhe nga ana e Liman Staneci që përbënte karhun tjetër të një lidhje gjithandej etnisë. Aradhës së Sharrit - Më pas nis një varg zinxhir i shtrirjes së dhunës përmes një sulmi i parë i armatosur vale të re të arrestimeve, burgosjeve, por edhe vrasjeve sikur që pasoi detyrimisht tërheqjen kah Maja e Sharrit që shoqërohet me një anarki të pranidodorëzimit në mes forcave të huaj të koalicionit fashist. Nga ana tjetër pas një konflikti të armatosur ka dalë në skenë Mullai i kazasë në mbrojtje të atyre që po u rrezikohesh jeta, pasuria dhe lëvizja e tyre nga të ashtuquajtura "Dora e zezë" që vriste e priste natën dhe ditëm drekë, edhe atë në qendër të kazasë së vjetër. Por, secili po arrinte të kuptojë atë që po ndodhë ishte qartësia dhe bindja se nuk ka zgjidhje tjetër pos lirimt nga ajo "Dorë e zezë" që u sillej kokave të tyre si një murtajë dhe me tehun eskadronave të vdekjes. Shumëkujt i

ra hise që për t'i dalë në krah një grupi të tij që po tërhiqej malit nga një rrethim spontan që po i bëhej atyre se gjoja me veprimet e tyre, fillimisht numëroheshin në gishta dhe po e sertoni e hatroni zullumqari që shfrehej për t'i nënshtuar me jetuar ende me logjikën e robit dhe shfrytëzimin e robit deri në asgjesim dhe asimilimin e atyre që po e rezistoni fuqinë e tyre pushtuese. "LIDHJA II E PRIZRENIT"- Krahu "Lidhja II e Prizrenit" në juglindje të Kosovës në krye me Adem Gillavicën e Mulla Idris Gjilani. Mulla Idris Gjilani nga dr.Muhamet Pirraku i kazasë i kishte mbledhur krerët e gjitha krahinave juglindore në një besëlidhje për të mos lejuar asnjë grup të trupave të huaja për të kaluar këndeje kufirit përgjatë udhës së Frëngut nëpër të cilën udhë lëviznin përmes vijës hekurudhore në juglindje dhe përendim. Aty bashkohen të gjithë në një fushëbetejë të mbeten të pamposhtur te Reka Gjakut- Rainës, ku trupat pushtuese u kapën nga forcat vullnetare në një trekëndsh të asaj ngushtice që nisi përpjetë deri në Majën e Zezë, të Brezës dhe atë të Sharrit, duke iu dhënë një mësim se si luftonin për tokën e tyre, ku me atë rast si ditë feste morën dhe vendosën Shka-bën dykrenore pa kurrfarë nishani tjetër në të gjitha qendrat përgjatë frontit juglindor. Në një copë të vogël tokë, në një cep të saj, po bënë luftë të madhe...

Beteja e Rekës Raincës -Sikurse Beteja te Maja e Kikës e 29 gushtit të vitit 1944, që njihet si luftë resistuese për mbroje të etnisë shqiptare nga sulmi i forcave pushtuese serbo-bullgare për vijat frontale të hapur me 28 gusht 1944 - 30 nëntor 1944 përgjatë udhës së frëngut, Maja e Kikës, Ristovcë, Tasjan dhe Brezë ~ Serbi -Maqedoni.



Majtas: Abdullah Presheva, ulur , Liman Staneci, epror dhe mësuesi Mark Gashi (i dyti nga e majta HetëKoka)

Në këtë betejë, forcat vullnetare janë udhëhequr nga atdhetari Ramiz Cernica. Ndjej për obligim që për hir të objektivitetit shkencor historike, se formacionit të luftëtarëve të mobilizuar nga Mulla Ahmet Malisheva në vijen e parë, t'i bëj disa sqarime rreth asaj se kush ishte komandant kryesor, i forcave vullnetare në këtë betejë, ku ngadhënjyen forcat vullnetare shqiptare.^[1] Pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste, më 9 shtator 1944, forcat e rezistencës kombëtare, konformë urdhëresës së KQ të Lidhja e Dytë e Prizrenit, në viset e çliruara, u themeluan organet politiko-ushtarake edhe për nënprefekturën e Preshevës. Nënprefekt u zgjodh Limon Staneci, komandant i xhandarmerisë Ali Staneci, kurse komandant i forcave të rezistencës u zgjodh Ibrahim Kelmendi. Filloi mobilizimi i vullnetarëve dhe u caktuan komandat e zonave mbrojtëse, në vijën hekurudhore Kumanovë-Preshevë Bujanoc, të udhëhequr nga njerëzit me ndikim si Xheladin Kurbalia, Hoxhë Lipovica, Sylë Hotla etj. Beteja e Muqibabës - Dhe ajo e Llaposhnicës që pasoi pas betejës në Rekë të Raincës¹⁰ përgjatë udhës Frëngut * Reka e Gjakut (u zhvilluan në rrethinën juglindore të Gjilanit, Kosovë më 30 nëntor 1944 ndërmjet një koalicioni të LNÇ- antifashist të Ballkanit dhe BRSS pro anglo-amerikane. Depërtimi i shpejtë i forcave të rreshtuara

nga mbeturinat e forcave çetnik serbo-bullgare të Ballkan tronditi parinë politike që i udhëheqte shqip-tarët dhe atë të vendeve fqinje, për shkak të ndikimit prorus, karshi boshtit anglo-amerikan të boshtit antifashist. Më 6 tetor 1944 u formua brigada XVII maqedonase me Glisha Sharanoviqin komandant, që shpejt shtoi radhët e numrin e ushtarëve. Më 14 nëntor, kjo brigadë hyri në Shkup për t'u nisur po atë ditë për në Kaçanik. Vetëm për një muaj e diçka, deri më 14 nëntor 1944 likuidoi rreth 200 shqiptarë. Pas vrasjes se 128 vetave ne katundin Bllacë e Ulët, kjo brigadë u nis për në Karadak të Gjilanit, me atë rast në Stubëll masakroi mizorisht tetë shqiptarë. Më 30 nëntor të viti 1944, thirrjes së lidhur në Kuvendin e Livadhit të Shehit te Bria e Preshevës një ditë më parë u ishin përgjigjur vetëm vullnetarët e tri fshatrave; Buricë, Lipovicë, Kokaj, Llocë, Depcë deri në dhjetëra veta, por numri i tyre iu shtuan edhe për disa vetë. Trupat e mobilizuara të komanduara nga Sharanoviqi prej Gjilanit, depërtojnë përmes Pisjanit dhe nëpër Zhegër, duke trupuar lumin Morava e Binçes për ta shkelur Kardakun. Siç dihet pas tri bisedave të ndër-mjetësuar e Abdullah Preshevës, i cili nuk kishte garantuar se Brigada XVII serbo-maqedone do të kalonte pa shkelur "në çdo pëllëmbë toke, duke hyrë edhe nëpër brenda nëpër shpia", nuk ishte arritur marrëveshja për leje kalimin nëpër Karadak, pasi që edhe para orës para të mëngjesit iu ofruan Myqybabës. Aty i priten rojet shqiptare. Kolonat pushtuese janë shtrirë për dhe barkas dhe kishin kërkuar leje për të kaluar për Preshevë. Kjo kërkesë e tyre nuk u pranua, dhe ne ora 10 filloi sulmi i tyre. Fillimisht, mbrojta e barikaduar mirë i theu mbi tri herë dhe mobilizoheshin prapë me vullnetar tjerë në Pasjan, duke qëndruar deri në mbrëmje. Numri i tyre vinte e shtohet gjithnjë, duke u shtuar me serbë të katundeve të Anamoravës, derisa ndodhi dhe u plagos komandanti i forcave shqiptare Ymer Saçipit - Myqybabë, i cili përherë ishte në krahun e mbrojtjes së popullatës civile,

edhe të serbëve local të Pasjanit gjatë pushtimit Italo-bullgar dhe ku shumë kishte të plagosur të tjerë e të vranë. Forcat e kualacionit prorus që mësynte prej tri anëve në ora tetë hynë në katund, nga i cili gratë dhe fëmijët ishin larguar në drejtim të Karadakut lindor me kohë dhe ishin vendosur në Kokaj dhe Llocë. Më vonë pas depërtimeve nga Maja e Curretëve, ku ishte edhe komandant pas që ka marrë plagë vdekjeprurëse, dhe katundit i vihet zjarri shtëpive nga forcat okupuese. Pas plagosjes në anën e majtë nën kraharor të Ymerit, rezistencën e armatosur e kishte pas mbajtur një grup në tërheqje, ku i kishte pas veti njësitin e vëzhguesve në prapavijën e luftes barikadohet në Llapushnicë, ku derdhet përroi i Hardhisë në shpatin e Kokajve, po atë ditë pas Shën Mitrit të vitit 1944, pasdite një luftë ballë për ballë me forcat armike që ia kishini vënë zjarrin Myqybabës. Beteja e Llap- ushnicës -Komandantët lokalë ia kishin mbajtur krahun përëndimor në Komitetin për mbrojtjen e trojeve etnike nga aneksimi i dhu-nshëm serb, për t'ia prerë vijën hyrjeve të forcave të huaja, përmes enklavave, te lumi i Moravës, të Brigadës XVI serbe dhe asaj të XVII maqedone, ku u bë një rezistencë e armat-osur nga vullnetarët për ta mbrojtur pragun e shtëpive të tyre të prirë nga Komandant Ymer Saqipi(Myqybababa) dhe Hoxhë Lipovicës. Pas plagosjes në anën e majtë nën kraharorë të Ymerit, rezistencën e armatosur e kishte mbajtur një grup në tërheqje, ku i kishte pas veti njësitin e vëzhguesve. Në prapavijën e luftës barikadohet në Llapushnicë, ku derdhet përroi i Hardhisë në shpatin e Kokajve, po atë ditë ditë pas Shën Mitrit të vitit 1944, pasdite një luftë ballë për ballë me forcat armike që ia kishin vënë zjarrin Muçibabës. Atë ditë në vijën e frontit siç dihet kishte mbetur i plagosur për vdekje Ymer Myqybababa sa ishte në tërheqje në drejtim të Kokajve, si edhe një luftëtar nga katundi Llovcë i lagjës së Hazirajve, Ahmet Haziri, plagoset dhe pas dy javësh vdes më vonë nga plagët e marrë vdekjeprurëse. Më 14 dhjetor

1944 plagoset Rifati i mulla Isufit Lipovicës, i cili vdes pas një kohe nga plagët e marra. Vija frontale e betejës ishte nga Kotliana e deri te Gryka e Saqajt, dhe deri te Maja e Curr-etëve. Në tërheqje disa luftëtarë, ku pastaj u fortifikuan në një shp-ellë guri te përroi i hardhisë dhe vranë togun e diversant të armikut, për t'i dhënë leksion atyre që kishte mësy Karada-kun. Disa prej tyre i kishte nxënë taksirati e vriten aty, 6 të parët mbetën të vranë. Ma vonë përforcimet tjera arritën të kapen dhe mbahen rob nga ana e çetnikëve. Dy të rinjtë, Jashari dhe Kadri Koka pasi që i lidhën për pushkatim, i liruan sa për t'i bartur me gomar për t'i ngarkuar të vranët në Llap-ushnicë, ndërsa të tjerët e vranë anës tjetër të vendi i quajtur te Qafa e Lekit në mes Buricës, Lipovicës e Myqybabës, të cilët i përcollën me qerret të mbushur përplot me trina kah Pasjani. Të vranët në fund të përrot të katunishtës që bie në lumin Llapushnicë, një nga një lidhur si ngarkesa me dru, i kishin ngarkuar me një gomar, por një prej kufomave që ishte më i lehtë ia merrte anën. Prej tyre e kishin lidhë në paragon të samarit deri te Laku, te Mullini Kokaj. Aty në lakesën për ballë Birës së kaçakëve u kishte rrëshqitur njëri prej tyre e u kishte ra me kokë përtokë. Këtë e paguan me nga një të rënie të kondakut të pushkëve, Arifi i Myqybabës, Jashari me Kadriun e Kokajve, dhe nuk iu nda fare stupci deri sa ishin varrosur te vendi i quajtur varret e huaja në kodër të Kokajve. Plaku Sali Koka i kishte pritur te vendi i quajtur Rup, partizanët e revoltuar të cilëve u kumtuar në emer të katundit Kokaj se, pos fëmijëve deri 13 vjeç dhe pleqve e grave e të sëmurëve nuk kishte njeri tjetër në Kokaj dhe nuk do të ketë rezistencë të armatosur, ndërsa burrat janë larguar nga paniku se mund t'ju ndodh ndonjë e keqe, pasi që ishin dëgjuar të shtëna me armë dhe shkëmbim zjarri në Myqybabë dhe Llapushnicë. Bataloni duke kaluar kishte hasur në një zigurë lisi të fshehur te Mëhalla e poshtme e Kokajve, plakun Hajdar Burica të cilin e kishin vranë me gjakëftoftësi nga afërsia. Nuk kaluan shumë ditë

dhe prapë u kthyen të paftuar ashtu siç kishin ardhur pas tri javë pas Shën Mitrit për t'i marrë eshtrat e atyre që ishin vranë për tokën e huaj. Duda te Kokajt që kishte qëlluar rastësisht t'i bie aty pari në arën e saj, ku ishin varrosur, kishte dalë njëri nga ata që drejtonte ceremoninë e zhvarrimit për t'i kërkuar asaj nëse u kishte mbetur borxh për tokën që kishin varrosur aty. Sot e atë ditë vendi quhet “vend i vakëfit”, ku janë varr-osur e zhvarrosur asqeria e huaj, secili prej atyre që u vranë i kanë mbledhur eshtrat, thonë pjesëmarrës të asaj lufte pas kthimit të tyre nga mali, të cilët ishin vullnetarë në vijën frontale te Qafa e Myqybabës. Dhashtë Zoti e qofshin të fundit, si ogur i zi. *Vendasit e kishin pranuar dhe ishin rreshtuar përkrah LNÇ-së, por jo të nënshtruar edhe me pushtimin nga serbo-sllavo* Krahu juglindor kishte mbajtur ushtritë e huaja për të mos invaduar deri në ditën 28 qershor-28 gusht 1944. Beteja për udhë të Frengit. Fronti i përbashkët lindor i Aleancës antifashiste Jalta, ia kishte prerë vijën zonës perëndimore dhe lindore, sipas pazarit të tyre tjetër kund. Secili (Ai) që nuk i ka duart e përgjakura le t'i bashkohet aleancës antifashiste, u tha, Ali (Ferat) Bej Draga, përfaqësuesve të legjislaturës së vjetër Ministër në Beograd. Tkurrjet (ngushtimi) në lindje të vendit si: Depcë, Caravajkë, Staneci, Elezbalia, Kruhalia, Buhiqi, Ilica, Ranatoci - Muhaxhirët e Kokajve, Maxhere ishin nisur kaherë të parapërgatiten për aneksim me anë të vrasjeve të hapura dhe misterioze, përmes likudimeve, arrestimeve, dëbimeve, maltretimeve, varfërisë, mbjelljes së frikës. Zvoglimi i territoreve patë filluar menjëherë pas luftës serbo-turke (1876-1878) kur në territorin e Karadakut vendoset një numër i shqiptarëve (muhaxhirëve) të ikur nga trevat e Vranjës dhe të Toplicës. Pas luftërave ballkanike, Luftës së Parë Botërore dhe Lufta Dytë Botërore një pjesë e shqiptarëve të këtushëm, për shkak të trysnive politike, fetare dhe ekonomike, shpërngulet për në Turqi. Karadakut me nëntë fshatra të tij, që shtrihen në Luginë të Preshevës i

takonin Kosovës, si dhe dy fshatra të Malësisë së Bujanocit. Para Luftës së Dytë Botërore u aneksuan në territorin e komunave të Bujanoci dhe Preshevës si qendra komunale të Kosovës lindore e të aneksuar nga Serbia. Kuvendin e Livadhit të Shehut te Karadaku lindor i Preshevës më 30 nëntor të viti 1944, thirrjes së lidhur në Kuvendin e Livadhit të Shehut te Bria e Preshevës një ditë më parë u ishin përgjigjur vetëm vullnetarët e tri fshatrave: Buricë, Lipovicë, Kokaj, Llocë, Depcë deri në dhjetra veta, por numri i tyre iu shtuan edhe për disa vetë. Forcat tjera shqiptare të prirë nga Ali Syla ishin në krahinë tjetër në Përroin Vaçka Ilicës, ndërsa Mulla Idris Gjilani, po kalonte me truprojen te Ura e Budrikës, sikur edhe trupat e komanduar nga Hysen Tërpeza në gjendje gatishmërie për mbrojtje të popullatës civile. Limon Staneci ish-sekretar në nënprefekturën e Gjilanit, Ibrahim Kelmendi në përcjellje të situatës te Prroni i Kokajve të poshtëm, dhe pastaj kalojnë në anën e Sllubicës perkarshi, ndërsa Adem Stançiqi, kishte bërë thirrje "për vetëpërmbytje dhe mosprofokime të armatosura, porn ë istikame. Terrorizmi sllavoçetnik dhe Fronti Lindor -

Pasojat e kësaj ditë, ku në vijën e frontit siç dihet kishte mbetur i plagosur për vdekje komandanti Ymer Saqapi në tërheqje në drejtim të Kokajve, ku vdes dhe varroset te varrezat e mëhallës së poshtme. Edhe një luftëtar nga katundi Llocë i lagjes së Hazirajve, Ahmet Haziri, plagoset dhe pas dy javësh vdes më vonë nga plagë e marrë më 14 dhjetor 1944, si edhe vëllai i Hoxhë Lipovicës. Të plagosur pati edhe të tjerë si dy djemtë i axhë Baftjar Depcës, të cilët janë strehuar në mes të katundit Llocë dhe Kokaj te Livadhet e Kishës me vetëm nga një bombë në kokë, të cilët i shpëtuan ekspeditës pushtuese serbo-bullgare. Komandanti Ymer Myçybaba, i plagosuri u transferua në katundin Kokaj, te përroi i Kokajve, ku pas kishte marrë plagë vdekjeprurëse. Ndërroi jetë dhe u varros në varrezat e Mëhallës së poshtme të Kokajve . Djegia e 73 shtëpive, hambarëve dhe plemëve

të Muçibabës u bë më 30 nëtor 1944 dhe fillim të dhjetor 1944, duke mobilizuar serbët lokal dhe trupat dezertuar çetnike për t'iu vërsulur drejt territorit të Karadakut lindor të Gjilanit dhe Preshevës, kinse për t'i ndihmuar brigadën XVI të Serbisë, të cilat bëjnë plojen në Isevukaj, ku u masakruan 93 veta, 33 veta në Gospo-nicë, 13 veta në Sllubicë, në Kokajt 3(tre) e tjerë. Komandanti, Ymer Saqip Muçibaba kishte mbajtur krahun perëndimor në Komitetin për mbrojtjen e trojeve etnike nga aneksi-mi i dhunshëm serb, për t'ia prerë vijën hyrjeve të forcave të huaja, përmes enklavave, te lumi i Morava e Binçës, të Brigadës XVII maqedono-kosovare, po i vinte në ndihmë Brigadës XVI serbe të shpartalluar gjatë depërtimit në malësi të Karadakut dhe Gollakut përgjatë vijës frontale prej Majës Kikës e përtej vijës hekurudhore udhës frëngut e gjer te Reka e Raincë dhe të Brezës. Brigada në fjalë vazhdoi rrugëtimin për të kaluar në Gollak, ku fati i një bataloni të saj ishte shkatërruar në mes të Qarrit, Vriçecit dhe Gurit të zi, nga kishin arritur të shpëtojnë vetë gjashtë veta kanë aritutr të gjallë në Vranjë, (Arkivi rajonal Gjilan, LNÇ). Fronti i Kosovës Lindore - Më 17 dhjetor 1944, rreth 1000 burrave nën armë, të Malësisë së Bujanocit në Zarbincë dhe të Karadakut të Preshevës u mbajt Kuvendi themelues ku u zgjodh Shtabit Drejtues të Rezistencës Shqiptare për Kosovën Lindore, nën udhëhe-qjen e Mulla Idriz Gjilanit, i cili u zgjodh edhe komandant i Forcave vullnetare shqiptare të krahut Lindor dhe sekretar Muharrem Fejza, zëvendëskomandant Sylë Zarbinca, kurse për anëtarë u emruan komandantët e njërive (guerile): Shefki Hajdini-Desivojca, Ajet Rainca, Lam Breznica, Ajet Kosovica, Xheladin Kurbalia, Lotë Vaku, Hoxhë Isuf Lipo-vica, Faik Tairi dhe Sulë Hotla. Komandanti i çetave të armatosura balliste për krejt viset e Kumanovës edhe në rolin e anëtarit të Shtabit të Lëvizjes së Rezistencës Shqip-tare të Kosovës Lindore, edhe në rolin e promotorit për organizimin e

Komiteteve të Rinisë Nacionaliste për Mbrojtjen e Kosovës në viset e Kumanovës, Sylë Hotla, ndërsa në rajonin e Karadakut të Kumanovës vepronte Batalloni i Karadakut nën udhëheqjen e Sulë Hotlës, sipas urdhrave që vinin nga Mulla Idrizi, respektivisht prefektura e Gjilanit dhe Shtabi Suprem për Mbrojtjen e Tokave të Liruar Shqiptare të Kosovës Lindore. Rezistenca e armatosur pas Luftës së II Botërore - Rezistenca e armatosur me grupin e fundit të Hasan Alisë e mësuesit Mustafë Koka i lindur në katundin Kokaj më 1931. Mustafë Koka gjatë viteve të fundit të Luftës së Dytë u bashkua një njësi të Brigadave shqiptare që po kalonte nëpër Kokaj, si luftëtar 15 vjeçar në nëntor të 1944 dhe më vonë sa qëndroi në Tiranë, kreu kualifikimin për mësues. Me në fund të vitit 1947 ishte kthyer në Kosovë, ku filloi punën e mësimit, nevojë kjo që ishte shumë e madhe për malësorët e Karadakut dhe banorët e Anamoravës. Puna e Mustafë Kokës në fushën e arsimit nuk zgjati shumë pasi që pushteti komunist jugosllav për shqiptarët e Kosovës u bë i padurueshëm, kështu që Mustafa vendosi të ballafaqohej me pushtuesin edhe në mënyrë të armatosur. Për disa vite rresht, Hasan Alia Remniku dhe Mustafë Koka u bënë sino-nim i tmerrit për serbët, ka qenë simboli i rezistencës së pushtimit jugosllav të pas Luftës së Dytë Botërore. Së bashku me patriot të tjerë, përfshirë Hasan Remnikun, u vra pabesisht në një pusi që ia kishte përgatitur UDB-ja më 11 tetor 1951. Mësuesi Mustafë në mendjen e tij kishte edhe ngjarjet historike. I kujtohet se si arriti t'i bashkohet një batalioni të armatës shqiptare, në dimrin e madh, para se të kapitullonin nazistët, deri sa po kalonte aty pari. Mustafa, si një trembëdhjetë vjeçar në një mënyrë jo të zakonshme ishte lidhur me ta, pasi që në një gjuajtje me armë, te kroi i përroit të Kokajve, nuk e kishte gabuar shenjën. Mustafës i miklo-nin këmbët duke pritur komandant Haxhiun, për të marrë lejen e tij, që ta provonte edhe ai. Me të parën ndau rrasën e gurit në thërmija, dhe

pasi që luftëtarët e trimëruan për një sukses në shenjëtari aty për aty, kërkoi që t'i bashkohet, nëse mundë ta lejonin ata dhe familja e tij, për të vazhduar shko-llimin dhe stërvitjet në përfitimin e shkathtësive ushtarake. Atë ditë Mustafa mori pëlqimin, por më parë duhej ta kryente shkollimin si kusht i parë për ta ndihmuar vendin e lënë në duart e të huajve. Duke u ndarë prej tyre mori edhe përshëndetjet për mësuesit shqiptarë të cilët ishin tërhequr në kryeqytet. Me të arritur në kryeqytetin e vendit, studioi tre vjet e gjysmë në gjimnaz. Në stërvitjet për shenjëtari nderohet me medalje të artë si përfaqësues i vendit në garat ballkanike. Ai, me të mbaruar shkollimin, me një dekret emërohet mësues i parë, fillimisht në Uglar, pastaj në Remnik dhe Gjylekarë.

PËRBALLJA E MËSUESIT MUSTAFË KOKA ME UDB-në - Në fund të muajit maj 1951, të fillimit të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, dy oficerë të lartë të UDB-së e ndjekin hap pas hapi. Ardhjen e UDB-së në fshat e parandiente mësuesi Mustafë Koka si kob i rikthyer nga ajo ditë që kishte përcjellë për në burg, babanë, axhën dhe vëllain. Kah gjysma e atij muaji i trokasin në derën e banesës së tij në Remnik. Sipas Arif Sylës, sekretar nëinstancat komunale të arsimit, tregon sot me rastin e 57 vjetrit të atyre ngjarjeve se, "Mustafa ishte ri dhe nuk mund ta duronte ma maltretimin dhe zullumin e UDB-ashëve, të cilët e merrnin të premtëve pas mësimitdhe deri të hënëve nuk e lëshonin, kur një ditëpara se tëkthehej mësuesi nga një mbledhje e katundit, i cili i kishte kërkuar që të vihen në lidhje me Hasanin sepse nuk mund tëqëndronte në ilegalitet, kur kërkohet që ta dorëzonin njeriune fundit të ilegales. Alia, Lila dhe Voja, futen të paftuar nëbanesën e tij, kinse për ta kaluar natën, por qëllimi i tyre, ishte që ta dëbojnë atë për tej bjeshkëve. Pasi kërkoi ta lejonin të shkonte për të fjetur te shërbëtori i shkollës, sepse aty ishte ngushtë ai e kishte lënë një revole, "pallaber" i gjermanit për ta ruajtur kokën. Në mëngjes kur

u kthye nuk patën kohë për t'u përshëndetur sepse u kthyen për ta përcjellë ardhjen e UDB-së. Andaj vendosi t'i kthehet malit, tjetër udhë nuk pati. Merr revolen "beretë", që e kishte amanet nga babai dhe ju kthehet "mysafirëve" në odën etij për ta dërguar amanetin e etërve në vend. Me të hyrë në derë, i gjen duke luajtur shah, por në vend se t'i luante figurat e shahut për t'i nxënë në mat, nxjerr revolen dhe zbrazi në ta. Duke dalë jashtë me nxitim, e pa gruan e axhës Ahmet në oborrin e shtëpisë së tij. Përballja kundër atyre pushtuesve po zinte fill si rezistencën e mosdurimit, mbylljes brenda vetvetes dhe shikimi i horizontit për të qarë atë rrethim të hekurt që po ngushtohej ditë e për ditë shtohet edhe më tepër. Ajo po bëhej në mes brigjeve të lumit Morava dhe Bjeshkës së Madhe, Karadakut përmes mësueseve, nxënësve e studentëve nëpër manastire e mejtepe që përherë po shtohet me mësimin amtar ndër oda e konake të kthyer në mësojtore të para fetare dhe laike, siç u veprua me rastin e mësuesit Mustafë, cili mbante në një sistem strukturën e një lëvizje ilegale që po shtohet në radhët e shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë që kishte filluar mbi atë Lëvizjen Çlirimtare që për shqiptarët. Mustafa kaloi shtëpi më shtëpi, mal më mal e gur më gur, deri në jatakun më të sigurt. Më vonë ra në lidhje me Hasan Alinë, të cilët vendosën të largohen nga atje, për shkak se ishte shtuar zullumi mbi jatakët e tyre. Kah fillimi i vjeshtës shkuan në anën tjetër të Arbërisë së lirë. Ata nuk arritën ta kapërcejnë malin për të dalë përtej gardhit, bënte mjegull dhe binte shi vazhdimisht. Ishte një mot i lig që mbahet mend më gjatë se hereve tjera. Por papërkulshmëria dhe lufta e vazhdueshme, edhe pse i kanë zvogëluar në masë, nuk kanë arritur asnjëherë të na zhdukin. *Udha e këputur në mes të kufirit shqiptar* - Një ditë vjeshte, derisa po priste lidhjen në Kokaj, kishte vendosur të rrezikonte: do të qëndronte në kullën e vet. Mustafa po i qëndronte në besë nënës, se nuk do t'i bie në duar UDB-së për të pësuar si ishe

keq e më keq, ashtu siç i ndodhi babait të tij, edhe pas amnistisë së premtuar. Mustafa e nuhati i pari tradhtinë dhe nuk e lëshonte nga tyta e armës I.Z. që kishte marrë përsipër për t'i përcjell matanë gardhit. Iu kujtua edhe vrasja e dhjetë vjet më parë buzë kufijve të gardhit të thurur me zapti edhe aty, ku kurrë nuk e patën vendin. Edhe pas lënë me fjalë të varrosët në mezhide të kufirit për të cilin kishte luftuar gjithnjë para se ta lëshonin në mënyrë kolektive tokën te Molla e Kuqe, për t'i shpëtuar shfarosjes. Sipas planit të marrë nga UDB-ja e dinte se Hasan Alia do të goditët në gjoks, Mustafën në Kokë, ndërsa Agush Bresalci të pritët me breshëri, derisa do ta kalonte lumin me gruan e tij në shpinë. Mustafa e mbante përkrahu gruan Rabën. Ai mbante edhe armë të gjatë edhe një revole "beretë" që e kishte amanet nga vëllai i tij Jeta. Beretën e mbante në brez. Pas kësaj, duke kaluar me hapa të shpejtuar nëpër një rrafshinë, për herë të parë, pas gjithë asaj lufte, po i tradhtonte mendja. Në këtë heshtje shkrepën dy armë. Menjëherë pas kësaj u ndezën kandilat e turpit për ta ndritur terrenin, derisa Mustafa me Agushin ai prenë dritat me rafalët e tyre, me qëllim që ta mbulonin terrenin me terrin e asaj nate të pabesë, që ishte improvizuar si në skenë të teatrit, te vendtakimi në Dri. Dritat e kthyer në drejtim të tyre, së bashku me sirenën e trupave pushtuese fare pranë tyre, po e ndriçonin ujin e Drinit të përgjakur prej tre burrave dhe dy grave. Ndërsa një ushtar i ri po i përgjigjej zërit të gruas së Agushit, Qibrijesë, për t'i dhënë një pikë ujë me grusht. Këtë e ndaloi komandanti Kristë, duke ia sharë nënën shqiptare... "Do t'iu vrasim të gjithëve!". Lama e miellit të kazasë po i priste në agun e parë qëkur ranë. As në emër të katundit nuk ua dhanë kufomat, as të mësuesit të vrarë bashkë më bashkëshorten e tij, dhe as të tre kaçakëve të tjerë. Familja e ngushtë e mësuesit kishte mbetur në gra e fëmijë. Nëna mallkonte edhe në ditën e tretë që ishin ekspozuar te pazari i Lamës. Asnjë gjëmë, asnjë pikë lot nuk i kishte dal asaj

burrëreshe, as para masës së dalë te Lama e millit. Nëna e Mustafës, Habibja, e kishte rritë për krenarinë e sotme. Pas vrasjes, trupi i tij u ekspozua në Gjilan¹¹, si formë represive dhe mënyrë për të frikësuar banorët e kësaj ane të Kosovës. Citatet: Riza Drini : "*Boshti i ra Rusisë. Gjermania e humbi luftën* " Drini qante e dëneste: "*Shihe, kam dronë se punët do të marrin mbrapësht dhe së shpejti nëpër këtë tokë të shenjtë shqiptare do të rrjedh gjaku rrëke i shqiptarëve sa që toka nuk do ta pijë. Unë nuk po e di se ku do të mbetet Kosova dhe fati i kosovarëve. ..*". Drini: "*O Hysen Tërpeza, ja ku ta them: Kosova mbaroi. Ti si djalë i ri që je, ia jep besën kombit shqiptar se do të luftosh deri në fund. Dikush duhet të luftojë!*". Prefekt!*Hysen Tërpeza ta jap besën, zotëri prefekt se me ditë që do të bëhen rrafsh Kosova dhe Shqipëria, se pa luftuar kundër armikut nuk do ta lë* ". Vendasit e kishin pranuar dhe ishin rreshtuar përkrah Luftës nacional çlirimtare, por jo të nënshtruar edhe me pushtimin nga sllavokomunistet . Ali Draga, i biri i Ferat Dragës ministër në Beograd : * Njoftonte se" Përkrahja prej boshtit (Anglo-amerikan) që kishte fituar në vitin 1942, (kah fundi i '44-tës) nuk ekziston më prej marrëveshjes së Jaltës"(kumtuar nga dëshmitarët e kohës).

11

Gjilani ishte qytet, qendër kazaje në sanxhakun e Prishtinës të vilajetit të Kosovës pranë një lumit që derdhet në Moravë. Sipas Sami Frashërit, ky qytet ndodhet 35 km në juglindje të Prishtinës, e cila ka 4500 banor. Gjilani ka 2 xhami, 1 kishë, 2 shkolla fillore. Kazaja e Gjilanit kufizohet nga juglindja me kazanë e Prishtinës, në veriperëndim me sanxhakun e Shkupit dhe në verilindje me Serbinë. Së bashku kazaja ka rreth 190 fshatra me 30000 banor.Në territorin e saj shtrihen fushat pjellore dhe e rrethuara me vargmale te Mali i Zi (Karadakut) që përbën kufirin juglindor, në kufirin me Serbinë gjendet mali Goljak (Gollaku), kurse në anën perëndimore shtrihen malet e Zagovcit (Zhegocit) dhe Koniça. Nga këto male zbrasin lumenjtë që formojnë Moravën dhe nëpër kazanë e Gjilanit zbrer në Serbi ku derdhet në Deti i Zi. Kjo kaza është e njohur për ujëra minerale dhe për disa kisha e kala e sidomos për kalanë e Novobërdës e cila gjendet në pjesën veriore të kazasë. (Gjilani zuri një vend të rëndësishëm më enciklopedinë e njohur dhe të parën nga një autor shqiptar siç ishte Sami Frashëri



Kroni i parë i Kokajve përballë shtëpisë së Mësuesit Mustafë Koka

"Prej Kumanove, shkova në katundin Mateç, siç pata mësua gjendej Sylë Hotla me 150 vetë të armatosur. Përveç këtyre, ai kishte edhe tjerë shokë që kishin armë, dhe më tha se në rast nevoje edhe ata mund të vijshin. Për këtë plak të sinqertë, trim dhe me dinjitet, shokët e tij dhe të gjithë shqiptarët e rrethit të Kumanovës kishin respekt. Pa ndonjë vështirësi, ky plak kreshnik dhe unë u muarrëm vesh me i luftue partizanët, se sa këta tentofshin me kalue hekurudhën, e cila ndan shumicën shqiptare prej shumicës serbo-maqedone. Më 11 shtator 1944, u ktheva në Preshevë... " sipas memoareve të prof. Ibrahim Kelmendi-Aliu*[4] , përshkruar gjendjen e para fillimit të luftimeve për mbrojtjen e Preshevës dhe kufijve etnikë. Regjisori i njohur jugosllav, Veljko Bulajiq, duke u bazuar në këtë aktivitet të Mustafë Kokës, sipas skenarit "Poslednje Albanske Bande na Kosometu" (Bandat e fundit të shqipt-arëve në Kosovë), gjiroi filmin e njohur Kapetan Leshi, ku mësuesi që paraqitet në këtë film është Mustafa, kurse vendi është katundi Kokaj. Natyrisht, filmi paraqet ngjarjen e rregulluar sipas shijes së pushtetit okupues serb.



Mësuesi Mustafë Koka, Tiranë, koorik 1947



Burim i të dhënave ¹²

¹² Sipas dokumenteve të botuar Historiku i Preshevës përmbledhje shkrimesh, si dhe libri Ibrahim Kelmendi- Aliu "Presheva-...Ibrahim Osmani-Kelmendi ka *M.Xhemajli: Hysen Tërpeza, një legjendë për Kosovën, Biseda/intervista, dr.Muhamed Pirraku: "Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore...", Anamorava e Kosovës në revolucion 1941-1945 Grup autorësh,artikujt nga autori N.Ramadani:Revista "Fjala jonë", Prishtinë, 1996, "Dëshmi mbi luftën e fundit*Lufta e II Botërore, si dhe dëshmitarëve të pjesëmarrësve të gjallë të atyre ngjarje, Flaka e Revolucionit, pjesa e IX, Skender Latifi- "Lugina e Preshevës...",Emin Pllana, Kosova dhe reformat në Turqi, Prishtinë, 1978. Mr. Aliriza Selmani;Gjilani me rrethinë 1908-1912. Prishtinë 1998

[5] , përshkruar gjendjen e para fillimit të luftimeve për mbrojtjen e Preshevës dhe kufijve etnikë.

- Dr.Fehmi Rexhepit, historian dhe dokumenteve arkivore të arkivit rajonal të Gjilanit, Shkupit, Kumanovës të arkivuara nga Selim Norça, Kurtesh Agushi,



KOKAJT ME RRETHINË ~ KOKAJT E KOKALLARË

Kokaj është një fshat në Malet e Karadakut (Malet e Zeza), Gjilan, Kosovë. Vendbanimi Kokaj shtrihet në juglindje të territorit të Komunës së Gjilanit, gjegjësisht në skajin juglindor të territorit të Kosovës. Ky vendbanim i vendosur

Hoxhë Ibrahim Capari, si dhe të bashkëpunëtorëve e dëshmitarëve të atyre ngjarjeve të Kardakut 1941-1943, të botuara edhe në librin "Flaka" (pjesa e IX) nga Autobiografia.

- LNÇ në rrethinën e Gjilanit nga dr .Fehmi Rexhepi

Kurtesh Agushi jetonte në Shkup, ishte një ish-student i Beogradit, dhe njeri kyç i LNÇ-së në rajonin juglindor të Kosovës, i cili në vitin 1936 kishte marrë pjesë në demons-tratat e studentëve dhe të komunistëve të Beogradit për të kërkuar armë që të shkonte e të luftonte në Spanjë, dhe kryetar komune në Kamenicë (Dardanë-Ibrahim Osmani-Kelmendi ka lindur më 16.04.1916 në Preshevë.

thellë në Malet e Karadakut është 18 km larg Gjilanit(12.2 km vija ajrore nga qendra e Gjilanit dhe 10.20 nga qendra e Preshevës dhe 17 km nga Bujanoci). Fshat kodrinor-malor i tipit të shpërndarë, i vendosur në shpatet e Maleve të Karadakut, në gjerësinë gjeografike veriore prej 42° 23' 26 dhe 21° 34' 46 të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimin Kokaj e përbëjnë tri lagje: Lagjja e Poshtme, Lagjja e Epërme dhe në mes të tyre Lagjja e Gurinës. Për nga lartësia mbidetare dallojnë lagjet njëra prej tjetrës. Nga 650 m lagjja e Poshtme, 700 m e Gurinës dhe 750-800 ajo e Epërmja. Maja më e lartë arrin 860 m lartësi mbidetare. Territori i katundit Kokaj kufizohet me atë të Llocës në veri, të Sllubicës në lindje, në jug me Maxherën dhe Ranatocin (që i takojnë komunë së Preshevës) e në perëndim me territorin e Myqëbabës dhe Buricës. Ndryshe territori i katundit Kokaj shtrihet nga Lumi i Sllubicës në lindje , deri te Lumi Llapusha (Lapushnica) në perëndim dhe nga Kodra e Lestes (Llocë) në veri deri te vendi i ashtuquajtur Atare në jug (Ranatoci). Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të katundit Kokaj është 402.52 ha. Katundi Kokaj i takon Bashkësisë Lokale të Pogradjës¹³. E tërë Bashkësia Lokale e Pogradjës ka një sipërfaqe prej 50km² ose 9.7% të territorit të komunës, në vitin 1981 përbënte 4.3 % të tërë numrit të banorëve të kom-unës, ndërsa pas luftës edhe pjesëmarrja e popullsisë është edhe më e vogël. Komuna e Gjilanit ka territor prej 253 km² dhe rreth 130.000 banor (vlerësim viti 2003). Si vendbanim është krijuar para dy shekujve kur banorët e parë erdhën nga vendbanimi i Sanxhakut të Nishit, Klaiq. Katundi Kokaj përbëhet prej tri lagjeve të ndara njëra nga tjetra, e ato janë: Mëhalla e Poshtme, Mëhalla e Epërme dhe në mes tyre shtrihet Gurina *Shkolla e katundit.

¹³ Wikipedia shqip|kategoria|Kokaj|grup përdoruesish



SHTRIRJA DHE HAPËSIRA GJEOGRAFIKE-POZITA¹⁴

Në shikim, të relievit të kësaj treve qartë dallohen: pjesa e ulët e Luginës së Moravës së Biçës në qendër të kësaj treve që shtrihet prej anës perëndimore e deri në verilindje. Duke shkuar kah ana jugore dallohet Lugina e lumit Sllubica. Në anën perëndimore lumi i Llapushë*La(puss) nga latinishtja Guri i bardhë thelluar shtratin e vet e që dallohet me këtë veçori nga të gjithë lumenjtë e Anamoravës, gjegjësisht nga degët e Moravës së Binçës. Në mes lumit Llapushë dhe lumit Sllubica shtrihen kodrat si fillim i Malave të Karadakut, të cilat arrijnë lartësinë deri në 850m (Kodërgati). Në anën lindore të kësaj treve prej lumit Sllubica dhe Moravës së Binçës ngritët kodra e Garës dhe ajo e Dupillës, gjithashtu vazhdim i Maleve të Karadakut me lartësi deri 937 m. Kurse në anën veriore ngritët kodra memajën Shpati i Keq me 815 m lartësi mbidetare¹⁵.

KUSHTET ATMOSFERIKE DHE RRJEDHAT ... ¹⁶ -

Klima në juglindje të Kosovës është e mesme kontinentale , ngase ka një lartësi relative mbidetare prej 110 m. Nuk ka erëra të forta në këtë fushë. Rëndom fryn veriu, i cili vjen nga verilindja. Kjo erë veriu që është mjaftë e thatë, e shpeshherë kur vjen me borë edhe shiu është rebesh i imët dhe i shkurtër. Kjo erë është e ftohtë, gjatë dimrit shpesh sjell

¹⁴ Wikipedia shqip|kategoria|Kokaj|grup përdoruesish

¹⁵ Wikipedia. Karadaku

[Dardha](#)

borë të imët. Era perëndimore, e cila vjen nga drejtimi i Prishtinës, nëpër në Anamoravë sjell shi e herë-herë është shumë e fortë. Në popull njihet si " *Era e Kosovës*", dhe për këtë erë thonë se " *edhe lag edhe thanë*". Nga jugu , kah Malet e Karadakut fryn era e cila dimrit sjell mot të butë, për këtë erë në Karadak thonë se " *e shkrinë borën*". Anamorava dhe vendbanimet përreth kanë dimra të butë. Përgjatë fushë së Anamoravës si në atë të Epërmen dhe në at të Poshtmen janë prezent rrymat e erërave. Pjesa më e nxehtë është Anamorava e Poshtme, kurse pjesët më të larta janë më të ftohta. Luginat mund të konstatojmë se janë më të mbrojtura nga erërat sesa kodrat përreth. Janë erërat veriore dhe perëndimore të cilat sjellin të reshura, ndërkaq, mesatarja vjetore për rajonin e juglindjes së Kosovën është mbi 10.6⁰ C. Mesatarisht, të reshurat vjetore janë të mëdha, 550 mm, kurse në pjesët më të ulta janë më të vogla se sa në viset më të larta në shpatet e Maleve të Karadakut, ku diferencat hipsometrike të luginave dhe maleve në rajonin e juglindjes shkaktojnë ndryshimin e temperaturave, erërave dhe ndikojnë në rrjedhat ujore, në truall, në botën bimore e shtazor edhe në vetë aktivitetin e njeriut. Prej rrjedhave ujore vija më e gjatë është Morava e Binçës, por rëndësi të madhe ka edhe Reka e Karadakut, Sllubica¹⁷ dhe Llapusha (nica). Në të kaluarën këta dy lumenj më së shumti shfrytëzoheshin për t'i vënë në lëvizje shumë mullinj për bluarjen e drithërave. Luginat e këtyre lumenjve janë me sipërfaqe të punuara, kurse kodrinat me livadhe e kullosa. Puna ekspluatuese e njeriut, eruzioni nga të reshurat i kanë ndryshuar pamje në natyrën e kësaj treve ekologjike. Druri ka qenë bazë më e madhe, dhe tash po shkatërrohet sepse më pak po përdorët në ndërtimtari, duke ia zbritur rëndësinë e tij si dru vetëm për djegje, ndërsa sipërfaqet e punuara

¹⁷ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Sllubica>

gjithnjë po reduktohen, e më tepër po kthehen në djerrina.

ETIMOLOGJIA PËR KOKAJ

Kokajt nga vendi Dardhë (Pukë)

Në vitet '80-ta të shekullit XX vendbanimi Dardhë (Pukë) arrinte në 300 shtëpi. Dardhë (Pukë) ka qenë e banuar që në lashtësi. ... Vllaznitë janë Kokaj e Bibaj. Nga Kokajt janë

vllaznitë: Çela (Çelakaj), Selmani (Selman), Margjeçi (Margjeç). Nga Bibajt janë

vllaznitë: Pali ... Shqipëria etnike / shqip / nr.143[[2]]. Tuma supozohet se është e shekullit VI, p. e s. ku janë gjetur importe të vazove greke Lluga e Becit, Livadhi i Din Imerit, Kodrat e Kokajve, Bunari i Avdisë, etj.



Dardhë(Pukë)

Kokajt nga fshati Dardhë (Pukë) shtrihen në verilindje të Pukës, në të majtë të Drinit, përballë Berishës së Radogoshit e Bytyçit (Tropojë), Lugut të Bytyçit. Në vitet '80-ta të shekullit XX vendbanimi Dardhë (Pukë) arrinte në 300 shtëpi [3]. Dardhë (Pukë) ka qenë e banuar që në lashtësi. ... Vllaznitë janë Kokaj e Bibaj, nga Kokajt janë vllaznitë: Çela (Çelakaj), Selmani (Selman), Margjeçi (Margjeç). Nga Bibajt janë vllaznitë: Pali ... Shqipëria etnike /shqip / nr.143. Në lartësinë e udhës automobilistike, nga Qafa e Shkambit vizitorit i shfaqet përpara sysh një

fushëpamje madhështore: Qebiku në të majtë të lumit, poshtë Pjashtog (*dikur një fushë e gjerë dhe shumë pjellore tani e përmytur nga Drini*)- *Bregu i Dardhës me Vaun*; Tejdrinja duke filluar me Hasin, Bytyçin, Pla e Gash, Sernica me Krasniqe dhe më në thellësi Alpet, Dardha pasqyrohet për here të pare në dokumentet osmane, ku del në trajtën Darda. Më 1529 – 1536 shënohet me 13 zjarre (shtëpi). Me 1571 dhe 1591 shënohet me 10 shpi. Siç shihet për 60 vjet nuk ka rritje, përkundrazi pakësim shtëpish. Edhe pas afro nje shekull e gjysmë, më 1671 Don Stefano Gaspari rregjistron vetëm 12 shtëpi me 130 frymë. Nga këto të dhëna shihet se Dardha, si dhe fashatra të tjera të Pukës, kanë pësuar dëme të mëdha e shkatërrime gjatë shek. XV – XVII. [[4]] Në fundshekullin e XIX katundi i Dardhës është njohur me 80 shtëpi. Në vitet “80 të shekullit XX Dardha arrinte në 300 shtëpi[[5]].Dardha ka qenë e banuar që në lashtësi. Edhe emri është me origjinë ilire. Prof. Eqerem Çabej në “*Studime etimologjike në fushën e shqipes*”, III. Tiranë, 1987, shpjegon: “dardhë, f. këtë fjalë e lidhin që prej Hahnit e këtej me emrin e popullit dardan e të vendit të tyre Dardania ... e mbarë shqipes”.Dardha[[6]])





Alpet shqiptare



Ura e Vezirit Kukës



Perroi i Kokaj, Kukës, Albania

KURBINI:Tribuna Shqiptare - Rrjolli: Shkruante se... Kokaj të besimit katolik ish nga shekulli i katërt pas lindjes së Krishtit hyjnor! Ndër vite u ngrite flamuri i Skenderbeut mbi vidhin e madh të Kokajve. shpalosnin Flamurin e Kastriotit. ... Sipas gojëdhënave: Kështjellën e pat rindërtuar ushtria e Gjergj Kastriotit - (Skënderbeut) para një beteje antiturke, që quhet Beteja e Kirit. Po sipas gojëdhënave, kjo kështjellë priti vetë Skënderbeun, që për nder të tij ranë fuqishëm këmbanat e kishës së Shën Gjergjit të Ballexës, që thuhet se u dëgjuan deri larg në

fshatrat e Krajës. Kjo pra tregon për rëndësinë që kishte në luftën kundër osmanllinjve Malësia e Madhe,

Rrjoll me vetë pozitën gjeografike dominuese, si dhe me vetë zhvillimin e kësaj treve, ku shpesh flitet se këtu preheshin pará (lekë), e prodhohej baruti. Duhet theksuar se pas pushtimit Turk, kjo kështjellë thujse u shkatërrua, aq sa këtu banonin vetëm 4-5 familje. Për kështjellën në qytezën e Ballexës, sipas gojëdhënave flitet se shërbente si vend që mblihdeshin të gjithë burrat e mençur të Malësia e Madhe për të organizuar besëlidhjet e tyre, e vendi ku takoheshin quhej Çang, ku edhe sot e kësaj dite, malësorët e quajnë këtë "Kështjellë", "Forca e **Lekëve**" (*shqiptarëve Verior*". Edhe në kohën e Balshajve, kjo kështjellë ishte përdorur si vend strehim (Rrjoll)^[1].

Në Rrjoll është një lagje, në Rrjoll ka pasur një qytetërim të pashoq e që ka lulëzuar në mesjetën e hershme e deri ato të Lezhës , Durrësit e Drishtit etj. Rrjoll ka qenë i përmendur për mullinjtë e tij, të shumtë e modernë për kohën, ku përmenden mbi 40 mullinj. Këtë fakt e vërteton më së miri edhe mbiemri Mullisi në shumicë. Madje në Rrjoll gjindeshin Valanicat që përgat-itnin shajakun, me të cilin bënin veshjet e tyre. Në një dokument të vitit 1881 thuhet se Rrjoll ishte bajrak në vehte me 163 shtëpi e 1310 banorë, ku të gjithë ishin katolikë. Për prejardhjen e Rrjollit ka shumë hipoteza, mendohet që ata që janë të ardhur nga Kuçi (shqiptarë). Në një dokument Osman thuhet se: "Bajra-ktar ka qenë nga fisi (katolik) i Kokajve, (Kokë Leka) por duke qenë aleat me kryengritësit Dervishajt nga Shkodra kundër Vezirit, u zëvendësua me një musliman nga Kurtajt". Gojëdhana nga historia e treguar prej fisit Kokajve: Aty thonë se i pari që u bë me një fe me turkun ishte marrë si humbje gjaku dhe fisi e nderi. Hasani, një ndër katër vëllazëritë të fisit, nga ata sa numërohen ndër krerët e fisit të Kabashit që donte të krijonte karrierë në hierarkinë e Osmane. Mirëpo, feja ua

kishte prerë lakun dhe, vendosi të ndërronte atë pa i pyetur krerët e fisit që lidheshin *si mishi e thoi*, edhe atë për një copë tokë që kishte marrë ngaveziri. Ndonëse nga ajo kohë po kalonte qysh në kohën kur po e bënte një shekull, gati pas betimit që kishin bërë para të madhit Skënderbeu, për ta luftuar turkun në rrethin e Arbërisë veriore. Ishte i katërti i vëllezërve Kokë Lekatë fisit që Hasani i kishte hatëruar shumë. Kokaj i hidhëruar si një nga ata më zemërakët, thonë se tradita e paska kthyer në njeri që preu besën e Lekës. Hasani si denim do të lëshonte vendin për t'u arratisur për Kosovë. Pas një kohë, kur u bisedua me krerët e familjes së Hasanit, ai vet po e marrka vesh betimin e vëllait të madh, Kokë Lekës. Koka *ke thye besën e fisit dhe ke kaluar në fenë e turkut* që sipas hesapeve të fisit. Hasan Koka e dinte vetë sesa ishte zemëruar dhe fort i rreptë në këto hesape, sepse se duronte kush atë në fise si "kokë turku!". Këtë e hetoi edhe vëllai tij, dhe pa një pa dy, ai vendosi që të largohet para se ta dëbonin. Një ditë prej ditësh mblodhën pleqësinë nga katër krerët e fisit dhe Kokën si kryeplak e priti me të keq këtë që Koka i vihet pas vëllait në pritë te Ura e Vezirit pran Kukësit,.. Më vonë takohen krerët e fisit. Në Kuvend u mblodhen pa qenë asnjë kundër se, Kokaj u shpallë fajtor përndjekjen dhe që Leqiti- vëllain Hasanit. Kuvendi solli vendim se nuk i vihet prita vëllai pse kalon me fe tjetër, i thanë burrat e Kabashit. Kështjella Lekëve pa kurrfarë të keqe e vendosi t'i bëjë leqe duke ia hequr vendin pijetar të fisit të Kokës e t'ia jepte Qafës, vëllait të dytë sipas hierarkisë. Kokaj e humbi edhe vetë mbeti në dorën e pleqnarëve të tjerë. Megjithatë, nuk e lanë keq shumë. Ai mbeti me atë që u la vendi i plakut, që do të thoshte sipas Kanunit, kreun Vezirit, ndër katër pleqtë e fisit sa ishin në pleqësi në Kabashit. ...Ja, historia e treguar nga fisi i Kokajve: Gjatë kohës së Gjergj Kastrioti {Skenderbeu...Malësia ende po i këndonte Kabashi- me aq zë që kishte: *Dy trima dy atdhetar, që i*


kishte Arbëria mbarë/ Njëri ishte Gjergj
 Kastrioti etjetri Kokaj. Kokajt i takojnë besimit
 katolik(kishës bizantine dhe asaj naplitane) në veri dhe në
 jug, ndërsa prej shekullit XVI, ka pasur kalime në islam,
 shumica e atyre që tash shtrihen në Kosovë, Lugina e
Preshevës Maqedoni dhe te Mali i Zi, si dhe diasporë. Ja, si
 e përshkruan- rapsodi shqiptar të Kënga epika e jonë,
 ngjarjet e më vonshme: Atje në Lidhjen e Prizrenit/ me Abdyl
Frashërin e shumë patriot për t'i dalë Shqiptarisë zot .
Pushka- anëmbanë krisi/ u sulën hordhitë turke të Dervish
Pasha/dhe kullave të Skurajve u vunë flakë përsëri e gjithë
 veriut me shpi për ship/ por nuk mposhtej zogu i shqipës/ as
 nuk mposhtejshin bijt e Kurbinit kurrënë luftën e vendosun
 për liri! Gju për gju me Gjin Pjetrin/ Plakut ligjëvenës
 at Shtjefën Gjeçovi radhiste te Kanuni i Lek Dukagjinit/
Kanuni i maleve shqiptare dhe Patër Klement Milaj/
 shkruente historinë e Kurbinit shkruente për Gjin Pjetrin,
 për burra luftëtarë, për- lufta e beteja, qysh
 nga Pllana e Zheja deri te Skuraj e Tallajbeja/ për
 burrat laçianë milotas/ zhenjanë lesteras e shllaznianë/
 malbardhas shkopetas gallatas/ gurrzakë e bregamatas / që
 në t'aguem të 28 nandorit mes Milotit t'ati viti vitit të
 'dymbëdhjetë mbi vidhin e madh
 të Kokajve shpalosnin Flamurin e Kastriotit me fjalën e
 rrebtë trimnore të Gjin Pjetrit dhe me krismen e gjashtës së
 tij mizore/ e të treqint pushkëve breshëri/ të treqint burrave
 luftëtarë / të Kurbinit- Krujës mbarë /
 Rroftë Liria/Rroftë flamuri kuq e zi !
**Kokajt e Qeparoit dhe të Pilurit nga jugu
 në Himarë janë me të gjitha mëhallat e tyre me gjak dhe
 vend shqiptar**



Qeparoi i vjetër

Koço Kokëdhima(shkruan editor i gazettes më tirazh më të madh në Shqipëri” Shekulli”): *Nuk kemi shpjeguar akoma vetëm historinë e mëhallës së Dhimëgjonajve. Kjo u krijua nga Dhimë Gjoni. Ky ishte nga Kërshavëza e Korfuzit. Ai ishte peshkatar dhe vrau një person e ra në hasmëri në vendin e tij. Erdhi vetëm në Qeparo dhe u vendos në një shpellë buzë detit në Skalomë. Qysh në shekullin e 16-të, që kur ka ndodhur kjo histori, edhe sot, shpella në fjalë quhet Shpella e Frëngut (shpella e të huajit, konsiderohet të jetë ardhur nga vendbanim Fushëdjegur, që pas vdekjes së Skenderbeut dhe rëniesë së shtetit të tij). Dhimë Gjoni, me kalimin e kohës, u njoh me fshatin dhe fshati e pranoi dhe i dha nuse një vajze vendi, me te cilën bëri Gjon Dhimën. Dhe kështu nisi Mëhalla e Dhimëgjonasve me Gumaj-t, Oesarajt, Kokajt, Kondajt, Merxhanajt, Mëhillajt, Stamatajt. Nga Kokajt (që konsiderohen se janë vlonjat të ardhur nga rrethi i Vlorës, konkretisht nga vendbanimi Fushëdjegur, ku vetë një banorë i kësaj mëhalle (Kokaj), ku të gjitha fiset dhe familjet e tjera të fshatit tonë janë shqiptare të pastër prej vendi, prej gjuhe e prej gjaku. Ish-gazetarja e Shekulli-t, Lindita Çela, në muajin gusht të vitit 2012, u intervistua Koço Koka, por nuk i kuptoi mirë dhe i shkroi gabim shpjegimet dhe fjalët e tij për historinë e familjes së Xhorxh Tenetit[9]]. Koço Koka e shpjegoi historinë kështu siç është e vërteta. Historia dhe pema*

gjenealogjike e Dhimëgjonajve u shkrua nga Nine Guma, në fillim të shekullit të 20-të. Ai u vra në luftën italo-greke. Gjatë bombardimeve italiane ra një predhë në shtëpinë e tij dhe e vrau. Pas tij, pemën gjenealogjike të Dhimëgjonajve e ka plotësuar dhe vazhdon ta mirëmbajë edhe sot nipi i Nines, miku dhe bashkëfshatari im Vasil Guma. Nine Guma përmendet edhe sot për bletët e tij. Ai, në vitet '30 kishte 200 koshere, që i mbante në Harcale.



Pilur

Koço Kokëdhima: *Projekti 200-vjeçar grek për aneksimin e Himarës. Ne jemi dy popujt më të vjetër të Ballkanit dhe kemi jetuar gjithmonë si dy vëllezër e nuk kemi luftuar kurrë kundër njëri-tjetrit*”, publikuar më 12.03.2013 / 12:00] </ref> Kokëdhima u rikthehet rrënjëve të të parëve. Bën pemën gjenealogjike, kthehet shekuj prapa, te historia e të parëve të gjakut të vet që erdhën në të shkuarën e largët nga Tërbaçi i Vlorës për tu ngulur në Qeparoi (Himarë, jugu i Shqipërisë).

Koço Kokëdhima: Ishte një ikje e detyruar, nën dhunën e pushtuesit Osman, për të mos dorëzuar fenë e krishterë. Për të hedhur rrënjë të reja atje lart në Qeparo, buzë Deti Jonit, mes shkëmbinjve, ullinjve më të vjeter të Kokajve në botë, vendasve që i pranuan për tu bërë pjesë e tyrja. Djali i Qeparoit, kthehet tu japë përgjigje atyre pyetjeve të famshme, që po një tjetër djalë himarjot, Petro Marko i

famshëm bënte dekada më parë: Pra ç'jemi ne? Shqiptarë! Po pse e humbëm gjuhën? Ashtu edhe KoëoKokëdhima që sot ka përgjigjet e veta. Ka bërë dhe bën biznesmenin,botuesin dhe kësaj radhe provokon duke bërë

studiuesi: sjell ritet, zakonet, doket, lojrat, mërgimin dhe mërgimtarët, luftërat dhe luftëtarët, vende dhe ngjarje për të ngulur në mendje të të gjithëve: Himara ka qenë, është dhe do të mbetet thjesht një tokë shqiptare.

Ndërkaq, pos Kokajve të shtrirë gjithandej etnis dhe trugut shqiptare dhe diasporë-Kokajt e pilurjotet e kanë prejardhjen nga fshati i vjeter Pilurnë verilindje të fshatit të sotshëm, (Pilur). U larguan nga katundi i vjeter në vitin 1650. Pilurjotet ne fillim shkuan në Kastanë por shpejtë u larguan prej andej dhe u vendosën ne fshatin e sotshëm Pilur që ndodhen aty edhe sot e kësaj dite. Disa duan të thonë se ne jemi të ardhur, nga krahinat veriore të Mirditës, Dukagjini etj. Veshjet tradicionale- Veshja tradicionale Pilurjote është fustanella e famshme me xhamadan. Fiset e fshatit: Pilarjotet e fshatit Pilur janë fiset pos Kokajve, dhe Tavaj, Qesaraj, Gjijnaj, Dedelagaj, Gjikedhi maj, Dhramaj, Krekaj

[KURBINIT](#)«[TribunaShqiptare](#)

(<http://sq.wikipedia.org/wiki/Qeparoi>)



Qeparo, Himarë, Delvinë



Emrin “Kokaj” rrjedh nga familja e dikurshme feudale që kishte përjetuar lulëzimin më të lartë në periudhën e formimit të shtetit të Arbrit, si dhe gjatë periudhës së shtetit të Skenderbeut . Familja Kokaj nga etimologjia e emërtimi Koka (dialekti toskë) ka qenë e vendosur në Fushëdjegur të rrethit të Vlorës, Delvinë, Sarandë. Sipas diplomatit dhe historianit Mr.Vrion Koka pas rënies së shtetit të Gjergj Kastrioti - Skenderbeu janë depërtuar banorët e kësaj familje, shumica për Itali¹⁸ e vende tjera. Një vendbanimi me emrin *Kokaj* është në *Fushën e Mbishkodrës në Shqipërinë Veriore* * *Mati në Veri të Koplikut, deri në një Lagje në Klaië të Lebanës, Kokajt e Gjilanit, Kaçaniku(Kokajt)*¹⁹ . Me të njëjtin emër quhet edhe përroi në qytetin Bajram Curr. Mati dhe Dibër, Malësia e Tuzit, Gjakovë, Shkoder, dhe Tiranë, si dhe te arbëreshet e Italisë dhe arnautet e Turqisë. Klaiqi është vendbanim në Dardanië verilindore (sot Serbia jugore) prej nga kishin ardhur banorët e katundi Kokaj. Nga ky vendbanim pra e kanë prejardhjen banorët e katundit Kokaj të Karadakut.

18 Në këto intervista kanë qenë: *historia e dhimbshme e përmendin shtegtime drejt Italisë së shqiptarëve nga Kruja, Shkodra, çamërishtes të cilat i gjejmë tek pjesë nga monografia “Të folmet arbëreshe të...”, Vera Koka: *Une jam nga Mati..! Mbimeri Koka është mbimeri i vajzërisë ndersa Kurti i martesës..! Origjina e largët nga Vlora (Fushëdjegur) por që edhe babai im është lind e rrit në Mati.. Origjina e Kastrioteve.. Në përshkrimin që i bëhet Kosturrit tek Origjina Sknderbeut dhe Kastrioteve përshkruhen edhe pozicioni gjeografik dhe lumejtqë kalojnë në brigjet e tokave të Kosturrit, gjë që nuk i ka asnjë vend tjetër....Si pas Fran Bardhit, kur Balsha i Shkodrës dikur u fuqizue më shumë, atëherë vllazëria e kastrioteve lëvizën e u larguan nga Kosturri. Thuhet se fillimisht zunë vend në Ujmisht të krahinës së Lumës, ku ndërtnuan edhe dy-tre kala të vogla... Mandej udhëtuen duke lëvizur vazhdimisht e ndrruar vend, nga Luma e Kuksit në Diber, mandej Mat, Krujë... e së fundi siç dihet Gjon Kastrioti u vendos në Krujë. Koço Kokëdhima: Projekti 200-vjeçar grek për aneksimin e Himarës. *Kokëdhima që sot ka përgjigjet e veta. Ka bërë dhe bën biznesmenin, botuesin dhe kësaj radhe provokon duke bërë studiuesin: sjell ritet, zakonet, doket, lojrat, mërgimin dhe mërgimtarët, luftëtarët dhe luftëtarët, vende dhe ngjarje për të ngulur në mendje të të gjithëve: Himara ka qenë, është dhe do të mbetet thjesht një tokë shqiptare.* Lufta e Kokajve dhe Mustafajve të Delvinës për pushtet. Vj.1704: *Asgjë nuk e prishi qetësinë në tri ditët e para. Selim Bej Koka me të shoqen kishin vrarë veten. Krerët e tjerë të Delvinës, Gjirokastrës e Kardhiqit me Mustafa Pashën e Demir Dostin me familjet e tyre, nja gjashtëdhjetë rob, Ali Pasha nisi nëJaninë.****

¹⁹ Akademiq me origjinë shqiptare, Aleksander Matkovsik

Klaiqi²⁰ kishte më shumë se 80 shtëpi, kanë qenë të pasur dhe ekonomikisht të zhvilluar për shkak të tokës pjellore, ekonomike zejtare dhe familjare.




Livadhet e Kokajve dhe pylli në Klaiqit

Më 1837 prej Klaiqit janë shpërngulur disa familje, si Kokajt, që kishin mundësi materiale dhe më të pasura për të i ikur ekspeditave të komitëve serb, pasi kishin qenë tagrambledhës (spahi), dhe shtypja ndaj tyre ishte më e theksuar jo vetëm në Klaiq, por edhe në fshatra të tjera, që kufizohej me lagjet dhe vendbanimet e dikurshme shqiptare si: *Gërgurovci*, *Bajra*, *Poroshtica*, *Llapashtica*, *Bucë*, *Drvodol*, etj. Ata duke mbledhur taksa (*të dhjetat*) kanë rënë ndër ta edhe në hasmëri. Pasi Kokajt kishin marrë vendim të shpërngulen detyrimisht pasi që ishte sjellë vendimi i një kuvendi. (është një rrugë e katundit me emrin sokaku i Kokajve). Disa shtëpi, po në atë kohë janë vendosur në Gjilan. Shumica syresh jetojnë edhe sot në këto dy vendbanime. Mandej banorët e lagjes Klaiq të qytetit të Gjilanit, (*të cilit ende i kanë pronat e tyre në Klaiq të nacionalizuara pas Luftës së Dytë Botër-*

²⁰ Rifat Klaiqi, Libri mbi dëbimet nga Gjiu i Toplicës...

ore) muhaxhirët e katundit Kokaj gjegjësisht një lagje të Ranatocit, i cili ndodhet në Karadakun e Preshevës .



Vendbanimi shtrihet (Kokaj) në mes të Gjilanit dhe Preshevës, vendbanim ky që pas vendosjes së pushtimit të Mbretëris SKS njihet edhe me emrin, Inatoc. Mirëpo, banorët e Kokajve dhe rrethina kurrë nuk e kanë njohur me këtë emër, sepse është emër i imponuar me pushtimin e këtyre trojeve nga ushtria serbe në vitin 1912. Qëpari u vendosen në Pogradjë, ku edhe kanë jetuar tre vite. Pastaj tokën e blejtën nga Isa Beu i Shkupit, ndërsa kontratën e kanë bërë “tapi” në Vranjë. Në kontratë shkruante se është paguar toka nga "Kisha e Epërme" në veri e në jug deri në " Zllatare ", ndërsa në lindje nga Lumi Sllubica e në perëndim deri te Lumi Llapushnicë. Klaiqi²¹ është fshat në komunën e Lebanës të Jabllanicës (sot Serbia jugore), dikur i banuar me shqiptarë të cilët u dëbuan me dhunë nga pushtuesit serb. Rreth 50 vjet më vonë në vitin 1878, pas pushtimit nga ushtria e tretë serbe nga banorët e mbetur në Klaiqi të

²¹ <http://www.klaiqi.com/libri>, shtegtime rrugëve të ngrira, R.Klaiqi.

Lebanës katundit Kokaj e dëbuan pas uzurpimit të shtëpive dhe ekonomisë disa familjarëve të Ali Bylykbashi dhe Demir Klaiqit, të cilat vendosën në vendbanimin te Muhaxhirët e sotshëm të Kokajve, sikur edhe tri familje tjera që janë vendosur në mes të Kaçanikut dhe Ferizajt dhe mbajnë mbiemrin Koka, dhe shumë familje tjera në Gjilan, Preshevë, Peja, Prishtinë, Shkup, Gjakova, Kumanovë etj .

Antropogjeografi dhe etnografi serb A. Urosheviq duke u provuar të argumentojë për imigrimin e popullsisë së Kosovës nga Shqipëria, askund nuk përmend se banorët e vendosur në Kokaj janë të shpërngulur nga viset e Serbisë së sotme jugore. Vendbanimin e kanë krijuardy bijtë e Ademit, vëllezërit, Hasimi dhe Ismajli, nga të cilët janë krijuar dy mëhalla: mëhalla e Epërme dhe mëhalla e Poshtme. *Familjet Koka (Hasimi 10 shtëpi) dhe ajo Halilaj (Ismajli, 11 shtëpi) kanë imigruar në këtë vend nga Malësia si katolik, [4].Te kroit të katundit Kokaj, kur u vendosen për herë të parë, Ademi me dy bijtë Hasimin, Ismajlin dhe nipin Ali Bylykbashin.* Nga toponimet më te rëndësishme janë: Harrnicat, Ara e Kishës, Ara e Magjethatës, Dushkaja, Gurina, Rrahi, Kacek-aba, Gumnishta, Dardhishta, Roga e Vogël, Roga Madhe, Firaja, Kacurreta Hajdarit, Roga Rrushit, Roga Fletave, (Zll)Arëtare, Gurët e Kuq, Humëza, Rrezet, Gumnishta, Plepishta, Pehari, Qarret, Lekeni, Zabeli, Livadhi Veselit, Kroni i Dafinit, Hujt e Sahitit, Kroni i Ftonit, Kroni i Haxhi Mustafës, Prroni i Vidhit, Çeshmja e Zahës, Ara Salihit, Ko-saqina, Rrashi Sylës, Ara e Havës, Pusi i Dafinit, Pusi i Kallakanxhës, Lugu i Gjan, Ara Rup, Roga e Musteqerrës, Guri Fetahit, Guri Qahës, Shpella e Kaçakëve, Shpella e Arushës, Puhishta, Rameridi, Varrezat e poshtme, të Gurinës dhe ato të mëhalles së Epërme në Rup dhe ato të Klaiqëve te Muhagjieret e Kokajve, Ara e Eminit, Malet Goleshit, etj. Toponimet e *Muhaxhiereve të Kokajve* janë: Lejthishta, Varret e “Mazëve” (vlenë të përmendet se këto varreza janë në

qendër të fshatit dhe janë të vjetra dhe të panjohura), Imeridi, Goleshi, Kroni i Mines, Kroni i haxhi Isahit, Zllatare e Vogël, Rrezja, Zllatare e Madhe, Peshenica, Arat e Sahitit, Mashalla, Kodra e Luleve, Fërkemi i Kalit, Kroni i Kopilit, Suravaci, Guri i Gjyrishecit, Ara e Kodrës, Sherekica, Përroni i Alisë, Dardhishta, Roga e Dredhëzave, Ara e Bunarit, Te Guri, Guri i Nriklës, Kroni i Ftohtë, Mali dhe Mullini i Dalipit etj Popullësia²² -

Gjeneralogjia e Kokajve *(*Shih skemën familjare të Kokajve*) - Banorët e parë: Ademi me dy bijtë Hasimin dhe Ismajlin dhe nipin e tij, Ali(Bylykbashin). *Mbi kronin e katundit Kokaj u vendosen për herë të parë Ademi me dy bijtë Hasimin dhe Ismajlin dhe nipin e tij, Aliu.* Sipas fletëregjistrimit të parë te hoxha i Pograxhës që është bërë në vitin 1848, dhe regjistrimit zyrtar me 1948 katundi Kokaj ka pasur 250 banorë, në vitin 1953 ka pasur 289 banorë, në vitin 1961,342, në vitin 1971, 386 ndërsa në vitin 1981, 376 banorë. Nga viti 1981 e këndej ka pasur vazhdi-misht zvogëlim të popullsisë si pasojë e emigrimit të banorëve në drejtim të qendrës komunale të Gjilanit. Rënie të numrit të popullsisë ka shkaktuar lufta e fundit kur nga ky fshat u shpërngulën shumica e popullsisë si pasojë e pasigurisë. Në vitin 1999 paramilitarët serbë kanë masakruar disa banorë të këtij katundi. Sot në këtë fshat jetojnë vetëm pesë familje me rreth 30 banorë.

EKONOMIA - Katundi Kokaj është fshat tipik agrar. Nga sipërfaqja e përgjithshme 402.52 ha, 121.21 sipërfaqe me ara, pemishte me 89 ari, me livadhe 5.00 ha, kulloja 20.00 ha, ndërsa pyje 234.00 ha. Sipërfaqet me toka jo produktive janë 23.00 ha²³.

Jetesa në Kokaj - Kur të parët e katundit Kokaj ishin vendosur në këto troje, aty nuk kishte tokë të punueshme. Ata fillimisht merreshin me kultivimin e bagëtisë edhe pse nuk kishte kushte të mira. Kishte pak

²² Wikipediashqip: Kategoria|Kokaj

²³ Bot.Wikipedia shqip/ kateg. Kokaj/

kulloso, kryesisht tereni ishte i mbuluar me pyje jo të kultivuar si duhet. Kështu ata u detyruan të çelin toka të reja, kështu duke i shfrytëzuar drunjët dhe cunga e rrënjët për nxehe, ndërsa toka shndërrohej ne tokë të punueshme, e cila jepte rendimente të dobëta në prodhimin e drithërave. Përveç grurit e misrit, fshatarët kultivonin edhe tërshërën, thekrën, groshë, kunguj, patate, etj. Gjithashtu kultivonin edhe shumë lloje të pemëve e sidomos perimeve, si domate, qepë, specat, tranguj e më vonë edhe shalqirin e pjeprin. Popullata në Kokaj së voni prodhonin edhe bimë industriale, siç është duhani. Ata mbillnin mjaft sipërfaqe me duhan që u mundësonte angazhimin e të gjithë anëtarëve të familjes pavarësisht moshën dhe gjininë. Kultivimi i duhanit deri vonë sillte fitime të mira. Duhani kultivohej sidomos pas Luftës së Dytë botërore, deri ka vitet e tetëdhjeta. Me shtimin e familjeve, edhe krahu i punës, ata vazhdimisht hapnin toka të reja, por gjithnjë burim i jetës në fshat ishte krahas drithërave mbeteshin bagëtia. Në mungesë të kullosave dhe thatësira që mbretëronin kokajt e kishin problem edhe shtimi i fondit dhe kultivimi i bagëtive posaçërisht kopeve me dele dhe të dhive. Nga kafshët më së shumti mbanin lopë (gjedhe), dele, dhi, buallica, kuaj e gomar (për transport) etj. Meshkujt në fillim më shumë ishin të angazhuar në hapjen e tokave të reja dhe ruajtjen e kafshëve, sigurimin e ushqimit, femrat angazhoheshin në përgatitjen e ushqimit, përpunimin e qumështit dhe disa punë të lehtë fushës. Për veshmbathje, më së shumti i bënin nga leshi dhe lëkura e bagëtisë, nga “pastrërma” që thernin për s dimëre. Pastaj nga lëkura e bagëtive vetë i bënin mbathjet - opinga. Zejtaria kishte zënë fill me farkëtarin për mprehjen e sëpatave dhe veglave të punës që e mbante Haliti i Demirit dhe Osmani Isahit. Pas veglave të punës ata bënin edhe armë brezi kapsolla me barut dhe jataganë, zeje kjo e ushtruar edhe sa ishin në vendbanimin e më hershme në Klaiq të Lebanës, ku shumica edhe prej andej kishin sjellë kovaçin dhe vekun, gërhana dhe

mjete tjerrese të leshit. Veglat muzikore fyelli dhe çiftelia bëheshin nga vetë kokallarët si Azizi i Eminit, i bënte çifteliet prej drurit të arrës, defin apo tupanin prej plancit të kafshëve, si dhe fyellin e kavajt prej drurit të shtogut, nërkaq, vëllai i tij, Ibishi e ruante mullirin e katundit. Ahengjet i bëni odave sidomos gjatë dimrit me ditë të tëra, dasmat deri në pesë ditë, prej natës s kanaxhexhit (kallamboqit) të enjteve e deri në ditën e grave deri me 300 mysafirë. Zijafeti bëhej nga magjetoret me të përmendura dhe hyzmeqaret që shërbenin ditë e natë. Nga përpunimi i leshit gratë e vyeshme thurnin gjësende të ndryshme për veshmbathje, si xhemperë, çorapë, etj. Si për fëmijë ashtu edhe për të rritur. Gjithashtu kishte edhe shtëpiake të zonja të cilat dini shumë mirë ta përdorin vekun nga ato që përmenden janë familja e Demir Kllaqit të Muhaxhret e Kokajve (*paisje prej drurit*), të cilat bënin thurjen e qilimave, janave etj. Meshkujt kur mungonte fuqia punëtoreshë punonin arat e tyre, në këto punë shpesh iu ndihmonin edhe femrat, për të siguruar ushqimin për familje, por edhe për bagëtinë. Bagëtinë gjatë verës i kullotnin nëpër fusha e male, por për dimër kishin sanë, kashtë dhe tallë, e cila nuk iu mjaftonte. Ata duhej të përgatitnin për kafshët e tyre edhe ushqimin nga dushku. Kështu ata krositnin drunjtë me dushk të mirë dhe ato në një formë i konservonin duke krijuar stoqe prej dushku. Pastaj në dimër dushku i konservuar përdorej si ushqim për kafshë, por në veçanti për dele e dhi. Drithërat: *gruri, elbi, tërshëra, thekra etj*), ruheshin në hambare të ndërtuar prej dërrasave, ndërsa misri nëpër n tavane të shtëpive ku edhe thahej, mandej nëpër kosha të ndërtuar me thupra druri. Bluarja e këtyre drithërave e bënin në mulliri e ndërtuar në lumin Llapush, si Mulliri i Katundit (që ishte në pronësi të katundit), mandej Mulliri i Dalipit (sipas pronarit). Pas elektrifikimit të katundit në vitet e '70-ta punonin edhe mullini me një guri i Halitit, Latifit, Bislimit, Sahitit, etj. Kokajt dalloheshin edhe me mjeshtëritë e tyre në ndërtimin e objekteve të banimit dhe

të mullinjve. Dalloheshin edhe në përpunimin e drurit në ndërtimtari, i bënin vetë bishtat e mjeteve të punës si: sopatës, kazmës, krenat e trajt, drrasat për shtëpi të gdhendura nga druri i bungut dhe i ahut. Punimi i tokave dhe shfrytëzimi i pyjeve bëhej deri në vitet e '70-ta me mjete primitive. Ata vetë me mjeshturinë e tyre prodhonin mjete të ndryshme pune si qerre, parmenda, zhgedha për tërheqje të qeve, samar për kuaj, mandej mjete për shtëpi si kaca, tpina, lugë, enë të ndryshme prej dheut "botës" kuq, çerep, vorba e etj, ku ende është vendi i quajtur te toka e kuqe në Kokaj. Në fshat kishte edhe bletarë të vyeshëm. Bletari i dalluar ishte plaku i katundit haxhi Isai, haxhi Shaipi. Ata me sukses kultivonte numër të madh të shtëpizave (koshere) me bletë të cilat nuk i kultivonte për përfitime, por më shumë për nevojat e njerëzve të këtyre anëve për qëllime shëndetësore. Fshatarët, atë pak tregti që e bënin, kryesisht realizonin në Preshevë dhe Gjilan. Por vlen të përmendet se kishte edhe të tillë që dinin të bënin tregti, kryesisht me vajguri, krip, sheqer, byber, duhan edhe me qytetet si Kumanova, Shkupi. Përveç punëve të bujqësisë, ku vitet e 70 e 80-ta paisen me traktor dhe mjete tjera agroteknike për kultivimin e bërëqetit dhe ngritjen e minifermeve. Mbase kjo shtoi edhe nevojën dhe interesimi për tregti, shisnin produktet e veta bujqësore dhe blektorale, dhe ato prodhime të bëra nga latimi drurit dhe prej të ardhura të tyre i blenin sende të nevojshme për shtëpi, vajguri, krip, sheqer dhe kafe, mandej duke udhëtuar në qytete të ndryshme edhe jashtë vendit. Njerëzit filluan të ndiejnë nevojën për riorganizimin e ekonomive famljare dhe shtimin e nevojës për një diapazon më të gjerë të diturisë me ekspertë të fushave të ndryshëm, ekonomistë, juristë, arsimtarë të profileve të ndryshëm, mjekë, etj. Kështu që filloi interesimi për shkollim. Për këtë lëmi, do të flasim në kapitullin e veçantë.


Shtëpitë (pojata, mullinjë, oda, shkolla dhe xhami) Shtëpitë vatra të banimit ishin nga llojet e ndryshme në ven-dbanimi Kokaj, ku dalloheshin ato të krijuar para 200 vjet-ëve, ka lënë pak gjurmë të kaluarës materiale nga e kaluara.

Shtëpia e Halitit Merselit (*ish shtëpia e Ramadanit dhe e Halitit Hazirit*)



Në kohën e themelimit të katundit ishin ngritura disa kasolla të tipit dikurshme të banimit mure të mbuluara nën një kulm të mbulluar me kashtë thekre ose fieri, në mes vatra e zjarrit dhe në kulm oxhaku i mbulluar me saqin në mes, veriku i varur me enë bakuri dhe qerep balte, të cilat shtriheshin te shtëpiat e Maliqëve, rrëzë kodrinave pranë prronjëve, stanet (pojatat) e bagëtive, shtëpitë e banimit të fillim shekullit XX, ku dalloheshin ato dykatshe me dritare me grila në katin e përdhësë dhe katin e dytë me parmak, si të Halilajve, Fezajve, pastaj më vonë ato të Rushitëve, Rrustemëve, Mustafës Merselit, Sahitajve, Hasanit, Nevzadit, shtëpia e Halitit, ish shtëpia e Hazirëve, si dhe kasolla e Hasimit, Miftarit, Zahirit, Mehmetit Zylfit (që konsiderohet si shtëpia e parë, tash e Avdilit), Dautit, Syles, Selmanit, Selimit Halitit etj), sikur edhe ato përdhese "Dollma" që kishin dy dhoma me një Gjezenti (Divanhane) me izbe (podrume) dhe ballkon terasa, hajat (krevat). Ato ndërtoheshin si tip i katundit që shtrihen gjithandej malëlesië së Kardakut të Shkupit. Vendbanim me shtëpi të shpërndrara në familje të mëdha

shumë anëtarsh dhe mëhalla e epërme dhe e poshme, si edhe mullinj të shumë karakteristik në lumin pranë Llapushës, prrockën e Kokajve, dhe me puse, kroje në odorre, oda, (*Dalipit, Salihit, Isahut*), dhe me veglat e punës. Në arën e Demir Klaiqit janë gjetur enë, gypa, qypa prej qeramike. Këtë e dëshmojnë: enët funerale, pitoset, veglat e punës, peshojat piramidale e konike dhe enët pothuajse nuk ekzistojnë më. Ruajtjes së tyre askush nuk i ka kushtuar kujdes. Në këtë pikëpamje i tërë rajoni është i varfër. Të parët në këtë hapësirë, siç është thënë edhe më parët, u vendosën në këtë hapësirë para 200 vjetësh.



Shtëpia e Nevzadit

Shtëpia e parë e familjes së parë të ardhur nga Klaiqi ishte një kasolle, e ndërtuar me material të dobët: me shtylla druri apo hunj të gjatë, të ngulitur për tokë dhe e thurur me thupra. Ky lloj muri lyhej me baltë. Mbi të disa drunj në formë trajesh, mbi të cilën radhiteshin drrasat. Mbi to hidhej balta disa familje shtronin fier apo kashtë dhe mbulonin çatit me kashtë Thekre. Ky tip kasollash ndryshohej me kalimin e kohës. Kokajt që në fillim të ardhjes së tyre në këtë rajon dalloheshin nga fshatarët tjerë përreth me talentin e tyre për shtëpianik në banimit dhe në mjete të punës, të cilat vetë i bënin. Edhe pse ishin të fundit që erdhën në këto vise ata u dalluan shumë shpejt me gjeturin e tyre. Shumë

shpejt ndërtuan mullirin e katundit, pastaj nuk u kënaqën me këtë, por ndërtuan edhe të dytin. Të dytin e ndërtoi familja e Rrustemëve. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX ndërtimi i shtëpive arriti një shkallë më të lartë në zhvillimin e arkitekturës. Fillon ndërtimi i shtëpive në kat dhe me material të fortë me gurë, tulla të pjekura dhe haraston (prej rërës e gëlqerës së përzier), dhe muret anësore të trasha 50/70 deri 1metër. Në këtë lloj shtëpive dykatshe* katërdhomshe, tridhomshe përdhese, n'G-e, dhe katrorshe (Kulat), prinin familjet eko-nomikisht më të forta. Këto shtëpi kishin dimensione 8 me 10 metra. Kati i parë ndërtohej me gurë. Tavanin e kishin me dërrasa të trasha , të cilat viheshin mbi trajt të trashë, të cilët ishin të përforcuar me qypri të gjatë tepërtej shtëpisë. Mbi dërrasa hudhej balta e përzier me kashtë. Pra, kjo ishte dyshemeja e katit. .



Sahitajt

Në kat ngjitej me shkallë prej guri e rrasash të lëmuara. Shkallët vendoseshin nga ana e jashtme mbi hyrjen përdhese deri në hajat apo siç quhej “divanhane” të katit dhe hamamxhiku. Nga “divanhaneja” hyhej nëpër dhomat e katit tri sosh. Dhomat ndaheshin me mure të thurura prej pallash nga të dy anë të shtyllave, brenda të cilave viheshin gurë të imët të përzier me baltë. Muret lyheshin me baltë. Më vonë këto mure ndërtoheshin me gurë apo qerpiç të papjekur. Sipër dhomave viheshin trajt, mbi të cilët radhiteshin dërrasat e gdhendura mirë dhe më të holla se të katit

përdhesë. Kulmi i shtëpisë kishte formën e një koni me bazën në formë kubike. Pra, ishin kulm me katër ramje të ujit. Kulmet mbuloheshin me rasa guri apo qeramikë. Dhomat, përveç derës, kishin nga një dritare, madhësitë e tyre ishin të ndryshme, të cilat mbylleshin me një letër të trashë të ngjitur për druri me brum buke. Këto më vonë u zëvendësuan me xhama. Kati i parë sherbetnte si dhomë dite, ishte “shpija e zjarrit”. Aty qëndronin gjatë ditës gratë dhe fëmijët. Aty përgatitej ushqimi. Aty gratë punonin punëdoret e tyre nga leshi, pambuku etj. Në këtë dhomë ditore hyhej me opinga mbathur. Disa stola (shkama) me tri këmbë shërbenin për ulje. Dhoma ditore apo kati përdhesë kishte një oxhak bukur të madh dhe trapazanin. Lartësia e harkut të tij ishte deri 1.5 m, ndërsa gjerësia e tij (7.5 m) sa për të zënë saçin, çerepin, tepsinë, kazanët etj. Nga oxhaku lëshohej një zinxhirë i trashë - veriga në të cili vareshin kusia e kazanët me ujë për t’u ngrohur. Pranë oxh-akut, na një skaj, vendosej çerepi i nxehtë me zjarr për t’u pjekur buka. Kjo mbulohej me gaca e hi të nxehtë. Xhyveçat e botës për gjellëra vendoseshin mbi “*sanxhak*” trekëmbësh. Në mungesë të tij përdoreshin gurët. Mbi të vendosej saçi për ta pjekur bukën. Në një skaj të dhomës ishte magjja ku ulej brumi dhe gatuhej buka e pitja. Na magje mbahej mielli. Në muret e dhomës vareshin mjetet e kuzhinës, si sita, fërterja, lekat për ujë, tas, lugjet e drunit e gjëra tjera. Deri vonë shumë sosh, në katin përdhesë, në gjysmën e dytë të dhomës ishin të vendosura bagëtia e trashë. Pra, në një mënyrë shërbente si ahur të cilat i ngjiteshin shtëpive si aneks. Kjo ishte e ndarë me një mur prej dërrasash. Por, kishte raste kur kjo pjesë ndahej me mure prej pallzinash apo edhe çerpiçesh. Në katin e shtëpisë hyrja ishte nëpërmjet shkllëve të gurit apo drurit, nga ana e jashtme e shtëpisë ose brenda deri në hajat apo ballkon. Ky hajat ishte në formë të një paradhome, i hapur, me një thurrje prej dërrasash deri dy metra lartësi. Kjo hapësirë shërbente për ndeja gjatë ditës

dhe vrojtohej rrethina, mëhalla, natyra.... Në disa sosh, një pjesë shtrohej me fier e kashtë , mbi të cilat qitej çerga, hasra etj. Në këtë hajat, në vazhdim në korridor kishte edhe një trapazan, ku vendoseshin teshat e fjetjes së dhomave e gjësende tjera. Dhoma më e mirë ishte e dhoma e musafirëve. Ajo dallohej prej të tjerave për derë, dritare , tavan e mure , shtrojë e mbulojë më të mirë. Mysafiri, sipas traditës, duhet të pritet mirë dhe përcillet i lumtur. Këto shtëpi të mëdha kryesisht të familjeve të forta ekonomikisht kishin edhe oborr të madh. Oborri ishte i thurrur me thupra, mbi të cilin qiteshin therra si mbulojë. Në hyrje të oborrit ishin dyert prej dërrasave, ndërsa pranë tyre një derë e ndarë që quhej kapixhik, që shërbente për hyrje dhe dalje nga oborri. Në oborr ishin renditur objektet përcjellëse të shtëpisë si: oda e muafirëve, pozllomi (ahuri) për bagëti të trashë, pjata me torishten përjashta për bagëtinë e imët, pastaj koshi për misër, hambari i drithërave , fllaniku i bulmetit , koteci i pulave etj. Diku në ndonjë kënd ishte i lidhur qeni i shtëpisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore -

Në Kokaj fillon ndërtimi i një tipi i ri i ndërtimit të shtëpive. Ishin këto ndërtesa dykatëshe e shpesh edhe me podrum (shih foton.): kati përdhese dhe ai mbi të. Edhe kati përdhese edhe ai mbi të kishin nga dy dhoma. Në katin e sipër shkoh-
ej nëpërmjet shkallëve të dërrasave nga bingu ose ahu. Shk-
allët ishin nga ana e brendshme por kishte raste edhe nga të
ishin edhe nga ana e jashtme. Korridori i katit ishte i shtruar
me dërrasa. Ky lloj i shtëpive ndërtohej me material të fortë:
gurë, qerpiç, Qypri, tra, hatlla, shtylla*stub. Kulmi, bëhej
me krena dhe mbuloja bëhej me qeremide apo tjegulla.
Madhësia e odave të këtyre shtëpive ishte, zakonisht, 4 me 4
metra apo oda e ndejave më e madhe. Dyert dhe
dritaret*(xhama) ishin prej druri dhe qelqi. Njëra nga
dhomat e katit përdhesë shërbente si kuzhinë, ndërsa tjetra si
dhomë ndeje. Dhoma në kat ishin dhomat e fjetjes për çiftet
e rinj të familjes, por shërbenin edhe për mysafir. Dhomat

në kat ishin mirë të përgatitura me shtrojë. Që nga dera ishin me qilima, janë, hasra dhe me pustuqia. Muret e dhomave ishin të gëlqerosura, ndërsa dritaret, dyert, dollapet etj ishin të ngjyrosura. Më vonë kah fundi i viteve të 60-ta dhe fillimi i viteve të 70-ta filloi ndërtimi i shtëpive të tipit të ashtuquajtur në "G", sepse kishin formën e shkronjës G, dhe ato dy njëkatëshe: "Dollma" me podrumin "Izma" përdhësës. Kryesisht ishin shtëpi njëkatëshe, më të gjëra se ato më të mëparshme. Me shkallë Brenda ose të jashtme druri apo guri tash nga betoni, hyhej në terracë apo korridor hyrës.. Brenda ka një korridor të gjerë sa një gjysmë dhome. Nga njëra anë e korridorit është dho-ma më e madhe me nish, që shërben për kuzhinë. Në anën tjetër të korridorit janë dy dhoma për fjetje. Prej korridorit shkohet në dy kthina më të vogla: në banjo dhe taulett. Edhe ky tip i shtëpive ndërtohej me material të fortë: gurë, tulla, hekur, beton, qeremide, tjegulla. rtj. Ky lloj i shtëpive është edhe tani pranishëm. Në fillim të viteve të tetëdhjeta filluan dhe u ndërtuan një numër i vogël i shtëpive të reja, por shumë shpejt u ndal ndërtimi sepse me të madhe filloi edhe emigrimi i popullatës në drejtim të qendrës komunale. Shtëpitë e fundit të ndërtuara nuk kanë dallim nga ato të qytetit. I plotësojnë të gjitha nevojat bashkëkohore të familjes. Kanë më shumë dhoma, kuzhinë moderne, dhoma dite e të pritjes, korridore, terca, banjot, shkallët e të tjera. Në këto shtëpi përdorej edhe ujësjellësi me rënie të lirë e edhe me energji elektrike. Këto shtëpi i ndërtuan punëtorët tanë të punësuar në botën e jashtme për anëtarët e familjeve të tyre. Në fshat është ndërprerë ndërtimi, sidomos pas luftës së fundit, ku popullata ishte e rrezikuar nga okupatori serb. Pas luftës ka mbetur një numër i vogël i familjeve që jetojnë në fshat. Pamja që shfaqin për ndërtimet e reja në katund, shtëpi modeste, ndonëse shumë sosh përdhese, i kanë shtuar hjeshinë katundit sa mund të bëjnë jetën jetë aty, por edhe ato të vjetrat tashmë të rrëzbitura edhe pse ende kishin ruajtur atë që ishte më e bukura

me stolisje arkaike prej guri dhe druri të gdhendur e mbuluar me tjegulla të hirta të pjekura në furrë prej ustallarëve të përmendur dhe gurët e drurët e gdhendur të mjeshtërve, udhët me kalldrëme që quhet edhe si udhë e pazarit, dhe këto të rejat të shtruar me rërë. Kokajt gjerë më tash e kanë punuar tokën dhe i ruajtjen bagëtinë si dhe këto veprimtari bënin vetë ose përmes rrogëtarëve të paguar si stinor në Shën Gjergj e Shën Mitër. Edhe krojet e shumta që ka shumë sosh që burojnë rrëzë majes kodrës .

Konfiguracioni i vendbanimit është karakteristike edhe për turistët, plotësojnë bukurinë e kësaj zone malore kufitare, që frekuentohet nga të katër anët e lidhur me rrugë të asfaltuar deri në tre-katër kilometra, por të shtruar me zhavorr, ndonëse jo ende me një infrastrukturë shëndetësore-rekreative dhe sportive, pos asaj që ka falë nëna natyrë e virgjëreshë, pa ndotës, po me ambient ekologjik. Edhe njerëzit janë shumë mikpritës dhe gatuajnë specialitete karakteristike tradicionale dhe evropiane, ndonëse ende nuk ia kanë idenë për ta bërë me një motel, restorant apo bujtinë, duke ia shtuar edhe vend kampingjet për turistë verorë që ia mësojnë të kalojnë pushimet e vikendit apo ato verore në ambiente malore me trastë në krah me pak bukë e dhallë, që tu ikin koha e lirë²⁴ .

Llojlojshmëria e botës bimore dhe shtazore (te Kokajt*
- Sipas njohurive të deri tashme nga njohësit e vendit, pamja e relievit duket e ndryshëm, sikurse edhe klima mjaft e pësh-tatshme, por edhe krojet, pusët, përrockat dhe lumenjtë për anash në lindje dhe perendim; Lallpusha dhe Sllubica me burimet ujore llojet e tokave sidomos kjo varej edhe nga përkuajdesi dhe zgjidhja nga faktori njeri, kanë ndikuar në përhapjet e shumëllojshme të pemëve, bimëve dhe shtazëve. Në hapësirën tokësore të katundit Kokaj, por edhe më gjerë dominojnë bashkësitë bimore të pyjeve, livadheve dhe ato agrare²⁵. Sipas njohurive të deritanishme që janë bërë

²⁴ N. Ramadani, shkrime, artikuj për Kokajt

²⁵ Wikipedia shqip|kategoria|Kokaj|grup përdoruesish

publike nga paraardhësitë e Kokajve, kur ata erdhën si të parët e katundit në këtë vend, daton se sipërfaqja e tokës ishte mbi 90 për qind e mbuluar me pyje dhe fare pak kullosa, Livadhe dhe pjesa tjetër djerrina ndërsa ara s'kishte fare, pyje kanë përhapje drunjë gjethëramës nga ato të dushkut më së shumëti kishte drunjë bungu, qarri, shparthi, bunjëbuta, shkozë e butë dhe e egër, Paja, Blini, Plepi, drunjë me fryte, Murrizi, Kulumria, Kaça, por edhe lloje tjera, lajthia, murrizi, thana, frashri, krekëza, bliri, vidhi, panja, dardha e egër, molla e egër, vidhi. Poashtu edhe bungu dhe ahu gjithnjë e më tepër po rrallohen, ekziston vetëm nëpër disa vende të rralla sikur rrezeve me drunjë bung, kurse rreth përronjëve, aty ku ka më shumë ujë rritet shelgu, plepi. Për shkak të kofiguraci-onit të pjerrtë të sipërfaqeve të punuara të tokave, por edhe ato të papunuara ka pasur dhe ka shembje dheu dhe rritje e erozionit që po shkakton shkatërrimin e tokave të punuesh-me. Me mbjelljen e rigjenerimin e pemëve dhe drunjëve, po i kushtohet pak kujdesi në ripërtëritjen e hapësirave me drunj për ta mbrojtur tokën nga erodimi, poashtu edhe hapësira tjetër me rrethinë dhe gjerë, deri më tash është ruajtur dhe është pasuruar me bimë mjekësore dhe aromash të mira jetësore të një ambienti klimatik me disa bimë mjekuese të tilla, që gjenden në këtë hapësirë: arra, hithi, hurdha, kamomili, karota e egër, kulumbria, lajthia, mëllaga, mështekna, murrizi, fieri, shelgu i bardhë, shtogu, kaça, thana, uthulla, patatja e egër, lëmyshku, lloje të ndryshme të kërpudhave, etj. sikur se edhe disa nga shumë bimë të tjera që ka kjo trevë. Edhe pse hulumtimi, përdorimi dhe kultivimi i këtyre bimëve do të mundësonte përfitime të mëdha dhe një shkallë të rritjes së përkujdesit shëndetësor nga mjekësia popull-ore.Tradicionalisht popullata e këtushme është marrë me pemëtari, rritjen dhe ruajtjen e bagëtisë, ku thjesht jetohej nga mishi, leshi, lëkura, qumështi dhe produktet e tyre, janë siguruar të ardhura për shumë familje, duke i përdorë edhe

për nevoja dhe kushtet e rënda jetësore, si: kau për të lëruar dhe tërhequr qerren, kali për kalërim e ngarkim për bartjen e produkteve për në treg dhe anasjelltas, por pa bagëti nuk është mundur as të mendohet jeta në këtë pjesë malore, ku pas prerjës së pyjeve, i hapnin tokat e reja pjellore për të mbjellur me grurë, misër, fasule, patate, etj. Fillimisht kur sipërfaqet aso kohe ishin të mbushura më shumë me pyje, kokajt kryesisht mbanin lopë, dele dhe dhi, pastaj bagëti të trashë, edhe buajlë më vonë pasi arritën t'i rrisin sipërfaqet me toka të punuara, mbanin edhe kope me lopë dhe dele. Sa për nevoja të veta ata mbanin edhe kuaj, gomarë, qetë pastaj edhe buajë, buallica, ndonëse për mungesë të kullosave për malësorët mbajtja e bagëtive ishte mjaft e kufizuar, sidomos për lagjen e mesme Gurinën dhe atë të poshtme²⁶. Si rezultat i mungesës së hapësirave me kullosa popullata e kokajve ishte e shtërnguar dhe e detyruar që bagëtinë ta çojë edhe në hapësirat e fshatrave fqinje, si në zonën e lumit Sllubicë dhe Llapushnicë kah Burica dhe Myqybaba, por edhe kah Loca dhe Ranatoci, edhe në Magjere, Rekës kah Caravajka, kah i kishin pronat e tyre për rreth katundit. Nga shtazët e egra, egërsirat nëpër malet e katundit dhe rrethinës shpesh duken si bashkëvendas të tyre edhe dhelpra, lepujt, ujqit, vjedullat derrat e egër, kaprojtë, ketrat etj.



Sejdi S.Rexhepi

²⁶ Wikipedia shqip|kategoria|Kokaj|grup përdoruesish

Edhe pse numri i ujqve dhe derrave të egër është shtuar, por edhe zhdukur herë pas here dukshëm, që kanë rrezikuar bagëtinë në fusha, ndërsa derrat kanë shkaktojnë dëme të mëdha arave me të mbjella me misër e poashtu edhe kopshteve. Sipas njoftimeve të bëra nga banorët e këtushëm, kjo është bërë herë pas here si fushatë e organizimit prej shoqatave të gjuetarëve dhe numri të vogël të tyre që mbajnë armë gjuetie që në vitet e shtatë-tetdhjetat kanë pasur armë të tilla çdo e treta shtëpi. Kokajt sikur edhe rrethina e saj është e përshtatshme edhe për pemëtari, si: molla koke, të kuqe, të verdha, të bardha, verore, të ëmblat dhe të tharrtat, të brydhta, dardhat ujëse të verës dhe vjeshtës, bostane, kakiqke, ballgure, verore, dimrore, etj, nga shpezëtaria, si ato shtëpiake, pula të buta edhe të egra, gjeldeti, shota, pata, etj, edhe pse numri i disa shtazëve dhe shpezëve është në zvogëlim e zhdukje e sipër, siç është rasti me macen e egër, vjedullën, drerin, hutin, thëllëzën, e sidomos shqiponjën, sokoli, që me dekada rritej në zgafellet e katundit, i cila ende jeton më gjahun e saj të preferuar për gjueti, lepuj, minjë, breshka, por edhe kanë rrezikuar shpezë shtëpiake si pulat, patat, shotat dhe qurat etj.

KULTURA DHE ARSIMI -Shkolla e xhamia e katundit



Shkolla në Kokaj
me 1935/36 -----



Xhamia në rekën e Sllubicë

ndërtohet Xhamia te Lumi i Sllubicës nga Xhemajli Hajrullahu - Banorët, gjegjësisht të rinjtë e katundit Kokaj, përveç disa të rinjve që ishin shkolluar në mejtepet e Preshevës e më vonë në Locë, pastaj në xhaminë e përbashkët të ndërtuar në vitin 1930 pranë lumit Sllubica, të tjerët nuk patën fat të shkoll-ohen deri pas Luftës së Dytë Botrore. Përfundim ishte fati i djaloshtit Mustafë, i cili kur gjatë viteve të fundit të Luftës së Dytë iu bashkua një njësi të Brigadave shqiptare që po kalonte nëpër Kokaj, si luftëtar 15-vjeçar në nëntor të 1944 dhe më vonë sa qëndroi në Tiranë, kreu kualifikimin për mësues. Në fund të vitit 1947 ishte kthyer në Kosovë, ku filloi punën e mësimit, nevojë kjo që ishte shumë e madhe për malësorët e Karadakut dhe banorët e Anamoravës. Më vonë, pas Luftës në vitin 1947 në katundin Llocë u hap shkolla fillore ku ishin përfshirë gjeneratat e ndryshme e të rinjve. Deri në vitin 1967 vijuan shkollën fillore shumë gjenerata, të cilat vazhdonin shkollimin në Pogradec e tutje. Në vitin 1967 plakur Nezir Haliti (Mixha Nezë) ndërtoi shkollën me vetëkontribut dhe në pronën e vet në mes të katundit në afërsi të lagjes Gurinë. Mësues të parë ishin pikërisht të rinjtë e këtij katundi, të cilët ishin shkolluar, si Rrustem Rrustemi e Halil Halili. Numri i nxënësve në të katër klasat ishte nga 45 e deri në 55 nxënës. Sot kësaj shkolle i kanoset rreziku i shuarjes për arsye të mungesës së nxënësve. Në këtë vit shkollorë i ndjekin mësimit vetëm katër nxënës me të cilët punon mësuesi veteran Shefki Xheladini. Mësuesi Shefki ishte nga Sllubica, vdiq më 2008 në Gjilan. Ndërsa ka udhëtuar për çdo ditë për të mbajtur mësime në Kokaj në shkollën që punoi rreth 49 vjet. Viti kur u pensionua shkolla kishte një nxënës në klasën e parë, një nxënës në klasën e tretë dhe një nxënës në klasën e katërt. Në vitin shkollor 2008-09 regjistroheshin edhe dy nxënës në klasën e parë.

Vrasja e shtatë banorëve në fshatin Llovcë dhe Kokaj më 5 prill 1999, ku në këtë vrasje grupore masakëruan, plagosën, torturuan dhe përndjekën dhe arrestuan, dhjetra sosh. Masakra e Llovcë ku u vranë e u masakruan 7 vetë (Shqiptarë) ndonëse, kjo nuk është harruar nga bashkëfamiljarët e tyre dhe dëshmitarët okular, ku në masakrën e fshatit Llovcë më 5 prill 1999 janë vrarë ekzekutuar: *Rabit Tahir Dalipi (1951)* , *Kokaj, Xhevrije Ramë Zeqiri (1944)* , *Xhemail Kadri Halimi (1969)*, *Llovcë, Sami Abdyl Xhelili (1971)*, *Llovcë, Avdi Selver Rexhepi (1975)* , *Kokaj, Rahim Bajram Ymeri (1954)* , *Llovcë, Nexhmije Riza Azemi (1949)*, *Llovcë.*

Në 14 vjetorin e vrasjes askush nuk u përkujdes që të shënohet përvjetori i tyre. Nuhi Xhelili dhe Shabi Azemi thanë për rajonipress se kjo është paturpësi e institucioneve komunale. Të plagosur kanë mbetur, Nazmi Hajdini dhe Marigona Azemi. Dëshmitari i kësaj masakre Behxhet Mehmeti nga Llovca ka mbijetuar , por është maltretuar e torturuar nga një grup i serbëve të Pasjanit ditën kritike. Siç rrëfente **Naser Reshat Haziri (Kokaj)**, të cilin pasi paramilitarët i vrasin bashkë fshatarët **Rabit Dalipin** dhe **Avdi S. Rexhepin** dhe , **Xhemail K. Halimi, Llovcë, Sami A. Xhelili** shtatë qytetarët e pafajshëm atë dhe disa të tjerë i dërgojnë dhunshëm në drejtim të fshatit Pograxhë ku gjatë rrugës paramilitarët e vrasin edhe Nazim Hafiz Rashitin (1939). Behxheti dhe një bashkëudhëtare e tij, thotë se: “ i kanë arrestuar dhe marrë peng nga afër varrezave, që ishin duke u kthyer nga Pogragja për në fshatin Llocë, ata, dhe janë torturuar dhunshëm, të lidhur si pengje të gjalla, deri afër Pasjanit, kur janë liruar. Ata gjatë rrugëtimit për në Gjilan vazhdimisht e kanë kërcënuar për likuidim fizik. “*kur arritëm në Gjilan kemi shkuar në stacionin policor në Gjilan, pastaj paramilitarët vendosën që të na dërgojnë në Pasjan, ku ndodhej shtabi i forcave paramilitare serbe.* Behxheti thotë se na kanë maltretuar e torturuar me orë të

tëra që të tregojmë se ku ndodhet shtabi i UÇK-së” thotë Behxheti. Dëshmitari tjetër Naser R. Hazirit, i cili ka rrëfyer për agjensin e Lajmeve “*Kosovapress*”, për ditën kur ndodhi vrasja përgjatë rrugës Kokaj Llocë dhe deri në Pogradjë, kanë qenë mbi 24 serb të paramilitarë të armatosur me uniformë të ish-APJ-së. Paramilitarët serb të armatosur, ata afër dushkajës së Kokajve, kanë vrarë mësuesin, Rahim B. Ymerin nga fshati Locë dhe Xhevrije Ramë Zeqiri nga Muhaxhierët e Kokajve dhe trupat e tyre i kanë djegur-karbonizuar. Të vrarë e pare në këtë ditë kam parë edhe trupat e Xhevrije Ramë Zeqirit dhe Driton Xhelilit nga fshati Ranatovc (Kakajt) Komuna e Preshevës”.

Pastaj, paramilitarët kanë hyrë nëpër shtëpitë përgjatë rrugës në Llocë, si dhe kanë shtënë në drejtime të ndryshme. Pa paralajmërim për ti ndjekur banorët e mbetur nga shtëpitë e tyre. Pas kanë dëgjuar krismat e armëve, banorët e fshatit Llocë kanë filluar të ikim në drejtim të Pograxhës, Bilinicës dhe Sllubicës. Në dalje të fshatit te lagja e Curretëve ishte goditur nga një snajperistë dhe vrarë Nexhmije Azemi dhe një fëmijë mbesa e saj dyvjeçar Albulena ishte plagosur në duartë e saj, kurse në mesin e këtyre të vrarëve ishin edhe dy qytetarë të fshatit Kokaj, Rabbit Tahiri dhe Avdi Rexhepi. Ndërkaq të plagosur sipas këtij dëshmitari kanë qenë Nazmi Hajdini dhe Albulena Azemi. Ky dëshmitar ka identifikuar grupin e paramilitarëve si Sava (shumari) nga Pasjani, dhe një farë Dragani po nga ky fshat si dhe Dragan Timotijeviq oficer nga Gjilani. Sipas **Muhamet Q. Ramadanit**, të dy viktima kanë qenë të djegura, të tjerat të masakruara dhe të ekzekutuara. Dëshmitarë të këtij ekzekutimi dhe masakrimi sipas tij kanë qenë edhe policët Negovani nga Ranillugu dhe Dragani nga Zhegra. Dëshmitari tjetër Nuhi Xhemail Ramadani pas ngjarjes ka deklaruar për *Kosovapress* se: Kanë djegur shtëpinë e tij dhe të kusheririt të tij Ramadanit, si edhe shtëpinë e Xhaveritte Kokajt. Ata, atë ditë ka parë tek kanë hyrë nga drejtimi i Ranatovcit në Kokaj kah

Llapushnica një grup prej dhjetra paramilitarëve serb, të cilët kishin qëndruar në hyrje të Kokajve , te Rupa për 24 orë. *“Kur kemi marrë vesh se ata kanë hyrë nga disa drejtime ne kemi dal në male, bashkë me ta edhe familjet dhe shumë familje tjera të strehuar aty janë tërhequr në drejtim të Sllubicës, Lagjes së Zahirajve. Bashkë me djalin e vogël Nexhatin, Nuhiu, thotë se: para syve të tyre fare pranë rrugës Kokaj- Llocë në afërsi të vendit “Kish e epërme”, Dushkaja është vrarë gruaja e muhaxhirëve të Kokajve, Xhevrija dhe mësuesi Rahimi Pasi janë larguar paramilitarët kemi kontrolluar se kush është vrarë, dhe u jemi bashkuar afër shkollës në Llocë.*

Në vendin e quajtur *“Elbishte “*, pasi janë tërhequr banorët, ata janë kthyer për të marrë bagtinë e tyre, Nehat S. Haziri, i cili pasi që kishte parë me kohë ardhjen e grupeve të armatosur dhe ishte tërhequr me kohë nga fshati. Pas tyre në vendin e quajtur *“Elbishte me atë rast kemi parë se është vrarë, Rabit Dalipi dhe Avdi Rexhepi nga fshati Kokaj dhe Xhemail Halimi dhe Sami Xhelili nga fshati Llocë”,* thotë Naseri, të cilin e kanë detyruar të hidhet mbi trupin e Nazmiut, i cili si i plagosur rëndë arriti të shpëtonte pasi që nuk kishte pranuar ti vihet zjarri nga Naseri si 13 vjeçar t’i cilin nën breshërin e armëve, e kishin ndjekur në drejtim të Pogradit dhe Sllubicës. Të nesermën në vendin e quajtur *“Elbishte”,* janë marrë trupat e vrarë, të Rabit Dalipi dhe Avdi Rexhepi nga fshati Kokaj, si dhe Xhemail Halimi dhe Sami Xhelili nga fshati Llocë, të cilët ishin duke u kthyer në fshat për të liruar bagëtinë e lidhur nëpër vathët e tyre, Ata e kishin tërhequr të plagosur edhe Nazmi Shaip Hajdini, pasi që ishin liruar edhe të kidnapuarit, Behxhet Mehmeti dhe Menderes Ramushi. Më vonë bashkëfshatarët tjerë, në mesin e tyre edhe Naseri dhe Mejdiu nga Pogradja kanë parë tek vendi i quajtur *“Kisha e epërme”* kufomat e djegura të mësuesit Rahim B. Imerit nga Lloca, Xhevrije Zeqirit nga Ranatovci të cilët të ngarkuar në një traktor janë bartur afër

varrezave të Llocët te vendi i quajtur “ Dardha e Nezirit” janë varrosur në varrezë të përbashkët. Këto vrasje me përgjegjësi të plotë deklaroj se janë kryer nga Dragani i Zhegrës, pylltari Sava nga Pasjani dhe Negovani i Ranilugut të cilët kanë qenë polic në Gjilan” ka dëshmuarë ocular. Pastaj të njëjtën ditë në fshatin Pograxhë është vrarë nga paramilitarët serb edhe Nazim Rashiti i cili është ekzekutuar në të hyrë të fshatit Pograxhë në vendin e quajtur “Skrep”. Në vendin e quajtur “Mullini i Arapit” në dalje të fshatit Uglarë, janë kaur dhjetra udhëtar duke u tërhequr nën-breshrin e armëve të tyre, në mesin e tyre edhe **Muhamed Qahil Ramadani dhe Halit H. Haziri**, të cilët ishin duke u të-rhequr nga Gjilani pasiqë kishin marrë ushqime për familjet e tyre për në Kokaj, në të cilin ditë e kishin pushtuar trupat paramilitare, duke vrarë dhe plagosur qytetarë rasti përgjatë Rrugës Kokaj- Llocë - Pogradjë dhe Uglarë. Fillimisht e ki-shin ndarë për pushk-atim Muhamedin nga rruga si të dy-shuar ” pjesëtar i UÇK-së ”, ndaj të cilit kishin shtënë nga një distance, por fati e deshti që në atë rast, vijnë edhe grupe tjera të banorëve të Uglarit dhe përzihet bashkë me ata për t’iu bashkuar më pastaj me kusheririn e tij, Halitin në Uglarë. **Deklaratë e Muhamet Q. Ramadanit.*

Në Pogradjë janë djegur shtëpi kurse minat janë vendosur nga rezervistët e fshatit Pasjan si Tomiq Negovan nga Rani-llugu, Mlladeni dhe Dejan Arsiq nga fshati Bilinicë. Pas luftës janë gjetur materiale , dokumentacione dhe processverbale me të dhënat për gjetjen e shumë kufomave të shqiptarëve, viktima të rëna nga veprimet e forcave ushtarake – policore serbe. Gjyqtari hetues Zhivojin Jankoviq, ka nënshkruar raportin ku thuhet se në fshatin Llovcë janë hasur shtatë kufoma ku njëra prej tyre e Raim B. Imerit ka qenë tërësisht e karbonizuar. Kjo vrasje mund të kualifikohet si vrasje masive është shkruar në raport, si masakra më e rëndë në Gjilan llogaritet ajo në Llashticë , Zhegër, Llovcë, dhe Zhegovc.

PERSONALITETET PUBLIKE TË KOKAJVE

Haxhi Isah Koka - Është i lindur në katundin Kokaj të Gjilanit më 1905. Ishte djali i dytë i Mustafës pas Sylejmainit, (i cili kishte lënë vetëm një vajzë, Ajshen që ishte rritur nën përkujdesjen e Isahut). Babai i tij, Mustafa, ishte i edukura në mejtepet e kazasë së Gjilanit. Ai kishte edhe mundësitë materile. Mb-ase kishte arritur te pasuria për të shkuar në haxh, edhe Isah kishte shkuar gjurmëve të babait të tij, duke e kryer këtë obligim fetar më 1968, që ishte i edukura me dije e kulturë. Ai u shqua për njohuritë e tij në historiografi dhe hartografi, ku shumëkush këshillohej, ndëse nuk kishte ndonjë përgatitje të lartë arsimore pos mësimave nëpër mejtepet e atëhershme të kohës, tek i cili kanë qenë edhe akademikë, etnologë, gjeografë, historianë, shkrimtarë e gazetarë të shumtë. Ishte ndër pleqënarët e përmendur të kohës së tij. Haxhi Isahu, kishte lënë pas dy djemë Osmanin dhe Mustafën dhe katër bijat e tij. Edhe pse nuk ka mbajtur ndonjë pozitë të udhëheqësit të katundit Kokaj, ai ishte kryeplaku i katundit edhe i përmendur në pleqënar të Kazasë së Karadakut dhe anamoravë. Isah Koka ishte kryefjale e historisë së Kokajve të Gjilanit, dhe më gjër. Ai është i derdhur kudo në çdo rrëfim, në çdo bisede për Kokajt dhe gjithandej etnisë, ishte dhe mbetet leternjoftim krenarie e Kokajve, të Karadakut, Gjilanit dhe Kosovës. Ai është ai me të cilin krenohet historia e lexuar në hartën tonë etnike, me të cilin krenohet çdo shqiptar i mirë. Për Isahun është shkruar, por jo sa duhet, i cili e la të shkruar gjeneologjin e Kokajve, ishte *Lahutë e Malësisë* dhe, ai ia mësonte popullit. Isahu kishte nderim për shkollën e dijen edhe pse vet ishte me pak shkollë fetare të kënduar te

hoxhallarët, do të pohojmë se ai ia dinte fort mire vlerën e shkollës, edukimit fetar dhe atdhetar, si dhe për të, ishte njeriu i pashkolluar, ishte si njeriu i pavlerë. Isahu ëndërronte shkolla, dije, kulturë, edukatë e kanunore dhe fetare për shqiptaret. Është për-mendore, që koha e paqte që do të vije, veç do ta lartësoje dhe historia do ta ruaje mire në gjirin e vet këtë ersonaliteti prej një pleqëdari . Haxhi Mustafa, babai i Isahut dhe i Sylejmanit. Isahu i solli në jetë dy djem: Mustafën, i cili vdesë i ri dhe djalin e madh: Haxhi Osmanin (1928-2010), i cili la djemët Mula Isufi Imam i Xhamisë në Arbëri të Gjilanit, Sylejmanin, Mulla Ilijazi Mustafa, kryeimamin e Bashkësisë Islame të Gjilanit, Fesalin.

Isahu vdiq me 1989 dhe u varros në fshatin e tij në Kokaj.

Nezir Haliti-Axha Nezë (1900-1982) -

Neziri i kishte edhe dy vëllazër, Behlulin dhe Beqiri Halitin dhe me tre djemët e tij, Rifatin(i arsimuar me kontributin e babait në mejtepin e Preshevës dhe medrezen "Isa Begu", të Shkupit, i cili shërbeu si imam në xhaminë e Caravajkës së Kardakut deri në pensionim), Sallahu, djali i dytë i cili shërbeu me vite deri në pensionim në shkollën e katundit Kokaj (paralele e ndarë) dhe Ibrahimin. Gjendja arsimore edukative e tij dhe brezave të kaluara ishte e kufizuar. Pos mësimit fetar të organizuar në xhaminë e Sllubicës dhe odave të Kokajve nuk patën mundësi tjera, edhe pse vetëdija ishte ngritur edhe pse në vijimin dhe shkollimin e atyre që ishin të edukuar po numëroheshin në gishta dhe nuk ndryshojë dukshëm. Aga Nezë i pari ishte së paku për Kokajt që mundësoi hapjen e shkollës në mësim amëtar në fshat. Ngase shkollat nga katundi ishin larg për të udhëtuar 5-7 kilometra rrugë për moshat e reja drejt shkollës 6 (gjashtëklasëshe) në në Llovcë dhe tetë vjeçarës në Pogragjë. Nezir Haliti, plaku Nezir, pas moshës 60 vjeçare jete, përkundër pengesave nga shumë fanatik dhe pa përkrahjen materiale nga pushteti i atyre viteve e ndërtoi shkollën në tokën e vet në mes të katu-

ndit. Objektin e shkollës me katër dhoma, dy klasës dhe zyrën i bëri të gatshëm për në vitin shkollor 1967-68, kur mësimi filloi në gjysëvjetorin e dytë të atij viti shkollor. Sikur edhe shumë fshtrave të tjera, edhe Kokajt u ndihmuan me paisje mësimore dhe inventar shkollor me banka dhe karrige për nxënës dhe arsimtar, me dy dërrasa të zeza, ulëse, shkumësa, sfungjera e mjete mësimore tjera shkollore. I shërbeu shkollës deri me ndarjen e tij nga jeta më 1982.

Mulla Rifati mësimet e para i ka filluar ne Llocë, mësim jepte Mulla Bejta i Caparit, ky ishte pedagogë i afte i kohës. Gjatë studimit 4 vjeçar në medresen e Gjilanit dhe 4 viteve tjera ne Preshevë. Ne Gjilan ishte nxënës i Mulla Salihit nga fshati Miresh dhe atdhetarit Mulla Idrizit nga Velekinca. Që të dy ndikuan në arsimin dhe edukimin e tij të më vonshëm, religjioz dhe në ate kombtarë. E tëra kjo ishte para luftës së dytë botërore, pasi që vitet nuk i dinë saktësisht, mirpo lufta ishte ajo e cila edhe në jetën e tij kishte vënë ca kufijë të veprimtaris së tij. Tregon se në Gjilan kur ishte duke mësuar Hoxha kishte dhënë një libër shqip dhe i kishte treguar se me ta zanë këtë pushteti i asaj kohe ishte më keq se me ja zanë ndonjë armë, e që ky i jep Haxhi Isahit i cili edhe e kishte ruajtur derinë vitet e vona. Jeta thot ishte e vështirë në atë kohë, shpesh here pasi terrohej e kam qel derën e kubes që të më bëjë dritë për të lexuar në mungesë llambe apo qiriu, i kujtohet se si nkë here Mulla Alia nga Lloca ua kishte dhënë ka dy dinarë me të cilat kishin kaluar javë të tëra, mirpo si lehtësim ishte edhe ajo që nuk ishte i vetëm. Në shoqërim të tij ishte edhe Mulla Xhaferi e një kohë edhe Isufi djali i Haxhi Isahit. Mësimet i vijon fillimisht në Preshevë te Mulla Alia dhe Nexhatia me Mulla Xhaferin, hoxha i ardhshëm i fshatit që ishte bashkë me të. Përpos mësimëve fetare fëmijve ju mëson edhe shkrimin shqip të cilin e kishte mësuar nga Mësuesi Hasan Dyngjeri mësimdhënës nga Shqipëria. (*Kategoria: Kokaj*)

ZEJULLAH HALILI (1945 – 2004



ZEJNULLAH HALILI
1945 - 2003

Jetëshkrim

Zejnullah Halili shkrimtar i njohur për fëmijë. Pas plot pesë viteve, miqtë dhe të afërmit e shkrimtarit, Zejnullah Halilit, e kanë shumë më të vështirë ta mbajnë një takim letrar apo të pinë një kafe, pa e përmendur buzëqeshjen, alegorinë, fisnikërinë, çiltërsinë, dëlirësin që nxirrte dritë nga uni i tij kreativ. Zejna, siç e quanin të gjithëmë shkurt e më ngroht, vetëm ndërroi dhomën në moshën 59 vjeçare, më 26 shkurt 2004, derisa po e nderzte makinën për të shkuar në punë. Çast që e ndau edhe nga misioni i tij, që t'i kthehet vendlindjes përgjithmonë, duke këputur vrullin e punës edhe nga "Libri i hapur" në RTK, që kishte rifilluar t'i kthehet programit arsimor. Megjithëse, ai për artistët e fjalës dhe skenës, posaçërisht fëmijët dhe dashamirët e arteve, fjalës së shkruar

artistike do të mbetët përgjithmonë, ashtu siç ishte edhe vetë shpirti i tij prej artisti. Frymën liridashëse e përhapri edhe gjatë veprimtarisë së tij në redaksinë për fëmijë të Radio Prishtinës, pas luftës në Radio Kosova e Lirë, në redaksinë e revistave të ndërmarrjes së dikurshme "Rilindja", dhe kudo tjetër që ishte i gjallë. Vdekja vetëm sa është koritur me Halilin, duke e ndarë në mes, pati thënë, Rifat Kukaj. Zejnullah Halili u lind në Kokaj më 5 nëntor 1945, në vitet e golgotës te Karadaket.

Shkollimi fillor dhe të mesmen e kreu në vendlindjen e tij, të mesmen në Gjiilan dhe të lartën Gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Me krijimtari letrare nisi herët të bëjë emër, duke filluar që në bankat e shkollës fillore, për të përvijuar edhe gjatë kohës sa punoi si mësues në fshat dhe qytetin e Gjiilanit. Halilin e tërhiqte elita kriju-ese dhe i dha lamtumirën vendlindjes në kohën, kur gati e gjithë Kosova ishte e tillë. Fillimisht për disa vjet punoi si gazetar, redaktor, udhëheq emisionet për fëmijë të RTV Prishtinë, sikur edhe në redaksinë e botimeve të revistave të "Rilindjes", kryeredaktor i GEP-it, Pionierit, etj., duke lënë pas vetit një opus letrar të pasuruar prej 26 veprave të ndryshme letrare për fëmijë dhe të rritur. *Vepra e parë "Ylberi", vjersha 1969, "Shitësja flokartë", vjersha e tregime 1971, "Ç'thonë pulëbardhat", tregime 1973, "Eshkë e drit" tregime 1977, "Lamtumirë shkurtabiq", vjersha, 1983, "Vendlindja shihet në zemër", tregime, 1984, "Përralla lozonjare", vjer-sha 1987, "Pikaloshja" tregime 1988, "Qirinj të ndezur", tregime për të rritur 1988, "Mollëkuqja", 1989, "Ylli le të na hyjë në mes", vjersha, 1990, "Ëndërr e këputur", si dhe "Udha kah agu", janë romanët më të realizuara, si edhe veprat: "Si u bë pikalorja bletë", "Djaloshi brenda mollës", "Pres orën tënde", "Ditë e hatashme", për ta përmbyllur me librin "Unazë". (Shkëndija, 2008, Prishtinë).*




Rrustem Rrustemi –

Rrustem Murat Rrustemi është gazetar shqiptar. Rrustem Rrustemi u lind më 30.08.1947 në katundin Kokaj të komunës së Gjilanit, në një familje me traditë bujare. Shkollimin fillor e kreu në Pogragjë, të mesmen në Gjilan dhe studimet universitare në Universitetin e Prishtinës në gjuhë dhe letërsi në vitin 1982. Filloi punën si mësues i parë i katundit në Kokaj në vitin shkollor 1967/68 në vitin e parë të hapjes së shkollës. Punoi në gazeta të ndryshme, radio dhe televizion si repor-ter, korrespondent dhe redaktor. Prej 1.09.1975 deri më 1.06. 1986, gazetar redaktor në Programin Informativo-Politik të Televizionit të Prishtinës. Pas mbylljes së mediave elektronike në Kosovë ngeli pa punë. Në ndërkohë kohë pas kohe u paraqit me shkrime në disa gazeta vendore të ish-Jugosllavisë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, përkatës-isht prej 1.10.2000 deri më 1.06.2002 punoi në detyrën e redaktorit në gazetën " Kosova Sot". Tani punon në detyrën e korrespondentit të Radio France Internationale (RFI), programi në gjuhën shqipe. Gjatë punës së tij u mor me të gjitha zhanret e shkrimeve gazetareske, duke përfshirë edito-rialin, komentin, replikën, reportazhin, përshkrimin, skicën, fejtonin etj.Gjatë punës së tij në institucionet mediatike kis-hte funksione përgjëse në redaksitë ku punoi. Përvç punës në redaksitë e ndryshme botoi artikuj të ndryshëm dhe shënime publicistike.

Halil Halili (8.5.1944 në Kokaj të Gjilanit- vdiç në Prishtinë me 21 dhjetor 2010) shkollën fillore e kreu në fshatin Llocë, dhe Pogragjë, shkollën e mesme Normale në Gjilan, e mbaroi në vitin 1968, nërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike - grupi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe ne Prishtinë. Pas përfundimit te normales punoi në fshatin Kokaj 1968/69, pastaj ne fshatin Llabjan në vitin 1971, dhe poashtu edhe në Bresalc dhe Pogragjë si arsimtare i Gjuhës Shqipe deri ne fund te vitit 1973.Prej vitit 1978 u inkuadrua në shkollën fillore "Emin Duraku" në Prishtinë ku punoi deri në pensionimt.Jetoi në Prishtinë me bashkëshorten, vajzën Miranden - profesoreshë e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe djemtë Arsimin e Artanin të cilët përkohësisht janë në Londër. Varrimi i të ndjerit u bë në varrezat e vendlindjes në fshatin Kokaj të merkuren padite me 22 dhjetor 2010.

Mursel Gani Ahmet u lind më 5 prill 1949 në Kokaj të Gjilanit në një familje me traditë arsimdashëse. Mursel Ahmeti shkollën fillore katërvjeçare e kreu në katundin Llocë dhe përvijoi shkollë tetëvjeçare në Pogragjë të Gjilanit. Shkollën e mesm - Gjimnazin " Skenderbeu" e mbaroi në Preshevë në vitin 1969. Në vitin 1970 regjistroi studimet Universiteti i Prishtinës , Fakulteti Juridik në të cilin diplomoi me gjeneratën e parë në vitin 1974. Pas diplomimit u punësua në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ndërsa në vitin 1975 u zgjodh gjykatës i Gjykatës Komunale në Gjilan ku punoi deri në vitin 1980. Në vitin 1980 u zgjodh sekretar i Sekretariatit për punë komunale-banesore dhe pronësore-juridike si dhe u zgjodh anëtar i Qeverisë komunale të Gjilanit. Këtë detyrë e kreu deri në vitin 1986. Nga vitin 1986-1990 ishte me punë inspektor i Administratës Komunale. Në shtator të vitit 1990 u largua nga puna me dhunë nga pushteti serb. Pas çlirimit më 1999 kur rifilloi punën në Gjykatën Komunale të Gjilanit. Në vitin 2005 u zgjodh kryetar i gjykatës komunale, ku punon edhe tash.

Ilaz ef. Mustafa -Është lindur më 1967 në Kokaj të Gjilanit. Pas përfundimit të shkollës fillore në vendlindje, regjistrohet në shkollën e me-sme islame "Furkan" në Damask të Sirisë ku kreu me sukses në vitin 1989. Studimet universitare i vazhdoi në "Universitetin mbretëror të Jordanisë" në Aman të Jordanisë, ku diplomoi më 1994 në katedren e gjuhës dhe lëtërsisë arabe dhe drejtësi islame. Me të kthyer nga studimet filloi punën akti-ve të thirrësit, imamit, hatibit dhe mualimit. Prej vitit 1994-97 punoi si profesor në Medresënn e mesme "Alaudin" paralelja në Gjilan. Pastaj prej vitit 1997-2001 punoi si vaiz në këshillin e bashkësisë islame në Gjilan. Nga viti 2002 e tutje kalon në detyrën e imamit, hatibit dhe mualimit në xhaminë e lagjes Arbëria (ish-Qenar Qeshme) në Gjilan. Në virin 2006 botoi veprën e parqë me ligjërata (hytbe) "Hytb-et e xhamisë" të mbajtura gjatë vizitave nëpër xhamitë e ndryshme të Gjilanit dhe fshatrat përreth. **Dauti Dauti** është lindur më 1960 në Kokaj të Gjilanit. Shko-llën fillore e kreu në Prishtinë kurse të mesmen, gjimnazin, në Gjilan. Ka kryer fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet postdiplomike i kreu në Thames Valley University të Londrës - në degën e Unionit Evropian. Shkrimet e para i ka botuar në "Bota e Re", pastaj ka vazhduar të shkruajë në revistën javore "Zëri",



Daut Dauti

për të cilën, nga viti 1994 e deri më 1999 ka qenë korrespondent nga Londra. Gjatë vitit 1999 -2001 ka punuar redaktor në IWPR (Institute for War and Peace Reporting)

në Londër, dhe ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë. Nga viti 2000 deri në fillim të vitit 2002 ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm i SHGK (Shoqata e Gazetarëve të Kosovës), organizatës së parë të pavarur të gazetarëve në Kosovë. Gjatë kësaj kohe (2000 - 2002) ka qenë edhe anëtarë i pavarur në KQZ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve). Gjatë vitit 2002 ka qëndruar në Dayton, në Kettering Foundation, ku ka bërë hulumtime shkenc-or në lidhje me medien dhe demokracinë. Që nga kjo kohë, duke qenë anëtar shkencor (International Fellow) i këtij instituti të rëndësishëm amerikan, ka hulumtuar dhe botuar një varg studimesh në fushën e gazetarisë, politikës dhe atë të shkencave juridike. Gjatë vitit 2005 ka punuar si këshilltar për media i kryeministrit të Kosovës, Bajram Kosumit dhe zëdhënës i kësaj qeverie. Kohëve të fundit ka punuar në zyrën për informim të IOM (International Organisation for Migration) në Londër. Poashtu, gjatë këtyre viteve, në Londër ka vazhduar të paraqitet me shkrime dhe ka debatuar për çështjen e Kosovës në forume dhe media të ndryshme britanike dhe në media tjera botërore. Poashtu, është angazhuar edhe si këshilltar për informim dhe çështje të Ballkanit për organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare. Kohëve të fundit, në medien e Kosovës, është paraqitur edhe si analist - kritik i procesit politik në Kosovë. Daut Dauti është autor i këtyre librave: “Reflektime Shqiptaro-Britanike”, “Lufta për Trepçën”, “Unioni Evropian - Nga Ideja në Realitet”, “Building an Independent Media in Kosovo - Ngritja e mediave të pavarura në Kosovë”, “Assemblies and Ancient Deliberation According to Code of Lek Dukagjini”. Daut Dauti ka botuar një numër të konsiderueshëm të artikujve dhe punimeve shkencore në gazeta dhe revista në vende të ndryshme.



Agim Dauti i lindur më 30.06.1966, shkollimi fillor dhe të mesëm e kreu në Gjilan, jeton dhe krijon në egzil. Agimi është shkrimtar nga katundi Kokaj në Komunën e Gjilanit. Ka të botuara dy libra poetik: "Tokës që më dha emër" dhe "Mall ose ëndërr e ndërprerë". Poezia me titullin "Fëmija" nga libri "Tokës që më dha emër" i krijoi famë ndër shumë shkrimtarë në Kosovë.



**Dr. Nexhat Rrustemi med.specialist
FMH-psichiatrie et psycho/psycho**

Nexhat Rrustemi i lindur në katundin Kokaj të komunës së Gjilanit më 1963. Nexhati sikur edhe bashkëmoshatarët e tij dhe ma të moshuarit e katundit e njohim si një djalosh i urtë dhe nxënës shembullor. Pas shkolles fillore që e ndoqi në Kokaj, Llocë e Pogradjë, vazhdoi shkollimin e mesme në Gjilan.

Qysh si i ri 16 vjeçar u angazhua bashkë me bashkëfshatarët e tij, Isën, Musën, Nijaziun në lëvizjen për çlirimin e Republikës Kosovës, duke qenë bashkëthemelues i Grupit ilegal, ku zhvilloi veprimtarinë me nofkën "Shpëtimi" te formuar më 4 qershor 1980 në katundin Kokaj. Në shtëpi të Isës dhe me iniciativën disa shokëve të tjerë, themeluan edhe fletushkën "Ushtima e maleve", të redaktuar nga një këshill

botues "Koka", "Sokrati", "Komiti", "Shpëtimi", "Kuqeziu", e tjerë. Nexhati edhe e shtypi me makinen e vet të shkrimit numrin e parë të asaj fletushkën të grupit « Ushtima e Maleve » në të cilën i botoi edhe disa poezi e shkrime historike mbi shqi-ptarët. Si nxënës i shkollës së mjekësisë në Prishrinë ishte pjesëmarrës aktiv i demonstratave të 81-tës. U persekutua nga regjimi serbo-jugosllav si shumë anëtarë tjerë të grupit dhe shumë të rinj të tjerë kosovarë. Pasi e kreu shkollën e mesme të mjekësisë u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ligjëratat i përfundoi në vitin 1990, por për shkak të përjashtimit të disa profesorve shqiptar të fakultetit nga regjimi i Millosheviqit mbet pa i kryer 4 provimet e fundit (si shumica e studenteve të gjeneratës së tij). Si shumë studentë dhe intelektualë kosovarë ai mori rrugën e mërgimit. Në Zvicër punoi fillimisht si infermier në periudhën prej vitit 1995 - 1997, ai i kaloi provimet e mbetura në fakultetin e mjekësisë të universitetit të Prishtinës (i funksionilizuar me kontributin e gjithë shqiptarve në Kosovë e në diasporë dhe me devotshmërinë e mësime dhënëseve). Më 2 qershor 1997 e mori diplomën e mjekut të licensuar. Më 1 maj 1998 u punësua si mjek asistent (me diplomë të Republikës së Kosovës, Universitetit të Prishtinës) në spitalin psikiatrik të kantonit të Friburgut. Pastaj e kreu specializimin në psikiatri dhe psikoterapi. Pasi i kaloi me sukses provimet e nevojshme në Universitetin e Gjenevës për nostrifikimin e diplomës dhe e mori diplomën federale të mjekut (e njohur nga federata e mjekëve të zvicrës FMH (federatio medicorum helve-ticum) fitoi autorizimin për të praktikuar profesionin në mënyrë të pavarur. Ishte shembull i një suksesi me gjithë pengesat e shumta në rrugëtimin e tij profesional. Në qendren e qytetit (Place du Tilleul 7) Bulle në Zvicër, kantoni i Friburgut në një pllakë metalike është shënuar; Dr Nexhat Rrustemi med. specialist FMH psychiatrie et psychotherapie/ psychogeriatric dhe tregon se në atë ndërtesë gjendet kabineti

mjekësor të dr. Nexhat Rustemit. Gjithë arritjet e tij dhe karrieren e tij profesionale.(Musa Haliti)

Nijazi Ramadani u lind në vitin 1964 në Kokaj të Gjilanit. Mësimet e para (fillore) dhe shkollën e mesme dhe të lartë universitar matematikë-Informatikë (Fakulteti Edukimit në Gjilan dhe Prishtinë), që ishte një bazë e mirë për të përvijuar krijimtarinë e nisur që nga bankat e shkollës fillore dhe për një integrim në arte.



Nijazi Ramadani

Krijimtarinë fillestare për fëm-ijë dhe të rritur ka filluar ta publikojë në periodikun letrar në fund vitet e shtatëdhjeta dhe tetëdhjetës, kur edhe anatemo-het nga jeta publike pas rreshtimit politik në lëvizjen komb-ëtare të atyre viteve dhe pikërisht për këtë burgoset në 25 korrik të vitit 1981. merret me shkrime letrare, publicistike, kulturore dhe politike, të cilat i boton herë pas here në të përditshmet dhe periodikun shqiptar. shkrimet mund t'i gje-nden edhe të botuara në të përditshmën "Rilindja", pastaj në revistën letrare e periodike " Jeta e re", "Pionieri, Gep-i, "Flaka" të Shkupit, "Haemus", Bukuresht, gazeta Athina, Athinë, gazeta shkodra si dhe "Shkëndija", revista "Paqja", të Prishtinës, por edhe në gazetatat shqiptare "Shekulli" të Tiranës dhe "Koha jonë". Ramadani më pas vazhdoi me paraqitjet në gazetën "Bujku", "Euro-Rilindja, Tiranë, "Koha ditore", "Zëri", "Bota e re", "Fokus", "Epoka e re", ku punoi pas vitit 2000, dhe botoi varg shkrimesh në të përditshmet: "Express", "Infop-

ress" "Kosova sot", "Iliria post", "Pavarësia news" "Lajm" të Prishtinës, Agjensia e lajmeve "Kosovapres". Gjatë punës së tij u mor me të gjitha zhanret e shkrimeve gazetareske, duke përfshirë editorialin, komentin, replikën, reportazhin, përshkrimin, skicën, fejtonin etj. Gjatë punës së tij në mediat elektronike dhe të shkruara ishte redaktor përgjegjëse te e përko-shmja "ushtima e maleve", dhe në redaksitë në cilat punoi, ku përveç punës në gazetari, botoi artikuj të ndryshëm dhe shkrim letrare dhe publicistike. punon mësimdhënës në shk-lën "Mulla Idris Gjilani" në Velekincë të Gjilanit, koordina-tor i artistëve, krijuesve, gazetarëve "Rrjedha", udhëheq edicioin "Rrjedha", ku botoi një varg veprash, dhe editoi revistën "Ushtima e maleve", është anëtar te Shoqata e shkrimtarëve të Kosovës. Jeton e krijon në Gjilan. Botoi këto vepra: **"Dhe shkronjë arbri"** (përmbledhje me poezi), "Jeta e Re" Prishtinë, **1995**, **"Kosova dhe vetëvendosja"**, SHB "Rrjedha"(Ushtima), Gjilan, 1998, trajtesë historike dokumentare dhe politike: **"Një qasje në teatër"**, SH.B. Rrjedha, 2004, Gjilan **"Vrojtime artistike"**, vështri-me letrare, SHB Rrjedha, Gjilan, 2006, **"Qasje tjetër për ske-nën"**, 2006 , SHB "Rrjedha" Gjilan, **"Imazhe kohe"**, POEZI:1978-2008, SHB Rrjedha, Gjilan, 2008, **"Imazhi i ngrirë"**, (roman) bot. "Rrjedha", Gjilan '12, **"Vështrime letrare"**, dhe **"Shtegtim në histori"**, '12. Çmimi letrar: Vendi i dytë në poezi "Libri shoku më i mirë", i ndarë me rastin e ditës së çlirimit të Gjilanit,1978, Biblioteka "Amë" Gjilan. **Bibliografia e botimeve:** Nijazi Ramadani: 1978/ 2008 Fitues i Çmimit Kadmus: Klubi i shkrimarëve "Drita", rev-ista Pelegrin, Athinë 2006, për tregim kritikë letrare.



Enciklopedia: TË TË RËNËT DHE PLAGOSUR NGA KATUNDI KOKAJ GJATË DHE PAS LUFTËS II BOTËRORE: KOKAJT E MARTIRIZUAR²⁷ -

Martirë, dëshmorë të martirizuarit (të vrarë, plagosur, internuar, burgosur dhe torturuarit) të Kokajve 1943- 2000¹.



1. Hazir (Ramadan) Haziri

Hazir Ramadan Haziri (1915-1943) ishte një aktivist dhe patriot i rëndësishëm shqiptar nga Kokaj, Gjiilan. Haziri lindi

²⁷ Wikipedia shqip|kategoria|Kokaj|grup përdoruesish

më 1915 në fshatit Kokaj të Gjilanit. Haziri kishte mbetur jetim, pasi babai i tij, Ramadani, ishte torturuar mizorisht nga policia bullgare në vitin 1918, dhe kish vdekur pas plagëve të marra në luftë, si pjesëtar i Lidhjes së Kaçakëve në Malësi të Karadakut. Ajo Malësi asokohe ishte nën pushtimin e Bullgarisë. Haziri me katër vëlzërit dhe motrën e tij u rritën nga nëna, Dile Memishi(Lafeta).Prej vitit 1937, për sa ishte duke punuar në Sllipqan Lipkova të Kumanovës si shegert, Haziri u lidh me aktivistin shqiptar Abdullah Preshevën. Më vonë, përmes lidhjeve familjare krijoi kontakte edhe me patriotin Xheladin Kurbaliun, deri sa edhe ai u burgos, dhe vazhdoi veprimtarinë kombëtare me minatorë në minierat e Llojanit e të Shurrddhanit. Haziri (Kokaj) ishte ndër luftëtarët kryesorë të formacionit të Luftës Nacional Çlirimtare në viset Gjilan-Karadak-Preshevë-Kumanovë pas formimit të aradhës së parë shqiptare të komanduar nga Xheladin Kurbalia dhe Avdullah Presheva. Sulmi i parë i armatosur për marrjen e Minierës së Llojanit, e cila ndodhet në mes të Preshevës dhe Kumanovës, ndodhi natën e 28 shtatorit 1942. Aty kishin ardhur edhe luftëtarë të tjerë, të cilët zgjodhën Xheledin Kurbalën për t'u prirë në aksionin e parë për të liruar nga pushtuesit digat e pasura të minierës. Në aksionin parë Xheladin Kurbaliu, komandant, Fadil Hoxha, Komisar Kurtesh Agushi, Sinan Hasani, Riza Selimi, Reshat Xhaferi, etj.si korier përgjegjës për përcjelljen e arradhes ishte dhe Hazir Koka.^[1]Në mars 1943, Hazir Haziri²⁸ u vra në pushi, në

²⁸ Referencat: [▲](#) Dr.Fehmi Rexhepit, historian dhe dokumenteve arkivore të arkivit rajonal të Gjilanit, Shkupit, Kumanovës të arkivuara nga Selim Norça, Kurtesh Agushi, Hoxhë Ibrahim Capari, si dhe të bashkpuntorëve e dëshmitarëve të atyre ngjarjeve të Kardakut 1941-1943, të botuara edhe në librin Flaka (pjesa e IX) nga Autobiografia. [▲](#) [[dokumenteve arkivore të arkivit rajonal të Gjilanit, Shkupit, Kumanovës të arkivuara nga Selim Norça, Kurtesh Agushi, Hoxhë Ibrahim Capari, Hasan Dyngjeri, Xhemush Bina, Kurtesh

vendkalimin kufitar bullgaro-italian në vendin e quajtur Suka – Capar. Bashkë me të plagos edhe një bashkëfshatari kushëriri i tij. U varros në Capar dhe, pas vrasjes së tij, në vend të tij u caktuan Ramiz Cërnica dhe Kurtesh Agushi. Hajredin Haziri¹²⁹.

2.Daut D. Dauti, u lind në katundin Kokaj më 1910, ishte udhëheqës i katundit, pjesëmarrës i Luftës i rezistencës së armatosur përgjatë udhë frengit të Kosovës lindore. Në vijën e frontit të asaj lufte marrë plagë vdekjeprurse dhe është bartur në shpinë nga Isahu i Haxhi Mustafë Kokajve nga vija e frontit në Raincë të Preshevës deri në Cërraticë më 28 gusht 1944. Varroset në Cërraticë . Rufat Qazimi i lindur në Kokaj, gjatë pushtimit italian- në ditët e Shqipërisë 1941-1943, kishin ikur nga katundi i tij prej zullumit të pushtuesve bullgar, ku ishte pushtimi e shtypja më e egër. Rufati me formimin e Batallonit të Rinisë Kosovare, sikur shumë atdhetarë të tjerë antifashistë iu bashkua rrathëve vullnetare. Rufat pati fatin e këtij batalloni që shumë prej tyre mbeten të vrarë nga forcat çenike-partizane serbe. Ai u vra më nëntor 1944, me 6 pjesëtarë tjerë të Batallonit kosovar të Rinisë në moshën 27 vjeçare. Varri nuk i dihet. Rustem Dalip Rustemi, i lindur në Kokaj, njëri nga djemtë e Dalipit të Rustemit, pasi që pushtohet katundi i tij nga forcat serbo-bullgare të Brigadës XVII të Maqedonisë, ishte arratisur për t'iu bashkuar më pastaj forcave shqiptare të tërhequra kah Karadaku lindor. Mirëpo, fati i tij ishte tragjik më 28 nëntor 1944, kur në katundin Gosponicë, kishin hyrë forcat e mobilizuara serbe të Brigadës III të Preshevës. Rustemin këto banda kriminale e vranë sa ishte mysafir së

Agushi, si dhe të bashkëpunorëve dhe dëshmitarëve të atyre ngjarjeve të Karadakut/1941-1943. http://sq.wikipedia.org/wiki/Hazir_Haziri_%28Koka%29

bashku me 33 banorë të Gosponicë dhe Bukurocës keqe dhe tjerë viktima të terrorit të ushtruar ndaj popullatës së pafajshme të këtyre lokaliteteve nga bandat serbo-bullgare nëntor 1944, varoset në vendin varezën në Gosponicë të Preshevës.



Idriz Rashit-Koka, i lindur më 1908 në familjen Rushiti të katundit Kokaj. Ishte vëllai i tretë i Hetës, Muharremi dhe Destanit, pas pushtimit bullgar të Moravës dhe Kardakut, kalon me banim në Gjilan. Idrizi ishte plagosur nga bullgarët në një konflikt të armatosur dhe shkëmbim zjarri te vendi i quajtur bujashkat e Magjerës, ku kishte ndodhur ngjarja ishte përkarshi te Stanica e bugarëve te Seferët. Në pranverën e vitit 1942, kishte shkuar për ta marrë me qerre kusheriri i tij, Haziri, nën breshrin e armeve kishte arritur për ta tërhequr perms udhës së Drumit të Magjerës së Epërme, kah Xhamia e Sllubicës, e kishte sjellur në shtëpi. Dhe së fundi nga plagët e marra në hyrje të Lluqanit më 28 gusht 1944 në vijën e frontit te Maja e Kikës dhe përgjatë

udhës së frengit me 1944, vdes rrugës për Gjilan në hyrje të Dobëqanit (Mireshit) dhe varroset në varresat e Gjilanit, ku jetonte me nderime qytetare si dëshmor i asaj lufte. Idrizi kishte lënë një djalë, Ismajlin dhe tri vajza në jetë. Muharrem Rushit Koka dhe Hetem Rushiti (*Hetë Koka*) në gusht të vitit 1947 u burgos në Gjilan dhe u dënua me 13 vjet burg, i mbajti 7 vjet. Muharremi, porsi vëllai Hetemi i dënua me 35 vjet burg, vdiq në burgun e Nishit, si përgjegjës i forcave shqiptare nënprefekturën e Gjilanit, ku ndodhi vrasja dhe arrestimet e grupit në Livoç pas depërtimit nga Serebia në vitin 1943. TË LIKUIDUAR: Mustafë Hetem Rashiti pas një përleshje më dy udbash gjatë arrestimit të tij në Remnik që shkuan ta burgosnin. Por, Mustafa i vrau të (dy udbashët) dhe doli në mal me Hasan Alinë e Remnikut. Ata u vranë me tradhti në vendkalimin kufitar te Bistrica të Prizrenit. Mustafa ishte 21 vjeç, i shkolluar në Tiranë. Varri nuk i dihet. Rabije (*shoqja e Mustafës*) Kokaj, në shtator 1951 në Zhur të Prizrenit u masakrua nga UDB`ja bashkë me të sho-qin Mustafë Etemin. Ishte 20 vjeçe. Varri nuk i dihet. Hasan Alija-Remniku në shtator 1951 në Zhur të Prizrenit u kap dhe u vra nga UDB`ja bashkë me Mustafën dhe Rabijën. Ishte 48 vjeç. Varri nuk i dihet. Të vranë në atë aksion kanë mbetur edhe Agush Metaj Bresalci, u vra në shtator 1951 në Zhur të Prizrenit së bashku me personat e lartpërmendur. Ishte 35 vjeçar. Qibrije Agush Bresalci u vra nga UDB`ja në shator të vitit 1951 në vendkalimin kufitar te lumi Bistrica të Prizrenit. Vëllai i Mustafës Ramiz H. Rashiti si përkrahës i grupin e parë politik që operonte në Karadakun e atyre viteve, e kaloi jetën e tij si emigrant politik . Jonuz Halit Haziri u plagos në nëntor të vitit 1944 në Dukagjin në moshën 33 - vjeçare. Pjesëtar i shumëfishtë i rradhëve ushtarake të grupimit SS dhe Brigadat vullnetare Nacional-çlirimtare të Kosovës.

TË BURGOSUR PAS LUFTËS: Ajet Rushiti në tetor të vitit 1946 u dënua me 13 vjet burg në Mitrovicën e Sremit, i mbajti 10 vjet burg. Jetoj nga viti 1975 në katundin Leran . Vehbi Hetë – Kokaj në tetor të vitit 1946 u dënua 6 vjet burg në Prishtinë. I mbajti 1,5 vjet në Prishtinë, kurse 1 vit në Mitrovicë. Me moshë ishte 17 vjeç. Jetoj pas Aksionit të Armëve i shpërngulur në Kumanovë (Sipas kujtesës së Vehbi Etem Rushitit, i lindur më 2 shtator 1929 në katundin Kokaj, jetoj në Kumanovë që nga viti 1971, i cili rrëfeu për ekzekutimet dhe torturat e rënda fizike ndaj familjes Rushiti). Dëshmorët, martirët e të plagosurit e luftës së fundit në Kosovë dhe Kosovën Lindore 1999-2000

10. Rabbit (Tahir) Dalipi, nga katundi Kokaj, mosha 48 vjeçar, babai 8 fëmijëve, i vrarë me 6 prill 1999, nga paramilitarët serb në Llocë, duke u kthyer në shtëpi në Kokaj pasi që një ditë më parë ishin larguar nën breshrinë e armëve nga forcat militare serbe.11.Avdi (Selver) Rexhepi, mosha 22 vjeçar, i vrarë më 6 prill 1999, nga paramilitarët serbë në Llocë, duke u kthyer së bashku me Rabbitin (dhe dy moshatarët e tij të katundit Llocë) në shtëpi në Kokaj, pasi që një ditë më parë ishin larguar nën breshrinë e armëve nga forcat militare serbe.³⁰

³⁰ . Llocë më 5 prill 1999 janë vrarë dhe janë varrosur: Rabbit Tahir Dalipi (1951) , Kokaj, Xhevrije Ramë Zeqiri (1944) , Xhemail Kadri Halimi (1969), Llocë, Sami Abdyl Xhelili (1971), Llocë, Avdi Selver Rexhepi (1975) , Kokaj, Rahim Bajram Ymeri (1954) , Llocë, Nexhmije Riza Azemi (1949).



Arifi, Llukmani dhe Miftari(UÇK

Qemajl Jakup Zeqiri – Qemajl Kokaj i lindur më 1979, (djali i madh i Jakupit të Haqif Kokës, edhe Haqifi ishte rob luftime si pjesëtar i Batalonit shqiptar "SS-Skenderbeg", pastaj i mobilizuar dhe i plagosur në Brigadat e UNÇ të Kosovës 1944), *Qemajli në filim të vitit 1999, iu bashkua rradhëve të UÇK-së së bashku me Arbenin(tash më dëshmor i kësaj luftime), Agronin(nip iu Kokajve nga Gosponica), Arifin, Miftarin, Llukmanin, si pjesëtar i Brigadës 128, operacioni "Shigjeta" të UÇK-së të Zonës së Pashtrikut, i plagosur në maj 1999, gjatë luftimeve pas thyrjes së kufirit shqiptarokosovarë. Invalid i luftës së UÇK-së. Edhe xhaxhai i Qemajlit, emrin e të cilit e mba me krenari veterani dhe invalidi i luftës së fuindit, Qemajli.*

Arif J.Arifi- djali i vogël i Jasharit të Sinanit, i lindur në vitin 1973 në Kokaj, ku e krey Shkollën fillore në vendlindje, të mesmë Ndërtimtari e lartë në SHM"Memet Isai", Gjilan, shkollimin univerzitar në Fak. Edukimit, Qendra në Gjilan, dega juridike. Në Gjilan prej kur edhe jeton me familjen e tij, në Lagjen Arbëria. Arifi sikur shumë të tjerë iu përgjegj thirrjes së atdheut në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 u rreshtua në rradhet e luftëtarëve të lirisë, pjesëtar i UÇK-së, Zona e Kardakut dhe e Llapit. Gjatë kohës sa shërbeu ishte i pa ndar me Llukman .

Llukman M.Ismajlin – djali i katërt i Muharremit të Rahmanit, sikur shumë të tjerë iu përgjegj thirrjes së atdheut

në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 u rreshtua në rradhet e luftëtarëve të lirisë.

Në u inkuadua në rradhet e UÇK-së, pjesëtar i Zonës së Llapit dhe të Karadakut. Pas përfundimit të luftës u inkuadrua në pjesën reserve të TMK-së deri me shpërbërjen e saj dhe formimin e trupave të FSK-së. Tash punon si korir në SHMUltë.”A.Ajeti”, Gjilan.

Miftar F.Sinani- djali i vogël i Fetahut të Sinanit, i lindur në vitin 1973 në Kokaj, ku e krey Shkollën fillore në vendlindje, të mesmë Ndërtimtari e lartë në SHM”Memet Isai”, Gjilan, prej kur edhe jeton me familjen e tij, në Lagjen Arbëria. Arifi sikur shumë të tjerë iu përgjegj thirrjes së atdheut në fillim të vitit 1999 u rreshtua në rradhet e luftëtarëve të lirisë, pjesëtar i UÇK-së.

Shefki Xh. Behluli - djali i tretë i Xaferit, i lindur në vitin 191968 në Kokaj, ku e krey Shkollën fillore në vendlindje, deri më shpërthimin e luftës ishte jashtë Kosovës në Gjermani dhe Zvicërr, iu përgjegj thirrjes së atdheut në fillim të vitit 1999 u rreshtua në rradhet e luftëtarëve të lirisë, pjesëtar i UÇK-së. Jeton dhe punon në Gjilan, prej kur edhe jeton me familjen e tij, në Lagjen Arbëria.

Të arrestuarit, të burgosurit, të denuarit dhe të torturuar nga Sigurimi serbo-jugosllav pas ngjarjeve të pranverës së vitit 1981 për veprimtari ilegale nga katundi Kokaj: Alejdin Rrahmani , Isah Rrustemi, Nijazi Ramadani , Nexhat Rrustemi, Musa Halit, etj

Të internuar 1941-45-Asllan Aziz Azizi, Gjermani ku edhe vdiq. Rexhep Ilaz Rrustemi, Internuar në Gjermani 1941-1945 . Haqif Zeqiri, Jonuz Halit-Haziri, Xhavit Hamit Sahiti, Fetah Sinani.

TË HUMBUR: Qemajl Haqif Zeqiri i lindur me 1938 në Kokaj. Në vitin 1964, kishte shkuar për të kryer shërbimin e obliguar ushtarak, pasi që kishte pasur një operacion ishte lajmëruar se i takon zones së goditur nga tërmeti të Shkupit të vitit 1963 dhe ishte liruar për të pasur një vizitë familjes

së tij në Kokaj. Qemajli, duke u kthyer për pushim nga shërbimi ushtarak psoi aksidentalisht pasi që treni Express nuk ndalet në Tasaj, ai hidhet nga treni dhe godet shtyllën nga merr plagë vdekjepruse. Aksidenti pasoi pasiqë ushtarët që kishin prejardhjen nga kufizohej pas tërmetit katastrofat të Shkupit më 1963. Nga Stacioni i trenit në Preshevë edhe trupi i tij bartet në Shkup dhe përzihet së bashku me trupat e viktimave të pidentifikuara të tërmetit, varroste në Shkup. Varri as sot nuk i dihet.

VDEKJET TRAGJIKE E KURBETÇARËVE: Haki Emin Halit –Haku ishte i biri i dytë i Eminit, i lindur më 1938, vdes tragjikisht në një fatëkeqësi trafiku afër Leskocit (te ura) gjatë kthimit prej Gjermanisë, ku ishte duke punuar jashtë vendit. Haku me atë rast ishte me një shok të tij, duke u kthyer për pushim në vendlindje, kur u rrokullis nga ura, duke përmbyllur jetën e tij, ende pa arritur në shtëpi. Varroste në Gjilan, ku jetonte me gruan dhe dy fëmijët e tij. Asllan H. Azizi u lind në vitin 1947 nga babai Halit dhe nëna Feride në katundin Kokaj. Asllani ishte fëmija i parë në familjen e ngushtë, ndërsa i treti i vëllezërve Hasan dhe Halit Azizit. E emruan sipas vëllait të tyre Asllanit të vdekur në Gjermani. Gjatë jetës së tij, Asllani jetoi një kohë në katundin Kokaj pastaj në Gjilan . Në fashtin fqinj në Llocë kreu shkollën katërklasëshe, por kur erdhei koha të vazhdoi shkollimin prindërit nuk e lejuan ta vazhdojë shkollimin. Ky fakt Asllanin e mundoi gjatë tërë jetës së tij. Në moshën 20 vjeçare Asllani u martua me Zymrijen nga Lloca me të cilën pati katër fëmijë: Eminen, Feimen, Halitin dhe Valbonën. Asllani në fillim të viteve si shumë bashkëf-shatarë të tij u detyrua të punojë përkohësisht jashtë vendit. (Francë). Pastaj u kthye në vend për ta vazhduar jetën në fshat, ku u mor me punët e bujqësisë në fshat. Jeta e vështirë në fshat e detyroi që të shpërngulet nga katundi në vitin 1980 dhe u vendos në lagjen Arbëria në Gjilan . Posa u vendos në venbanimin e ri u mundua të punësohet. Arriti të punësohet përkohësisht si

zëvendësim. I paknaqur me gjendjen ekonomike dhe për të ardhmen, u detyrua prapë të kërkojë punë jashtë vendit, kësaj radhe në Zvicërr. Punoi në ndërtimtari deri në fillim të vjeshtës kur në rreth-ana edhe sot jo të njohura mirë ndërroi jetë në vëndin e punës, pikërisht në orët e paraditës të 14 tetorit të vitit 1982.

Në fatkeqësi natyrore:**Ruzhdi Rahim Rustemi** 1932 – 64 Ruzhdi Rustemi u lind më 1932 nga babai Rahimi dhe nëna Qelebija në katundin Kokaj. Ruzhdiu ishte fëmija i dytë në familje dhe kishte një vëlla më të madh, Avdylin. Lumturia e kësaj familje nuk zgjati shumë pasi që në moshën 2 vjeçare Ruzhdiut i vdes nëna. Më vonë, në moshën 7 vjeç-are, i vdes edhe babai. Ruzhdiu, bashkë me vëllain Avdylin, mbetën nën përkujdesjen e familjarëve dhe banorëve të katundit, që u janë shumë mirënjohës. Këta dy të ri, ndonëse u rritën pa prindër, nuk u mungoi dashuria, edukata dhe vullneti për të ecur përpara në jetë. Gjatë jetës së tij Ruzhdiu jetoi dhe punoi në katundin Kokaj. Në moshën 20 vjeçare Ruzhdiu u martua me Pashien, me të cilën pati 2 fëmijë binjak, Rahimin që tashmë jeton, dhe Pashien e vogël e cila në vitin e parë të jetës vdiq. Gruaja e Ruzhdiut, Pashia, vdiq menjëherë pas lindjes dhe nuk arriti të shijojë dashurinë amnore. Ajo vdiq në mungesën e përkujdesit mjeksor. Pas vdekjes së Pashies, Ruzhdiu martohet me Lutfijen, gruan e tij të dytë. Edhe me të pati një djalë që nuk jetoi. Ai u nda edhe me Lutfije dhe u martua me Shahën me të cilën jetoi deri në fund të jetës. Përkundër fatkeqësisë dhe jetës së vështirë arriti të jetë i lumtur pranë birit të tij Rahimit që e donte dhe kujdesej shumë për të. Ruzhdiu humbi jetën nga një fatkeqësi natyrore. Më 23 qer-shor të vitit 1964 atë e goditit vetëtima derisa po punonte në arë. Kjo ishte dita kur familja jonë përjetoi dhembje dhe pik-ëllim. Pas vdekjes së tij, vëllai Avdyli së bashku me bashkë-shorten Hanifen e morën nën kujdes të birin Rahimin dhe gjatë gjithë jetës ata i ofruan dashuri dhe kujdes të barabartë me fëmijët e tyre.

Rahimi trashëgimtari i vetëm i Ruzhdiut, është i martuar dhe ka 4 fëmijë.

Vdekje aksidentale në moshën 40 vjeçare- Baki Xhemail – Ramadani – I lindur më 1943, djali i madh i Xhemailit dhe i Dudijesë, qysh heret filloi t’ia mendoj hallet vetës dhe familjes së tij, ndonëse në moshën 7 vjeçare i vdiq babai. Ai sëbashku me vëllaun Nuhiun dhe motren Hamiden u rritë nën përkujdesjen e nënës Dudie dhe xhaxhait Qahilit. Në moshën 16 vjeçare pati një ngatërres për rrugë der sa shkante te halla e tij, te Rushtajt, dhe u detyrua të përdorë armën për vetëmbrojtje, që kishte trashëguar nga familja. Për këtë rast u dënua me 18 muaj heqje lirie me kusht, por pasi që më vonë u muar në shërbimin ushtarak dhe prej andej përcjellët për në vuajtje të denimit në burgun Sllovenska Kradisht. Pas vuajtjes së denimit rikthehet në përmbylljen e shërbimit të obligueshëm ushtarak, dhe pastaj i kthehet familjes në Kokaj deri sa pati një aksident tragjik në malin e tij, në Llapushnicë duke i siguruar dritë për dimrin e vitit 1984. Baku i la tri vajza (Mihrijen, Sevdijen dhe Eminen) dhe djalin Xhemailin që kishte trashëguar emrin e gjyshit të tij. Xhemaili tash jeton me familjen gjstë anëtarësh në hyrje të Malishevës së Gjilanit.

Në fatkeqësi trafiku: **Zahir Qahil Ramadani** (1950-2010)

Zahiri u lind më 1950 në katundin Kokaj, i cili qysh në moshë të re me 1967, kishte pësuar në aksident trafiku gjatë kthimit me tren Beograd- Preshevë (Tasan) nga kurbeti, ku ishte duke punuar në sezonin veror. Në rrethana të panjohura sa ishte duke fjetur kishte përfunduar në hyrje të një tuneli pranë hekurudhës. Pasi që gjendet gati gjysmë i vdekur hospitalizohet në spitalin Ushtarak të Beogradit, pastaj edhe të Prishtinës e Shkupit.Me këtë rast kishte marrë lëndime të renda trupore (fizike dhe trauma psikike). Edhe pse gjendja shëndetësore ishte përmirësuar, ai jetoi me pasojat e fatkeqësisë deri në ditën e ndarjes nga jeta më 12

janar, (tre muaj pa i mbushur 60 vjet jetë). Zahiri nuk ishte i martuar dhe nuk la trashëgimtar.

MANIFESTIME - Ditë e takimit familjar Kokaj Kokajt nga do ku janë, janë përcaktuar që e diela e fundit e korrikut të jetë Ditë e takimit familjar në vendbanimin Kokaj dhe takimi mëton të jetë tradicional. Takimi i fundit në diasporë u mbajt më 06 qershor 2008 nga mërgimtarët në Bruk , Argau në Zvicër. Mërgata e parë shqiptare e familjes së Kokajve, daton nga vitet 1468, e këndej, ku pas vdekjes së Skenderbeut me shpërbërjen e shtetit të Skenderbeut, ku kjo familje ekonomikisht e forte e kishte mbajtur shtetin, pas kësaj shpërbërje fillohet me ndëshkimin e saj, duke dhënë haraçë turkut, janë detyruar të shpërngulën drejt veriut, pastaj në Itali dhe Turqi. Vitet prej gjysmës së tretë të shekullit XVI, një familje nga krahina e Matit kalon në Dibër së bashku me fisin e Kastriotëve për shkak të lidhjes së tyre, kurse njëra prej tyre, Hasan Koka, kalon në Kosovë, prej nga shtrihen, më pas gjithandej etnisë*³¹

Mërgimtarët tanë-Kokajt deri më sot



³¹ Marrë nga libri “Orosi dhe fiset e tij”, si dhe nga Aleksander Matkovski dhe mr.Vroin Koka me origjinë nga Familja Kokaj.

Emigrimet e para nga vendbanimet e Trekëndshit të Toplicës datojnë që nga viti 1833/42, kur hartohet plani serb për dëbimin e Arnautëve (si “turci”), edhe familja e Adem Kokës së bashku me nipin Ali Bylykbashi, i cili edhe ishte spahi gjatë, detyrohen të shpërngulen nga Kaliqu i Lebanës, pas një vendimi të marrë për dëbimin e tyre me 1842.

Lëvizjet tjera emigruese janë përcjellur edhe më pastaj në drejtim të Turqisë, por emigrimet tjera pas vendosjes ë në Kokaj, ku themeluan vendbanimin e tyre, nuk ka pasur, pos atyre në drejtim të Shkupit, Kumanovës, Preshevës, Prishtinës, posaçerishtë në Gjilan, ku janë vendosur shumica e familjeve dhe janë plotësisht të integruara në jetën publike dhe civile. Mërgata e parë e organizuar ishte krijuar me punësimin e përkohshëm në Francë, Zvicërr, Gjermani dhe Austri prej vitit 1967, e këndej.



Pamje nga Takimi Familjar - Kokajt u bënë me shkollë para 44 vjetëve - Kokaj, katundi u bë me shkollë para 42 vjetëve me kontributin e Nezir Halitit-Kokës. Shkolla shtrihet në mes lagjes së epërme dhe të ultë ka lëshuar rrezet e dritës për 40 vjet edhe shkolla katërklasëshe në Kokaj. Shkolla e katundit është ndërtuar në vitn 1967, ku u shkollua me gjeneratat e para të dala nga kjo shkollë e ngritur me

vetëkontributin e plakut Nezir Koka- axhës Nezë. Banorë të rinj të katundit Kokaj, përveç disa të gjeneratave të mëher-shëm që ishin shkolluar në mejtepet e Preshevës dhe Shkupit dhe më vonë në xhaminë e përbashkët të ndërtuar në vitin 1936 në lugin-ën e lumit Sllubicës pran Kokajve, të tjerët nuk patën fat të shkollohen deri pas Luftës së Dytë Botërore. Në Locë pas Luftës II Botërore u hap shkolla fillore, parale-lja e ndarë e SHF "Liria" të Pogradit, ku deri në vitin 1967/68 , ku u shkolluan shumë gjenerata, të cilat pos shkollimit të rregullt ata mbajtën edhe kurse për zhdukjen e analfabetizmit për gjeneratat më të rritura sidomos përfshirja e femrave në shkollim ishte gjithë përfshirëse, të cilat vazhdonin shkollimin e më tutjeshëm. Derisa në vitin 1967/68, kur u bë katundi me shkollën e ndërtuar me vetëkontribut dhe në pronën e tyre nga Nezir Haliti. Mësuesit e parë që patën fatin ishin edhe të rinjtë që sapo kryen shkollimin: Rustem Rustemi dhe Halil Halili. Numri i nxënësve në të katër klasat ishte për vitin 1972/73, gjithsejt 14 nxënës të regjistruar, të cilët e përfunduan tetëvjeçarën dhe vijuan shkollimin e më tutjeshëm, pos Ferinaze Hazirit dhe Nadie Halilit, të cilat vijuan mësimet deri në klasën e gjashtë për shkak të kushteve të vështira të udhëtimit, të tjerët përfunduan së paku shkollimin e plotë fillor apo të mesëm dhe të lartë, si: *Abedin Behluli, Nijazi Ramadani, Qerim Ismajli, Ismajl Azizi, Habib Sadriu, Hamit Limani, Emin Emini, Mejdi Maliqi, Zijadin Maliqi, Xhemajli Nevza-dit, Dalip Dalipi, Rifat Qazimi*. Numri i shkollarëve sillej nga 45 e deri në 55 nxënës derisa numri i banorëve sillej prej 350 me rreth 70 familje. Shkolla sot gjendet në një pozitë para shuarjes për arsye të mos renovimit dhe të mungesës së nxënësve. Në këtë vit shkollor i ndjekin mësimet vetëm katër nxënës me të cilët punon mësuesi Shefki Xheladini nga Sllubica, i cili sivjet, kur janë regjistruar edhe dy nxënës në klasën e parë do të zëvendësohet pasi që ka kaluar me vendbanim në Gjilan. -

IKONA E KOKAJVE (1900-1982) - Aga Nezë i kishte edhe dy vëllezër, Behlulin dhe Beqiri Halitin dhe me tre djemtë e tij, Rifatin (i arsimuar me kont-ributin e babait në mejtepin e Preshevës dhe metresën "Isa Begu", të Shkupit, i cili shërbeu si imam në Xhaminë e Caravajkës së Kardakut deri në pensionim), Sallahu, djali i dytë i cili shërbeu me vite deri në pensionim në shkollën e katundit Kokaj (paralele e ndarë) dhe Ibrahimin. Gjendja arsimore edukative e tij dhe brezave të kaluara ishte e kufizuar dhe, pos mësimit fetar të organizuar në Xhaminë e Sllubicës dhe odave të Kokajve nuk patën mundësi tjera, edhe pse vetëdija ishte ngritur. Edhe pse në vijimin dhe shkollimin e atyre që ishin të edukuar po numëroheshin në gishta dhe nuk ndryshoi dukshëm. Aga Nezë i pari ishte së paku për Kokajt që mundësoi hapjen e shkollës në mësim amëtar në fshat. Ngase shkollat nga katundi ishin larg për të udhëtuar 5-7 kilometra rrugë për moshat e reja drejt shkollës 6 (gjashtëklasëshe) në Llovcë dhe tetë vjeçarës në Pogragjë. Nezir Haliti, plaku Nezir, pas moshës 60 vjeçare jete, përkundër pengesave nga shumë fanatikë dhe pa përkrahjen materiale nga pushteti i atyre viteve e ndërtoi shkollën në tokën e vet në mes të katundit. Objektin e shkollës me katër dhoma, dy klasëshe dhe zyrën i bëri të gatshme për në vitin shkollor 1967-68, kur mësimi filloi në gjysmëvjetorin e dytë të atij viti shkollor. Sikur edhe shumë fshatrave tjera, edhe Kokajt u ndihmuan me pajisje mësimore dhe inventar shkollor me banka dhe karri-ge për nxënës dhe arsimtarë, me dy dërrasa të zeza, ulëse, shkumësa , sfunxhera e mjete të tjera shkollore. I shërbeu shkollës deri në ndarjen e tij nga jeta më 1982. Kokajt u arsimuan në nivele të larta të ndryshme universitare: Zejnullah A. Halili (Shkrimtar), Rustem M. Rustemi, Halil A. Halili (arsimtar), Mursel G. Ahmeti (Jurist), Daut Dauti (Jurist, publicist, master), Salih A. Rustemi, arsimtar (Historian), Jakup M. Rustemi, (Jurist, master), Nexhat A. Rustemi (mjekësi, neoro-

psikiater), Isah M. Rrustemi (Mjekësi, doctor), Nijazi Q. Ramadani, (arsimtar, publicist, shkrimtar), Ramiz B. Ismajli.



KTHIMI I PËRMALLSHËM (*Fejtoni për Kokajt, takimet familjare të Kokajve 2008*) / Vendbanimi Kokaj në mes të Gjilanit dhe Preshevës. Nga mbretëria SKS njihet edhe me emrin Inatovc. Mirëpo, bano-rët e Kokajve dhe rrethina kurrë nuk e kanë njohur me këtë emërtim të imponuar . Takimet familjare të kokajve është një festë e paharrueshme dhe tradicionale e banorëve të Kokajve, të Malësisë së Kardakut, që mbahet zakonisht verës. Banorët takohen përmall-shëm në mes vete. I ka marrë malli për të afërmit, për vendlindjen, arat, fushat, kodrat, lumenjtë, varret e çka jo tjetër. Këto janë "Ditët e takimet familjare" në Kokaj Takimete fundit që nisën diasporë është mbajtur në verën e vjetme(6 qershor 2008, nënv.jonë nga mërgimtarët e kokajve në Bruk Argau të Zvicrrës. Toka e tyre shtrihen nga "Kisha e Epër-me" në veri, e deri në jug në " Artare", ndërsa në lindje nga lumi Sllubica e në perëndim deri te lumi Llapushnicë. Pikniqet malore të këtij vendi po tregohen më tërheqëse në verën e sivjetme dhe, sikur është shtuar edhe

interesimi i të gathëve të kthehen për të pushuar apo jetuar për pak çaste së paku në vendlindjen e tyre. E adhurojnë vendlindjen e të parëve të kësaj anë të Malësisë së Karadakut. Aty, ku deri dje nuk funksionoi as telefonia mo-bile. Kokajt kanë ujë të pijshëm dhe është shtruar një pjesë e mirë e rrugës me vetë kontributin e qytetarëve të Kokajve.




Pamje: Kokajt e epërm

KOKAJ, DJE DHE SOT ... Pos arritjes së sinjalit të telefonisë celulare, uji është me rënie të lirë dhe instaluar në shumicën e shtëpive që janë për banim apo mund të renovohen me pak investime, si dhe pjesa më e madhe e rrugës që të shpie atje është e pritur për t'u shtruar me asfalt, madje është rritur edhe çmimi i tokës dhe i shtëpive, ndërsa janë shtuar ata që duan të kenë të bërë një vend strehëve të atyre çatave në atë katundin malor-kodrinor .

Katundi Kokaj shtrihet në juglindje të Gjilanit në gjerësinë gjeografike gjatësisë gjeografike lindore dhe lartësi mbidetare 565 m., lagjja e Poshtme dhe 643 m lagjja e Epërme. Si vendbanim është krijuar para dy shekujve kur banorët e parë erdhën nga vendbanimi i Sanxhakut të Toplicës, vendbanimi Klaiq. Katundi Kokaj përbëhet prej tri lagjeve të ndara njëra nga tjetra, e ato janë: Mëhalla e Poshtme, Mëhalla e Epërme dhe në mes tyre shtrihet Gurina, ku edhe është shkolla e katundit e ndërtuar në vitn 1967, me iniciativën e plakut Nezir Haliti. Banorët, gjegjësisht të rinjtë e katundit Kokaj, përveç disa të rinjve që ishin shkolluar në mejtepet e Preshevës më vonë në xhaminë e përbashkët të ndërtuar në vitin 1930 pranë lumit Sllubica, të tjerët nuk patën fat të shkollohen deri pas Luftë së Dytë Botrore, kur në katundin Locë u hap shkolla fillore. Deri në vitin 1967 vijuan shkollën fillore të ulët shumë gjenerata, të cilat u shkolluan në Pogradjë . Në vitin 1967 plaku Nezir Haliti (Mixha Nezë ndërtoi shkollën me vetëkontribut në pronën e vet, në mes të katundit në afërsi të lagjes Gurinë). Mësues të parë ishin pikërisht të rinjtë e këtij katundi, të cilat ishin shkolluar si Rrustem Rrustemi e Halil Halili. Numri i nxënësve në të katër klasat ishte nga 45 e deri në 55 nxënës. Sot kësaj shkolle i kanoset rreziku i shuarjes për arsye të mungesës së nxënësve. Në këtë vit shkollorë i ndjekin mësimet vetëm katër nxënës me të cilët

punon mësuesi veteran Shefki Xheladini. E kaluara e katundit Kokaj rrjedh nga Klaiqi prej nga ishin ardhur banorët e katundi Kokaj, kufizohej me lagjet dhe Vendbanimet e dikurshme shqiptare si: Gërgurovci, Bajra, Poroshtica, Llapashtica etj. Nga ky vendbanim e kanë prejardhjen banorët e katundit Kokaj në Karadak, mandej banorët e lagjes Klaiq të qytetit të Gjilanit, (të cilin ende i kanë pronat e tyre në Klaiq të nacionalizuara pas Luftës së Dytë Botërore) muhaxhirët e katundit Kokaj, gjegjësisht një lagje e katundit Ranatoc, i cili ndodhet në Malet e Karadakut, komuna e Preshevës. Vendbanimi Kokaj në mes të Gjilanit dhe Preshevës, vendbanim ky që pas vendosjes së pushtimit të Mbretërisë SKS njihet edhe me emrin, Inatovc. Mirëpo, banorët e Kokajve dhe rrethina kurrë nuk e kanë njohur me këtë emër, sepse është emër i imponuar me pushtimin e këtyre trojeve nga ushtria serbe në vitin 1912.



HISTORIA E PËRGJAKUR (Pjesa e 2-të) - Më 1999 në Kosovë erdhën mijëra paramilitarë serbë, të cilët masakruan banorë në të gjitha fshatrat e Kosovës, por edhe në katundin Kokaj e fshatrat tjerë të kësaj ane të Kar-dakut. Të parët e këtij vendbanimi së pari u vendosën në katundin Pogradjë, ku edhe sot ruhet emri i sokakut me këtë emër, " sokaku i Kokajve", ku edhe kanë jetuar 3 vjet. Pastaj tokën e kanë blerë nga Isa Beu i Shkupit, ndërsa kontratën e kanë bërë në Vrajë. Në kontratë shkruante se është paguar toka e tyre, e cila shtrihen nga "Kisha e Epërme" në veri, e deri në jug në " Artare ", ndërsa në lindje nga lumi Sllubica e në perëndim deri te lumi Llapushnicë. Klaiqi është fshat në komunën e Lebanës të Jabllanicës (sot Serbi jugore), dikur i banuar me shqiptarë, të cilët u dëbuan me dhunë nga pushtuesit serb. Kjo kohë është e njohur si dëbim me dhunë nga vatrat stërgjyshore. Shumë fshatra u boshatisën dhe ikën më të keqës nga barbaria serbe. Shqiptarët u përzunë me dhunë. Ata i lanë tokat, arat, pyjet, fushat, por i lanë edhe hambarët me grurë, koshat me misër, stallat me kafshë e çka jo tjetër. Ishte një shpërngulje masive dhe tepër e dhembshme. Për këtë dëbim mbasi, disa autorë shqiptarë kanë shkruar edhe libra e studime shkencore historike). Pra, trojet që nuk harrohen lehtë. Trojet që nuk harrohen - Sabit Uka është njëri ndër aut-orët shqiptarë që ka shkruar më së shumti për shpërnguljen e shqiptarëve prej atyre troj-eve të kësaj kohe. Ai ka botuar tre libra me shënime të kësaj kohe të rëndë të shqiptarëve. Andaj, 50 vjet më vonë në vitin 1878, nga banorët e mbetur në Klaiq të Lebanës katundit Kokaj iu bashkohen edhe familja e Ali Bylykbashi-Koka dhe Demir Klaiqit-Koka, të cilat vendosën në vendbanimin te Muhaxhirët e sotshëm të Kokajve, sikur edhe tri familje tjera që janë vendosur në mes të Kaçanikut dhe Feri-zajt dhe mbajnë mbiemrin Koka, dhe shumë familje tjera në Gjilan, Prishtinë, Shkup, Kumanovë, e tjera. Sipas regjistri-mit të parë që është bërë në vitin 1948 katundi Kokaj ka pasur 250

banorë, në vitin 1953 ka pasur 289 banorë, në vitin 1961, 342, në vitin 1971, 386 ndërsa në vitin 1981, 376 banorë. Nga viti 1981 e këndej ka pasur vazhdimisht zvog-lim të popullsisë si pasojë e emigrimit të banorëve në drejtim të qendrës komunale të Gjilanit. Po rënie të numrit të popullsisë ka shkaktuar lufta e fundit kur nga ky fshat u shpërngulën shumica e popullsisë si pasojë e pasigurisë së këtij lokaliteti, i cili gjendet afër kufirit. Nga kjo kohë gjer më tashti kanë ndërruar kohë tjetër. Ishte një kohë e nënshtrimit nga barbaria serbe. Erdhen kohë të tjera, për faktin se, ajo "gjendje" nën okupim të regjimit serb nuk durohej, popullata e ndjeu këtë rëndim të keq. Të rinjtë filluan të largoheshin nga trojet e tyre dhe zënë vend në shtetet e perëndimit. Kjo të përkujton një gjendje të skajshme të pasigurisë. Dhe, në vitin 1999 ndodhi lufta në Kosovë. Lufta barbare serbe, e cila mori qindra e mijëra jetë njerëzish të pafajshëm. Erdhën vullnetarët nga Serbia, si nga Vranja, Leskovci e mese tjera, vetëm e vetëm të masakrojnë e ta dëbojnë popullatën shqiptare nga trojet .

SKENARËT SERBË - Ky skenar është hartuar nga nacionalistët serbë, po edhe nga Akademia Serbe e Beogradit. Nga 27-28 (e deri më 5-6 prill) e më vonë erdhën në Kosovë me mijëra paramilitarët serbë, të cilët pa kurrfarë shkasi kanë masakruar disa banorë të gjitha fshatrave të Kosovës. Kanë masakruar edhe në katundi Kokaj e fshatra të tjera të kësaj ane të Kardakut, si në Zhegër, LLashticë, Shurdhan, Selishtë, Lladovë e të tjera. Sot në këtë fshat jetojnë vetëm pesë familje me rreth 30 banorë. Kokaj është fshat tipik agrarë. Nga sipërfaqja e përgjithshme 402 .52 ha, 121.21 sipërfaqe me ara, pemishte me 89 ari, me livadhe 5.00 ha, kullosa 20.00 ha, ndërsa pyje 234.00 ha. Sipërfaqet me toka jo produktive janë 23.00 ha. Shumë shtëpi ishin të shkatërruar dhe disa prej tyre dukesh-in si të lëna shkret e të braktisura fare, por te Kokajt, thonë se, "janë të shumtë ata që po kthehen për t'i rinovuar apo ndrequr për banim të

përkohshëm, ndonëse fare pak janë ndihmuar apo përkrahur pos katër sosh, për t'i sanuar dëmet e luftës dhe të tërmetit të 24 prillit 2002, iu premtoi prioritet e Qeverisë shtrurja me zhavor e rruges 5 km, Llovcë-Kokaj për zonën kufitare (por ende nuk është realizuar), sikur edhe ish i pari i komunës së Gjilani, por edhe KFOR-i amerikan për çështje civile. Tani shihet një fshat i vogël, ku nuk kanë mbetur më shumë se trembëdhjetë shtëpi, siç tregojnë shën-imet të diktuar nga përfaqësuesi Kokajve, sepse librat amëz i kishin grabitura ata që u shporrën më 9 qershor 1999. Dik-ur, në fund të vitit 1970, katundi Kokaj konsiderohej katundi më i banuar në zonën kufitare me Serbinë dhe Maqedoninë në komunën e Gjilanit, me rreth 500-600 banorë dhe numër-onte jo më pak se 100 shtëpi. Katundi gjendet jo më larg se 20 kilometra në juglindje të Gjilanit, në një lartësi prej 850 metrash mbi nivelin e detit. Katundi malor i Kokave figuron prej kohësh në atraksionet turistike të alpeve të Malësisë së Karadaket, edhe pse i harruar për një kohë të gjatë. Dëshëm të dimë më tepër dhe u gjendem në këtë lokalitet, Kokaj. E vizituam këtë lokalitet të Karadakut jetik të Idriz Seferit, kreshnikut të kësaj ane. Por, nuk mungojnë njerëzit që shkojnë për ta kërkuar atë stinë ikanakë..

Në "Sheshin e valleve" - Në muajt korrik e gusht gjallërohet edhe me ndonjë festë dasmash, gazmendesh tradicionale që organizohen nëpër shtëpi apo siç i quajnë vendasit "Sheshi i Valleve" dhe pret dasmorët në vadën e ndarë për të marrë apo dhënë nuse të re malësore. Festat e motmotit, siç janë Shën Gjergji dhe Shën Mitri, janë kremtuar si festa pagane dhe kanë mundur të mbijetojnë, edhe pse gjatë pushtimeve të huaj, duke e ruajtur edhe pronën private si të drejtë të patjetërsueshme me buri-me të ftohta të ujit. Njëri prej tyre, i quajtur "Kroi i katundit", përdoret edhe sot si ujë për kuzhinë dhe bërjen e çajit prej luleve më të pijshëm. Shtëpitë janë të ndërtuara me gurë si në gjithë zonën e Malësisë së Karadaket, në katet përdhese dhe shtëpi Kulla, ndërsa specialiteti me të preferuara

është pikërisht lakrori i gatuar me dy petë dhe flija e bërë me mazë tëmbli dhe të fërguara me saç të nxehtë oxhaku. Ka nga ata që e preferojnë të kalojnë pushimet edhe dimrit, por vështirësitë që u sjell bora, shpesh i bëjnë të pakalueshme rrugët për në Kokaj, ndonëse të dhënë dhe janë më të pasionuarit pas gjahut dhe rrëshqitjes me ski në borë, që shpesh deri në Shën Gjergj nuk shkrihet në majat e malit të Karadakut. Për historinë e katundit Kokë, thuhet se është një vendbanim jo i vjetër sa edhe interesant. Sipas tregimit të një më të moshuari, Haxhi Isë Koka, ky fshat (Kokaj) është themeluar e shtuar vazhdimisht prej të "ikurve të dalë maleve", kaçak-ëve të Kokave që përndiqeshin nga Serbia (nga vendi Kliq, Toplicë) më së shumti për arsyen se nuk donin të konverto-nin fenë dhe ta njohin pushtimin dhe pastrimin etnik të tyre. Emri "Koka" vjen nga një e dhënë që thotë se: "kryengritësit që themeluan Kokë...Kaçakët e Kokajve (*Fejton dokumentare*) -Për historinë e katundit Kokë, thuhet se është një vendbanim jo i vjetër sa edhe interesant. Sipas tregimit të një më të mo-shuari, Haxhi Isë Koka, ky fshat (Kokaj) është themeluar e shtuar vazhdimisht prej të "ikurve të dalë maleve", kaçakëve të Kokave që përndiqeshin nga Serbia (nga vendi Kliq, Toplicë) më së shumti për arsyen se nuk donin të konverto-nin fenë dhe ta njohin pushtimin dhe pastrimin etnik të tyre. Emri "Koka" vjen nga një e dhënë që thotë se: "kryengritësit që themeluan Kokën (lexo: Kokaj), ishin nga fisi Koka që ndihmoi shumë pas pushtimit otoman si dhe gjatë luftërave ushtrinë e Skënderbeut, ku sipas mr. Vroin Koka, ata pastaj u shpërndanë për Itali e gjetiu, por kishin mbetur edhe prej tyre që kërkonin strehë rreth një stani në male, kur i pyesnin "kur e bënë Stanin në Kokë, paguan prej një kumarxhiu të shkuar në Shkup për 33 dukat ari".

MUHAXHIRET NË KOKAJ - Bëhet fjalë për një vendbanim nga njerëzit e dëbuar prej Livadheve të Klaiqit në Toplicë me 1835, nga fisi Koka që gjendej gjithë andej

etnisë, ndërsa dëshmia e akademik Matkovskit me origjinë shqiptare nga fisi i Koka, si dhe mr. Vroin. Koka të dhënat historike flasin për një vendbanim të Arbërisë në Fushëdjegur, të shpërndarë nga Koha e Skënderbeut, ndërsa këtu u hap shkolla e parë turqisht në shekullin e kaluar nga hoxha i Kokajve, nga mulla Smajli, pastaj në pjesën e parë, pos shkrimit cirilik, mësohet privatisht nga dijetarët edhe në alfabetin shqip. Kurse pas Luftës së Dytë Botërore, këtu hapet shkolla shqipe, ndërsa më 1969 rifilloi mësimi fillor, kurse në vitet e '70-ta, katundi Kokë numë-ronte rreth 600 shtëpi, shumë sosh me profesioni blegtorë të parë dhe duket se kanë qenë puna e druvarit. Që nga viti 1835 deri më 1912 në këtë malësi punonin ende sharrat e kokave, jo aq adekuate, por me teknikën më të mirë të saj kohe, me pemë, aq sa mbeti edhe shprehja e njohur. Ndërtimi i shtëpive, odave, hambarëve, të kthyera kah juglindja prej guri e me drunjte bingu në gjithë katundin, tregon për një maket origjinale të stilit oriental dhe evropian që mund të haset edhe në gjithë vendbanimet e vjetra të tjera në Mal-ësinë të Karadakët prej Gjilanit e deri në Shkup, për karshi janë majat më të larta, si: Maja e zezë, ajo e Godenit dhe Sukës, si dhe Maja më e lartë e Sharrit që ende në këto ditë vere është e veshur me borë, ndërsa edhe gjatë gjithë verës rrallë ndodh të shkrihen pika me të lartë e saj. Midis burimeve të shumta krojeve, në këtë rrugë që përshkohet për gjith-andej është i pasur edhe me uji termal i quajtur "Banja e Uglarit", që shërben si ujë kurativ për shërimin e reumës, ..

PAMJE TË PASHLYESHME - Shtëpitë dhe konfiguracioni i vendbanimit më karakteristike edhe për turistët, plotësojnë bukurinë e kësaj zone malore kufitare, që frekuentohet nga të katër anët e lidhur me rrugë të asfaltuar deri në tre-katër kilometra, por të shtruar me zhavorr, ndonëse jo ende me një infrastrukturë rekreative dhe sportive pos asaj që ka falë nëna natyrë e virgjëreshë, pa ndotës, po me ambient ekologjik. Edhe njerëzit janë shumë

mikpritës dhe gatuajnë specialitete karakteristike tradicionale dhe evropiane, ndonëse ende nuk ia kanë idenë për ta bërë me një motel, restorant apo bujtinë, duke ia shtuar edhe vend kampingjet për turistë verorë që ia mësyjnë të kalojnë pushimet e vikendit apo ato verore në ambiente malore me trastë në krah me pak bukë e dhallë, për ta kaluar kohën e lirë. Jo larg në Rup ishin varrosur edhe martirët e vrarë gjatë luftës së fundit (1999), ku pas varrosjes së disa njerëzve publikë, qoftë edhe të vdekurit; dëshmorë, martirë, shkrimtarë dhe, shumë njerëz publikë, aty në Rup të varrezat tyre mbesin në kujtesë ato pamje të dashmë. Kokajit ngado ku janë, janë përcaktuar që e diela e fundit e korrikut të jetë Ditë e takimit familjar në vendbanimin Kokaj dhe mëton të jetë tradicionale. (Kosov sot, Prishtinë)

Komuna / Marketing

FSHATI QË NDAHET NGA DY KUFJI

Të gjallët këndeje, varret matanë kufirit

• Pavarësisht se realiteti i imponuar politik i ka ndarë me një kufi të gjallët dhe të vdekurit, në Kokaj jeta ka vazhduar, por me vështirësi të mëdha



Verës ringjallet sheshi i valleve

Tabela e identifikimit këtë vend si kufi provincial, ndonëse mund të jetë vendosur për orientim të pagënjaltëve nderkombëtarë. Banorët kanë rrethet se më parë një tabelë e kufit ka qenë e vendosur diku rreth 200 metra me në thellësi të territorit të Serbisë, ndërsa tani gjendet në brenësi të territorit të Kosovës. Gjatë muajve të verës, në Kokaj gjerëron natyra dhe gjallëron jeta. Behen edhe dasmat dhe grometë tradicionale që organizohen nëpër shtëpi, apo, siç e quajne vendësit, të "Sheshi i Valleve". "Koca i katundit" përdoret edhe sot si ushë për kuzhinë dhe për bërjen e çajit prej huleve. Në Kokaj spikasin shtëpitë e ndërtuara me gjarë, si në gjatë zonës e Malësisë së Karadakut. Verës, Kokaj është një vend i mrekullueshëm, sepse atje ndihen të bërë me maaz, gjen bukë e pjekura me saç dhe të mirat e tjera që i ka ky fshat me traditë, tërësi dimesi është veshtrë i arditshëm. Në majt e malëve të Karadakut shpeshherë boren e e Shën Gjergji.

I. MUSLIU

Gjilan, 21 maj

Kokaji gjendet në luginën të Gjilanit, në një territor që shtrihet edhe në pjesën e Preshevës, matanë kufirit. Ky vendbanim është themeluar para dy shekujsh, nga banorët e parë që erdhën nga Sanxhaku i Toplicës, përkrahësit nga fshati Kllaç. Sipas regjistrimit të parë, që është bërë në vitin 1948, fshati Kokaj kishte 250 banorë, numër ky që është rritur nga viti në vit, deri më 1981, por kështu e këndej ka filluar rritjen në drejtim të qytetit të Gjilanit, por edhe të Preshevës. Bëhen më të madhe të popullsisë ky fshat e ka përjetuar pas luftës së fundit, si pasojë e pasigurisë për të jetuar në këto zona kufitare. Tani atje rralle shihet ndonjë oxhak që tymon, ndërsa shkolla ka rreth në 3-4 xhënës. Pas Luftës së Dytë Botërore, vetëm një numër i kufitarëve të rinjë patën fatin të shkolloheshin. Ndër të parët ishte Mustafa Rushiti, i

cili më 1944 u bashkua me rrejtësin e Brigadës Shqiptare që po kalonte nëpër Kokaj. Në Tiranë këtu kualifikimin për mesues. Në fund të vitit 1947 ishte kthyer në Kosovë, ku filloi punën e mësimit-hënës, nevojë kjo që ishte shumë e madhe për malësorët e Karadakut dhe banorët e Azanovës. Më vonë u hap shkolla edhe në Kokaj. Mësuesi i parë ishte Ernest Brosteni, e më vonë edhe Halli Halli. Në vitin 1972/73, numri i nxënësve në të katër klasat ishte gjithsej 14, të cilët e përfunduan ketejçerën dhe vijuan shkolllimin e mjetueshëm. Ferizazë Haziri dhe Nalje Halli, për shkak të kushteve të veshitja, nuk arritën të shkollojnë më tej. Sot, dyzet vjet me vonë, shkolla ka rreth në katër xhënës, thotë Nijazi Ramadani, banor i fshatit Kokaj.

Serbanë nuk ka qenë lehtë të jetohet në këto vite. Provokime ka pasur edhe për banorët e fshatrave fqinjë, Zahajit e Myçibabë, që po ashtu i përkasin kësaj zone. "Ata nuk mund të shkojnë të lirë as të varret e familjarëve të tyre", thotë Ramadani. Aliregen se sakti i Fejzës, njëri prej dy djemve të Adenit, themelues i katundit, ka mbetur matanë kufirit. Megjithatë, jeta në Kokaj nuk është shuar. Banorët nuk deshirojnë që të humbën gjumet, të pakten jo guset e varreve. Përgjegj për jetën dhe të vdekanit në Kokaj paraqet baza ushtarake serbe, me e madhja në Luginën e Preshevës, që është afër kësaj zone. Ata kanë humbur të vetmin barmë jesece ark, kullosat, livadhet dhe malet. Megjithatë, fshatari janë të vendosur për t'i ringjallur këto troje, që po zvogëlohen padrejtitësisht nga zgjidhjet politike arbitrare. Në tabelën që është vendosur nga KFOR,

Jeta në zona kufitare, e vështirë

Përreth zonës kufitare me

SHKRIME, ARTIKUJN SHTYPI DHE PËRKUSHTIME

Tkurrjet e territorit në juglindje të Kosovës po ndodhin edhe sot në brezin kufitar me Serbinë ([i]te katundi Kokaj të Gjilanit)[/i]Kokajt fshat i brezit kufitar po përballet me hallet e shumta, shkolla, rruga dhe izilimi nga bota . Si të dilet nga ajo gjendje? - 6 maj 2009, (Ditë e motmotit (Shën Gjergj), fillimi i verës 2009) Banorë të katundit Kokaj të Gjilanit, të cilët janë afër kufirit me Serbinë, janë shprehur të vendosur që të qëndrojnë në pronat e tyre. Ata kanë kërkuar disa herë përkrahje më të madhe të institucioneve lokale e qendrore dhe investime, si: në përfundimin e rrugës Llocë-Kokaj, deri te pika kufitare me Serbinë, e cila ditëve të fundit sipas deklartave te bano-rëve të mbetur në tokat e tyre, kanë shtyer (zbritur tabela) deri afer 100 m Xhamisë së Sllubicës. Ndërkaq, të mërkurën (Ditë e motmotit (Shën Gjergj), fillimi i verës 2009) në një raport 13 min. të RTK-së, medum i vetëm publik i Kosovë, te emisioni Pro et contra (të reporterit Zekë Sinani) është bërë bubleke zhvendosja e tabelës që shënon zonën ndarëse kufitare mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në kilometrin e 20-të mes kumunave të Gjilanit dhe Preshevës. Sipas Reshta dhe Nehat Hazirit ka ndodhur tkurrja teritoriale mbi 100 metra, duke lënë matan kufirit lagjen e Muhaxhierve te Kokajve dhe varrezat e Mëhallës së epërme të Kokajve.Patrollimi i xhandarmërisë dhe milicisë serbe, i ka sjellë shqetësim permanent për sigurin e tyre. Ata nuk e kanë të lirë të shkojnë në tokat e tyre dhe te varrët për të varrosur apo vendos një lule apo lutje për të afërmit e vetë. Varri iFezës njërit nga dy djemët e Ademit, themeluesë i katunditka mbetur matanë kufirit. Reshati ka potencuar faktin se "prania shumë afër në kilometrin e fundit të bazës ushtarake më të madhe në Luginën e Preshevës (Koosvës Lindore) si edhe shtyrja e tabelës që ma tej nuk mund t'i afrohen ban-orët dhe bagëtia e tyre". Ata kanë humbur të

vetmin burim jetese, arat, kullosat, livadhet dhe malet e tyre, deklarom njëri nga më të moshuarit nga Muhaxhirët e kokajve, të lindur në Kokaj dhe kanë certifikatat e lindjes të lëshuar nga zyrja e vendit në Pogra-gjë nga ofiçari Rexhep Rexhep, banor i komunës së Gjilanit, tashmë e ka braktisur shtpinë dhe tokën e vet. Atyre iu ka premtuar Kryetari i Komunës së Gjilanit përkrahje në infra-stukturën e katundit, si elektrifikimi, renovimi dhe mundës-isht në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht të bëjnë të përdorshëm rrugën që lidh edhe me fshtrat tjera të brezit kufitar. Monitorimin e trafikut dhe kalimeve ilegale, si edhe gjetjen e një zgjidhjeje politike për zonën e ngu-shtuar teritoriale, ashtu siç është vepruar me Maqedoninë si dy shtete fqinje ka deklarura për RTK, të enjtën pas orë 12.00, kryetari i Komunës së Gjilanit . z. Mustafa. Edhe fshatarët janë të inkurajuar për t'i ngjallur ato troje që po zvoglohen padrejtësisht nga argumenti i forcës dhe zgjidh-jeve politike arbitrare që fati i ndau pas viteve të '50-ta nga trunq i Kosovës, si Buhiqi, Staneci, Lezbalia, Kurbalia, Seferët, Maxherën, Gosponicën, Zahirajt, tashmë së fundi edhe Kokajt që janë banorë familjar të Kokajve [b]. (Gramos)

Kjo tabelë qe rishtazi është vendosur nga KFOR-i, në varrezat e katundit Kokaj, dhe pas së cilës shihen shtëpitë e katundit Ranatoc, që sipas kësaj tabele gjenden në Serbi, ka irrituar jo vetëm banorët e kësaj ane, por edhe të gjithë ata që e lexojnë. Në tabelë kufiri nuk quhet shtetëror por provincial apo krahinor. Tabela si duket është vendosur për të shënuar kufirin dhe për të këshilluar ushtarët e KFOR-it që të mos kalojnë pas saj pasi që territori matanë është Serbi. Banorët kanë deklaruar se më parë një tabelë e këtyllë ka qenë e vendosur diku rreth 200 metra më në thellësi të territorit të Serbisë por më brenda territorit të Kosovës. ..

MUSTAFË KOKA³² – KAÇAKU I FUNDIT I KOSOVËS³³



Mësuesi Mustafë Koka

Mustafë Koka³⁴ në Remnik ishte sapomartuar me Rabien, e cila vdes shtatzënë bashkë me burrin dhe Qibrije e Agush Hazirin, grupin e Hasanit³⁵, më 1951. Nga fillimi i vitit 1951, erdhi një kthesë të fortë nga Shqipëria. Në këtë drejtim, ndikim të madh pati mësuesi Mustafë Koka³⁶, të cilin UDB-a e mbante në thumb për agjent të shërbimit informativ shqiptar, sepse atje kishte vënë disa kontakte më përfaqësues të ndryshëm, e sidomos me ata kosovarë që

³² Mustafa i Hetës dhe i Habibës, ishte lindur më 1931 në Kokaj të Gjilanit. Katër klasë gjimnaz dhe një kurs ushtarak i kishte kryer në Tiranë, kurse kursin e pedagogjisë në Prizren. Punoi mësues në Uglar, Lubishtë dhe Remnik.

³³ Rrëfim i Ismail Idriz Koka, djali i xhaxhait të mësuesit. & Ismaili, i cili më 26 mars 1999 në mbrëmje është gjuajtur me pushkë snajperike nga një fqinj serb, ku fatmirësisht nuk ishte goditur, kurse gjurmët e fishekut gjenden edhe sot në librat e bibliotekës së tij.

³³ R. Asllani: Monografia “*Hasan Alia* – luftëtar për etninë shqiptare

vinin nga Shqipëria. Sipas të dhënave të provincës së UDB-ës në majin e vitit 1951, nga Shqipëria erdhi Hysen Thaçi , ish-komandant i Komandës së Vendit në Skënderaj të Drenicës, (më 1945-46), i cili pas mbajtjes së burgut, më 1948, shkoi në Shqipëri. Ai në katundin Zabel të Drenicës e organizoi një takim me përfaqësuesit e organizatave politike ilegale shqiptare të Kosovës. Xhaferi dhe Voja ... J. Bullajiqit në fejttonin e tij, "Rilindjes", "Prita në Bisatricë" ,"Dy oficerët e rinj të UDB-së - Xhafer Lilën dhe Vojislav Taliqin -Vojën, Ata shkuan në Remnik në mbrëmjen e 5 qershorit 1951 dhe i morën në pyetje "disa jatakë" të Hasan Remnikut dhe tërthorazi edhe mësuesin Mustafë H. Koka, prej të cilëve grupi ndiçej prej tyre. Mengjesi i hershëm i datës 6 qershor 1951, ishte I kthyeshëm, sepse mësuesi Mustafë e mori armën “ Beret” dhe e hapi ngadalë derën e dhomës ku I kishte lënë në mbrëmjen e vonshme për ta kaluar natën, të cilët po flinin udb-ashët - Xhaferi e Voja, dy operativistët e me detyrë që të merrnin në pyetje disa jatakë e Hasan Remnikut dhe mësuesit Mustafë Koka, me të cilin po bisedohej me shumë kujdes, që të mos e kuptonte se UDB-a është duke e përcjellë – citat i J. Bullajiq: *"Duhej bërë përpjekje për të bindur Mustafën, që të bashkëpunojë me shërbi-min e organeve të sigurimit jugosllav, por të mos hetohet aktiviteti "armiqësor" i tij.* Sipas dëshmimeve të shumë remnikasve, Xhaferi dhe Voja arritën në Remnik pas drekës dhe fillimisht shkuan në shit-oren e katundit, e cila ishte afër shkollës. Aty u ndalua mësuesi Mustafë, i cili sapo i kishte lëshuar nxënësit në pushimin e gjatë, deri sa ishte duke lozur sha me kolegët e tij, në zyre. Ai parandjeu thellë ardhjen e kësaj makinerie “vrastare”se me UDB-ën kishte mbetur ky takimi i fundit. Sipas J. Bullajiqit Xhaferi dhe Voja atë natë, u vendosën në shtëpinë ku banonte mësuesi dhe aty i morën në pyetje pos disa fshatarëve edhe Mustafë Kokën. Ishte kjo shtëpia e Ahmet Nezirit, në odën e të cilit banonte Mustafë Koka me nusen e posamarrë, Rabien, bijë e

Remnikut. Pas darke mësuesi u ofroi udbashëve të shkonin për të fjetur në banesën e tij, pasi gruan e kishte dërguar në gjini, kurse Mustafa do të flinte te ndonjë fshatar. Në banesën e Mustafës dy udbashët i vazhduan hetimet me një vrazhdësi. Më në fund, sipas Bullajiqit, i thanë se ata i dinë të gjitha lidhjet e tij me Hasan Remnikun dhe me organizatën ilegale antijugosllave.

Mësuesi atdhetar i pamposhtur, duke përvijuar gjurmët e veta nën dritën e hënë dhe hijet e territ zbret deri në shtëpinë e Arif Sylës dhe sipas të UDB-ës ia e kishte dërguar arkivin e organizatës së NDSH-së: *Merre dhe dërgoja Hasanit - le të gjendet te ai derisa të bashkohemi*. Tërë natën e lume nuk bënë gjumë, duke peshuar në mendjen e tij, se si do t'ia dilte me aksionin e parë të armatosur!? Për t'i vrarë dy operativistët e UDB-ës. Ai e kishte vendosur që kur ishin takuar në shitore paditën e kaluar, edhe për këtë qëllim i tërhoqi në banesën e tij, sepse ka shtrojë më të pastër..!, ai në vend se t'ia kthej pragun në derë të hapur siç e pretendonin se është paguar për strehimin e tyre, shumë shpejt u rikthye në morg. Ai, deshti që t'i mos u linte vrragë për familjen dhe popullin. Para se të qelin agimi i ditës së 6 qershor 1951, e mori dhe e përgaditi armën dhe e hapi ngadalë derën e dhomës ku po flinin oficerët e paftuar - Xhaferi dhe Voja. Mustafa, duke mos dashur t'i vriste në gjumë i kishte zgjuar, duke u thënë se: Këte po e bënë në emër të lirisë së Kosovës dhe të popullit shqiptar, duke i dënuar me vdekje. Kam nderin që jam dora që do t'i jap fund fuajtjeve që po ua shkaktoni - Krismat e pushkës u dëgjuan larg dhe nxitën frikën te njerëzit e kësaj ane së mos po shkrep në kokat e tyre, por kësaj here mbi kokat e atyre që zbatoni planet famkeqe të UDB-së. U trazua katundi, kurse i zonja e shtëpisë, sapo ishte dal, e pa mësuesin që po dilte me nxitim, pas që kishte dëgjuar disa të shtëna me armë në odën e të cilit u vranë dy oficerët e UDB-ës. Ajo shkoi me vrap në odë t'i tregonte të shoqit Ahmetit. ... Voja dhe Lila, të dy ishin të plagosur për

vdekje, Lila merrte frymë thellë, dhe u ngrit në bërryla dhe i tha ta njoftojë milicinë - shkruante J. Bullajiqi. Dy oficerët e plagosur rëndë, porsa u takuan me milicët dhe punëtorë të tjerë të sigurimit, që kishin ardhur për t'i marrë të plagosurit për vdekje, që ishte njëri gjallë deri te qeshmja e Budrikës, u thanë se nuk është tjetër kush pos Mustafës, fajtor për vrasjen tonë. “Ne nuk qemë të kujdesshëm sa duhej me Mustafën dhe e paguam me kokë”. Shefi i Policisë së Kosovës, Shaban Kajtazi: "Xhaferi dhe Voja kishin pasur prindërit burra. Ata nuk kërkuan asnjë hasmërie për popullsinë dhe kurrfarë hakmarrjesh për të bijtë e tyre. Pas kësaj ngjarjeje që kur shtiu Mustafë Koka në oficerët e UDB-ës dhe pjesëtarëve të tjerë të sigurimit të shtijë në eprorët e lartë të lartë të sigurimit jugosllav. Pastaj filluan burgosjet, arrestimet së pari burgosjen jatakun, Ilmi Godenin (vëllai I tij, u torturua mizorisht deri sa nga pasojt vdiç, pas tre javësh. Edhe Arif Sylën, kuririn dhe bashkëpunëtorin më të afërt të tyre, ndaj të cilit bënë hetime intensive dhe të gjata. Arifi duke qëndruar i palëkundur, torturohet aq shumë, vetëm t'u hakmerrej atyre që e vën në torturë mizorë. Meqë UDB-a nuk kishte argumente se “Arfi Syla ka marrë pjesë në vrasjen e dy oficerëve të UDB-ës, së bashku me Mustafë Kokën, i dhanë instruksione për mënyrën e bashkimit dhe e liruan”. Mirëpo, Arfi Syla nuk thyhej, vazhdoi me përmbushjen e detyrave të reja, të marra nga Hasani dhe mësuesi Mustafë Hetë Koka, i cili sa vinte e përpiqej për ta bindur Hasan Remnikun se ishte ngushtuar rrethi, kur ata duhej të largoheshin pa dëshirën e tyre nga Kosova dhe të kalonin në Shqipëri, sepse push-tuesi kishte arritur kulminacionin me marrjen në pyetje e tortura të shumë kryefamiljarëve, ... Lidhur me këtë se vinte koha e ftoftë ishte ngushtuar shumë, Bullajiqi shkruante për Mustafën: "Mustafa përpiqej që ta binte Hasnin "se momentalisht çdo qëndrim i mëtutjeshëm është i kotë. Mendonte se me çdo kusht duhej të kalohej në Shqipëri. Atje do të lidhen me

rezistencën shqiptare të organizuar kundër Jugosllavisë, kurse tani sa më parë duhej që të largoheshin nga Kosova". Mustafë Koka, madje e dërgoi Arif Sylën në Shkup, me një letër për Gajur beun nga i cili kërkonte të studionte mundësitë për t'i përcjellë në Shqipëri këta njerëz: Mustafën me grua, Agushin me grua dhe Hasanin vetë. Sipas të dhënave nga terreni, aty nga fundi i qershorit të vitit 1951, Hasan Remnikut i bashkohet edhe Agush H. Mehmeti, për të cilin garantuan jatakët e tij besnikë: Smajl Deli Muji dhe Smail e Naman Deli Qorroli të Bresalcit, të cilët më vonë do të dënohen me burg si mbështetës të tyre. Nga mesi i vitit 1951, për mbylljen e dosjes "Hasan Remniku - Alia, Aleksa Vuçiniqi i përgatiti kurthin për zënien e personaliteteve shqiptare që ishin në arrati përmes komandantit të stacionit të milicisë në Bresalc dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ata e morën Hasan Remnikun dhe e sollën në kullën e Agush H. Mehmetit, në gushtin e vitit 1951, edhe Mustafë Hetë Koka me gruan, në kullën e Agushit në Bresaalc u bashkuan prej kah nisën për në Shqipëri. Bashkimi i Agush H. Mehmetit dhe i Mustafë H. Kokës me Hasanin, që forcoi dhe sa vinte e po zgjerohej, pasi që iu dha leksion UDB-së se, nuk do ta kenë lehtë ta shuajnë lëvizjen atdhetare pë liri, si dhe dhe e ndërlikoi mundësisë për zënien dhe likuidimin e tyre me ndonjë atentat nga ana e ndonjë të besuari të UDB-ës. Në pjesën e dytë të gushtit 1951, me treshin: H. Remniku, A. Mehmeti dhe M. Koka u takua mësuesi cernicas, Ramadan M. Hoxha. Qëllimi i takimit ishte përpilimi i një liste me emra shqiptarësh për burgosjet, për vrasjet dhe për dhunën e pushtuesit jugosllav në viset juglindore të Kosovës, të ofruar prej Ramadan Hoxhës, takimi ky që u mbajt në Malet e Livoçit të Epërmë. Hasani ishte krahu i Ramiz Cernicës që interesohej, edhe të të birit të tij, Raifit, të cilët ishin në burg në Mitrovicën e Sremit, pas Jo-së së madhe me Serbi dhe "Po", me Shqipni, në Kuvendin e Prizrenit, kur u aneksua me dhunë Kosova nga ana e Serbisë./R.Asllani/ Të premtën,

më 12 tetor 1951, kufomat e tyre po ekspozohen te Lama e Millit, Gjilanit, (sot shtëpia e mallrave). Gjatë kësaj dite te kufomat ishte edhe nëna e Mësuesit Mustafë e cila njihet për qëndrimin e saj.”*Halla të qoftë gjiri që ta kam dhanë..*” si dhe mijëra qytetarë gjilanas e nga periferia. Të shtunën, me 13 tetor 1951 ditë pazari. E tërë rrethina e Gjilanit u derdh në Lamën e millit, por t'u bërë nderin e fundit pesë dëshmorëve të lirisë së Kosovës. Hasani Alia, Agush H. Mehemin me gruan Qibrien, Mustafë Koka me Rabien. *Të gjithë ata që i kanë parë kufomat e ekspozuara, madje edhe nga dy e më shumë herë vërtetojnë se vetëm Rabije Koka ka pasur një njollë të zbehtë të gjakut në këmishën e bardhë mbi brez, në anën e majtë!. Asnjë plumb nuk i dukej se t'i kishte depërtuar nëpër tessa e në trup?! Nga shënimet e terrenit, Shaban Kajtazi, ka ritreguar se Ismail Zenuni i ka thënë se vetëm gruaja e mësuesit ishte gjetur e gjallë pas ployës, se ajo kishte rënë në lumë dhe se e kishte bartur uji bukur larg sa që mezi e gjetën. Ndërkaq, disa pjesëmarrës të korpusit të Mbrojtjes Popullore që mor-ën pjesë në këtë “aksion” të UDB-ës “Prita në Bistricë”, vër-tetojnë se një oficer boshnjak ka thënë: -Njëra grua kishte mbetur gjallë dhe më është lutur ta vras dhe e vrava”. Në mbrëmjen e së dielës, më 14 tetor 1951, UDB-a e mbylli ekspozitën e grupit në Pazarishten e Gjilanit. Kufomat e luftëtarëve të lirisë i ngarkuan në “Doç”, dhe i dërguan në oborrin e kazermës së JNA-së, ku edhe i varrosën me një gropë. Me një shkrim të dr. Muhamet Pirrakut, thuhet se kufomat janë djegur me benzinë, por ne nuk e kemi hasur këtë të dhënë në terren, kurse vendvarrimi është identifikuar në muajin tetor, edhe pse ka pasur disa të dhëna edhe më parë. Për realizimin e kërkesave jetësore të kombit! UDB-a për të mbjellë tmerr në popullsinë shqiptare i burgosi mbi 27 jatakë dhe bashkëpunëtorë të Hasan Remnikut dhe bashkël-uftëtarët. Një numër të madh i dënoi me dënime drakonike. *³⁷ R A.)*

³⁷ Ramadan A. Monografia “*Hasan Alia – luftëtar për etninë shqiptare*”

Humazh te varret e tyre



b) Familjarët shpresojnë se janë gjetur eshtrat e pesë luftëtarëve të grupit të fundit të çlirimtarëve për rezistencë të armatosur ndaj ripushtimit jugosllav me 1945 të Kosovës *Gjilan, 10 tetor (Kosovapress)*

Me rastin e 57 vjetorit të vrasjes së grupit të fundit të çlirimtarëve për rezistencë të armatosur ndaj ripushtimit jugosllav më 1945 të Kosovës në krye me Hasan Alinë, familjarë të tyre dhe qytetarë të tjerë, i kanë nderuar me një minutë heshtje dhe kanë vendosur lule të freskëta në vendin e shënuar ku dyshohet të jenë të varrosur eshtrat e tyre, për t'u nderuar kështu për herë të parë publikisht pesë anëtarë të Ballit Kombëtar, për rënien e tyre në altarin e lirisë. Grupi i Hasan Alisë ku kanë bërë pjesë edhe Agush Haziri me bashkëshorten Qibrijen dhe Mustafë Rushiti-Koka me bashkëshorten Rabijen, konsiderohen ballistët e fundit shqiptar përkatësisht rezistuesit e fundit të armatosur të Ballit Kombëtar, të cilët u likuiduar nga pushteti komunist jugosllav. Fillimisht, ata janë nderuar me një minutë heshtje në vendin e ekspozimit të kufomave të tyre në vendin e quajtur asok-ohë "Lama e Millit", tani Sheshi "Abdullah Tahiri", për të vazhduar pastaj drejt kazermës ku janë bërë homazhe në vendin e shënuar ku dyshohen se janë të varrosur trupat e tyre fshehurazi në mes të muajit tetor të vitit 1951. Hasan Alia, nipi i Hasan Alisë tha se më në fund, pas 57 viteve, po

bëhet një hap i mirë drejt ndriçimit se ku gjinden eshtrat e këtij brezi që bëri një luftë të drejtë për popullin e tij. Ai tha se është nipi i Hasan Alisë. sepse nga gjenerata e parë nuk ka mbetur askush, dhe se për më se 50 vjetësh ajo gjeneratë e ka pasur mjaft vështirë për të jetuar me atë push-tet mbi supe. Por, sipas tij, pavarësisht prej rrethanave dhe sakrificave dhe të gjitha persekutimeve që ndodhen brenda kësaj periudhe u arrit që disa familje ta mbajnë me dinjitet dhe ta ruajnë personalitetin e këtij grupi që bëri shumë për popullin e tij. *“Nuk na takon vetëm neve familjarëve të jemi aq krenar për ta sepse lufta e tyre duhet të jetë krenaria e kombit ngase vepra e tyre i takon tërë kombit”*, ka thënë nipi i Hasan Alisë. Nijazi Ramadani duke shpalosur biografinë e Mustafë Kokajt, tha se puna e tij në fushën e arsimit nuk zgjati shumë pasi që pushteti komunist jugosllav për shqiptarët e Kosovës u bë i padurueshëm, kështu që Mustafa vendosi të ball-afaqohej me pushtuesin edhe në mënyrë të armatosur, duke iu bashkuar Hasan Alisë. Ndërsa në emër të familjes së Agush Hazirit, historiani E. Haziri tha se ndihet i lumtur që pas 57 vjetësh këto tri familje që përfaqësojnë Hasan Alinë dhe shokët e tij, të bashkuar kanë shënjuar këtë vend për ti treguar të gjithëve se ky shtet i ri i krijuar sot i ka rrënjët e ujitur me gjak shumë më thellë. Akti i ditës së sotme ka simbolikën e tij se ky popull duhet fillimisht të krijojë harmoninë e brendshme kombëtare në mënyrë që të ecë përpara. *“Harmonia e popullit bëhet kur të gjitha gjeneratat e dëshmorëve, heronjve, të gjithë ata që kanë rënë në altarin e lirisë e meritojnë dhe e marrin vendin e tyre të duhur”*, ka thënë Haziri. Ai tha se shpreson që në të ardhmen, institucionet e Kosovës do t’i përkrahin në hapjen e këtij vendi , nxjerrja e eshtrave të Hasan Alisë dhe të tjerëve, që është një pjesë e historisë kombëtare. Edhe folës të tjerë shpalosen të dhëna në lidhje me Hasan Alinë, Mustafë Kokës dhe të tjerët duke theksuar përkushtimin e tyre për të luftuar deri në frymën e fundit për të mirën e

kombit të tyre. Ndryshe, Halim Jetishi. i cili tha se ishte vozitës dhe binte shpesh funksionarët në kazermë kur kishte ndonjë ngjarje, rrëfeu para familjarëve, atë të cilën ia kishte thënë një per-son i vjetër me emrin Gjoka, po ashtu vozitës i komunës se ai në ato momente sa ishte në kazermë po qëndronte mbi varrin e Hasan Alisë dhe grupit të tij. Kjo por edhe disa të dhëna tjera sipas familjarëve, bënë që këta të shprespajnë se eshtrat e Hasan Alisë me shokë ndodhen brenda kazermës në qytetin e Gjilanit. (Muhamet Halili)

Mustafë Koka³⁸ – (Mustafa u lind në Kokaj më 1931) Mustafë Koka gjatë viteve të fundit të Luftës së Dytë iu bashkua një njësi të Brigadave shqiptare që po kalonte nëpër Kokaj, si luftëtar 15 vjeçar në nëntor të 1944 dhe më vonë sa qëndroi në Tiranë, kreu kualifikimin për mësues. Me në fund të vitit 1947 ishte kthyer në Kosovë, ku filloi punën e mësimit, nevojë kjo që ishte shumë e madhe për malësorët e Karadakut dhe banorët e Anamoravës. Puna e Mustafë Kokës në fushën e arësimit nuk zgjati shumë pasi që pushteti komunist jugosllav për shqiptarët e Kosovës u bë i padurueshëm, kështu që Mustafa vendosi të ballafaqohej me pushtuesin edhe në mënyrë të armatosur. Për disa vite rresht, Mustafa Koka u bë sinonim i tmerrit për serbët. Mustafa Koka dhe Hasan Alia Remniku, ka qenë simboli i rezistencës së pushtimit jugosllav të pas Luftës së Dytë Botërore. Së bashku me patriot të tjerë, përfshirë Hasan Remnikun, u vra pabesisht në një pusi që ia kishte përgatitur OZNA më 11 tetor 1951. Mësuesi në mendjen e tij kishte edhe ngjarjet historike. Ajetit, vëllait të tij, i kujtohet se si arriti Mustafa t'i bashk-ohet një batalioni të armatës shqiptare në dimrin e madh, para se të kapitullon nazistët, deri sa po kalonte aty pari. Mustafa, si një trembëdhjetë vjeçar në një mënyrë jo të zak-onshme ishte lidhur me ta, pasi që në një gjuajtje me armë, te kroi i përroit të Kokajve,

³⁸ Nijazi Ramadani:bot. “Bujku”(ish-Rilindja), rev.”Paqja” , “Jehona”

nuk e kishte gabuar shenjën. Musafit i miklonin këmbët duke pritur komandant Haxhiun, për të marrë lejen e tij, që ta provonte edhe ai. Me të parën ndau rrasën e gurit në thërrmija, dhe pasi që luftëtarët e trimëruan për një sukses në shenjëtari aty për aty, kërkoi që t'i bashkohet, nëse mund ta lejonin ata dhe familja e tij, për të vazhduar shkollimin dhe stërvitjet në përfitimin e shkath-tësive ushtarake. Atë ditë Mustafa mori pëlqimin, por më parë duhej ta kryente shkollimin si kusht i parë për ta ndihmuar vendin e lënë në duart e të huajve. Duke u ndarë prej tyre mori edhe përsëritjet për mësuesit shqiptar, të cilët ishin tërhequr në kryeqytet. Me të arritur në kryeqytetin e vendit, studioi tri vjet e gjysmë në gjimnaz. Në stërvitjet për shenjëtari nderohet me medalje të artë si përfaqësues i ven-dit në garat ballkanike. Ai, me të mbaruar shkollimin, me një dekret emërohet mësues i parë në vendlindjen e tij në Rem. Në qershorin e parë të fillimit të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, dy oficerë të lartë të UDB-së e ndjekin hap pas hapi. Ardhjen e UDB-së në fshat e parandiente mësuesi si kob i rikthyer nga ajo ditë që kishte përcjellë për në burg, babanë, axhën dhe vëllain. Kah gjysma e atij muaji i troka-sin në derën e banesës së tij në Remnik. Në fillim të qersh-orit të atij viti (1951), dy oficerë të lartë të UDB-së e ndje-kin hap pas hapi. Ardhjen e UDB-së në fshat e parandiente mësuesi si kob i rikthyer nga ajo ditë që kishte përcjellë për në burg, babanë, axhën dhe bijtë e vëllait. Kah gjysma e atij muaji i trokasin në derën e banesës së tij në Remnik. Para se të kthehej mësuesi nga një mbledhje e katundit, ku kërkohet që ta dorëzonin njeriun e fundit të ilegales, Hasan Alinë. Sipas dëshmimeve të arkivuar dhe të botuara atë natë me dhunë janë Lila dhe Voja, futen të paftuar në banesën e tij, kinse për ta kaluar natën, por qëllimi i tyre, ishte që ta dëbojnë atë për tej bjeshkëve. Voja, i tha: Ikë, ose ulu nën këmbët tona, derisa mësuesi kërkoi me ngulmë ta lëshonin banesën e tij, por ata as që lëvizën. Këtë nuk mund ta përpijë, tha vetë me veti.


Dhe kërkoi ta lejonin të shkoi për të fjetur te shërbëtori i shkollës. Atje ai e kishte lënë një revole, Beret për ta ruajtur kokën. Këtë s'mund ta duroj, iu tha ai, ndonëse që te dy iu sulën, duke e përgjakur fytyrën e tij, nëntëmbëdhjetë vjeçare. Ndërkaq, ai nuk jepet fare para tyre, ngrihet me forcën e fundit në këmbë dhe mezi shkon te portieri i shkollës të bëjë një sy gjumë, por mjerisht atë natë nuk fjeti fare. Para se të shkoi te kinse flejë, në oborrin e shtëpisë i pa fëmijët e axhës së tij që kishin dalë për ta pritur. Por, atë ditë nuk patën kohë për t'u përshëndetur. sepse u kthyen për ta përcjellë ardhjen e UDB-së. Mësuesi ishte përshëndetur me një mik, i cili vdiq gjashtë javë më vonë nga torturat e UDB-së, por nuk i tradhtoi shokët dhe Mustafën deri në vdekje. Ai i kishte në burg babën, axhën dhe i vëllai i madh. I morën në besë për t'i amnistuar më vonë, por dhelpra a ka besë? I dënuan përjetë, vetëm vëllai i madh kishte shpresa të dalë nga burgu. Iu kujtuan babai, xhaxhai dhe vëllezërit në burgun e Nishit. Xhaxhai tjetër, i vrarë në frontin lindor, e shumë e shumë tragjedi të tjera. Andaj vendosi t'i kthehet malit, tjetër udhë nuk pati. Merr revolen "beretë", që e kishte amanet nga babai dhe ju kthehet "mysafirëve" në odën e tij për ta dërguar amanetin e etërve në vend. Me të hyrë në derë, i gjen duke luajtur shah, por në vend se t'i luante figurat e shahut për t'i nxënë në mat, nxjerr revolen dhe zbrazti në ta. Duke dalë jashtë me nxitim, e pa gruan e axhës Metë në oborrin e shtëpisë së tij. Mezi i dolën fjalët nga Voja e i tha: thuaj se i vrau mësuesi Mustafë se e zuri gjaku që po i vlonte pas gjithë asaj që na bënë. Nuk pata qare, nuk e bëra për nam as nishan. Me të dal nga katundi, ecte lirisht nga ana e malit, nxitonte për ta zënë hapin kah Mulliri i Hanit të Axhës. Aty e la një fasule që ia kishte dhënë nusja e tij, Raba, për të mos e nxënë gjaku. Theu rrugën dhe kaloi kah shkolla e Ukë Metave për të zbritur pastaj në lumin Llapushë dhe për të vazhduar rrugës që e qet te Muhaxhirët e Kokajve. Kaloi shtëpi më shtëpi, mal më

mal e gur më gur, deri në jatakun më të sigurt. Më vonë ra në lidhje me Hasan Alinë, të cilët vendosën të largohen nga atje, për shkak se ishte shtuar zullumi mbi jatakët e tyre. Kah fillimi i vjeshtës shkuan në anën tjetër të Arbërisë së lirë. Ata nuk arritën ta kapërcejnë malin për të dalë për tej gardhit, bënte mjegull dhe binte shi vazhdimisht. Ishte një mot i lig që mbahet mend më gjatë se herëve tjera. Atij iu kujtuan të gjitha tragjeditë e popullit të vet që kishte shkak-tuar pushtuesi mbi ta për ta zhdukur dhe përzënë. Mustafa në këtë moment të vështirë ndiente një krenari dhe kishte shpresë se popullin e tij nuk do të mund ta zhduk as tash ky pushtues, ashtu siç nuk mundi ta zhduk asnjë pushtues deri më tash. Ai kujtonte disa popuj të tjerë që kishin jetuar në antikitetet si: trakët, avarët etj. e sot nuk janë më. Edhe dyn-djet me origjinë mongole sa janë munduar të na mbajnë nën sundimin e tyre, të asimilojnë e të zhdukin gjithçka gjetën mbi tokë dhe nëntokën e pasur. Por, papërkulshmëria dhe lufta e vazhdueshme, edhe pse na kanë zvogëluar në masë, nuk kanë arritur asnjëherë të na zhdukin. Një ditë vjeshte, derisa po priste lidhjen në Kokaj, kishte vendosur të rrezi-konte: do të qëndronte në kullën e vet. Mustafa po i qënd-ronte në besë nënës se nuk do t'i bie në duar UDB-së për të pësuar si ishe keq e më keq, ashtu siç i ndodhi babait të tij, edhe pas amnistisë së premtuar. Mustafa e nuhati i pari tradhtinë dhe nuk e lëshonte nga tyta e armës Ismajl Zenuni që kishte marrë përsipër për t'i përcjellë matanë gardhit. Iu kujtua edhe vrasja e dhjetë vjet më parë buzë kufijve të gardhit të thurur me zapti edhe aty ku kurrë nuk e patën vendin. Edhe Feza e kishte pas lënë me fjalë të varrosët në mezhde të kufirit për të cilin kishte luftu-ar gjithnjë para se ta lëshonin në mënyrë kolektive tokën te Molla e Kuqe për t'i shpëtuar shfarosjes. Sipas planit të marrë nga UDB-ja e dinte se Hasan Alia do të goditët në gjoks, Mustafën në Kokë, ndërsa Agush Metaj të pritët me breshëri, derisa do ta kalonte lumin me gruan e tij në shpinë. Mustafë e mbante

përkrahu gruan Rabën. Ai mbante edhe armë të gjatë edhe një revole “Beretë” që e kishte amanet nga vëllai i tij Jeta. “Beretën” e mbante në brez. Pas kësaj, duke kaluar me hapa të shpejtuar nëpër një rrafshinë, për herë të parë, pas gjithë asaj lufte, po i tradhtonte mendja. Në këtë heshtje shkrepën dy armë. Menjëherë pas kësaj u ndezën kandilat e turpit për ta ndritur terrenin, derisa Mustafë me Agushin ai prenë dritat me rrafshinë të tyre, me qëllim që ta mbulonin terrenin me terrin e asaj nate të pabesë, që ishte improvizuar si në skenë të teatrit, te vendtakimi në Bistrica e Prizrenit. Dritat e kthyer në drejtim të tyre, së bashku me sirenën e trupave pushtuese fare pranë tyre, po e ndriçonin ujin e Drinit të përgjakur prej tre burrave dhe dy grave. Ndërsa një ushtar i ri po i përgjigjej zërit të gruas së Agushit, Qiprijes, për t’i dhënë një pikë ujë me grusht. Këtë e ndaloi komandanti Kristë, duke ia sharë nënën shqiptare... "Do t’iu vrasim të gjithëve!". Lama e miellit të kazasë po i priste në agun e parë qëkur ranë. As në emër të katundit nuk ua dhanë kufomat, as të mësuesit të vrarë bashkë me bashkëshorten e tij dhe as të tre kaçakëve të tjerë. Familja e ngushtë e mësuesit kishte mbetur në gra e fëmijë. Nëna mallkonte edhe në ditën e tretë që ishin ekspozuar te pazari i Lamës³⁹. Asnjë gjëmë, asnjë pikë lot nuk i kishte dal asaj burrëreshe, as para masës së dalë te Lama e Millit. Nëna e Mustafës, Habibja e kishte rritë për krenarinë e sotme. Rabën e mori mësuesi nuse edhe sa ishte në male, pa dasmë, por dasmë të madhe të kam bërë sot, ia numëroi një nga një te koka mësuesit, nëna e tij. Pas vrasjes, trupi i tij u ekspozua në Gjilan, si formë represive dhe mënyrë për të frikësuar banorët e kësaj ane të Kosovës. Duke u bazuar në këtë aktivitet të Mustafë Kokës, regjisori i njohur jugosllav, Veljko Bulajiq, sipas skenarit "Poslednje albanske bande na Kosometu" (Bandat e fundit të shqipta-

³⁹ (Nijazi Ramadani, Revista Paqja, 22 shtator 2008, Prishtinë)

rëve në Kosovë), xhiroi filmin e njohur ”Kapetan Lleshi”. Mësuesi që paraqitet në këtë film është Mustafa, kurse vendi është katundi Kokaj. Natyrisht, filmi paraqet ngjarjen e rregulluar sipas shijes së pushtetit okupues serb.



Prita në Bisticë* “pjesë nga Fejtoni i botuar në gazetën Rilindja”Jovan Bullajiq: (*Rilindja, E merkure, 9-VI-1965*)



Fejtoni për mësuesin Mustafë Kokës, Hasan Ali Remnikut dhe Agush Mehmetit i botuar si shkrimin i shtypit zyrtar të Rilindjes së atëhershme. Vazhdimet e fejtonit të atëhershëm po i japim, gjithashtu, pa ndryshime, ku mund të shihet gjuha e atëhershme shqipe para se të unifikohet në standardin e sotëm. Natyrisht, këtu jepet varianti zyrtar i ngjarjeve të pasluftës, të cilat ngjarje ishin lëvizje kundër sundimit komunist jugosllav por nga pushteti qenë cilësuar si armiqësore.



Mësuesi Mustafë Koka

Lexuesit më të moshuar mund ta kujtojnë filmin Kapetan Lleshi. Skenari i këtij filmi qe bazuar në këtë fejton, autor

i të cilët është Jovan Bullajiq. Fejtoni për herë të parë që botuar në gazetën Politika të Beogradit, të cilin, të përkthyer në shqip, më vonë e botoi edhe gazeta e përditshme Rilindja.

Mësuesi Mustafë Koka, së bashku me Hasan Remnikun, në këtë fejtון, nga pushteti u quajtën banditë, por në fakt ata ishin ndër luftëtarët dhe heronjtë e fundit që u përballën edhe me armë kundër pushtetit komunist jugosllav. Siç do të shohim në vazhdim shërbimi sekret jugosllav punoi një kohë të gjatë deri sa i futi në kurth këta luftëtarë të cilët edhe i ekzekutoi. Prandaj, me agjentët e saj UDB-ja organizoi kurthin në fillim të tetorit të vitit 1951. Agjentët ishin paraqitur si njerëz të cilët kinse do të ndihmonin Mustafë Kokën dhe Hasan Remnikun për të kaluar kufirin dhe për të hyrë në Shqipëri. Rrugëtimi për të kaluar kufirin besohet se ka filluar me 6 tetor 1951 për ta përfunduar në mes të natës së 9/10 tetorit në “Pritën në Bistricë”. Në grup që u ekzekutuan në pritë, ishin: Hasan Remniku, Mustafë Koka me gruan Rabijen e cila ishte shtatzënë dhe Agush Mehmeti me gruan Qibrie Misin Alidema. Trupat e tyre të vdekur qenë ekspozuar në Gjilan te Lama e Miellit ku qëndruan disa ditë me qëllim që të frikësoheshin qytetarët dhe ata të cilët eventualisht do të guxonin të përsëritnin veprimet “armiçësore” të këtij grupi. *Rilindja, E merkure, 9-VI-1965.*

*

*

*

Ky felton i asht kushtue kujtimit t’oficereve t’UDB-se, Xhafer Liles e Vojisllav Taliqit – Vojes, që dhanë jetën e tyre me 6 qershor 1951 me rasën e likuidimit të një prej bandave të fundit të ballistëve në Kosovë e Metohi, tue mbrojtë fitoret e revolucionit.

Orët e vona atë natës së vjeshtës së vjetit 1951 kishin përfshi më të madhe qytetzen. Ishte vjeshta e pestë e mbasluftes, plot shi dhe monotone. Në dukje çdo gja ishte e qetë. Vetëm

vende-vende dukej nga ndonjë dritare e ndriçueme. Nji ndër to, në qendër të qytetzës, paralajmeronte diçka. Vërtet, në dhomën e palyeme, të ndriçueme me qirij, tre të rij ishin krrusë mbi nji hartë gjeografike. Asnjani prej tyne nuk ishte ma shum se njizet e pesë vjeç. Ishin këta tre oficerë të rij t'UDB-së. Pa fjetë, seriozë, tue mëshehë nervozitetin prej njani tjetrit, as që vëjshin re orët që kalojshin. Brengat e tyne ishin të shumta. Hartojshin planin e fundit operativ.

*

*

*

Çdo raport, leter sado të vogel, e paten në duer sa e sa here. Qenë kushedi sa herë në katundin Ribnik, afër Gilanit prej kah ishte ky Hasan Aliu, apo Hasan Ribniku, si e quejshin. Ribnikasit nuk munden të lirohen gjatë prej ankthit – pasojave të politikës serbomadhe e të dhunës dhe kohës së tmerrshme të luftës.

Megjithese ky territor ishte në pjesën ma të madhe i banuem prej popullsisë shqiptare, pushteti i atëhershëm ndaloi perdorimin e gjuhës shqipe madje jo vetëm nëpër shkolla e në jetën publike, por edhe në biseda private. Me të gjiha mjetet u pengua përhapja e kulturës kombetare të Shqiptarëve. Reforma agrare, që u përsërit shum herë në kët krah, nuk u ba për likuidimin e marrdhënieve feudale, por për realizimin e politikës së “sërbizimit” të kësaj krahine. Ndërsa në njanën anë komunistët e Kosovës e Metohisë, me të gjitha fuqitë që kishin në disponim, luftuen kundër dhunës e padrejtësisë, n'anën tjetër armiqat e popullit të ndreshëm shqipëtarë tue organizue banda plaçkitëse; tue shfrytëzue situatën e randë, në të cilën gjindej katundari i ndershëm e i varfun, hyjshin papritmas natën në shtëpijat e qeta të bujqëve dhe merrshin me vedi shpeshherë edhe koren e fundit të bukës, aq të nevojshme për të mbetë gjallë. Ribniku nuk ndryshonte prej katundeve tjera në kët krahinë.

Herët ne muzg, kur bujku shkonte në pushimin e vet të merituem, kur njeriut i paraqitet nevoja e madhe për ngrohtësinë familjare, për siguri e qetsi, kur zhurma e fëmijëve mbush me gëzim zemrën e prindërve, banorëve te vegjël të Ribnikut e të katundeve t'afërme iu desht të rrokin pushkën e të qëndrojnë roje pranë dritares s'errsueme, plot frigë e pasiguri, për të ruejtë at pak pasuni të fitueme me mund prej bandave të ndryshme...

*

*

*

Lidhja me organizatën N.D.SH.

I vetmuem dhe tue u frigue vazhdimisht se do të bijë në duert e organeve shtetnore, Hasani ndjente nevojë të madhe për përkrahjen e kujdo, që kishte ndonji randësi morale sadopak të vogël. Ai ia mbërrijti me e sigurue këte shum shpejt, tue u lidhë me Mulla Idriz Hoxhën, prej Kaçanikut, që në Kosovë e Metohi ishte iniciator dhe organizues i organizatës nacionaliste. Kët organizatë e udhëhiqte në Maqedoni Galuj Beji, me të cilin Mulla Idrizi, e ma vonë edhe vetë Hasani, vunë lidhje të forta. Nën patronatin e kësaj organizate, Hasani dhe jataku i tij kryesor Sylë Arifi ishin shum ma të sigurtë. Mirpo pak kohë mbas kësaj, Sylë Arifi shkoi n'ushtri dhe ky bashkëpunim i tyne u ndërpre për një kohë. Pak ma vonë, shkumjes së Sylë Arfit n'ushtri, organizata nacionaliste u zbulue edhe të gjithë udhëheqësit e saj kryesisht u burgosën. Mbas kësaj ngjarjeje, Hasani u përpoq të mbajë të paktën kontakte të kohëmbaskohshme me Galuj Bejin në Shkup, por i vetmuem e pa njerëz rreth vedit, përjetoi n'arati ditë shum të vështira. Nuk ishte lehtë me jetue në frigë të përhershme se do të zbulohet. Hasani kaloi kohën kryesisht tue kalue herë te njani e herë te tjetri jatak, e tue pritë ditë ma të mira. Nga friga e mosbesimit, ai qe i detyruem të mbajë me jatakët kontakte ma të shpeshta, në mënyrë që t'i frigojë e t'u bajë me dije se çka i prët,

nëqoftëse e tradhtojmë. Në këtë period qetësije thue se ishte zhdukë Hasna Ribniku. Sikur të mos kishin ngja disa ndërmarrje të vogla, plaçkitje ushqimi e të tjera, që i ndërmernte Hasani, ma tepër për të mbajtur mbas veti jatakët, do të kishte mundë të besohet se Hasani ose ka kalue kufirin, ose asht vra në ndonji përleshje me bashkëpunëtorët e vet. Ndiente ndjekjen mbas çdo hapi t'vet. Gjindej pak larg katundit Livoq. Fuqija në të zhdukej gjithnji e ma shum. Papritmas hasi një shtëpi të vogël, që ishte pak e largueme prej katundit. Nuk mendoi shum. Hyni në shtëpinë, ku kishte vetëm gra e fëmij. Banorët e shtëpisë u ndalën të friguem para grykës së drejtueme të pushkës. As kësaj radhe UDB nuk arrin ta kap Hasan Remnikun. Hasani forcohet pasi që i bashkohet Sylë Arifi i cili kthehet nga Cetina ku kishte kryer shërbimin ushtarak dhe ku kishte treguar aftësi të mëdha ushtarake. Në ushtri Sylë ishte akuzuar për sabotim por ishte liruar në mungesë të provave dhe dëshmive. Përforcimi më i rëndësishëm ishte ardhja e mësuesit Mustafë Koka në grup, i cili në atë kohë punonte në shkollën e Lubishtës dhe si shkolluar gëzonte autoritet në popull. Babai i mësuesit, axha, vëllezërit e tij dhe disa tjerë nga Kokajt qenë gjykuar si ballistë dhe dënuar me burgime të rënda. Megjithatë, grupi i Hasanit, që vendosi bazën në Remnik, sipas UDB-ës, po bëhej gjithnjë e më i rrezikshëm për “Jugosllavinë e re”.

Sylë të përpiqet të fitojë besim në katund dhe si i këtitillë të përpiqet me zanë ndonji pozitë në pushtet ose n'organizatat shoqnore.

Sylë kuptoi qëllimet e Hasanit, prej të cilit, përveç spjegimeve të rasës, muer edhe detyra konkrete: 1. Ta informojë rregullisht mbi qarkullimin e ushtrisë e të milicisë dhe t'interesohej se cilët njerëz i kërkojnë ata,

2. Të mbajë evidencën e njerzëve që jan bashkpuntorë aktivë të pushtetit të sotshëm, ti dërgojë listën e tyre në mënyrë që këta njerëz në momentin përkatës të likuidohen,

3. Të marri vesh se cilët njerëz janë të pakënaqun me rendin e tashëm shoqnor, në mënyrë që me kohë dhe sistemakisht ti rekrutojë përvedi.

4. Ta informoj për situatën në magazinat e shitoret e kooperativave, në mënyrë që me rasën e plaçkitjeve, të mos hasi befasi. Simbas të gjitha gjasave, Hasani mendonte gjithnji e ma seriozisht për organizimin e bandës së vet.

Lidhja me mësuesin e katundit në Lubizhdë

Ishte mbarimi i vjetit 1949. Sylë Arifi muer detyrë urgjente që të lidhet me një msusë të katundit Lubizhdë dhe të organizoj takimin urgjent mes tij e Hasanit. -Mësuesi Mustafa asht i lidhun me të njajtën ‘‘qendër’’si edhe unë...Detyrat na janë të njajta.-i tha Hasani Sylës, tue i spjegue pse asht e nevojshme që të lidhen me këtë mësues. Mustafa Rushiti mësues, i lindun më 1930 në katundin Kokaj të rrethit të Gilanit, rrjedhte prej një familje të mesme katundare. Baba i tij ishte udhëheqs i një grupi ballist, prandej mbas dorzimit në vjetin 1947 u dënue 20 vjet burgim të randë. Me babën gjindeshin edhe vllaznit e Mustafës, që gjithashtu u dënuen me burgim të gjatë. N’at kohë, vet Mustafa, për shkak se ishte i ri, nuk qe politikisht shum i interesuem. Mbas çlirimit hyni në radhët e brigadës partizane të Shqipnisë dhe bashkë me të shkoi në Shqipni, ndoq mësimet në Shkollën normale, e në të njajtën kohë kreu kursin ushtarak formative. Kështu, i rekrutuem prej shërbimit informative të Shqipnisë, u dërgue në Kosovë e Metohi. Mësuesi Mustafë Koka (Rushti) takohet me Hasanin dhe Sylën dhe pajtohen që të bëjnë plane për të ardhmen. Regjimi jugosllav mësuesin e cilëson si spiun të Shërbimit

Sekret të Shqipërisë me urdhër të të cilit është bërë takimi me grupin. Me propozimin e Hasanit, mësuesi vendos të kaloj në Remnik (Ribnik) për të punuar në shkollën e këtij fshati. * * *

Sylë Arifi iu përvesh menjherë punës. Nuk qe vështirë me u vu në kontak me Mustafën, sepse ky ishte përgatitë për këtë qysh ma parë.

Takimi qe caktue të mbahet një natë të ftohtë vjeshte, prandaj Hasani i primë prej Sylës, u nis për tu takue me mësuesin Mustafa Rushitin.

Gjatë rrugës, Hasani i spjegoi Sylës planin e vet. Sylë, si sekretar i Këshillit të vendit, duhej të rregullonte që Mustafa të transferohet në Ribnik. Përparsitë e këtij kombinimi ishin të qarta. Mësuesi duhej të gjindej afër, e nevojitej edhe për lidhjen me Galuj Bejin prej Shkupit. Kur mbërritën afër vendit të takimit, Hasani u ndal me pritë derisa Sylë të sjell Mustafën.

Takimi midis spiunit të Shqipnisë dhe Hasan Ribnikut qe shumë i përzemert. Hasani nuk la pa i ba menjherë me dije se ai e çmon punen balliste të babës së tij, por se vetem ia sheh për të madhe që nuk qëndroi deri në fund por u dorzue. Mandej i shprehu knaqsinë që djali i babës së tillë ka marr ‘rrugë të drejt’ dhe bindjen se ky do të qëndroj deri në fund. Mandej Hasani paraqiti planin: Mustafa, me ndihmën e Sylës duhet t’emnohet mësues në Ribnik, gjë që ky e punoi me/knaqsi. Mustafa pyet se kush asht tjetër prej mësuesëve në shkollë, e Sylë iu përgjegj se aty gjindet edhe një mësues dhe një mësuese e re. Hasanit i shëndritën sytë në mënyrë shtazarake, kur u përmend mësuesja. Sylë buzëqeshi me përzemërsi. Shikimi i kujdesshem i Mustafës tregonte se ai nuk kuptoi për çka po flet. Hasani i spjegoi shpejtë se për çka asht fjala dhe i shprehu dëshirën që atë natë të grabisin mësuesen, sepse ka ndërmend me kalue me të të paktën një natë. Mustafës kjo nuk i pëlqeu dhe shprehu frigën e vet se

kjo mund të damtojë krejt atë që po planifikojnë. Hasani muer një pamje serioze, u pajtue shpejt me Mustafën dhe në atë çast mund të fitohej përshtypja se i dha të drejtë. Mandej u ndanë, tue i dëshirue njani tjetrit çdo të mirë deri në takimin e ri në Ribnik. Shkolla ishte krejtsisht n'errsinë. Mësuesi e mësuesja flejshin në dhomat e veta, të qetë, tue mos parandie asgja. Kur iu afruen dritarës së saj, trokitën me shpejti dhe e thirrën ta hapi derën menjihërë. Për fat, mësuesja e re qe aq gjakftohtë saqë dhe menjihërë në dhomën fqinjë zgjoi kolegunë e vet, i cili kapi menjihërë pushkën, që e mbante pranë shtratit.

Të shtimet qenë të papritura edhe për Hasanin edhe për Sylën. Për një moment mbetën të shtangun, e mandej ua dhanë këmbëve. Menjihërë u alarmue tanë katundi, u organizue ndjekja, por edhe kësaj radhe pa sukses. Banditët thuese kishin hy në dhe.

Grupit i bashkohet Agush Hetemi. Mësuesi Mustafë Koka, i cili gëzonte respekt të madh në popull, bëhet udhëheqës ideologjik i grupit. Merret vendimi për mbledhje të fondeve për NDSH dhe fillon aksioni për prerjen e telave dhe shtyllave telefonike në rrugën Gjilan – Bujanoc. Pas këtij aksioni, grupi e likuidon Petar Markoviqin. Aksioni i pushtetit komunist jugosllav për heqjen e ferexhesë sjell pakënaqësi dhe bisedohet plani për vrasjen oficerëve të UDB-ës, Xhafer Lilës dhe Vojisllav Taliqit-Voja.

Aksioni për heqjen e ferexhës dhe burgimi i Sylë Arifit.

Në vjetin 1950 u zbatue aksioni me përpjestime të gjana për heqjen e ferexhës. Mbi Sylë Arifin si sekretarë i Këshillit popullor të vendit, ra përgjegjsi e madhe në kët aksion. Kjo ndikoi shumë. Anmiku i përbetuem i gjdo gjaje përparimtare dhe krejt asaj që ndërmirte pushteti, veshtirë mundi të pajtohet me faktin se këtë aksion duhet ta zbatoj edhe vet në praktik.

*Sylë Arifi, tue mos konsultue prorët e vet, i shtym nga urrejtja, bani gabim kardinal dhe ndërmuer fushatë shumë të rrepta kundër heqjes së ferexhës. Për shkak të aktivitetit të këtill, organet e sigurimit, me githëse pa dëshire, burgosën Sylë Arifin. Për bandën kjo që goditje e rënd sepse Sylë automatikisht u ndërrua edhe nga pozita e sekretari të Këshillit popullor të vendit. Mirëpo, mbasi për organet e sigurimit shtetnor ishte ma i dobishëm si i lir se sa në burg, sepse pritshin që nëpërmjet të tij do të hyjn në gjurmë eprorëve të tij, ai mbas një kohe dhe u lirue. I revoltuem për këtë, Sylë kërkoi në takimin e parë me eprorët e vet energjikisht që oficerët e UDB-ës, Xhafer Lila dhe Vojisllav Taliqi-Voja, të likuidohen menjher sepse “me veprimtarin e tyre e treguen se janë anmiq të popullit shqiptarë”. Ishte e vështir me e qetsue këtë bandit të tërbuar që dëshironte të hakmirrët, por mësuesi Mustafa udhëheqësi ideologjik i këtij grupi tradhtarësh diji të gjej edhe këtu zgjidhje të kënaqshme. -Duhet të kuptosh se vrasjet e këtilla në këtë moment nuk do të na sjellshin dobi, po vetëm do të na ngarkojshin ndjekje të reja. N’anët tjetër ndërmarrje të këtilla nuk mund ti zbatohet pa lejen e qendrës. Do të diskutojm nëqoftë se qendra pajtohet atëhere na do ta dijm si duhet vepruar. Mbas këtij shpjegimi Sylë u qetsue, por nuk ishte kurr i sigurt se banditi i kualitetit të tij nuk do të bëj ndonji gjë n’dorë të vet. * * * Mësuesi Mustafa, që në katund ishte si në shtëpi dhe gëzonte besimin me të madh ndër bujqit e pa informuem, muer mbi vedit, në saje të ndikimit të vet në katund, të zgjidhej ky problem. Në katund ishte i zbrazët vendi i referentit për arsim, prandej Mustafa mendoi se duhet të baj çdo gjë që Sylë të zëjë të paktën këtë pozitë, që nuk ishte e parëndësishme. Organet e sigurimit përcillshin zhvillimin e ngjarjes dhe për arsye objektive përkrahen përpjekjet e mësuesit për emnin e Sylës. Kështu mbas një kohe të shkurt, Sylë Arifi, i cili konsideronte se gabimet e tij janë harrue e lanë anash, u*

emnue referent arsimimi në komunë. Bandës kjo i përshtatej, sepse konsideronte se në këtë situatë takimet e shpeshhta midis Mustafës dhe referentit t'arsimit, Sylë Arifit, nuk do të jenë të dyshimta për shkak të natyrës së punës së tyre. Por, organet e sigurimit përcillshin me vigjilencë çdo hap të tyre njani prej të cilëve ishte spiun i përgatitun i Shqipnisë, por ende nuk mundshin me i hy në gjurmë Hasan Ribnikut. Kuptohet se ato dojshin me siguri se këta dy takohen me të kohë mbas kohe. Detyra ishte shumë delikate, prandej duhej me punue me shumë kujdes e durim, sepse edhe pa kujdesia ma e vogel mund të zgjonte dyshimin e banditëve , e kjo do tu jepte fund edhe shpresave që kjo rasë të zgjidhet shpejt. Kush ishin ubashët Xhafer Lila dhe Vojsllav Taliqi-Voja dhe cili ishte plani i tyre për të futur në kurth Mustafë Kokën? Kush ishin atdhetarët: Skender Kosova, Hysni Ataqi dhe Qerim Uka. Mustafa dhe Syla marrin pjesë në një takim sekret në fshatin Zabel të Drenicës. Vazhdon lidhja e grupit me Galuj Beun në Shkup.

* * * Mësuesi në të vërtetë ishte udhëheqësi i vërtetë i këtij grupi, komunikonte me mjeshtri me Hasanin, tue lanë të bindun se po i nënshtrohet komandës dhe pushtetit të tij. Nji ditë, mësuesi shkoi te referenti i arsimit dhe i spjegoi se asht e domosdoshme që t'udhtojnë me njiherë. Po at natë udhtuen me tren për Drenicë. Kur mbërritën në katundin Zabel, Mustafa e qoi në shtëpinë e nji miku të vet. Vetëm mbas mbërritjes këtu, ai i spjegoi se këtu do të mbahet nji takim i randësishëm me njeriun që ka mbërritë prej Shqipnie.

Kush asht Hysni Ataqi
Hysni Ataqi lindi në nji katund të Shqipnisë. Kur përfundoi lufta pati gradën e kapitenit partizan. Si i tillë u emnue në Sërbicë komesar i komandës së vendit. Ishte stabil e pedant dhe tregonte aftësi të jashtëzakonshme për organizim të mirë. Kjo komandë vendi mbërriti rezultate shumë të mira në punë. Nji numër i madh ballistësh, që gjindeshin në mal, u

dorzuen.N'at kohë u ba mobilizimi i popullsisë për armatë.në kët komandë çdo gja rrodhi mirë deri në gjysmën e vjetit 1945, e mandej rreth këtyne çashtjeve filluen të lindin probleme.Papritmas ballistët pushuen të dorzohen, të rijt bajshin rezistencë me rasën e mobilizimit, e disa edhe u aratisën në mal. Me një fjalë, gjdo gja muer te mbrapshten. Një gja ishte e qartë. Armiku nëpërmjet të dikujt, ndikonte negativisht ndër bujqit.Në periodën e mavonshme, kur u suprimuen komandat e vendeve, Hysni Ataqi u emnue shef i seksionit në Sërbicë. Mirëpo, veprimtaria anmiqsore në kët anë jo vetëm që nuk pushoi, por u ba edhe shqetsuese.Mbas një kohe, Hysnija u zu në vepër, e mandej u burgos dhe u dënue për veprimtari anmiqsore. Mbas mbajtjes së burgimit u kthye në katund. Posa u shpall rezoluta e informbiros, ai iku në Shqipni. Prej atje u kthye mbrapa si diverzant i pergatitun i shërbimit informative te Shqipnisë.Takimi midis këtyne dy spiujve të Shqipnisë, qe shumë i shkurtë, e çdo qëndrim i gjatë i rrezikshëm. Mjaftoi të shtërnguemit e dorës e mandej këta dy shkëmbyen letra dhe u ndanë shpejt e shpejt.Syla qe vetëm dëshmitar memec i krejt kësaj, e mandej, bashkë me mësuesin u nis mbrapa për Ribnik. Mustafa kërkoi menjihërë prej Sylës që t'i organizojë takimin me Hasanin, sepse ishte fjala për një gja urgjente.

Direktiva me shkrim

Takimi u mbajt në rrethin ma të ngushtë dhe me nguti të madhe. Mësuesi kaloi menjihërë në paraqitjen e qashtjes. Letra e marrun prej Shqipnie vinte prej Qerim Ukës. Ishte shumë e shkurtë, por urdhnat shumë precize dhe të përcaktueme. Ndërsa Mustafa lexonte letrën, dy tjerët e ndëgjuen me vemendje .

Letra pati këtë përmbajtje: -I dashtuni Mustafë, duhet ta bajsh atentat e të vrasish ndokend prej oficerëve t'UDB-ës në terenin tand, në mënyrë që të hakmirremi për vdekjen e Skender Kosovës i cili u vra nga ana e organeve

të sigurimit. Për këtë njeri tonin duhet të vrasish dy oficerë t'UDB-ës. Mustafë, unë po t'i përgjigjem letrës sate që më ke dërgue, e këtë detyrë mere shumë seriozisht dhe zgjedhi oficerët ma të mirë në terrenin tand. Mbas kësaj, asht urdhnue që t'ikish në mal.

Qerim Uka

Skender Kosova ka qenë oficer i shërbimit informativ të Shqipnisë, që si udhëheqës i një treshi diverzant u likuidue në territorin e Kosovës e Metohisë nga ana e organeve të sigurimit. Mbas leximit të letrës, këty ne tre bandidëve nuk iu desht të mendojnë shumë. Zgjedhja për ta qe e thjeshtë. Ata zgjedhën dy oficerët e rij t'UDB-ës- Xhafer Lilën dhe Vojisllav Taliqin-Vojën prej të cilëve banda frigohej ma së shumti. Nderkaq, Sylja muer si detyrë urgjente që të shkojë në Shkup për t'u takue me Galuj Bejin, e mësuesi Mustafa duhej të bante likuidimin e oficerëve të përmendun t'UDB-ës.

Ngushtimi i rrethit -

Në ndërkohë UDB-a – muer të gjitha masat e mundshme për të likuidue prej këtij tereni bandën e rrezikshme që çdo ditë bahej gjithnji e ma shtazarake. Organet e sigurimit disponojshin disa shënime se Hasan Ribniku gjindet në pyllin e Zhegranit dhe se mësuesi Mustafa takohet me te kohë mbas kohe. Kjo informatë duhej t'ishte patjeter e saktë, sepse puna e Mustafës u ishte e njohtun organeve të sigurimit qysh prej Prizrenit. Natyrisht, këte duhej me e vërtetue dhe argumentue. Ky ishte tereni i oficerit të ri t'UDB-ës, Voja Taliqit, mirëpo, mbasi ky ishte në këtë shërbim ende mjaft i ri, me të shkoi në kryemjen e detyrës edhe Xhafer Lila. Njeriu që duhej t'u tregonte gjurmën ishte mësuesi Mustafa, me të cilin duhej me bisedue me shumë kujdes. Nevojitet me nxjerrë prej tij krejt çka mund të nxirret, e në të njajtën kohë mos me i dhanë mundësi që të paktën për një moment të kuptojë se dyshohet në te, e jo ma

se dihet se ai bashkpunon me Hasanin dhe sa asht spiun i Shqipnisë



Mësuesi Mustafë Koka

Dy oficerët e UDB-ës, Xhaferi dhe Voja, shkojnë në banesë të mësuesit Mustafë duke u shtirë si mysafirë. Kur mësuesi i hetoi se “mysafirët” ishin agjent të UDB-ës, ata e pohuan këtë fakt dhe filluan ta kërcënojnë mësuesin nëse ai nuk e fuste në kurth Hasanin. Rilindja, E marte , 18-VI-1965

X. Duhej me u përpjekë për ta bindë Hasanin të bashkëpunojë me shërbimin tonë të sigurimit. Ishte shumë e rëndësishme që ai të mbetet i bindun se puna e tij anmiqsore asht krejtishtë e padiktueme. Detyra që iu besue dy oficerëve të ri t’UDB-ës njani prej të cilëve ishte shumë i ri dhe pa ndonji përvojë të madhe në këtë punë, nuk qe aspak e lehtë, sepse ishte fjala për një bandë shumë të rrezikshme.

Nervozitet në rradhët e ballistëve

Mbërritja e Xhaferit dhe Vojes më 5 qershor 1951 në Ribnik shkaktoi nervozitet ndër banditët, e sidomos ndër jatakët e luhatshëm. Oficerët e rij qysh mbas marrjes në pyetje të disa njerëzve të Hasanit patën zgjidhë enigmën ma të

randësishme. Hasan Rubniku gjindej me siguri në këtë teren dy të rijt ish in shumë të gëzuar, tue dijtë se kanë gjetë gjurmën e vërtetë raportet e tyre që i paraqitën menjherë mbas detyrës së kryeme, qenë plot optimizëm e besim se Hasan Rubnikut i janë ditët e numrueme. Jatakët treguen shumë pak, sepse me të vërtetë shumica prej tyre nuk dijsin ndonji gja ma të hollësishme, përveç asaj se Hasani gjindet në këtë teren. Por, edhe ky shënim qe shumë i randësishëm që rrethi të ngushotet sa ma shumë rreth tij.

Në banesën e mësuesit

- Kij kujdes, - i tha Xhaferi shokut të vet ndërsa i afroreshin shtëpisë, në të cilën banonte mësuesi Mustafa. Duhet të jemi me te shumë të kujdesshëm. Për punën tonë ai din sigurisht ma shumë se na. Asht e randësishme që për asnjë moment të mos dyshoj asgjë. Mos u frigo, iu pergjegj Voja tu pëshpëritë, sepse pat mbërritë në pragun e shtëpisë. I zoti i shtëpisë dhe mësuesi i pritën shumë mirë. Prej bisedës që filloi, kur u vendosën në dhomë, vështirë mund të mirrej me mend se krejt kjo asht ndonji gja tjetër përveç bisedës së zakonshme të fqijve të mirë. Xhaferi dhe Voja pyetshin për kushtet e jetës së të zotit të shtëpisë, si janë frytet e sivejme dhe të gjitha tjerat. Mësuesi tregoi mandej vështirsitë e veta që ka me gruen. Gjoja, baba i saj nuk dashka me dhanë për te, e ajo u detyruë me ikë. Për këtë arsye ai qe i detyruem ta dergojë gruen te prindët e vet, derisa të rregullohen mardhanjet me babën e saj. Mustafa qe shumë llafazan, thuese frigohej prej ndonji teme tjetër, sepse ia prente mendja pse gjinden në katund Xhaferi dhe Voja. Mund të fitohej pershtypja se nuk ishte i qetë, por ai ia mbërrinte me e mësuehë këte me shumë mjeshtri. Mas ni kohe i zoti i shtëpisë shkoi me kry punët e veta, e mbasi nata lëshohej me të madhe mesuesi u ofroi dy të rijve që të kalonjnë natën në dhomën e tij, e ai do të gjindet dhe do të flejë te ndonji mik në katund. Xhaferi e Voja e pranuen këte menjherë dhe

bashkë me mësuesin kaluen në dhomën e tij.Marrja në pyetje filloi në mënyrë të tërthort megjithëse mësuesi me pervojë e ndieu menjherë rrezikun. Zhagitja e bisedës zgjati mjaft, kështu që te mësuesi dukeshin qartë shenjat e lodhjes te dy oficerët e rij, të bindun thellë se gjinden në rugën e vërtetë për sigurimin e shënimeve ma të çmueshme, ndryshuen menjherë taktikën, tue konsiderue se kjo asht e vetmja rrugë e mundshme për të nxjerr ndonji gja prej mësuesit dinak. Ata i ban qartë me dije se për të i dinë të gjitha. Se dijnë për bashkëpunimin e tij me Hasanin dhe lidhjet me Shqipninë.Mesuesi përjetonte mundime të randa dhe ai nuk e pritte këtë, sepse jetonte i bindun se UDB-a, edhe në qoftë se dyshon, prapseprap nuk din kurgja të percaktueme.I ngushtuem prej pyetjeve të tërthorta të dy djelmohave të disponuem, që ishin thellë të vendosun për të sqarue deri në fund çashtjen, mësuesi tentoi në të gjitha mënyrat e mundshme per t’u nxjerrë prej kësaj sijuatue, por kjo nuk i erdhi per dore.Mbas kësaj, i tanë në djersë, ai u lëshue i pafuqishëm në shtrat, kurse duert i dridheshin në mënyrë të dukshme.Oficerët qenë të bindun se mësuesi u dorzue e mandej i ofruen nji mundësi.- Në qoftëse na qon deri te Hasan Ribniku njerzit e tij, do të të japim mundësi të shpëtojsh, e bindi Xhaferi në mënyrë shum sugjестive, edhe vet i lodhun prej bisedës së gjatë.Mësuesi heshte por fitohej përshtypja se çdo moment do të fillojë të flasi.- Mirë, mundemi me përfundue këtë bisedë edhe nesër në mëngjes, - tha Xhaferi, gja të cilën Voja e pranoi, sepse ishin të bindun se mësuesi në mëngjes do të tregojë çdo gja.Mësuesi mezi e priti këtë. Oficerët e rij u përpoqën madje edhe t’ia kthejnë disponimin me disa shaka, ndërsa ai ua ndreqte shtratin, gja të cilën mësuesi e pranoi në dukje, me shum përzemërsi.- Natën e mirë –u tha mësuesi me rasën e ndamjes, tue buzëqeshë miqësisht. Mandej mbylli derën dhe u zhduk n’errësinë.Voja e Xhaferi luajtën së pari një parti shah, e mandej, të kënaqun me ditën që kaloi, ushtrinë për të ba

pushimin e vet të merituem .Shtrati ishte ngapak i fortë, por djelmohat e lodhun mbas disa minutash u zhytën në gjum të thellë. Mbaje mend mirë çka po të them, sepse kjo duhet të bahet ashtu si po të them unë tash. Do të njoftosh Hasanin që të vijë menjherë në malin afër katundit, në mënyrë që në mëngjes të mundem me iu bashkue. Spiuni i Shqipnisë thuese kishte fillue të humbi nervat dhe toni i tij nuk duronte kurrfarë vrejti. Njeriu të cilit i drejtohej ishte Syla. Mësuesi Mustafë Koka vret agjentët e UDB-ës, Vojën dhe Xhaferin. Pasi këta dy udbash nuk vdesin në vend, njerëzit e pushtetit bëjnë çdo gjë që t'ua shpëtojnë jetën. I dërgojnë shpejt në spitalin e Gjilanit dhe pastaj në atë të Shkupit.

Mesuesi deshiron të kalojë në Shqipni
Në mesin e banditëve mbretëronte gjallni e madhe. Çdo gja u vinte për dore. Ishin krenarë për sukseset e veta. Patën disa përleshje me ushtrinë, por prej të gjitha betejave duelën të pa damtuem. Hasani flitte shpesh për trimnitë e veta, tue u përpjekë që para njerëzve të vet të paraqitet sa ma i tmerrshëm, ma i madh dhe ma i guximshëm. I vetmi njeri që në tanë kët disponim e ndiente vedin keq ishte mësuesi Mustafa. Ai e bindte Hasanin se momentalisht çdo qëndrim i matejshëm këtu asht i kotë. Mendonte se me çdo kusht duhet me kalue në Shqipni. Atje do të lidhen me rezistencën e organizueme kundër Jugosllavisë, e tash me çdo kusht duhet të largohen. Hasanit në fillim nuk i pëlqeu ideja për shkuarje në Shqipëri për të cilën gjë insistonte mësuesi Mustafë. Lidhjet e grupi vazhdojnë me qendrën e NDSH në Shkup. Një nga jatakët e Hasanit ishte serb. * * * Në Prizren tre oficer të UDB-ës, bëjnë plane dhe ndër marrin aksione për të futë në kurth grupin e Hasan Remnikut dhe Mustafë Kokës. Burgosen shumë njerëz me pretekst të mungesës së lejes kufitare në mënyrë që të fshihen gjurmët e spiunëve. Në mes tyre burgoset Musa të cilin, nën kërcënime, UDB-a e detyron të bashkëpunojë dhe të informojë në lidhje me grupin që dëshironte ta kalonte

kufirin. * * * *Fillon procesi i kurthës. Njerëzit e UDB-ës, Musa dhe Hamza, i bindin Hasanin, Agushin dhe mësuesin se çdo gjë ishte në rregull. Me 5 tetor 1951 grupit iu bashkohen edhe gratë. Rruga për në kufi të Shqipërisë fillon në Livoq, nga shtëpia e Hamzës, njeriut të UDB-ës. Nga ky moment lëvizjet e grupit vihen nën kontroll të UDB-ës.*

Jovan Bullajiq: Rilindja, E premtë, 25-VI-1965

XVII. *Gjatë tanë kësaj bisede, Agush Et'hemi që pat ik prej burgut, dhe mësuesi Mustafë nuk folën as një fjalë. Përcjellshin çdo lëvizje të njeriut në duert e të cilit duhet të vejshin jetën e vet tue i besue që ti kaloj për tej kufinit. Përcjellshin çdo lëvizje sado të vogël në fytyrën e tij dhe përpiqeshin të zbulonin ndonji gjë që eventualisht do ishte e dyshimt.- A jan të sigurt ata njerëz tu, mos do ngjasi ndoni mashtrim? – tha Hasani – njerëzit jan të sigurt. Njani asht prej Vërbice e tjetri prej Zhuri tek e fundit, nuk asht kjo hera e par për kta. Mendoj se nga kjo an mund të jen të sigurtë – tha Musa i qetë dhe i buzqeshun nga pak ironike, që do të thot -çka kini, po ju nuk frigohehi? Nata ishte e kthjellët. Rrezët e hanës bajshin të mundshme që bashkfolsit të shohin fytyrën e njani tjetrin si në mes të ditës. Gjatë bisedës, Hasani i afrohej shpesh ftyrës së Musës tue e shikue drejt në sy, se mos zbulon ndonji gjë që ky e sheh. Musa i bani ball të gjitha këtyne. **

** * Të gjithë ishin t'armatosun. Hasani kishte pushkë dhe automat gjerman, dy bomba dore, revolen dy rrathë me fyshekë të pushkës, fyshekli dhe dyrbi. Ishte i veshum me pantollona të zeza, bluzë oficerësh, mantil të shkurtë dhe opinga. Agush Et-hemi kishte pushkë, revole dhe mjaftë municion në rrathë e fyshekli. Ishte i veshun me rrobe ushtarake, e qorapat e katundit i dukeshin mbi pantollona dhe opinga. Rreth fytit kishte mbështjellë një shall të madh me lara. Mësuesi kishte pushkë gjermane dhe një revole që e pat marrë kur vrau Xhaferin e Vojën. Ishte i veshun n'uniformë milici. Grat ishin të veshuna me pantollona*

ngjyrë blu me këmisha të bardha nën xhemperat e lesht. Secila prej tyre kishte nga një revole. UDB-a finalizonte planin e pritës. U angazhuan të gjitha njësitë e Korpusit të Mbrojtjes Popullore dhe Milicisë së këtij teritori. Musa pritej të zbriste në Prizren për tu takuar me oficerët e UDB-ës, dy prej të cilëve ishin Ragipi dhe Shabani, që së bashku me shefin e tyre, kishin ardhur në Prizren nga Prishtina. Mirko, kolegu dhe shoku i ngushtë i Shabanit, nuk do të merrte pjesë në aksion pasi që nuk dinte të fliste mirë shqip.

Kufini asht afër Ragipi e Musa të ngarkuem me mjaft ushqim të fresket, i afroheshin ngadal vendit, me të cilin ishin vendosun banda. Kur u afruem pak ma shum Musa e dinte se Hasani po i përcjell me durbi. I a tha këtë Ragipit që edhe ai ta ket parasysh. Hasani iu dul përpara. Ky asht ai njeriu prej Zhuri, tha Musa tu e prezantue Ragipin. Hasani e shikoi në mënyr të dyshimt e mandej ia zgjati dorën në shenjë përshëndetjeje. Iu afruen të tjerëve e Ragipi përpiqej të jet i përzemërt dhe i gjall në bised. U përshëndetën me të gjithë. I pyeti se si kan udhtue dhe për të gjitha tjetrat. Me një fjal u tregue shum i gjall dhe i afërt. Mbas kësaj ata hangrën darkë. Objekt i mendjes së të gjithë të pranishmëve ishte mysafiri i ri. Friga dhe dyshimi jetonte në secilin prej tyre. E lijshin jetën e vet në duart e njerzve të panjohur e rrugdalje tjetër nuk kishte. Ragipi dukej serioz dhe i thelluem me mendime. Terenin e njeh mir, nuk ke çka frigohesh. Tek e fundit ti do të na prijsh vetëm deri te centrali e mandej udhëheq Shabani e ai është i sigurt. Nuk është kjo për të hera e par - tha Musa. Optimizmi i Musës dhe afërsia e kufinit sollën nifar gjallnie në mesin e këtyne njerzve. Qysh gjatë kësaj na shpejtuem hapat të ishimit të sigurt në afërsi të kufinit. Mbyllet perdja skenari i Bullaiqit vazhdon.. Rilindja, E marte, 29-VI-1965

Dëshmori Arben Ramadani -Kokaj⁴⁰



Arben Ramadani (13.06.1981- 19.05.2000)
Gjilan, Kokaj, me 19 maj 2009 - Në katundin Kokaj të Gjilanit nën patronatin e Organizatave të veteranëve të Luftës Çlirimtare të UÇK-ës dhe UÇPMB-së, u bënë homazhe te pllaka përkujtimore e dëshmorit, Arben Ramadani në katundin Kokaj të Gjilanit, pas rivarrimit nga Varrezat në vendlindjen e tij, në. Në varrin e Arbenit në vjetorin e rënies u vendosën për çdo vjet lule të vreskëta dhe kurora lulesh nga OVL dhe familjarët. Organizatat e dala nga lufta me përkujtimin e dëshmorit përkujtojnë edhe rëndësinë e luftës së Kosovës që ne sot po e gëzojmë për të cilën edhe ra Arbeni me dëshmorët dhe martirët tjerë të luftës së

⁴⁰ Shkrime e bot. Në gazetata” Epoka e Re”, ”Zëri”, “Bota sot”, 2001/05

UÇK/UÇPMB. Në këtë homazh me rastin e 9-të vjetorit të rënies së këtij dëshmori, në emër të organizatave të dala nga lufta dhe të Kosovës lindore dhe familjarëve në nderim të atij që nuk kursue as gjakun e vetë që të vihet në themel të lirisë dhe ardhmërisë. Lavdi! Biografia - Arben Ramadani u lind më 13 qershor 1981 nga Babai Sadiku nëna Rexhija, në katundin Kokaj, ishte biri më i madhi, pas tij mbetën në jetë vëllai Adnani, Mejdiu, Qahili dhe Fatlumi, si edhe dy motrat Zjaverja dhe Fitorja. I rritur në një familje bujare e me traditë atdhetare, ku pak ditë të lindjes së tij arrestohen xhaxhallaret e Arbenit, si dhe njëri nga ata edhe burgoste për veprimtari ilegale, shkrime dhe botime politike për bërjen e Kosovës Republikë. Ende pa i mbushur gjashtë javë nëna e Arbenit, i cili pasi kishte dëgjuar rapllimën e bastisjeve milicore, ishte zgjuar dhe në shenjë proteste me atë zë që kishte, i kishte irituar SUP-ovcat, të cilët kishin urdhëruar ta nxjerrin jashtë, fati që në mbrëmjen e fundit ishte shkruar e lexuar në ditar dhe materilat e "Ushtima e Maleve", që për fatin e asaj, edhe pse shpëtuan xhaxhallarët e tij dhe të tjerët që në mungesë të provave pas disa muajëve të lirohen. Mirëpo, ato letra nuk arritën të botohen deri pas 20 viteve më vonë në numrin 4-të të saj në mars-maj 2001, në revistën me të njëjtin emër edhe pse jetë shkurtur, u botuan ashtu si i pati kënduar ai vetë më vonë. Gjithë ajo punë ishte bërë te koka e Arbenit, duke e përkundur dhe kënduar si ninula djepi. Më 24 korrik të vitit 1981, kur ishte rrethuar nga forcat mil-icore familja Ramadani në Kokaj, atë pasdite, kur po e bast-isinin shtëpinë e familjes Ramadani, nena e tij, duke e marre me djepi Arbenin pesjavësh arrijnë të nxjerrin jashtë edhe ditarin dhe materialet e përgatitura për botimin e gazetës "Ushtma e maleve", nr.II/81[1]. Nga dyert e kësaj shtëpie kanë dalë edhe babgjyshi Ramadani, i mbytur në tortur nga bullgaret (1918) si dhe për heroizmat e familjes së tij (Haziri i Mustafës), i cili herët i kishte kuptuar rrëfimet për shtegti-met drejtë lirisë. Arbeni u rrit në

frymën atdhëtare të brezit të tij të pavarësisë, duke u mishëruar nga rrëfimet e babagj-yshit. Këto ndikuan në mënyrë të fuqishme në formimin e vetëdijes dhe kakarakterit të tij prej një luftëtari të kalitur edhe pse teper i ri, u rreshtua në moshën 17-vjeçare në luf-tën e fundit të UÇK-së. Ndërkaq, prej lindjes së tij, më 13 qershor 1981, ndikuan fuqishëm edhe ngjarjet e vitit 1981, ku u rreshtuan bijtë e bijat më të mira të këtij populli si edhe të përkrahur nga familja e tij edhe pse nga ana e sigurimi serb përcillëshin këmba këmbes, si te rrezikshem për pusht-etin okupues. Disa nga xhaxhallarët familjaret u burgosen si dhe u torturuan mizorisht. Arbeni ishte besnik me zemër të pastër, i heshtur por energjik, i dashur, i buzëqeshur si gjith-monë me të gjithë, por nuk i duronte padrejtësitë, luftonte gjithmonë kundër saj. Arbeni qysh i ri, në shkollë të mesme teknike, drejtimi i tekstitit përballet me pushtuesin serb në demonstratat e viteve 1989-1992 për të shfryrë urrejtjen e madhe ndaj robrisë së tyre, përkunder rrezikut që i kanosej. Me pas, fillon veprimtaria e tij aktive për t'u stërvitur në përdorjen e armëve të ndryshme e që shquhet teper për shk-athtësitë që posedonte. Në ditarin e tij të luftes ai shkruante se: Gëzimi më i madh ishte kur hynim me muncion në Kosovë, nuk ishim duarthatë e une ishta vetem një krah i saj i thjeshtë. Edhe pse i ri, kisha vendosur të luftoj për lirinë e vendit tim². Pas fillimit të bombardimeve, kur në Kokaj kishte hyrë me forca të mëdha ushtarake makineria serbe, ai vendosi që me Agronin të shkon në stërvitjet ushtarake nga i kthehet sërish maleve të Karadakut në sektorin e logjistikes. Ai, derisa ishte në radhet e UÇK-së ka kryer detyrën e korri-erit në përcjelljen e eprorëve të lartë të UÇK-së në mesin e të cilëve edhe drejtuesit politik të QPK-së e të Këshillit poli-tik të UÇK-së³ të cilët i kishin premtuar se pasi të përfundo-jnë luftën do të bëhen mësit për t'ia gjetur një bukuroshe, siç ishte edhe ai vetë. Pastaj u angazhua në ndërlihdje dhe në logjistikë, furnizimin me armatim, ofrimin e ndihmës në

bartjen e paisjeve për Radoi Kosovën e Lirë së bashku me Ibrahim Fejzullahun, tashmë dëshmor i lirisë etj. Komandant i ZOP të UÇPB-se, Mustafë Shaqiri - Shpëtimi ndër tjerash thekson se Arbeni i Kokajve, gjate vietëve 1998-1999, i bashkohet njësitit të Preshevës për të luftuar dhe dhënë hakun armikut serb, për ta mbrojtur nga bandat serbo-çetnike pjesën e okupuar të Kosovës Lindore me rastin e varrimit të tij. Kështu, ai u siguroi armatim të duhur luftëtarëve të Preshevës e të Bujanocit. Arbeni, më 19 maj, qëllohet për vdekje nga plumbat e armikut. Ashtu të plagosur, shokët e tërheqin deri në pikën “Apokalips” të KFOR-it në Pogradje⁴. Përkundër përpjekjeve të KFOR-it për t’ia shpëtuar jetën në Sojevë të Ferzaj, sytë e tij perëndojnë përgjithmonë për të mos vdekur kurrë. Sot eshtrat e tij pushojnë në vendlindjen e tij, në Kokaj, ku presin të prehen të qetë në dheun e Arbrit atëherë kur do të realizohet amaneti i tij për liri dhe paqe të plotë. UÇPMB-ja ishte vazhdimësi e UÇK-së në të cilën u bashkangjiten djemtë më të mirë të atdheut, prandaj edhe vepra e tyre e pavdekshme ashtë, siç janë edhe ata vetë të pavdekshëm me gjakun e derdhur për lirinë e shtrenjtë, pra gjaku i tyre i derdhur në shumë beteja të luftës së fundit të UÇK-së dhe të UÇPMB-së. Në një përkujtim në 8 vjetorin e rënies, ku u lexua testamente-nti të pllaka përkujtimore në Kokaj, pasiqë u bënë vizita dhe homazhe nga Shoqata e veteranëve, bashkëvendasve dhe bashkëluftëtarëve, në organizim të SHVL së UÇK-së e UÇPMB-së Nazmi Hajdini. Një varg lutje të ndryshme në shenjë të kujtimit të rënëve dhe betejave të bëra të asaj lufte për lirinë nga okupimi i vendit, sikur gjithandej, edhe të kësaj pjese juglindore. Pas kësaj lufte, meditonte, si gjithnjë, Agroni: Sikur të na mungonte shpresa se një ditë vendi s’do të ketë lirinë, vërtet jeta jonë nuk do të kishte kuptim, edhe terri po të mos kishte fund, për ai do mbetej ag e terr i tmerrshëm, që si i pamëshirshëm, do të sundonte jetën tonë.⁵ Fundi i fundit është fund që ka kuptimin e mbarimit të një

çështjeje. Logjika do të merrte formën e realitetit objektiv me thënien e mençur: Më mirë një fund i tmerrshëm se sa një tmerr i pafund, i apostrofoi bashkëluftëtari i Arbenit, për të vazhduar : "Mos harrojmë pra, tri shprehje: tmerrin, fundin dhe shpresën". Ishte ky mesazhi që u përcoll me rastin e përkujtimit të pesë vjetorit të rënies së këtij, pjesëtari të dy luftërave çlirimtare nga okupimi serb. Vegullonin figurat e ndritura, sa ishin duke folur për motmotin e fundit të shekullit të kaluar, si hijerëndë e i papërkulur, orator i mirë, i papërtuar, përmendi përballimet: tmerrin e dhunës, tmerrin e vrasjeve, tmerrin e shpërnguljeve dhe emigrimeve si dhe dëbimin e tmerrshëm të shqiptarëve atëherë e tash. Në fjalën e tij me këtë rast, vuri në spikamë virtytet e larta prej luftëtari, të dëshmorëve. Ai ka porositur se ata që dinë të çmojnë sakrificën më sublime për liri, paqe, përparim dhe integrim nuk do të shuhen kurrë. Kjo dëshmon se populli është për t'u përmbushur amaneti e atyre dhe vetëm kur të përmbushet ky amanet, ata do të prehen në tokën për të cilën ranë. Bashkëluftëtari i Arbenit kujton se ai si çdo i ri, shkoi ne Shqipëri⁶ për stërvitje për t'u kthyer më vonë me njësitin e tij përmes Maqedonisë në zonën e tij. Arbenin e gjejmë me njësitin e tij,⁷ duke operuar maleve të Karadaket. Ndërsa Agroni, një nga bashkëluftëtarët e tij të pandashëm deri në ditën e fundit thotë : "Arbeni ishte ushtar i heshtur, besnik dhe i përmbajtur që shquhej për guxim dhe kryerje të detyrave ushtarake. Duke qenë në radhët e para nga ata të luftëtarëve të Lagunës, ai ra dëshmor i parë duke kaluar zonën kufitare, derisa ishte me njësitin e tij. Ai ishte me zemër të pastër, energjik, i dashur, i buzëqeshur me të gjithë, por nuk i duronte padrejtësitë, luftonte gjithmonë kundër saj"⁸. Arbeni u rrit në frymën e kërkimit të dritës së lirisë, duke e shprehur edhe në krijimet e botuar në vargje si dhe urrente robërinë. Arrestimet, burgosjet dhe persekutimet fuqishëm ndikuan në vetëdijen, virtytin dhe karakterin e tij prej një luftëtari të paepur. Arbeni që në bankat e shkollës përballet

me pushtuesin. Si pjesëmarrës në protesta, ai shfryn mllëfin ndaj atyre që kishin shtypur, vrarë dhe burgosur popullin e tij. Ishte i vetëdijshëm për rrezikun që i kanosej. Kur lufta po trokiste në derë, ai i përgjigjet dhe futet në Lëvizjen atdhetare pa u hamendur. Edhe pse i ri, Arbeni kishte vendosur të luftojë për lirinë e atdheut. Në stërvitjet për përdorimin e armëve të ndryshme shquhet për shkathtësitë. Stërvitjet në Elshan dhe në Meken e Arbërisë e kalitën edhe më shumë, nga ku kthehet sërish maleve. Radhitet në logjistikën e Zonës në njësitin, i cili furnizonte luftëtarët e lirisë me armatim. Arbri i njihte mirë të gjitha shtigjet e maleve të Karadakët. Kushedi sa herë kishte kaluar me karvanin e gjatë, të ngarkuar mirë, për ta drejtuar kah shokët, të cilët e prisnin, ku derisa ishte në radhët e saj, Arbeni kishte bërë edhe detyrën e korrierit, duke përcjell eprorët e lartë në mesin e të cilëve edhe ish-drejtuës të lartë të KP dhe të Shtabit të UÇPMB-së,⁹. Me rastin e përvjetorit të rënies së tij këta eprorë, gjithmonë përmendin të bëmat e tij. Në pranverën përmbyllëse të këtij mileniumi, ai shkonte drejt përjetësisë, shkonte dhe bashkohej me të tjerët, duke i dhënë hakun armikut, i cili pas tërheqjes ishte barrikaduar në tokat tona, në pjesën lindore në Luginë. U vë në mbrojtje të popullatës së kësaj ane, duke u dalë përballë bandave kriminale të pozicionuara në pjesën lindore¹⁰. Ai u solli armatim të mjaftueshëm shokëve-luftëtarë të tij. Ende pa i mbushur të nëntëmbëdhjetat, i lindur, si hasreti i gjyshit, dhe nxënës i mësuesit të parë, në maj, sapo ishte mbushur mali me gjethe, sapo krisi pushka e parë e lirisë në Lagjen e Zahirëve të Sllubicës, te Kodra e Garës, në trekëndëshin e prerë padrejhtësisht, në luftën e pabarabartë qëllohet për vdekje nga plumbat e armikut. Përkundër përpjekjeve të paqeruajtësve për t'ia shpëtuar jetën në Sojevë, mbyllen sytë e tij përgjithmonë për të mos vdekur kurrë. Te Lisi, në Rup, te vendi Guri i varreve, në Kokaj pranë pllakës përkujtimore të gjithë mblodhën për çdo vitë për t'ia dhënë lamtumirën e fundit amshueshmërisë

dhe lindjes së tij. Ai nuk prehet i qetë në dheun e Arbërisë deri atëherë kur do të bëhet realitet amaneti i tij për liri dhe paqe. Lavdi!¹¹

Citate: Arbeni, si Feniksi që kishte hipur në piedestalin e liris me flakadan i art, kalëron i lirë. Se Arbeni sa ishte gjallë, këtë vend e mbuloi me nam. Dheu do të vazhdojë ta ruajë gjakun e atyre që rënë, gjithandej hartës sonë. I ngrirë, u kishte mbetur testamenti i tokës, brezave që po bien në altarin e lirisë duke ua shtrirë njëri tjetrit dorën e besëlidhjes, përfundon letër përkujtimi i Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së dhe UÇPMB-së . Memorial Arben Ramadani - Shtëpia në Kokaj, ku është lindur dëshmori Arben Ramadani në Kokaj, Gjilan, Kosovë, do të kthehet ne muze. Pas renovimit do të ekspozohen në ditët e festave kombëtare dhe përvjetorit të pavarësisë së plotë të shtetit të Kosovës. Pllaka përkujtimore e Arben Ramadani e shpalosur në përvjetorin e parë të rënies, si dhe një rrugë në Lagjen “Arbria” të Gjilanit mban emrin e tij.



Arben Ramadani – Kokaj (1981-2000)

Publikimet rreth botimit të gazetës ilegale “Ushtima e maleve”, Kokaj, 4 qershor 1980 / (33 vjetori i Fletushkës "Ushtima e maleve" 1979 / 2009)

Grupi ilegal (gueril) dhe Fletushka ("Ushtima e maleve") dhe kontributi i dhënë në Lëvizjen atdhetare për çlirim kombëtar 1979-1980/81/2009 / Gazeta "Ushtima e maleve", edicioni i parë, fillimisht rezu-ltoi si nevojë e kohës rrjedhë nisma për bërjen e një fletu-shke (reviste), ku fillet e saj datojnë në ngjarjet madhore të kombit më 10-13 qershor 1979, në 100 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit prej një grupi të gjimnazistëve të Gjilanit. Fletushka "Ushtima e Maleve", e cila botimin e saj e konkretizoi më 4 qershor 1980 / 15 janar 1981, e redaktuar nga redaksia e parë në përbërje të Nexhat Rrustemi- "Shpëtimi", Nijazi Ramadani- "Komiti", Naim Kurteshi- "Kuç e ziu", Nevzad Isufi "Furtuna", etj. e ndaluar nga pushtuesi si "veprimtari armiqësore nacionaliste-irredentiste". Grupi ilegal dhe Fletushka ("Ushtima e maleve") - Pas një konsultimi të vazhdueshëm mes periudhës 1979/80, fillimisht si nevojë e kohës rrjedhë nisma për bërjen e një fletushke(reviste), ku fillet e saj datojnë në ngjarjet madh-ore të kombit më 10-13 qershor 1979, në 100 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit prej një grupi të gjimnazistëve të Gjilanit. Sidomos pas kontakteve që po viheshin me Isa (Kokaj) e Nexhat Rrustemi (Shpëtimi) dhe Kemajl (Mali) e Naim Kurteshit (Kuçeziu) përmes Nevzad (Furtuna) e Abd-urrahim Isufit (Sokrati), të cilat më vonë iu shtuan radhëve tona edhe Ismajl Berisha (Vlora), Munafer Ahmeti (Munoja) dhe Musa Haliti "Rrufeja", Nijazi Ramadani "Komiti", ballinen e "Ushtimës maleve" dhe ilustrimet i bëri "Guri". Nga takimi i parë konstituiv i Grupi ilegal të 3/4 qershorit 1980,

Kokaj, në të cilin takim ishin të pranishëm: Isa (Kok-aj) e Nexhat Rrustemi (Shpëtimi)dhe Kemajl (Mali) e Naim Kurteshit (Kuqeziu) pëmes Nevzad (Furtuna) e Abdurrahim Isufit (Sokrati), Nijazi Ramadani "Komiti", Ismajl Berisha (Vlora), Munafer Ahmeti (Munoja) dhe Musa Haliti "Rruf-eja". Pas një darke që shtroi familja e Isah Rrustemit në Kokaj, shtruam nevojën e një organizimi më të koordinuar për të pasur një bashkërenditje e përgjegjësi në bashkëveprimtari ilegale të organizimit në grupe 3 apo 10 anëtarësh me një program e statut gjithëpërfshirës dhe të integruar në Lëvizjen kombëtare ilegale të atyre viteve. Fillimisht propozuam dhe hartuam një rend dite pesë pikësh, të cilat i lexoi Abdurrahimi që zotonte një oratori të mirë, kurse procesmbajtës ishim ne që atyre viteve ngjarjet ditore më të rëndësishme shkollore e veprimtaritë tjera jetësore. Ideja ishte që të shënojmë si një koncept bazë për të hartimin e një programi dhe statuti pune për të ardhmen.

*1. Lufta jonë politike dhe atdhetare për çlirim kombëtar (Koncept politik)2. Formimi i një grupi të tipit gueril me karakter të shpëtimit kombëtar. (Celula jopartiake)3. Plani dhe programi i grupit gueril. (Programi dhe statuti)4. Qëndrimi unik ndaj pushtuesit, qëndresa popullit. (Deklaratë publike)5. Nxjerrja e fletushkës "Ushtima e maleve", Kokaj, më 4 qershor 1980. * Programi nismëtar dhe deklarata politike:I. Programi i grupit nismëtar, hartimi i një programi praktik pune që do të jetë bazë që të mbahet në konspiracion të plotë (fshehtësi), ku përfshihen veprimtaria politike e organ-izative si një front i përbashkët gjithëkombëtar me statut e program jopartiak.II. Formimi i një elite(grupi) për koordinimin e komiteteve organizative s një lëvizje kombëtare për çlirim, duke mos përfshijtur luftë e armatosur si vazhdim i një lufte të gjatë çlirimtare të popullit për liri dhe pavarësi. Njëkohësisht do të mbështes Republikën e Kosovës si shtet i barabartë me të tjerat .*

III. Konceptimi i një parimi bazë për veprimtarinë tonë drejt bashkimit (integritit) kombëtar...IV. Fuqishëm mbështesim programin e LSHP, Kuvendin e Junikut dhe Konferencën e Mukjes dhe të Bunjajt dhe luftën e gjatë të popullit tonë me penë e pushkë për liri dhe pamëvarësi kombëtare.V. Integriti i grupit në një front të përbashkët me qëndrime unike ndaj çështjes kombëtare të pazgjidhur.VI. "Ushtima e maleve", të jetë organ informativ politik ... Miratuar më 4 qershor 1980, Kokaj, Gjilan, Kosovë .Pas aprovimit të rendit të ditës nga përfaqësuesit e pranishmit, biseduam edhe për planet e nxjerrjes së fletushkës "Ushtima e maleve", si organ i grupit. Fillimisht, diskutoi Isah Rustemi". Shokë, numri i parë fletushkës "Ushtima e maleve", po botohet në kuadër të 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, atëherë kur edhe u lëshuan rrezet e para për liri, çlirim e bashkim kombëtar të vilajeteve shqiptare në një shtet të pavarur kombëtar dhe bashkimit të forcave në mbrojtjen e atdheut të pushtuar nga osmanet dhe synimet grabitqare të më vonshme prej shovinistëve të Ballkanit. Pasi që më kalohet fjala te unë (Nijazi Ramadani). /Shokë, historia e popullit të Kosovës dhe e kombit është plot ngjarje të lavdishme dhe shembuj të shkëlqyer vetëmohimi dhe heroizmi në luftën për çlirim... Një shembull mund të jemi edhe ne me veprimtarinë tonë". Pastaj folën edhe Abd-urrahimi, Kemajli, Ismajli, Nevzadi, Nexhati, etj, duke marrë për obligim dhe detyrë punët në përgatitjen e gazetës "Ushti-ma e maleve". Materialet e dërguar për numrin e parë nga "Shpëtimi", "Ko-miti", "Kuçeziu", "Furtuna", i korrektoi dhe daktilografoi Shpëtimi me makinën e tij, të sjellë nga babai i tij, i cili pun-onte përkohësisht në Gjermani dhe nga "Komiti" me mak-inën e shkrimit të Musa Halitit, i cili kishte siguruar se mak-inën e kishte sjellë babai i tij (Musës) nga Gjermania (nga një takim pune në lokalet e Shkollës Filllore "Liria" në Kokaj nga Nexhati. Musai, Nijaziu dhe Isa. Veprimtaria ilegale fokusohet në vetëdijesimin dhe ngritjen e nivelit dhe ndërgj-

egjjes kombëtare si përmes literaturës historike, letrare dhe artistike me efekte publicistike, si gazeta "Liria", "Zëri i Kosovës", "Ushtima e maleve" (si organ i yni), botimet: "Me pushkë e pend për liri e pavarësi", "Shota dhe Azem Galica" (autorit Haxhiu), romani "Mic Sokol" S. Godos, "Këngët e lirisë", grup autorësh, gazeta "Shqipëria e re", e tjerë. Përmbytja e Ushtimës maleve, numri i parë kishte të përfshirë në ballinën e saj, një gravura të punuar me temë "Qëndresa" nga "Guri", pasonte me poezi si himni "Kosova" të Asdrenit, poemën e Mitrush Kutelit, "Kosova", trajtesat historike "Me pushkë e penë për liri dhe pavarësi, Lidhja shqiptare e Prizrenit, Lufta për autonomi dhe pavarësi kombëtare 1910-12, Luftat Ballkanike, Konferenca e Londrës, Parisit dhe Versajit (Komiti, Shpëtimi, "Furtuna", "Kokaj"). Cikël me krijime letrare nga "Kuqeziu", "Komiti", "Shpëtimi", e tjerë. Edhe një takim përmbyllës me rastin e promovimit të numrit të parë dhe përgatitjes së numrit të dytë të mbajtur në Livoc të Ultës, rezultoi me shpërndarjen e redaksisë dhe udhëheqjes së grupit për të punuar pavarësisht dhe me struktura të ripërtërira apo me shuarjen e tyre, për shkak të konspiracionit me një vendim unanim të pranishmëve. Arrestimet, bastisjet, burgosjes dhe procesi gjyqësor ndaj "Ushtima e Maleve"⁴¹.

⁴¹ Gazetë e pavarur e Kosovës lindore, "Ushtima e Maleve", Nr. 3, 4, 5,... Kokaj, Gjilan, 1998-2001,

Akti i rifillimit me botimet e shkrimeve enciklopedike të qershorit të vitit 1998, pas daljes në skenë të UÇK-së dhe aleatëve perëndimor, duke sjellë botimin e veçantë "Kosova dhe vetëvendosja", "Ushtima e maleve", Tiranë, 1998, pas-taj rifillimin në vitin 2000, kur është "datëlindja e saj e dytë" apo "ringjallja e saj" e rifillimit të punës së saj, publicistikë, "Golgota e fundit", botim special nga "Ushtima e maleve".


"Ushtima e maleve", edicioni i tretë nga janar-prill 2001, me botimet e veta ka sjellë materiale ekskluzive: Informacione, lajme, aktualitete nga zhvillimet në Kosovën juglindore

(Lugina e Preshevës dhe Maqedonia perëndimore), duke sjellë krijime dhe shkrime publicistike dhe të huazuara apo të përkthyer nga mediet më të ndryshme të botës si dhe ka për qëllim krijimin e një transversale për qasjen dhe integrimin e shqiptarëve dhe të tjerëve në sferat e zhvillimeve shkencore historike-aktuale me dëshmitë, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme globale dhe mbarë shqiptare me të gjitha zhanret e shkrimeve gazetareske, duke përfshirë editorialin, komentin, replikën, reportazhin, përshkrimin, skicën, fejttonin etj. Gjatë veprimtarisë së saj, si një nga mediet e vetme të

es dhe gjenocidial i Millosheviqit. "Ushtima e maleve", si medium i shkruar e përkohshmeja "Ushtima e maleve", ku përveç editimeve informative, aktualiteteve, art-kulturore, historike, enigmatike, fejttoni, ku u boton artikuj të ndryshëm dhe shkrim letrare dhe publicistike. Aty botohen shkrime nga më të ndryshme të redaktuar nga *Nijazi Ramadani*, redaktor përgjegjës, menaxher: *Fatmir Arifi*, përgatitja teknike, *Arbëresh Dalipi*, kontribuon që shkrimet aktuale t'u ofrohen para lexuesve edhe në vijat e frontit të rezistencës së armato-sur të UÇPMB-së dhe UÇK-së të botuar në përkohshmeja mujore "Ushtima e Maleve" në vitin 2001/2002, Nr. 03, 04, 05, 06(dy numrat e parë ishin botuar me 4 qershor 1980 / 15 janar 1981), ku e ka pasqyruar edhe zhvillimet aktuale, poli-tike, kulturore, historike, letrare të atyre viteve të cilat patën përfshirë rajonin si Kosovën dhe ish Jugosllavinë Jugore, të viseve shqiptare të aneksuara pas Kongresit të Berlinit, Konf-erencës së Shën Stefanit, Lidhjes Sh. të Prizrenit, Luftërave Ballanike, Jugosllavisë së Versajit 1919, si dhe të ripushtu-ara edhe pas Luftës Dytë Botërore. Në këtë gazetë është botuar gjithçka drejt për së drejti dhe nga dorëshkrime. Kjo gazetë është mbajtur me punë, perkushtim dhe seriozitet. Dalja e kësaj të përkohshme ka pasur misionin e shtypit të lirë dhe të pavarur para lexuesve të shtresave të ndryshme. Nexhat Rrustem (Kokaj), i arrestuar dhe i burgosur me këtë rast, i akuzuar si një nga organizatorët kryesor i liruar në mungesë të fakteve . Nijazi Ramadani(Kokaj), i arrestuar më 24 korrik 1981,i akuzuar si një nga organizatorët kryesor dhe i torturua sikur shumica e anëtarëve të grupit dhe, i dënuar me burgim më 1 gusht 1981, në procesin gjyqësor ndaj grupit ilegal dhe "Ushtimës maleve", pas mbajtjes në procesin hetues ndaj grupit dhe "Ushtimës maleve", detyrohet që vitin e tretë t'i nënshtrohet provimeve të klasës për shkak se procedurat

shkuara nga ky rajon i trazuar nga konfliktet e armatosura të shkaktuar nga pushteti okupu-

hetuese nuk e lejuan të ketë qasje në shkollim të rregullt, më në fund shpallët i pa fajshëm në mungesë provave. Musa Haliti (Kokaj) i arrestuar, bastiset shtëpia dhe i akuzuar për veprimtari të organizuar në grupin ilegal dhe gazetën. Lirohet të gjithë sikur edhe shumica e të rinjve të trajtuar të tjerët në mungesë të dëshmive mbi të cilat akuzohen, nuk arritën ta "kapin" as një fletë, as ekzemplarë të gazetës të cilat janë mbledhur pas leximit nga Nexhati, Nijazi, Isa dhe Musai. Kemajl Kurteshi, i arrestuar dhe i burgosur, lirohet si i dyshuar për veprimtari të organizuar i akuzuar si një nga organizatorët kryesor.. Abdurrahim Isufi(Gjyrishecë) i arrestuar dhe i trajtuar nga sigurimicat, lirohet si i dyshuar për veprimtari të organizuar. Ismajl Berisha (Svircë) i ndaluar nga policia ushtarake sa ishte ushtar në marinën ushtarake dhe më vonë i liruar, sikur edhe Naim Sahiti (Budrikë), i cili ishte i vetmi nga të gjithë grupi që arratiset jashtë⁴².



Ushtima Maleve, "01

⁴² Botimet : 1. albaniapress.com/indeksi?p=lexo_lajmin&id=9006#
2. gazetakritika.net/Forumi/Doreshkrim.php/index.php?itemid=2068

FSHATI QË NDAHET NGA DY KUFJI

Të gjallët kënde, varret matanë kufirit

• Pavarësisht se realiteti i imponuar politik i ka ndarë me një kufi të gjallët dhe të vdekur, në Kokaj jeta ka vazhduar, por me vështirësi të mëdha



1. pas së cilës duhet shpëritur e katundit Baranec, ka lënë varret baranecë e kësaj ane.

Verës ringjallet sheshi i vallëve

Tabela e identifikimit këte vend si kufi provincial, ndonëse mund të jetë vendosur për orientim të pajenabilitëve ndërkombëtarë. Baranec kanë rrethet se në parë një tabelë e kësaj ane e vendosur diku rreth 200 metra me rrethelë të territorit të Serbisë, ndërsa tani gjendet në brendësi të territorit të Kosovës. Çiftë mbarve të verës, në Kokaj gjelbëron natyra dhe gjallërit jeta. Bëhen edhe drama dhe garmëzë tradicionale që organizohen nëpër shtëpi, apo, si, e çfaqur vendit, të "Shërbë i Vallëve". Këto i katundit "përdoret edhe sot si një për kuzhinë dhe për berje e çaji prej luleve. Në Kokaj spikasin shpesh e ndodhena me garmë, si në gjitë zonën e Malësive të Karadakët. Verës, Kokaj është në vend i mrekullueshëm, sepse atje ndien aromën e pites dhe të fshat, të bota me mazë, gjen bukët e pjekura me saç dhe të mizat e fshat që i ka ky fshat me tradita, ndërsa ditët është vështirë i arritshëm. Në majë e malëve të Karadakët shpeshherë bostin e të Shën Gjergji. I. MUSLIU

Gjilan, 21 maj
Kokaj gjenden në juglindje të Gjilanit, në një territor që shtrihet edhe në pjesën e Preshevës, matanë kufirit. Ky vendbanim është themeluar para dy shekujsh, nga banorët e partitë të këndit nga Saracollia i Jugut, përkatësisht nga fshati Klak. Sipas regjistrimit të punës, që është bërë në vitin 1948, fshati Kokaj kishte 250 banorë, numër ky që është rritur nga viti në vit, deri më 1981, por këtu e këndeja ka fshat mësimi në drejtën të qytetit të Gjilanit, por edhe të Preshevës. Bëhen me të madhe të popullosë ky fshat e ka përjetuar pas luftës së fundit, si pasqirë e pasqurisë për të jetuar në këtë zonë kufitare. Tani një mallë shihet ndonjë orë që bëmën, ndërsa shkolla ka rrethor në 3-4 nxënës. Pas luftës së Dytë Botërore, vesën një muaj të kaluar i të rrive patën fatin të shkollës. Ndër të parët ishte Mesudë Rahati, i

cili më 1944 u bashkua me nushtin e Brigadës Shqiptare që po kalonte nëpër Kokaj. Në Tiranë këtu kualifikimin për mësues. Në fund të vitit 1947 ishte këtyri në Kosovë, ka fillor punën e mësimit, baranec, rrethor kjo që ishte shumtë e maalbe për malëzort e Karadakët dhe banorët e Anamorovës. Më vonë u hap shkolla edhe në Kokaj. Mësues i parë ishte Krenem Rexhepi, e më vonë edhe Halil Halili. Në vitin 1972/73, Krenem i rrethor në të kalte kishte ishte gjithë 14, të cilët e përbandan teteveçanë dhe vijuan shkollimin e mësueskësh. Ferizazë Haziri dhe Nadie Halili, për shkak të kuzhinëve të vesitira, nuk arrijn të shkojnë më tej. Sot, dyzet vjet më vonë, shkolla ka ngjarë në kater nxënës, thënë Nijaz Karadakët, banor i fshatit Kokaj.

Jeta në zona kufitare, e vështirë

Përreth zonës kufitare me

Serbinë nuk ka qenë lehtë të jetohet në këto vite. Provokime ka pasur edhe për banorët e Obilavre fshatit, Zabinaj e Myçillabë, që po aqshu i përkatën kësaj zone. "Ma nuk mund të shkojë të llo as të varret e familjarëve të tyre", thotë Karadakët. Ai rregjen se varr i Rrethor, një prej dy djemve të Ademit, themelues i katundit, ka mbetur matanë kufirit. Megjithatë, jeta në Kokaj nuk është shuar. Baranecët nuk dëshirojnë që të humben gjurmët, të paktën jo partitë e varreve. Pëngës për jetën dhe të vdekurit në Kokaj parajpet baze ushtarake serbe, më e madhja në Luglinën e Preshevës, që është afër kësaj zone. Ata kanë hambur të vetmin burim jetese arat, kullosat, livadhet dhe mizat. Megjithatë, tsharët janë të vendosura për i ringjallur këto troje, që po zvogëlohen padejshërisht nga agushatet politike arbitraze. Një tabelë që është vendosur nga KFOR-

Promemorie, shënime për Kokajt - Tkurrjet e territorit në juglindje të Kosovës po ndodhin edhe sot në brezin kufitar me Serbinë (tekatundi Kokajt të Gjilanit) Kokajt fshat i brezit kufitar, po përballet me hallet e shum-ta, shkolla, rruga dhe izilimi nga bota . Si të dilet nga kjo gjendje?!

- 06 maj 2009, (Ditë e motmotit (Shën Gjergji), fillimi i verës 2009) . Banorë të katundit Kokaj të Gjilanit, të cilët janë afër kufirit me Serbinë, janë shprehur të vendosur që të të qëndrojnë në brezat e tyre. Ata kanë kërkuar disa herë përkrahje më të madhe të institucioneve lokale e qendrore dhe investime, si: në përfundimin e rrugës Llocë-Kokaj, deri të pika kufitare me Serbinë, e cila ditëve të fundit, sipas deklartave të bano-rëve të mbetur në tokat e tyre, kanë shtyer (zbritur tabela) deri afër 100 m. Xhamisë

së Sllu-bicës. Ndërkaq, të mërkurën (Ditë e motmotit (*Shën Gjergji*), fillimi i verës 2009) në një raport 13 min. të RTK-së, medum i vetëm publik i Koso-vës, te emisioni Pro et contra (të reporterit Zekë Sinani) është bërë bublice zhvendosja e tabelës që shënon zonën ndarëse kufitare në mes të Republikës së Kosovës dhe Rep-ublikës së Serbisë në kilometrin e 20-të mes kumunave të Gjilanit dhe Preshevës. Sipas Reshta dhe Nehat Hazirit, ka ndodur tkurrja teritoriale mbi 100 metra, duke lënë matanë kufirit lagjen e Muhaxhierve te Kokajve si edhe varrezat e Mëhallës së epërme të Kokajve. Patrollimi i xhandarmërisë dhe milicisë serbe, i ka sjellë shqetësim permanent për sigurinë e tyre. Ata nuk e kanë të lirë të shkojnë në tokat e tyre dhe te varrët për të varrosur apo vendos një lule apo lutje për të afërmit e vetë. Varri i Fezës, njërit nga themeluesit të katundit, ka mbetur matanë kufirit. Reshati ka potencuar faktin se "prania shumë afër në kilom-etrin e fundit të bazës ushtarake më të madhe në Luginën e Preshevës (Kosovës Lindore) si edhe shtyrja e tabelës që ma tej nuk mund t'i afrohen banoret dhe bagëtia e tyre". Ata kanë humbur të vetmin burim jetese, arat, kullosat, livadhet dhe malet e tyre, deklaror njëri nga më të moshuarit, nga Muhaxhirët e kokajve, të lindur në Kokaj dhe, kanë certifikatat e lindjes të lëshuar nga zyrrja e vendit në Pogradjë nga ofiçari Rexhep Rexhep, banor i komunës së Gjilanit, tashmë e ka braktisur shtëpinë dhe tokën e vet. Atyre Kryetari i Komunës së Gjilanit u ka premtuar përkrahje në infrastukturën e katundit, renovimi dhe mundësisht në bashkëpunim me Qeverinë e Koosves, përkatësisht të bëjnë të përdorshëm rrugën që lidh edhe me fshtrat tjera të brezit kufitar. Monitorimin e trafikut dhe kalimeve ilegale si edhe gjetjen e një zgjidhje politike për zonën e ngushtuar terirtoriale, ashti si është vepruar me Maqedoninë si dy shtete fqinjje ka deklarura për RTK, të enjtën pas orë 12.00, kryetari i Komunës së Gjilanit . z. Mustafa. Edhe fshatarët janë të

inkurajuar për t'i ngjallur ato troje që po zvoglohen padrejtësisht nga argumenti i forcës dhe zgjidhjeve politike arbitrare që fati i ndau pas viteve të '50-ta nga trangu i Kosovës, si Buhiqi, Staneci, Lezbalia, Kurbalia, Seferët, Maxherën Gosponicën, Zahirajt, tashmë së fundi edhe Kokajt që janë banorë familjar të Kokajve (Gramos) *Kjo tabelë qe rishtazi është vendosur nga KFOR-i, në varrezat e katundit Kokaj, dhe pas së cilës shihen shtëpitë e katundit Ranatoc, që sipas kësaj tabele gjenden në Serbi, ka irrituar jo vetëm banorët e kësaj ane por edhe të gjithë ata që e lexojnë. Në tabelë kufiri nuk quhet shtetëror por provincial apo krahinor. Tabela si duket është vendosur për të shënuar kufirin dhe për të këshilluar ushtarët e KFOR-it që të mos kalojnë pas saj pasi që territori matanë është Serbi. Banorët kanë deklaruar se më parë një tabelë e këtillë ka qenë e vendosur diku rreth 200 metra më në thellësi të territorit të Serbisë por që tani gjendet më brenda territorit të Kosovës. (Dauti)*

Katundi Kokaj kërkon t'i rrikthehet emri i vetë në dokumentet zyrtare të R. së Kosovës -<http://www.kokajt.com>⁴³.

⁴³ www.kokajt.com , duke dashur që të jetë sa më transpa-rent me bashkëvendasit, të cilët kanë të drejtë të plotë të njih-en me njëri tjetrin dhe punën e tyre, pra, që nga 8 qershori 2008, po qëndron e hapur edhe faqja zyrtare në internet, për-mes së cilës ofron një pasqyrë të përgjithshme të aktivitetit të vetë dhe bashkëvendasëve tanë, kahdo që gjenden gjithandëj globit tokësor.

Kokajt.com, kjo web-faqe ishte një nga mënyrat më të avancuara të komunikimit me qytetarët, e cila iu jep mundësi atyre jo, vetëm të njohin e vlerësojnë punën e e bashkëvendasve, por edhe t'i kritikojnë, sugjerojnë, ndimojnë ata, nese ka çka dhe me atë që ka, t'i thuhet atyre si vëllai vëllait, e motra motrës, një familje në miniaturë. Në këtë mënyrë, **kokajt.com** mendohet që përmes freskimeve të inkurajojë nismën e vendasve që ta kontribuojnë dhe diskutojnë, si dhe të marrën pjesë aktive në vendimarrje për çkado që të jenë sa më afër vendlidnjes me mendje, zemer, shpirt e vepra.

Kokajt .com nuk është asgjë tjetër, pos një faqe interneti që aktualizohet dhe duhet t'iu shërbejë qytetarëve të vetë për t'i realizuar sa më lehtë synimet e tyre për një të ardhme më të mirë.

Kokallarë! Nisje e mbarë në shtigje të gjata!

Bashkohemi si dikur moti!

Faqja kokajt.com iu është kushuar katundit kokaj dhe banorëve të tij nga e kaluara e deri më sot.

Në këtë faqe mundë të gjeni gjithçka çka mundë të dihet për kokaj. Aktualizme nga e kaluar dhe e tashmja që kanë një strategji si dhe udhërrëfyimi kuptimplot për të radhmën? Pra, një faqe interneti e cila po nuk u aktualizua me ec bashkë me kohën është duke ngelur prapa. Edhe faqja:

Kokajt, banorët e brezit kufitarë andej dhe këndeje kufirit vlerësohet të jetë urë shumë e rëndësishme si banorë të këtyre trevave që brenda hapësirës etnike shërben si një urë lidhëse për prespektiven e banorëve të mbetur dhe të atyre që duan të kthehen atje. Kokajt duan të bëhet me identitetin e vet të mohuar rreth një shekulli, ata kërkojnë t'i rikthehet emri i vet, Kokaj, në dokumentet zyrtare të lëshuara nga Republika e Kosovës , e jo sië ishin më parë me emrin Inatoc. Katundi kur dihet se ka shumë familje si në Kokaj, por edhe në vendbanimet tjera që shtrihet në kilometrin e 20-të në juglindje të Komunës së Gjilanit që i përket zonës kufitare dëshiron të bëhet me identitetin e vet të mohuar rreth një shekulli. Katundit ishte ndërruar emri i vet i ruajtur me shekuj, Kokaj, pas vendosjes së pushtimit dhe krijimit të Jugosllavisë së Versajit me 1919. Vendbanimi Kokaj në mes të Gjilanit dhe Preshevës, venbanim ky që pas vendosjes së pushtimit të Mbretërisë SKS njihet edhe me emrin, Inatovc, ishte nisëm e mirë gjatë takimeve në Kokaj. Mirëpo, banorët e Kokajve dhe rrethina kurrë nuk e kanë njohur me këtë emër, sepse është emër i imponuar me pushtimin e këtyre trojeve nga ushtria serbe në vitin 1919. Një dokument me rëndësi (fotokopje nga origjinali) . Ky dokument është i vitit 1918 dhe qartë shihet regjistrimi i popullatës së Komunës së Preshevës me rrethinë. Katundi Kokaj është i shkruar me "Chochay". Për këtë fletë një dokument me rëndësi origjinal dhe e publikuar për herë të parë të cilën e solli Daut Dauti , journalist, ish-zëdhënës i Qeverisë së Kosovës. Nga sipërfaqja e përgjithshme 402 .52 ha, 121.21 sipërfaqe me ara, pemi ishte me 89 ari, me livadhe 5.00 ha, kullosa 20.00 ha, ndërsa pyje 234.00 ha. Sipërfaqet me toka jo produktive janë 23.00 ha. Poashtu edhe sipas vetë një dokumenti të hartografisë dëshmohet më emërtimin që kishte pasur gjer atëtherë kat-

www.kokajt.com/ , pra sikur edhe vetë interneti është për shkakun e aktualitetit interesant per lexuesin, ekziston për të qenë ajo për të cilën është destinuar.

"Uji nëse ec pihet, nese pushon shterrët" proverb.

undi Kokaj, ku (Lat (DMS) 42° 23' 26N Long (DMS) 21° 34' 46E Altitude (meters) 565 Time zone (est) UTC+1 (+2DT) Approximate population for 7 km radius from this point: 19576.(Google links for Kokince Google links for Kokince, Serbia & Montenegro.). Kokaj është një fshat në Karadakun e Gjilanit. Shtrihet në juglindje të Gjilanit në gjersinë gjeografike veriore prej 42° 23' 26 dhe 21° 34' 46 të gjatësisë gjeografike lindore dhe lartësi mbidetare 565 m lagjja e Poshtme dhe 643m lagjja e Epërme. Si vendbanim është krijuar para dy shekujve, kur banorët e parë erdhen nga vendbanimi i Sanxhakut të Nishit, venbanimi Klaiq, komuna e Lebanës. Katundi Kokaj përbëhet prej tri lagjeve të ndara njëra nga tjetra, e ato janë: Mahalla e Poshtme, Mahalla e Epërme dhe në mes tyre shtrihet Gurina, shprehet ish banori i Kokajve, Nijazi Ramadani. Kokajt sipas regjistrimit të parë që është bërë në vitin 1948 katundi Kokaj ka pasur 250 banorë, në vitin 1953 ka pasur 289 banorë, në vitin 1961,342, në vitin 1971, 386 ndërsa në vitin 1981, 376 banorë. Nga viti 1981 e këndeje ka pasur vazhdimisht zvoglim të popullsisë si pasojë e emigrimit të banorëve në drejtim të qendrës komunale së Gjilanit . Ramje të numrit të popullsisë ka shkaktuar lufta e fundit kur nga ky fshat u shpërngulën shumica e popullsisë si pasojë e pasigurisë. Në vitin 1999 paramilitarët serb kanë masakruar disa banoirë të këtij katundi. Sot në këtë fshat jetojnë vetëm pesë familje me rreth 30 banorë.(Zëri)

Renovimi i xhamisë së katundit Sllubicë – Gjilan

Xhamia e Sllubicës, fshat që shtrihet buzë kufirit që ndan Kosovën - (Luginën e Preshevës) dhe Serbinë është ndërtuar në vitin 1930/35. Për disa dekada me radhë xhamia në fjalë ishte vendtakim (për xhematin e fshtreve përreth andej e këndeje kufirit që tashmë i ndan edhe lagjen e Uahirajve të Sllubicës, si Kokaj, Muhaxhirët e Kokajve/Ranatoc dhe Magjere/Preshevë/), për shumë besimtarë të fshatrave shqiptare nga të dyja anët e kufirit, ku kryenin obligimet e tyre

fetare, por shërbente edhe për qëllimet tjera kombëtare. Mirëpo, gjatë migrimit të vazhdueshëm të fshatarëve nga fshatrat në qendrat më urbane, e sidomos gjatë viteve të fundit të sundimit të pushtetit serb, xhamia e Sllubicës pësoi dëmtimet dhe shkatrrimet serioze, dhe gjendja e saj pothuajse erdhi deri tek zhdukja totale fizike. Si pasojë e kësaj gjendje që nga fundi i viteve të '90-ta akti-itetet fetare në xhami pothuajse u shuan fare, për të mos thënë ranë në pasivitet të plotë. Gjatë kësaj periudhe, xhamia e cila ishte në shkatërrim e sipër, kishte mbetur streh për bagëti e shpendë të ndryshëm. Duke parë këtë gjendje të mjerueshme të xhamisë, Jusuf ef. Mustafa (Kokaj), veprim-ar i shquar për aktivitete fetare e kombëtare mori iniciativën që kjo gjendje të ndryshojë në të mirë të xhamisë. Synimi i tij, sikur edhe i xhematlive të kësaj xhamie ishte që kjo xha-i përsëri të jetë aktive dhe të jetë në shërbim të atyre pak besimtarëve të mbetur në këto troje. Meqenëse mulla Jusufi edhe vetë më parë kishte jetuar në katundin Kokaj, ku grav-tonte si xhematli i kësaj xhamie, për te sikur edhe për bashk-vendasit tjerë ishte motiv më i madh që të ndërmernte një hap të tillë. Sipas Fjalëve të Jusuf ef. Mustafës, (tashmë imam i kësaj xhamie) kostoja e renovimit të xhamisë ishte rreth 10.000 euro, ku ndihmë të mdhe dhanë banorët e Sllubicës, ata të katundit Kokaj si dhe banorët e fshatrave Ranatoc dhe Maxhere të Komunës së Preshevës, ku kont-ribut të veçantë dhanë besimtarët si: Vaxhid Haliti, Rrahman Latifi, Sabit Zahiri, Rexhep Sylejmani, haxhi Hazir Rama-dani, si edhe vetë Jusuf ef. Mustafa, i cili momentalisht usht-ron edhe detyrën e imamatit të xhamisë në mënyrë vullnetare.

*/*Revista Dituria, fq.207, Prishtinë, 2007*

/Rruga në zonën e kufirit rikthen banorët në tokat e tyre (Nexhat Buzuku) 11 gusht 2008 (Koha ditore)
 ,
 Banorët e zonës kufitare në Kokaj kërkojnë asfaltimin e rrugës. Ndërtimi i rrugës Llovcë - Kokaj, që do të lidhëj edhe me pjesën e Ranatocit dhe Maxherës, do të ishte urë

lidhëse mes fshatrave të Gjilanit dhe atyre të Preshevës, mjet komunikimi ndërnjerëzor dhe institucional

Lexo:74.52.64.18/~wwkoha08/index.php?option=com_content&task=view&id=11363&Itemid=33

Grupit ilegal dhe fletushkës "Ushtima e maleve"⁴⁴.

⁴⁴ Shpalime kohe/ përvjetor: 30 vjetori Grupi ilegal dhe Fletushka "Ushtima e maleve" 1979/2009

15

WW5_ZPgBRwJ:se2.isn.ch/serviceengine/FileContent%3FserviceID%3D10%26fileid%3D72E5EE4E-9AA6-0DE8-ADF7-FE828BE44A12%26lng%3Den+ushtima+e+maleve&cd=59&hl=en&ct=clnk
target=" _blank">209.85.129.132/search?q=cacheWW5_ZPgBRwJ:se2.isn.ch/serviceengine/c/FileC

14 von oshëtima

DisclaimerThe views expressed are those of theAuthor and not necessarily those of theUK Ministry of DefenceISBN 1-903584-67-1

13 von botimet elektronike

WW5_ZPgBRwJ:se2.isn.ch/serviceengine/FileContent%3FserviceID%3D10%26fileid%3D72E5EE4E-9AA6-0DE8-ADF7-FE828BE44A12%26lng%3Den+ushtima+e+maleve&cd=59&hl=en&ct=clnk

target=" _blank">209.85.129.132/search?q=cache

WW5_ZPgBRwJ:se2.isn.ch/serviceengine/FileContent%3FserviceID%3D10%26fileid%3D72E5EE4E-9AA6-0DE8-ADF7-FE828BE44A12%26lng%3Den+ushtima+e+maleve&cd=59&hl=en&ct=clnk ,

rrjedha.piczo.com/?cr=5, www

12 von Info

Kosovo Lindore / Preshevo 1999 - 2002 and the FYROM Conflict..

se2.isn.ch/serviceengine/FileContent?serviceID=10&fileid=72E5EE4E-9AA6-0DE8-ADF7-FE828BE44A12&lng=en.

Formal operations began in January 2000, with a politikal wing and local spokensmen operating aut Prishtina and Gjilane, and a journal.Ushtima e Maleve, that was soon appearig regularly an Kosovo bookstalls giving news of the war ...

10

Kosovo Lindore / Preshevo 1999 - 2002 and the FYROM ConflictFile Format:

PDF/Adobe Acrobat - View as HTML

journal, Ushtima e Maleve, that was soon appearing regularly on Kosovo bookstalls, giving news of the war. But Albanian success in Kosovo was n

9 von Info

everyoneweb.com/rrjedhashqiptare/ ... për Oshtimen

8 von oshtima

Fletushka "Ushtima e maleve", lexo:

ndryshe.com/mat.php?idm=13533

7 von Info

tribunashqiptare.albemigrant.com/index.php?subaction=showfull&id=1246041453&archive=&start_from=&ucat=6&prevnext=8

6 von Ushtima e maleve

news.albemigrant.com/?subaction=showfull&id=1246041453&archive=radiopresheva.ch/blog.php?page=bloguser&id=1&rowstart=6#blog3

5

Lulet pas dhjetë viteve të martirizimit mbi varret e Rabbit Tahir Dalipit dhe Avdi Selver Rexhepit/ Ata janë përkujtuar nga familjaret e Kokajve me 5 prill, ku para dhjetë viteve u masakruan nga paramilitarët serbë. / Sot është një ditë përkujtimi për të martirizuarit e kokajve të 5 prillit, që janë të varrosur në katundin Llocë, ku me këtë rast janë vendosur kurora lulesh mbi varret, Avdi Rexhepit dhe Rabbit Dalipit, prej bashkëfshatarëve të Kokajve. Kjo ditë që sa më shumë të kalojë koha aq më e rëndësishme do të bëhet më 17 Shkurt, kur do të hyjë në historinë e saj edhe Dita e Pavarësisë, ku simbolikisht është ngjarja më e rëndësishme për lirinë që po e gëzojmë sot.. Rabbit Dalipi 17. 02.1951 - 05. 04. 1999 ; Avdi Selver Rexhepi 01 10 1975 - 05. 04. 1999 / Janë mbushur 10 vjet nga martirizimi i

zemrashqiptare.net/article/ArtKulture/8657/?highlight=nijazi+Ramadani&match

4

gazetakritika.net/Forumi/Doreshkrim.php/index.php?itemid=2068

3

albaniapress.com/indeksi?p=lexo_lajmin&id=9006#

ibtauris.com/pdf/186064841X.pdf shih, botimin ne anglisht :Copyright © John Phillips, 2004 / The right of John Phillips to be identified as the author of this work has been asserted by him in accordance with the Copy-right, Designs and Pate Formal rebel operations in southern Serbia started in January 2000, with a political wing and local spokesmen operating out of Pristina and Gjilane and a militia journal, Ushtima e Maleve (Kokaj), on sale in Kosovo providing news of the littl
GJILAN, 7 septembar 1998: In the center of the town, police arrested Nijazi Ramadani (1964), a teacher and activist with the Union of the Political Subjects in Gjilan, "Qenar Çeshme" st.64/a.
bndlg.de/~wplarre/week435.htm

16 von Info

GJILAN, 7 septembar 1998 : In the center of the town, police arrested Nijazi Ramadani .
REPORT NO. 435. ON THE WIDESPREAD REPRESSION AND HARASSMENT PERPETRATED BY THE
SERBIAN POLICE AND OTHER AUTHORITIES IN KOSOVA - FROM SEPTEMBER 7 . SEPTEMBER , 1998

kushërinjve tanë, Rabbit Dalipit dhe Avdi Zymerit. Ata u vranë nga një grup i paramilitarëve serbë që trimëroheshin kur gjenin njerëz të paarmatosur duke mos i kursyer as fëmijët dhe gratë që vranë në të njëjtën ditë kur masakruan për vdekje edhe Rabbit Dalipin dhe Avdi Rexhepi. Më 5 prill të vitit 1999 kur lufta kundër për çlirimin e Kosovës po merrte hov duke mposhtur dhe poshtëruar gjithnjë e më shumë forcat e armatosura serbe, grupet ushtarake, paramilitare dhe polic-ore serbe gjithnjë e më shumë hakmerreshin në popullatën civile shqiptare. Një grup i tillë solli shkatërrim dhe vdekje edhe anët tona. Në këtë ditë, para 10 viteve, një duzinë paramilitarësh serbë, si hiena, erdhën në Kokaj për të vranë, plaçkitur dhe djegur në këtë pjesë të malësisë së Karadakut, ashtu siç kishin bërë para 50 viteve. Duke ardhur nga Ranatoci, grupi i këtyre kriminelëve serbë u nda në dysh me të hyrë në Kokaj. Njëri grup i paramilitarë serbë me vetura, traktor dhe gjëra tjera të plaçkitura ishte nisur në drejtim të Llovcës. Në mes Kokajve dhe Llovcës, aty te Podi apo te Rrënjët, këta paramilitarë masakruan Rahim Ymerin dhe një grua të Ranatocit e cila ishte mysaf-irë në Llovcë. Egërsirat serbe, pas ushtrimit të dhunës shtazarake, më në fund i kishin djegur këta dy njerëz të pafajshëm. Në të njëjtën kohë, të hipur mbi një traktor Rabbit Dalipi, Avdi Zymberi, Sami Xhelilin, Xhemail Halimin dhe Nazmi Hajdinin, nga Pogragja ishin nisur për në shtëpitë e tyre në Kokaj dhe Llovcë. Me të arritur në Elbishtë ky grup u takua me vrasësit dhe plaçkitësit serbë që po largoheshin nga Kok-ajt dhe Llovca pas vrasjeve dhe plaçkitjeve. Por, bishat nuk ishin ngopur me vrasje ndaj të pambrojturve dhe vepruan njësoj edhe me këta që hasën rrugës. Nga tërë këta shpëtoi vetëm Nazmiu, të cilin e kishin lënë për të vdekur. Pastaj, paramilitarët serbë vazhduan rrugën e ikjes për në Pasjan duke vepruar njësoj edhe në Pogragjë. Paramilitarët serbë, atë ditë, vetëm në Kokaj dhe Llovcë vranë 7 njerëz, të cilët u varrosën të nesërmen. Nën

organizimin e nipit të rabitit nga Pogragja dhe disa të tjerëve nga Llovca, jo larg varrezave të katundit, u bë varrimi i këtyre martirëve që u përcoll nga një kontroll i forcave të rregullta të policisë serbe. Edhe pse kanë kaluar 10 vjet nga vrasja e Rabitit, Avdiut dhe të tjerëve, është koha që t'i përkujtojmë njerëzit tanë të cilët nuk patën fatin që ta shohin lirinë që ne e gëzojmë sot e për të cilën u martirizuan ata. Të mos e harrojmë Rabinin me karakterin e urtë e të butë që kishte e të cilin kurrë nuk e dëgjuam të thoshte një fjalë të keqe për askënd. Prezenca e tij në mesin tonë gjithmonë ka sjellë gaz dhe hare. Edhe energjia që posedonte Avdiu ishte mahnitëse. Kur ndalemi pak për të pushuar nga hallet e kësaj bote dhe mendojmë e kujtojmë momentet e bukura që kemi kaluar me Rabinin dhe Avdiun, vetëm atëherë e shohim sa shumë na ka marr malli për ta. Atëherë na kujtohet fytyra gjithmonë e qeshur e Rabitit, të cilit, çkado që i bënim, nuk kishim gjasa që ta hidhë-ronim. Ne, sot duhet t'ua komunikojmë Rabitit, Avdiut dhe të tjerëve faktin se si i kemi mposhtur e poshtëruar vrasësit e tyre dhe shumë të pafajshmëve të tjerë. Duhet të lutemi që edhe Zoti t'i dëgjoj fjalët tona të mira që kemi për njerëzit e tanë siç ishte Rabiti dhe Avdiu, e që nuk patën shumë fat në këtë botë. (*D.Dauti*)

Artikull në IWPR për Kokajt në vitin 1999 (anglisht) -- Kosovo House Sales Cement Ethnic Divide /Property prices are shooting up on Kosovo's border with Serbia and speculators moving in as ethnic Albanians from Serbia proper move south to purchase the homes of departing Serbs *By Daut Dauti in Kokaj (Published on November 2, 1999)* The village of Kokaj is on one side of Kosovo's border with Serbia, the village of Ranatoc on the other in the district of Presevo. The population of both is ethnic Albanian, but those in Serbia are looking to move to Kosovo where they feel safer. Kokaj has changed in the past decade as its population dwindled from 600 to fewer than 200 at the beginning of 1999. Most moved to Switzerland to find work after Kosovo

was stripped of its autonomy. Today only some 30 villagers still live in Kokaj. The rest moved to the nearby town of Gjilan during the war for safety after six were killed by Serb paramilitaries in April. "Fear is the main reason why others have moved away," says Vaxhit, one of the last villagers. Pointing to the graveyard a few meters away in Serbia he explains ironically that "Our dead have become foreigners." The road to Serbia is busy with tractors and lorries. "It's not a secret. We sell cigarettes in Serbia", explains a lorry driver, adding that he also brings back goods from Serbia to sell in Kosovo, evading tax on both sides. The village of Bilnica is nine kilometers away. It is ethnically mixed with three houses belonging to Serbs who, according to a local farmer, "have not been convinced that they should move to Serbia". These Serbs were not compromised during the war and even journeyed with their Albanian neighbours to Gjilan to protest to the local police when Serb paramilitaries moved in - to no avail. Now, though innocent, they may be forced out by Albanians from Serbia wanting property in Kosovo. Agron, an Albanian from Presevo has come to Gjilan to buy a house on instructions from his two brothers in Switzerland and now is following their instructions to buy a house in Kosovo. He visits an orthodox church where Serbs and Albanians gather to buy and sell property. The improvised market is quite efficient. Owners who have moved to Serbia can be contacted by a Serb 'courier' who speaks a good Albanian. He takes off his car number plates and drives to towns in Serbia to trace the owners charging 30 German marks for the round trip to Vranje and 50 German marks to Nis. Local Albanians have mixed views about buying Serb properties, but will not miss their Serb neighbours. Some think that Serbs should simply go, leaving their homes as compensation. Others welcome the sales as an efficient way of getting rid of the Serbs. Serb sellers try to explain to Albanian buyers in the market that not all of them are

responsible for what took place in Kosovo, but the Albanians are not interested. Albanians do, however, complain about rising house prices and the appearance of speculators, buying properties cheaply from Serbs and selling them on at inflated prices to Albanians. In one instance, a house was bought for 600,000 German marks and sold for a million. Agron found a flat he wanted to buy and contacted the Serb owner via 'courier' in Vranje. She wanted 60,000 German marks, but dropped the price to 40,000 a few days later.

KATUNDI KOKAJ I GJILANIT, I ZONËS KUFITARE

- Në Kokaj të Gjilanit, një fshat ky i zonës kufitare, që gati më shumë vite i lënë pasdore. Deri me tashti shumë sosh janë shpërngulur për shkak të rrugës së pakalueshme për automjete, edhe ajo udhë që është ka pësuar dëmtime të cilat nga mundësitë e banorëve janë të përnovueshme, por tani kanë mbetur shpresat më të sigurt se jeta do të gjallërohet me kthimin e fshatarëve tashmë do të jenë të sigurt sepse në Kokaj në të ardhmen shumë shtëpi që janë shkatërruar, po rindërtohen. Rruga Pogradjë-Llovcë-Kokaj, e cila flitet se do të lidhë banorët e brezit kufitarë andej dhe këndej kufirit dhe vlerës-ohet të jetë arterie shumë e rëndësishme nga banorët e kët-yre trevave që brenda hapësirës etnike shërben si një urë lidhëse për perspektiven e banorëve të mbetur dhe të atyre që duan të kthehen atje. Kur dihet se shumë familje si në Kokaj, por edhe në vendbanimet tjera Ranatovc, Maxhere, Ilicë, Gosponicë, Gare e deri në Rovovicë të Preshevës për-shkohen nga kjo arterie rrugore që është i banuar me shqiptarë. Premtimet e Komunës së Gjilanit dhe të Ministrisë së Transportit e PTK për asfaltimin e rrugëve që lidhin zonat kufitare të Kosovës, i kanë inkurajuar edhe banorët e katu-ndit Kokaj që të mendojnë për kthimin në vendlindje. Madje vetë ata janë shprehur të gatshëm që të bashkë financojnë një projektet tillë. Musa Haliti deklaroi në vazhden e takimeve me zyrtarët komunal: " *Më 27 korrik*

2008 me iniciativën e Reshat Behlulit kemi shku në katundin Kokaj këta persona: Reshat Be-hluli, Rexhep Hasani, Musa Haliti, Bejtulla Hasani, Emerlla Haliti, nga kurrështja kanë ardhë edhe Jakupi i Isufit dhe Murati i Beqirit Mexhid Dalipi. Në praninë tonë i kanë bërë një analizë vizuale rrugës nga xhamia e Llocës e deri te kufiri në mes Preshevës dhe Gjilanit, pikërisht deri te shtëpia e Azizit të Eminit. Këtë analizë vizuale gjegjësisht këtë vrojtim të rrugës e kanë bërë Fadil Osmani përfaqësues komunal dhe dy inxhinierë, emrat e të cilëve nuk i dijë ju kërkoj falje. Kjo gjatësi e rrugës është 3.5 km e me gjerësi 5 m. Një javë më vonë pikërisht me 06 gusht 2008, në ora 18.00 jemi prit nga kryetari komunës Qemajl Mustafa, ku për hir të së vërtetës po e theksoj se edhe këtë takim e ka organizua Reshati. Në takim kemi marrë pjesë , Reshat Beh-luli, Hazir Ramadani, Basri Ismaili, Bejtulla Hasani, Musa Haliti, Mexhid Dalipi, ne e informuam kryetarin e komunës për rëndësinë jetike që ka kjo rrugë për katundin tonë Kokaj dhe fshatrat tjera si p.sh. Ranatocin, Magjeren, Ilincen, Buh-iqin, Gosponicë, Bukocë, e deri në Rahovicë të Preshevës etj. Nga ky takim ne ishim mjaft të kënaqur me premtimet që na i dha kryetari komunës. Na u premtua se projekti do të realizohet këtë vit kalendarik, kurse në vitin 2009 në muajin mars do të fillojë ndërtimi i rrugës ku u zotua se kjo rrugë nga Pogragja e deri te kufiri në mes Preshevës dhe Gjilanit do të realizohet si një projekt dhe do të punohet në të njëjtën kohë kur ndërtimi do të fillojë nga kufiri në drejtim të Pog-ragjes. Kokaj thonë se janë të shumtë ata që po kthehen për t'i rinovuar, apo rregulluar për banim të përkohshëm shtëpitë e tyre , ka thënë Hazir Ramadani, duke i parë mundësitë e atyre pak shtëpive që kanë ngelur në Kokaj, për të bërë diç-ka vetëm janë të vogla, por shpresat e tyre janë te komuna dhe Qeveria. Inkurajuese është fakti se në Kokaj po rindërt-ohen shtëpi të e vjetra dhe të shkatërruara nga banorët e larguar viteve të kaluara. Ai beson se ky projekt me prioritet do të përkrahet

sipas premtimeve edhe nga vetë banorët dhe mërgimtarët tanë nëse Komuna e Gjilanit dhe Ministria ven-dosin në mesin e prioriteteve. Sipas përfaqësuesit të katundit Kokaj, Hazir Ramadanit, i cili ka deklaruar se pasi që shumë herë janë takuar me zyrtarët komunal, ata kanë "varur " shpresat se rruga e tyre do të cilësohe si një investim kapital dhe do të ndihmohet nga komuna dhe Qeveria. Edhe Mexhit Dalipi, thotë se institucionet tona më në fund po përkrahin vendbanimet e fshatarëve të harruara e të lëna pasdore nga të gjithë pushtetet e kaluara, ku pos elektrifikimit të katundit dhe ndërtimit të shkollës me katër klasë nga vetë kontributi i plakut Nezir Haliti, nuk ka pasur përkrahje tjetër.

Në Kokaj të Gjilanit mbahen *"ditët e takimit familjar"* Ritakim me njerëzit e vendlindjes / Në vitin 1981, katundi kishte 376 banorë, ndërsa tani në këtë fshat kanë ngelur vetëm pesë familjae me rreth 30 banorë

Gjilan, 27 korrik- Në Kokaj të Gjilanit, një fshat ky i zonës kufitare, i braktisur bukur shumë ndër vite, janë mbajtur "Ditët e takimit familjar" , ku dikush është rikthyer atje pranë një lutje pranë varrit të të afërmve te tij, ose për të lënë një tufë lule mbi varrin e shkrimtarit Zejnullah Halili, apo të dëshmorit Arben Ramadani, apo të martirëve të luftës së fundit, Avdiut, Rabbitit dhe të tjerëve si dhe për t'u ritakuar me të gjithët të vendlindjes, qoftë me ata që ende jetojnë në Kokaj ose gjithandej Kosovës, viseve të tjera shqiptare apo edhe në diasporë. Katundi Kokaj shtrihet në juglindje të Gjilanit. Si vendbanim është krijuar para dy shekujve dhe banorët e parë erdhën nga Sanxhaku i Toplicës, vendi i quajtur Klaiq. Në vitin 1967 plaku Nezir Haliti (Mixha Nezë) ndërtoi shkollën me vetë kontribut dhe në pronën e vet në mes të katundit në afërsi të lagjes Gurinë. Mësues të parë ishin pikërisht të rinjtë e këtij katundi, të cilit ishin shkolluar si Rrustem Rrustemi e Halil Halili, thotë publicisti dhe poeti Nijazi Ramadani, një nga ish-banorët e katundit. Sot kësaj shkolle i kanoset rreziku i shuarjes për arsye të mungesës së

nxënësve. Sipas regjistrimit të parë që është bërë në vitin 1948 katundi Kokaj ka pasur 250 banorë, në vitin 1953 ka pasur 289 banorë, në vitin 1961, 342, në vitin 1971, 386 ndërsa në vitin 1981, 376 banorë. Nga viti 1981 e këndej ka pasur vazhdimisht zvogëlim të popullsisë si pasojë e emigrimit të banorëve në drejtim të qendrës komunale të Gjilanit. Rënie të numrit të popullsisë ka shkaktuar lufta e fundit kur nga ky fshat u shpërngulën shumica e popullsisë si pasojë e pasigurisë. Në vitin 1999 paramilitarët serb kanë masakruar disa banorë të këtij, dhe tani kokajt kanë ngelur me rreth 30 banorë. Shumë shtëpi janë shkatërruar, por Kokajt thanë në takimin familjar se: " janë të shumtë ata që po kthehen për t'i renovuar, apo rregulluar për banim të përkohshëm shtëpitë e tyre. I.Musliu ("Kosova Sot")

Malësia e Karadakut të Shkupit - Malet e Karadaku,

(Malet e Zeza) Lajm – Info/ Një rrugë për hapësirën etnike shqiptare?/ Premtimet e Komunës së Gjilanit dhe të Ministrisë së Transportit e PTK për asfaltimin e rrugëve që lidhin zonat kufitare juglindore të Kosovës, i kanë inkurajuar edhe banorët e katundit Kokaj që të mendojnë për kthimin në vendlindje. madje vetë ata janë shprehur të gatshëm që të bashkë financojnë një projekte tillë. Rruga Llovcë - Kokaj, e cila do të lidhë banorët e brezit kufitarë andej dhe këndej sipas Nijazi ramadanit, banorë i katundit Kokaj, kufirit vlerësohet të jetë arterie shumë e rëndësishme nga banorët e këtyre trevave që brenda hapësirës etnike shërben si një urë lidhëse për perspektiven e banorëve të mbetur dhe të atyre që duan të kthehen atje. Kur dihet se shumë familje si në Kokaj, por edhe në vendbanimet tjera Ranatovc, Maxhere, Ilicë, Gosponicë, Gare e deri në Rovovicë të Preshevës përshkohen nga kjo arterie rrugore që është i banuar me shqiptarë. Deri me tashti shumë sosh janë shpërngulur për shkak të rrugës së pakalueshme për automjete, edhe ajo udhë që është ka pësuar dëmtimi, të cilat nga mundësitë e banorëve janë të përnovueshme, por

tani kanë mbetur shpresat më të sigurt se jeta do të gjallërohet me kthimin e fshatrave të braktisura tashmë do të jenë të sigurtë sepse në kokaj në të ardhmen shumë shtëpi që janë shkatërruar, po rindërtohen, por Kokaj: "*janë të shumtë ata që po kthehen për t'i renovuar apo rregulluar për banim të përkohshëm shtëpitë e tyre* ", ka thënë Ramadani. Mundësitë e atyre pak shtëpive që kanë ngelur në Kokaj, për të bërë diçka vetëm, janë të vogla, por shpresat e tyre janë te Komuna dhe Qeveria. Inkurajuese është fakti se në Kokaj po rindërtohen shtëpi të e vjetra dhe të shkatërruara, nga banorët e larguar viteve të kaluara. Ai beson se ky projekt me prioritet do të përkrahet sipas premtimeve edhe nga vetë banorët dhe mërgimtarët e Kokajve me rreth 40 mijë euro nëse Komuna e Gjilanit dhe Ministria vendosin në mesin e prioriteteve. *Ilmi Musliu. ("Kosova Sot")*

Banorët e brezit kufitar sytë në institucionet e shtetit Rruga Llocë-Kokaj (Ranatoc) e gjatë rreth 5 kilometra, me gjersi asfalti 3.5 m, nëse përkrahet nga Komuna e Gjilanit dhe ministria e transporteve , kap vlerën e 180 mijë euro, ku me vetë kontributin e banorëve dhe mërgimtarëve tanë do të siguroheshin rreth 40 mijë euro.Rruga Llocë - Kokaj që lidhë banorët e brezit kufitar andej dhe këndej kufirit, vlerësohet të jetë arterie shumë e rëndë-sishme nga banorët e këtyre trevave që brenda hapësirës etnike shërben si një urë lidhëse për perspektivën e banorëve të mbetur dhe të atyre që duan të kthehen atje. Shumë familje si në Kokaj, por edhe në vendbanimet e tjera Ranatoc, Maxhere, Ilincë, Gosponicë, Gare e deri në Rahovicë të Preshevës, përshkohen nga kjo rrugë përreth së cilës banojnë shqiptarë. Deri më tani shumë sosh janë shpërngulur për shkak të rrugës së pakalueshme për automjete. Banorët shpresojnë që me asfaltimin e kësaj rruge jeta do të gjallërohet dhe numër i madh i të shpërngulurve do të mund të ktheheshin. Asfaltimi i rrugës Llocë -Kokaj do të jetë urë lidhëse mes trevave të Gjilanit dhe atyre të Preshevës. Sipas zyrtarëve, zonat

kufitare janë vlerësuar me prioritet. Do të ndalet shpërngulja massive/Përfaqësuesi i katundit Kokaj Hazir Ramadani, ka deklaruar se pasi që shumëherë janë takuar me zyrtarët komunal kanë "varur " shpresat se rruga e tyre do të cilësohe is një investim kapital dhe do të ndihmohet nga komuna dhe Qeveria. Mexhit Dalipi, thot se institucionet tona po përkrahin vend-banimet e fshatarëve të harruara nga të gjithë pushtetet e kaluara, ku pos elektrifikimit të katundit dhe ndërtimit të shkollës me katër klasë nga vetë kontributi i plakut nezir Haliti, nuk ka pasur përkrahje tjetër. Rruga Llocë-Kokaj (Ranatoc) e gjatë rreth 5 kilometra, me gjersi asfalti 3.5 m, nëse përkrahet nga Komuna e Gjilanit dhe ministria e transporteve , kap vlerën e 180 mijë euro, ku me vetë kontributin e banorëve dhe mërgimtarëve tanë do të siguroheshin rreth 40 mijë euro nëse prioritet i Qeverisë së Kosovës vazhdon të mbetet investimi në fshatrat e brezit kufitar. (9.08.2008 *Infopress, Ahmet Bilalli*)



PA,MJE NGA RUPA

RRËFIMET NGA ODAT TONA NË KOKAJ

Malet e Karadaku, (Malet e Zeza), e që në shumicën e rasteve njihet si Karadaku i Shkupit, shtrihet nga Morava e Binqes, në juglindje me një gjatësi rreth 50 , Luginës së Preshevës, në juglindje dhe fushës së Shkupit në jug. Struktura e relievit është mjaft e copëtuar. Këtë e bëjnë luginat e lumijnve si pjesë më të ulëta dhe majet e maleve si pjesë më të larta të relievit. Sendimentet reja në pjesën perëndimore, mesozoike, në pjesën e mesme dhe ato të vjetra të paleozoikut në lindje tregojnë një lloj-llojshmëri në ndërtimin gjeologjik⁴⁵. Moravë e Binçës. Relievi i lartë i kësaj zone pengon depërtimin e masave të nxehta të jugut, ndërsa ndaj veriut është e hapët. Zonën e karadaket të Shkupit e përshkon izoterma e vjetore 9 °C e 10 °C, kurse reshjet mesatare vjetore janë midis 700 e 800 mm. Kushtet e tilla natyrore janë shprehur në fizionominë e pejsazhit. Sipërfaqet më të mëdha janë pyje, duke përfshirë më se gjysmën e territorit të trevës. Sipërfaqet me ara përfshijnë 31% të territorit dhe janë për gjysmë më të vogla se në Drenicë. Kullotat dhe livadhet përfshijnë rreth 11 % të sipërfaqeve të tokave. Një strukturë e tillë e tokave ka kushtëzuar që popullsia të merret me shfrytëzimin e tokave punuese dhe sipërfaqeve me pyje. Blegtoria, për shkak të bazës ushqyese të vogël, është më e kufizuar. Janë male të larta prej 700 - 1.500 m. Pikat më të larta të këtyre maleve janë: Maja e Zezë me 1.219 metra lartësi dhe Maja Topanit

45 * ⁴⁵ *Formal rebel operations in southern Serbia started in January 2000 with a political wing and local spokesmen operating out of Pristina and Gjlane and a militia journal, Ushtima e Maleve (Kokaj), on sale in Kosovo providing news of the little war.*
INCLUDEPICTURE

["http://www.botasot.info/te_vogla/iiii.jpg"](http://www.botasot.info/te_vogla/iiii.jpg)

* MERGEFORMATINET _____ HYPERLINK

["http://www.ibtauris.com/"](http://www.ibtauris.com/) [_www.ibtauris.com_](http://www.ibtauris.com_)

Copyright © John Phillips, 2004-The right of John Phillips to be identified as the author of this work has been asserted by him in accordance with the Copyright, Designs and Patents Act 1988.

me 1.178 metra lartësi. Malet e Karadakut përfshijnë një sipër-faqe prej 389 km² dhe është e banuar me afro 50 000 banorë, përkatësisht 120 banorë në një km².

Fjalë të odave : *Fal k'tyne dy burrave që erdhën me mue se nuk pata me mjt as me folën para k'ti "meshlizit"..*

Vendi: Kokaj, u tregua n'oda t'Kokajve / Ish kanë pas thirr për me pleqërua një ngatërresë në Dobro-sin, plaku Haliti i Murseli nga katundi i Kokajve me pleqnar të tjerë të fiseve. Mirëpo, nuk i kishte pas mujt me prefund-ua as fjalën aty se i nxënke gjuha n'thua e kishte pas belbëz-ua nga pakë.U que njani prej burrave që nuk i pëlqente të vihet drejtësia për ndreqjen e të ngatërruarve të asaj treve, dhe i thotë Halitit: "Leje k'to llafe se spo mundsh me ba fjalën fjalë, e leje ma me drejtua "meshlizin".Ishte pas ngushtua Haliti dhe, duke u qar në këmbë, ia kth-eu fjalën:"Eftimiri i zotit kjo punë mbet e "prishtë" pa u ndr-eqën... Keni me më thirr por nuk vijë ma".Pas shumë tubimeve nga pleq të pajtimeve nuk u arrit kur farë marrëveshje mes tyre. Dhe më në fund u detyruan me i qua fjalë e me marrë prapë atë për ta drejtuar hesapin se nuk po bien në "razi" ngatrestarët. Dikur i qoi fjalë se do të kthehej prapë në odën e pajtimit por, me një kusht që t'i marrë me veti edhe dy burra tjerë që ta shoqëronin atë, për të cilin kusht pranuan, duke lënë me faj atë që ia kishte "pre" fjalën. Haliti i merr dy kushërinjtë e vetë, Qazimin e Hetë Kokën, dy kaçak të njohur të kësaj ane. Pasi që hynë në odë shikuan njëri tjetrin dhe panë që sa është"sahati", i thanë fol Halit se të paqmi dëgjua. Heta, i tha kush ashtë ai që një plakë në odë nuk e lënë me mbaru fjalën. Burri që kishte 'pre' fjalën ulë kokën dhe tjerët e dëgjuan deri sa e përfunduan muhabetin rreth asaj ndreqje, duke i thanë "ejvallah" për pajtimin e arritur. Haliti iu tha që t'iu fal k'tyne dy burrave që erdhën me mua se nuk pata me mjt as me folën para k'ti"meshlizit"..

Si e han dy kokallarë zijafetin u bamun gati për pashain n'mmoravic

Nji ditë vere ishin ra dy kokallarë prej Kokajve të Karadikut në fshatrat fushore t'moravicës dhe përgatit udhës ishin renditur për t'ia qar zijafetin me teknil prej pasulit e deri n'tatli. Iu ra udha dhe i vesin se për ku e kah po e qonin k'to tepsia e tava. Njani prej tyre iu thotë me lëshua udhën se për drekë e kishin ba/e gati një pashai të ardhur prej Shkupi.

Eh, mirë boll, ia kthyen me nji fjalë te dy kokallarët, Haziri dhe Merseli.

-Pse? - petën ata.

Sepse na menduam mos e keni bae gati për argatë që punojnë ë fushën se për pashën ka k'si zjafeti ku t'hyn ... (ia morrën t'epsita me pule e pite deri n'tamel oriz dhe i shënjuan me nji anëdhe e hanin pa frikë e pa mërzitën fare. Nuk kaloi pakë pasiqë e kishin fshirë zijafetin, ju kishte pas aradhen nji nga ata që tu thoshte se Pashai do t'i falte ata nëse u tregojnë arsyeën pse e kishin grabitur zijafetin e bam gati për të.

Mirë shumë, morën martinat me veti në krah dhe shkuan të pasha për të folu me të që mos me ba zullum të ata që e kishin ba e gati zijafetin për te.

Kur shkuan te ai, po i vet: Pse e hëngrët zijafetin, a ju treguan se ishte bae gati për mua, mos keni pas edhe ndonjë kajst tjetër, iu tha atyre dyve...po, po, na treguan dhe nuk kemi pas asnjë cak tjetër posqë e kemi mendua sa ishin t'umtë për bukë, dhe ka që tri ditë jemi dalë prej shpie deh nuk kemi hënë gër askund, . e për ty mënuam se ku t'kersitesh n'derë këtu ka nji zijafet ta bëjnë.Fal ju koftë kjo , se edhe ju u batë burra e folët njëmend.

RRËFIME NGA JETA E KOKALLARËVE:

Si u pritën mysafirët e Talë agës*Miftarë Kokës në odën e Dalipit Rustemit! Tali po enej odëm odë nëpër gjithë nahijet e Kosovës n'shp-in t'atkisë e me tirqi të zi me dymbdhjetë fije gajtani.Ishin kanë pas mbledhun nji ditë burrat e fisit të Kabashit prej anës Moravës së epërme për ta bae nji izjaret

k'ti burri që t'ia kthejnë vizitën atij që rrinte veç n'shalë t'atkisë e kon-akem konak. Ata e njihnin qysh prej Betejës së Kaçanikut te Guri i shpuem, kur me Zeqën e Zahën ia patën shti qyskien shinave për me ndal vaporin e Dergut e Xhavit Pashes me asqerin e turkut që mbanin edhe bajrakun n'istikamet e luftës. Burrat e Kabashit Vitisë që mbaheshin me lidhje fisi, shkuan një ditë n'Kokaj, duke vetë, ku rrinë me shpi e odë Miftar i Hasanit? Po, fati i kish qëllue me pyetën afër odës së Dalipit Rrustemit dhe pa hezitim i thojnë, hajde bujrum se qe k'tu e ka odën e Talin, se dalin e thirrën f'mia se nuk ka qëllue sot n'shpi, iu thonin atyre. Paspak dalin at' pasdite von dhe e thrasin prej rrezes përkarshi, O, Tal hajde se kan ardhën do jabangji dhe po te presin n'oden e Dalipit. Tali doli doli si prej shpelles nga kasollja e thurrun me thunje dhe e mbulluar me kashte te theknes dhe zbriti poshte te oda i priti dhe i perculli mysafiret, dhe ju tha ku te hyni në Kokaj oda e tij i pret e percjell mysafirë me bukë e mikpritje shqiptare?

Fjalë të odave Anton Çetta : " Kokajt po e rrejtkan hyqmetin, ndërta Lloca Zotin!". Grupi i etnologëve në krye me Anton Çetën, pas formimit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, kishin pasur një vizitë nëpër Karadakun e Shkupit ishin kanë pas ndalur edhe në Odën e plakut Haxhi Isa Koka për ta pyetur nëse kishte për tu thënë edhe ai, si një nga pleqnarët e kësaj treve. Fillimisht ata e pyesin nëse kishte për t'ia rrëfyer atyre ndonjë fjalë të urtë, fabule, proverb ose kashelash. Mbase ngushtohet para atyre burrave tu tregojë përrallën, iu tha atyre se, do t'i mbledh fëmijët e mëhallës që tu tregoi përrallën në një kënd të odës së tij (në Kokaj të Karadakut), dhe nëse ata do të kishin guxonin ta shkruanin e publikonin në kohën e monizmit. Pasi që mbledh fëmijët për rreth tij, nis t'u tregoi përrallën "Dhelpra dhe Gaforrja", më zë të lartë që ta dëgjonin gjithë oda, edhe studiuesit në krye me Anton Çettën. Ishin pas kanë njëherë dhelpra dhe gaforrja në miqësi për ta punuar

Arën në fund të guri të madh. Dhëlpër i tha gaforres së do ta mbante gurin që mos të binte dhe ajo do ta punonte arën. Gaforres nuk i erdhi as tash mirë që nisi me këto kushte punën, por prapëseprapë, iu deshtë të pranonte deri sa e mbolli bereqetin, edhe e korri dhe e grumbulloi në një strumbullar për ta ndarë me ortakun e vetë Dhëlpërën. Nis të zihen zënkat mes tyre se si ta ndanin grumbullin e hedhur të grurit, dhe prapë dhëlpër i qetë rabush që ta caktonin një pikë prej nga të niseshin me vrap për të arritur deri të strumbullari i bereqetit. Dhe, ai që arrin i pari do ta merrte bereqetin. Prapë gaforrja karshi dhëlpërës do të humbte, deri sa më në fund i shkrepri në mendje që posa që të nisen me gërshërët e saj ti ngjitej për bisht dhëlpërës besë prerë. Dhëlpër kurrë arriti fare afër grumbullit e shkundi bishtin për ta hedhur pa ditur gaforren në majë të grumbullit. Atëherë kthehet mbrapa dhe fletë vetvetiu: "Athua sa larg ka mbetur gaforrja dhe kur do të arrijë,...". Iu përgjigj gaforrja nga Maja e grumbullit: "Unë kam mbërrir këtu kaherë, por të pres ty". Dhe, bereqeti i mbeti gaforres... Nëse doni shkruan: "njëri nga ata që ishte pranë i tha troç se këtë nuk mund ta shkruani sepse prek pushtetin... tregon ndonjë tjetër". Plaku Isah Koka, i tha se nuk dinte tjera farë soji (përralla). Grupi i etnologëve në krye me Anton Çettën deri sa po kthehej prej Kokajve, udha i binte të vinte nëpër katundin tjetër Llocë që kalonte mes përmes arave që i punonin llocarët. Njëri prej tyre, kishte pas qenë duke livruar në arën e tij, ishte pas ndalur nën një dardhë dhe në brazdë mesi i qetësonte një fëmijë qetë të lidhur me zgjedhë dhe parmendë. U ndal dhe i pyeti disa kalimtarë: "Çka po bënte ky njeri aty? Ata i treguan se është lidhur në namaz për tu falur për Zotin. Në fund, Anton Çetta i tha atyre që ishin të pranishëm: "Kokajt po e rrejkan hyqmetin, ndërsa Lloca Zotin!". (Koka)⁴⁶

• 46 [Malet e Karadakut Anamorava / Klaiqi](#) *Lloca

Këngë popullore folklorike që përkushtohen për të rënet: (Këngë për mësuesin Mustafë Koka dhe grupin e tij)

N'MORAVË T'EPËR E N'KARADAK -
PRIN HASANI SI USHTARAK. F.14
MUSTAFË KOKA SI RRUFEJA,
ISH STRATEG PLOT IDE T'REJA
ARIF SYLA, ARKATAR-
MBLIDHTE PARE PËR LUFTËTARË

Lidhje të Jashtme

- [Informatë mbi shtrirjen gjeografike](#) / [Informatë mbi shtrirjen gjeografike](#) / [Informatë mbi shtrirjen gjeografike](#) [http://kokajt.com/\[12\]](http://kokajt.com/[12]) / <http://www.info-kokaj.tk/> / <http://www.kokaj.net/>

Burim i të dhënave

1. [^](#) I. Azizi, Ndryshimet socio-ekonomike të BL të Pogradjës. Punim diplome, FSHMN, Prishtinë 1986 [^](#) <http://nona.net/features/map/placedetail.868727/Kokaj/> [^](#) <http://www.klaiqi.com/libri> [^](#) Anatasije Urošević; Gornja Morava i Izornik, Jedinstvo. Priština 1993. (ribotim) [^](#) I. Azizi, Ndryshimet socio-ekonomike të BL të Pogradjës. Punim diplome, FSHMN, Prishtinë 1986 Projekti Commons ka materiale multimediale rreth artikullit: [Kokaj](#)

GJILAN: In the center of the town, police arrested Nijazi Ramadani (1964), a teacher and activist with the Union of the Political Subjects in Gjilan, "Qenar Çeshme" st.64/a.



[Wochenbericht von KMDLNJ/CDHRF - Weekly report - from September until September , 1998](#)
www.bndlg.de

[REPORT NO. 435 ON THE WIDESPREAD REPRESSION AND HARASSMENT](#)

XHA FER LILA, S'NDALEJ DOT, MËSUES MUSTAFËS,
 ÇKA PO I THOT: "SI N'DASH VDEKJES,
 TI ME I SHPËTUE
 –TE HASANI, KE ME NA ÇUE!..."
 PO ÇFARË MËSUESI, TI I THUE VETI -
 E MSHEFË NUSËN PREJ HYQMETI?
 ME PUNUE SI ARSIMTAR -
 DUHET T'JESHË PËRPARIMTAR!
 EDHE I FJALË, XHA FER E FLET:
 "PA NGO MIRË, O MËSUES I SHKRETË -
 NJI DETYRË NESËR TË PRET,
 T'NA BIESH NUSËN, T'NA BAN HYZMET!...
 "BUKUR FORT M'KENI NGUSHTUE -
 S'PATA KAFE ME U MARUE!
 S'PATA NUSE ME U BA HYZMET -
 GJUM' TË MIRË BAFSHI N'JASTEK!..."
 "ÇONJU BURRA PREJ DYSHEKAV'
 SË PËR JU, SOT KA ARDHË DEKA!
 N'EMËN T'POPULLIT DHE T'LIRISË,
 T'KOSOVËS DHE T'SHQIPNISË!..
 ASHT NISË RRUGËS KRYQ E TËRTHUER,
 PRANGAT N'KAMBË E HALLKAT N'DUER!
 N'KORETISHTË, KUR MBRRINI BURRI -
 I KA KËPUT HALLKAT ME GURI!...
 Kënduar nga Demir Krasniqi

Këngë për Arben Ramadanin⁴⁷

Diell e han sa t'i bien tokes
 Trim azgan rrit Djepi Kosovës,
 Po kujtojm si një Shqipe Mali
 Lind djal n'Kokaj t'Gilani
 N'pranverë t'81-it
 Prej familjes del Azgani
 U rrit ai zemer luani
 Atdheu thret – Arben Ramadan
 Kur Kushtrimi ra n'Kosovë
 Kap Arbeni pushken n'dorë

⁴⁷ * **Këngë për Arben Ramadanin**

Kënduar nga Hamit Kastrati, Tiranë, "Albumi "100 vite të pavarësisë së Shqipërisë"

Trim i rrall si yll që ndriti,
 N'Feken e Elshan per arm' stërviti,
 N'flamur t'kombit u betu
 Shqipes trojet m'ja Bashku
 Se Duro kjo tok Serbinë
 N'Shpirit e Zemer pat Trimerinë
 N'Karadak ish Brigada 113 -të
 Kam për kam Serbin tuj njek
 N'Çdo Aksion Arben Sadiki
 Prin i pari mes rreziki
 Bashk me vellezerit Kosovar
 Per Liri Bashkim Kombetar
 Nuk e nal Arbeni Pushken
 N'Preshevë e vazhdoi luften
 Ah kadal Qetnik i kralit
 Tash po i sheh bite e Shqiptarit
 19 maj vitit 2000 (dy-mij)
 Ra n'Presheve ai per Liri
 Ky Deshmor kurr nuk harrohet
 Emri ti n'breza trashigohet
 Ai Luftoi e ra si burrë
 Per nji Komb e nji Flamurë

Kënduar nga Hamit Kastrati, Tiranë, "Albumi "100 vite të pavarësisë së Shqipërisë"





FOTO-GALERIA KOKAJ







Monografia "Shtegtim në histori"(Kokajt 1842-2012)

Në monografinë "Shtegtim në histori"(Kokajt 1842-2012) nuk e bëjnë vetëm ata që njerëzit e e rëndomtë dhe ata që i kanë bërë vetit vendin në hierarkin e parisë së familjarëve të njëjës nga familjet më të përmendura që nga kohërat e Skenderbeut, duke u nxirr nga përditshmëria e individëve dhe ndodhive nëpër të cilat kaluan ata në krahurat e kohës dhe hapësirës në të cilën jetuan, punuan dhe qëndran vertikalisht. Memoriet e atyre i bëjnë njerëzit që e kanë përcjellë ngjarjet dhe breza të tërë deri më sot.

Format dhe forma e Monografisë "*Shtegtim në histori*"(*Kokajt 1842-2012*)" i ngjan më shumë formateve të viteve të fund në kohështrirjen e shekullit të kaluar dhe të shekullit që iku. Forma e formati i shkrimeve të përpunuara, të dokumentuara ka evoluuar nga etapa kohore në etapën tjetër, duke ngarendur pas trendeve të cilat e kishin katandisur gjithë hapësirën e etnisë sonë. Prandaj në këtë rast shikohet e krahasohen me format e Monografive moderne, monografia, ka gjeneralogjin familjare edhe tekst fonologjik dhe vizual sepse jetojmë në shekullin digjital, kjo kështu, është e mjaftueshëm e gatshme për botim, për të krahasuar me modelet e monografive moderne.

Prandaj, duke soditur nëpër të, vërehet se; pjesë a ngjarje të saj siç janë të thëna, identifikohen dhe argumentohen në dritën e fakteve duke i njohur plotësisht nga kokallarët, që po rrefiehet në atë që e nuk i kanë parë, dëgjuar apo njohur që e ndjejnë si nëpër familjarët e tyre . Një qytetar i thjeshtë që ka jetuar më shumë se 80 vjet në këto vendbanime kah janë endur prej anës në Fushëdjekur Pukë, Koplik, Kuks, Diber apo Mirditë dhe Lezhë, Tiranë. Ata sikur se edhe fiste

tjera, duke filluar nga Kastriotët që pas kryengritjeve dhe rezistencës së tyre nëpër ato luftëra kanë tretur edhe përtej detit në Itali dhe Turqi apo në ndonjë vend tjetër. Këto lëvizje janë regjistruar në drejtim të ndryshme të Kosovës si: Gjakovë, Prizren, Deçan apo Pejë deri në Klaiq, pastaj nëpër Karadak, ku kanë themeluar vendbanimin e tyre, Kokaj, i cili gjendet sot e atë ditë. Një lagjë e Klaiqëve në Gjilan, Kaçanik, Preshevë, Kumanovë, Shkup dhe Prishtinë pastaj rrethinë, ajo i duket si e panjohur duke pasur parasysh se monografia lexohet, shikohet, dëgjohet e komentohet edhe nga njerëzit e thjeshtë.

Monografia është balancuar në mënyrë të barabartë nëpër fusha, lëndë dhe materie, ku pjesë të saj herë-herë janë përforcuar qëllimisht me komente e shënime të shumta dhe duke shkuar në hollësi të lëndës, e pjesë tjera të saj janë të përshkruara barabartë, apo janë përmendur pjesërisht në trajtën e veprës / *Monografisë "Shtegtim në histori" (Kokajt 1842-2012)* / Pastaj për ngjarjet e ndodhitë më të hershme të kokajt me rrethinë të plota, të vërteta të faktuara në shirita filmi, do të mund të përcjellin të shoqëruara në arkivin fotografik të familjarëve të cilat janë në "Monografi "Shtegtim në histori" (Kokajt 1842-2012)". Kështu duke pasur parasysh edhe faktin se Kokajt me rrethinë, që nga e kaluara e deri ditët tona kanë qenë një vendbanim familjar të ndarë me komunitetet të përziera njerëzish e kulturash, veprimtarish, e zeje të ndryshme, ku me shekuj kanë bashkëjetuar dhe kanë pasur një shumësi të racave dhe qarkullim të mallrave e njerëzve e në monografi janë paraqitur në formën më të mirë të duhur.

Monografi "Shtegtim në histori" (Kokajt 1842-2012)

Ky publikim, falë syrit të mprehtë të një monografi nga si Nijazi Kokaj një lexuesi a profesionisti që përditë ka në dorë një monografi a vepër tjetër, sikur kjo formë shkrimi ka përvijuar me trendet aktuale të një kronikani të kohës, të cilat janë përcjellur brezë pas brezi, duke u fokusuar në dy shekujt e fundit 1842-2012, që botohet në 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe 5 vjetorin e shtetit të Kosovës, sikur edhe të lëvizjeve pozitive në visetë tjera të Kosovës lindore dhe të Maqedonisë, ku jetojnë shqiptarët dhe familjarët e tyre.

“Monografia..”Shtegtim në histori”(Kokajt 1842-2012)” është përplot histori e që duhet edhe të jetë, por, është e populluar me ngjarje historike, shpesh herë të shtrira gjithëandej etnisë, të cilat janë paraqitëshin edhe me mënyra tjera si psh.: foto, pjesë foljore, artikujve të dokumentuara referenciale dhe enciklopedike të njerëzve që i kanë ecur e provuar ngjarjet dhe janë pjesëmarrës të tyre, forma vizuale në Cd-rom apo formë digjitale të cilat e kanë pasuruar me bibliografinë e botimeve etj.

“Monografisë "Shtegtim në histori"(Kokajt 1842-2012)” , kjo monografi si lëndë hyn në grupin e posaçëm të veprave që kanë përshkrim të posaçëm bibliografik, të bibliotekave / bibliografët internacional si ISBD (M) dhe do të thotë: (Standardi Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për Monografi "Shtegtim në histori"(Kokajt 1842-2012) pra, monografia është vepër serioze publiko e botueshme e cila eksplicivisht dhe gjithanshëm trajton problemin e kokajve dhe kohës edhe hapësirës në të cilat jetuan ata, çështje ose lëndën, duke e trajtuar edhe një regjion sikur është Trekëndshi i Toplicës, Karadakut të Shkupit dhe të Kosovës lindore, qyteteve, jetës dhe veprave të veprimtarëve a shkrimtari, artisti, mjeku, luftëtari, dëshmori, politikani dhe

krahas kësaj vlerësohet jo vetëm puna e tij, por edhe periudhat ose drejtimet e veçanta politiko-shoqërore që i ka takuar. Pra, kjo monografia e trajton në mënyre të detajuar një temë atdhetare të posaçme e cila është në vazhdim e sipër. Qëllim ka përmbajtjen e shënimeve të publikimit monografik "Shtegtim në histori" (Kokajt 1842-2012), dhe i përcakton renditjen e elementeve dhe sistemin standard të inkorporimit në shënime. Zakonisht kur bëhet përshkrimi bibliografik i burimeve të saj, të dhënat ndahen zona përshkrimi. Duke e lexuar me kujdes, shihen materiale të cilat monografia, është mbarështruar me shkrimet që bëhen për të këto ditë dhe mjaftë është perfektë, por ishte e domosdoshme për Kokajt dhe të gjithandej etnisë sonë. Monografia ka një formë të bukur, ka edhe një botues dhe shtëpi botuese të respektuar e serioz siç është SHB "Rrjedha", përveç materialit të brendshëm cilësor monografia gjithashtu sjell një radhitje të intekruar të përmbajtjes dhe dizajnim cilësor e profesional nga një mësimsdhënës teknologjisë informatikës, lidhje e kopertina që do të pëlqehen nga lexuesi. Kokajt një vendbanim në malësinë e Karadakut të Shkupit, Etnia (Imazhi i Malësisë së Karadakut, Kosova lindore, Kokajt me rrethinë, Kokajt dhe Mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore, Kokajt ndër mote, Shtrirja dhe hapësira tokësore^ujore, Moti~ Klima, Etimologjia e Kokajve, Toponime, Personalitetet, Shkrime artikuj, (shënime, gojëdhena), Rreth botimit të gazetës ilegale "Ushtima e maleve", rrëfime nga odat e kokajve, dhe Foto-Galeria e Kokajve. Dhe si përfundim duke i kërkuar falje lexuesit të nderuar, për këtë shkrim ndoshta pak të zgjatur i cili nuk ka arritë të thotë të gjitha për dhe rreth "Monografisë "Shtegtim në histori" (Kokajt 1842-2012)" mundë të thuhet se ajo ka rolin e saj shumë të madh, për publikun e gjerë, e sidomos do të mbetet një dhuratë e çmuar për një vizitor të huaj i cili do të kishte një


kujtim të mirë me rastin e vizitës dhe ikjes nga Kokajt.

Pasthenie

Koka u rikthehet rrënjëve të të parëve. Bën pemën gjenealogjike, kthehet shekuj prapa, te historia e të parëve të gjakut të vet që erdhën në të shkuarën e largët nga vendbanimi Fushëdjegur prej Vlorës për tu ngulur në Dardhë (Dardhë, Matit të veriut të Shqipërisë deri në Klaiq), një ikje e detyruar, nën dhunën e pushtuesit osman, pastaj atyre serbo-bullgar për të mos dorëzuar kombin dhe fenë e tyre. Për të hedhur rrënjë të reja atje lart në Kokaj.

Kokajt, i kthehen me « këmbë në tokë » ngjarjeve të viteve 1842-2012, atje ku marrëzia kolektive e një grushti të mbetur, Klaiq, trekëndshi I Toplicës, ku shpalo ide dhe një flamur të Skenderbeut deri në një shekull e shtatëdhjetëvjet jetës se viteve të fundit, ku autori i ka bërë anatominë e fshatit të tij të lindjes, Kokaj, i cili sjell disa të vërteta të mëdha që kanë të bëjnë me historinë dhe jetën e asaj bashkësie familjare shqiptare, që është në dinamikën e ngjarjeve që trasuan në vorbullen e një lumi të trazuar kombëtar. Sjellja në kohë e lëvizjeve dhe gjeografisë së Kokës, e cila është shquar ndër vite, për rezistencën dhe shpirtin kryengritës ndaj çdo okupatori, turk, grek, serb, Italian, gjerman, bullgarë dëshmon edhe një herë tjetër për hipokrizinë dhe lojën e qarqeve të caktuara pushtuese antishqiptare të mirë-orkestruara deri më sot, që thjesht për një aneksim të dhunshëm e pushtues na kanë tragjizuar duke nëpërkëmbur dinjitetin jo vetëm të familjarëve fisnikë autoktonë të Kokajve që janë të ngulur aty nëpër viste shqiptare dhe diasporë me shekuj, por edhe të bashkëkombësve. Popujt japin e marrin me njëri-tjetrin, kryesisht fqinjët. Si komb kemi vlerësuar mikpritjen dhe jemi të vetmit që shtëpi jonë është e zotit dhe e mikut, të cilin e konsiderojmë si «perëndi». Dhe ende e ruajmë dhe e

mbrojmë me gjakun tonë. Autori në rrëfimin e tij e bëri detyrën, ashtu si bijtë tjerë të Kokajit, autori vite më parë me romanin e tij ik, «Imazh i ngrirë», Kokën e sjell në një moment e një kohë të mbarsur, për të thënë të vërtetat. Rrëfimi për të vërtetat e Kokajve i bën mirë për secilin atdhetarë dhe për çdo kokallarë. Autori edhe kësaj radhe provokon duke bërë studimin monografik: sjell ritet, zakonet, doket, lojrat, mërgimin dhe mërgimtarët, luftërat dhe luftëtarët, vende dhe ngjarje për të ngulur në mendje të të gjithëve: Kokajt në Kosovën lindore kanë qenë, dhe mbetën, dhe do të mbetet thjesht në një tokë shqiptare. Jetojnë kohë tjetër, ku që të gjithë kërkojnë që t'i atashohen me vlerat e tyre Europës, duke parë nga e ardhmja, për të lënë pas të shkuarën që na ndante. **(Editori)**



PËRMBAJTJA

1. Kokaj një vendbanim në Karadak të Shkupit.....	5
1.1. Etnia (Imazhi i Malësisë së Karadakut).....	8
1.2. Kosova lindore	14
* Kokajt me rrethinë	
2.1. Kokajt dhe Mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore	15
2.2. Presheva	
2.3. Rezistenca e armatosur e Karadakut 1941-1951	16
2.2. Kokajt ndër mote-.....	23
2.3. Shtrirja dhe hapësira tokësore^ujore	26
3.1. Moti~ Klima	27
3.2. Etimologjia e Kokajve	28
3.3. Toponminet.....	33
3.4. Personalitetet publike/krijues.....	70
3.5. Z.Halili, Rr.Rrustemi, D.Dauti, N. Rrustemi,N. Ramadani..	71
3.6. Enciklopedia e të rënëve.....	85
3.7. Idriz Rushiti Jeta dhe rënia/Familja Rushiti.....	
3.8. Hazir R.Haziri –Jeta dhe rëniaëve...	
3.9. Daut Dauti, Rufat Qazimi,Rrustem Rrustemi	
4. Shkrime artikuj, (shenime, gojëdhena).....	111
4.1. Mësuesi Mustafë Koka- jeta vepra dhe rënia.....	126
5. Arben Ramadani- Jeta e vepra pjesëmarrës i dy luftrave,..	146
6. Rreth botimit të gazetës ilegale “Ushtima e maleve”.....	153
7. Të burgosurit dhe të internuarit: <i>pas ngjarjeve të pranverës së vitit 1981 për veprimtari ilegale nga katundi Kokaj:</i>	
7.1. Të rënë/dëshmorët dhe martirët:.....	157
8. Rrëfime nga odat e kokajve.....	167
9. Foto-Galeria e Kokajve	169
10. Fejtoni për mësuesin Mustafë Koka.....	170
11. Këngë për Mustafë R.Kokën dhe për A. RAMADANI.....	178
12. Pashënia e librit	185

U shtyp: SHB “Rrjedha”, Prishtinë 2012

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

908(496.51)(092)

Ramadani, Nijazi

Shtegtim në histori : (rrëfimi për
Kokajt prej vitit 1842 deri në 2012) :
(monografi për Kokajt) / Nijazi
Ramadani. - Gjilan : Rrjedha, 2012. -
196 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

ISBN 978-9951-453-14-1

ISBN 978-9951-453-14-1

